Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI   nr. 96 / 2011

Edukata Islame
Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI   nr. 96 - 2011

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë:
Hajrullah Hoxha

Lektor:
Bislim Berisha

Korrektor:
Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**

Redaktor teknik &
Operator kompjuterik:
Nuhi Simnica

Shtyp: KOHA - Prishtinë

Tirazhi: 600

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 96 / 2011

Prishtinë
2011

EDITORIAL

Qemajl Morina

FENOMENI I QUAJTUR TARIK RAMADAN

Opinioni shqiptar ditë më parë pati rastin të njihet për së afërmi me dijetarin, mendimtarin, filozofin e predikuesin islam, me përmasa ndërkombëtare, Tarik Ramadan. Ai ishte për herë të parë në një turne në disa vende të Ballkanit, në atë që ai e quajti "ardhmëria e Evropës". Turneu i Tarik Ramadanit filloi me Bosnjën, Sanxhakun, Maqedoninë dhe përfundoi me Shqipërinë. Ajo që nga shumë orientalistë quhet "transverzalja e gjelbër", si simbol i ekzistimit historik të myslimanëve në atë pjesë të Evropës, që nga koha e Perandorisë Osmane. Kjo për dallim nga pjesa perëndimore e saj, ku myslimanët edhe pse sunduan për një periudhë të gjatë kohore afro tetë shekuj (732-1492), themeluan shtetin e fuqishëm në Andaluzi (Spanjën) e sotme, e cila ishte burim i Renesancës dhe Humanizmit Evropian. Por, pas ripushtimit të krishterë të asaj pjese të Evropës, myslimanët nën trysnitë e inkuizicionit u zhdukën, megjithatë, mbetën gjurmët e civilizimit dhe kulturës islame si dëshmi për ekzistencën e tyre.

Vërtet njeriu është para një dileme të madhe, për ta kuptuar fenomenin e mendimtarit mysliman evropian, Tarik Ramadan dhe shkaqet e interesimit për të, si dhe zhurma që bëhet rreth tij, kudo që ai shkon. Andaj, pyetja që shtrohet para nesh është, cili është roli i këtij dijetari, që kishte bërë revistën amerikane "Time" për dy herë me radhë, në vitet 2000 dhe 2004 ta radhit në mesin e njëqind personaliteteve më të rëndësishme në botë në shekullin e ri? Përse shumë dijetarë perëndimorë po e quajnë reformator i islamit, duke e emërtuar "Martin Luter i Islamit"?! Pastaj, shtrohet pyetja, çka e shtyri Qeverinë britanike në kohën e Toni Blerit ta zgjedhë këshilltar të kryeministrit, në kohën kur administrata amerikane ia ndalon hyrjen në SHBA, duke ia tërhequr vizën e punës në Universitetin katolik të "Notre Dame", me gjithë kontratën e nënshkruar për një vit.

Andaj, me të drejtë, analisti egjiptian, Husam Temam shtron pyetjen, si pati sukses ky studiues relativisht i ri ta imponojë vetveten si burim i besueshëm në çështje islame tejet të komplikuara dhe provokuese, në kohën kur në botën islame gjenden dijetarë islamë me përvojë më të gjatë dhe me veprimtari shkencore më të gjerë?

Kjo u vërejt edhe gjatë qëndrimit të tij shumë të shkurtër në Ballkan. Mediet kryesore vrapuan për të zhvilluar intervista me të duke shtruar pyetje prej më të ndryshmëve. Ajo çka zgjon interesimin te Tarik Ramadani, nuk janë mendimet e tij apo ajo çka ai thotë, por më tepër metoda e të menduarit të tij si dhe mënyra si ai shpreh atë dhe pozita nga e cila ai flet.

Rëndësia kryesore qëndron në "gjendjen" se si duhet të radhiten evropianët - Perëndimi pas tyre - qoftë duke pranuar apo refuzuar çdo gjë që ka të bëjë me lidhjet e tij me Islamin tash dhe në të ardhmen.

Rëndësia tjetër qëndron po ashtu në shumë dimensionalitetin që mund t'i bëhet leximit të mendimeve të këtij personaliteti, ku takohet mendimtari me luftëtarin, studiuesi me politikanin, në të sheh një përzierje të rrënjëve të tij arabe me personalitetin perëndimor. Tek ai mbetet gjithnjë fuqia për ruajtjen e kufirit apo kalimin e urës nga Islami politik në anën pas tij.

Rëndësia e tij së fundi qëndron në atë, se ai është prej të rrallëve që mundi të bashkojë në mes dy faktorëve kryesorë: faktorit arab duke i shtuar atë islam. Kjo është ajo që e dalloi atë prej mendimtarëve tjerë myslimanë që jetuan në Perëndim (Zeki Bedevi, Reshid el-Ganush

etj.), por ata vazhduan t'i përkasin botës arabe dhe islame, për atë ai ishte "myslimani perëndimor" e jo myslimani që jeton në Perëndim.

Biografia e Tarik Ramadanit thotë se, është i lindur më 26 gusht të vitit 1962. Ai është i biri i udhëheqësit të njohur të "Vëllezërve Myslimanë", Seid Ramadan. Gjyshi i nënës së tij është Imam Shejh Hasan el-Bena, themelues i Lëvizjes së "Vëllezërve Myslimanë". Kurse vetë Tarik Ramadani është lindur dhe është edukuar në Zvicër, ku ishte vendosur dhe jetonte familja e tij. Baba i tij është themelues i qendrës islame në Gjenevë, në vitin 1966. Ai kishte luajtur rol vendimtar në bartjen e mendimeve të "Vëllezërve Myslimanë" dhe Lëvizjes së tyre në Evropë dhe në Perëndim.

Tarik Ramadani, tash punon profesor i historisë së islamit bashkëkohor në Universitetin e Oksfordit. Më parë kishte punuar profesor i filozofisë islame në Universitetin e Frajburgut si dhe në Fakultetin e Gjenevës në Zvicër. Ai ka një numër të konsiderueshëm të veprave. Një numër prej tyre kanë të bëjnë me ekzistencën e myslimanëve në Perëndim dhe marrëdhëniet e Islamit me Perëndimin. Po ashtu edhe me çështjet bashkëkohore dhe laicizmin. Prej veprave të tij më të njohura janë "Si të jesh mysliman evropian?", "Myslimanët e Perëndimit dhe ardhmëria e Islamit", "Islami dhe Perëndimi, sfidat e modernizmit", "Myslimanët në Francë, rruga e bashkëjetesës" etj.

Tarik Ramadani flet për shumë gjëra, të cilat nuk mund t'i thonë shumë islamikë të tjerë edhe pse ata kanë të njëjtin mendim. Ai flet për diversitetin në Islam, sipas modelit dhe ambientit kulturor të veçantë, gjë që e bën atë të deklarojë për ekzistimin e "islamit evropian', të atij "afrikan", të islamit "arab" etj. Për të kaluar në një temë tjetër që ka të bëjë me "pakicat", është fjala për myslimanët që jetojnë në Evropë, sipas tij ata janë shumicë, duke u mbështetur në vlerat që ata përfaqësojnë: vlerat islame universale, të cilat në asnjë mënyrë nuk bien ndesh me vlerat esenciale evropiane. Për ta plotësuar këtë hallkë, ai shpreh admirimin dhe kënaqësinë e tij me modelin e sekularizmit evropian dhe ai nuk paraqet problem për të dhe myslimanët tjerë të Evropës. Në kohën kur ai shpreh këtë, bën ridefinimin e sekularizmit për ta rikthyer atë në esencën që atij i intereson. Ai është aspekti njerëzor dhe universal i sekularizmit. Sepse aty qëndron aspekti i lirisë fetare dhe adhurimit, duke mos hyrë në aspektin ideologjik që është kundër fesë, ashtu siç e kuptojnë dhe e propagandojnë sekularistët arabë. Nga kjo perspektivë, ai flet për domosdoshmërinë e takimit në mes vlerave islame dhe atyre sekulare, pasi ta bartë temën në terrenin e tij. Terrenin se sekularizmi në aspektin e lirisë së besimit dhe adhurimit që është identik me Islamin dhe këtu nuk ka kurrfarë problemi. Kurse sa i përket lirisë së veprimeve, sipas mendimit tij, çështja duhet t'i lihet të menduarit dhe i nënshtrohet polemikave. Këto çështje kanë të bëjnë me esencën e Islamit, me kusht të kuptohet se feja ka një rol shumë të rëndësishëm në të gjitha shoqëritë. Ashtu siç e pohojnë një numër i konsiderueshëm i protestantëve, katolikëve, çifutëve etj.

Tarik Ramdani në këtë aspekt vepron me një shkathtësi të jashtëzakonshme, sipas mendimit të kundërshtarëve të tij, pa u zhveshur nga "islamizmi" i tij apo pa kaluar së paku në modelin e sekularizmit mysliman, sipas metodës turke apo egjiptiane. Ai e di rëndësinë e dhënies së deklaratave të tilla, për shkak të të qenit të tij "islamik". Atë çka ai e pohon, ndoshta më shumë se ai e pohojnë prijës sekularë myslimanë, disa prej të cilëve jetonin në Evropë, siç ishin Nasr Ebu Zejd dhe Muhamed Arkun. Ai e paraqet veten, gjithmonë si vazhdimësi të një hallke të serisë së reformizmit dhe ripërtëritjes që nuk është ndërprerë asnjë herë në historinë e Islamit gjatë tërë historisë së tij, që nga koha e Shatibiut dhe Ebu Hmaid el-Gazlit duke përfunduar me gjyshin e tij Hasan el-Bena, përkatësinë e të cilit nuk e mohon edhe pse ai konsiderohet baba shpirtëror i të gjitha lëvizjeve të Islamit politik në shekullin fundit, botëkuptimet e të cilit janë plotësisht të kundërta.

Tarik Ramadani, apo "Vëllai i madh", është llagapi me të cilin njihet në lagjet popullore të Francës. Ai është mendimtari që di të flasë dhe i di fjalët e mendimtarëve dhe dialektin e tyre. Mirëpo, ai di se roli i tij është më i madh se një mendimtar, është më shumë se një reformator dhe simbol i një lëvizjeje popullore, në përbërje të së cilës janë gjenerata e reja të myslimanëve. Edhe pse kjo masë nuk ka ndonjë organizim hierarkik.

Tarik Ramadani është bërë pjesë e të gjitha betejave politike, të cilat po zhvillohen rreth Islamit në Evropë edhe pse ai është shumë larg marrjes me politikë në mënyrë të hapur. Ai është aktivist shoqëror dhe simbol rreth të cilit sillet një numër shumë i madh i të rinjve në tërë Evropën, ku shohin modelin, i cili iu paraqet një islam të butë e jo ashtu siç veprojnë sekularistët myslimanë, siç janë Omer Bekri dhe Abu Hmaza el-Misri, të cilët i ndan vetëm deti Lamansh.

Tarik Ramadani asnjëherë nuk ndalet nga aktivitet popullore. Ai merr pjesë në tubimet shoqërore, ku marrin pjesë me dhjetëra mijrëa të rinj të pakënaqur, të cilët kërkojnë rol dhe zgjidhje. Ai mban ligjërata në tubimet islame, duke përfshirë edhe kongresin vjetor të Unionit të Organizatave Islame të Francës. Ky tubim mbizotëron faqet kryesore të shtypit evropian. Nuk ka ndodhur, që e përditshmja franceze, Le Monde” t’i kushtojë titullin e saj kryesor ndonjë mendimtari tjetër, përveç tij. Ai është yll i debateve televizive më të nxehta, duke filluar prej emisioneve si: “100 minuta për të bindur”, të cilin e transmeton kanali nr.2 i televizionit francez, ku u ballafaqua me Nikola Sarkozin, kur ishte ministër i Punëve të Brendshme i Francës si dhe Zhan Mari Le Pain, kryetar i Ballit Kombëtar, parti e ekstremit të djathtë.

Tarik Ramadani, është “islamiku”i vetëm që mund të hapë fronte të reja, të cilat asnjëherë në të kaluarën nuk kishin qenë objekt debati tek islamikët. Kështu shohim atë se si afrohet me majtistët dhe vazhdon me bashkëmendimtarët e tij në çështje që kanë të bëjnë me drejtësinë shoqërore. Ai solidarizohet me kundërshtarët e globalizmit, duke shkuar edhe më larg sa që përpiqet që idetë e këtyre lëvizjeve t’i formulojë me shprehje islame (duke konsideruar Islamin rrugë për në jug).

Tarik Ramadani, ndoshta është i pari “islamik”, qoftë si mendimtar apo aktivist, duke hyrë në aleancë direkte mes lëvizjes “islamike” dhe “lëvizjes kundër globalizmit”, pas një aleance strategjike me shkrimtarin majtist të njohur, Alan Geriq, ish-kryeredaktor i gazetës “Le Monde” diplomat si dhe me të birin jolegjitim të Henri Korilit, një çifut, themelues i partisë Komuniste të Egjiptit.

Tarik Ramadani nuk mjaftohet vetëm me fjalë, por ai kalon në vepra duke pohuar se ardhmëria e vërtetë e lëvizjes kundër globalizmit do të jetë në bashkëpunim me Islamin.

Ai është “islamiku” që është në gjendje të hyjë në luftë me intelektualët çifutë në Francë, dhe atë betejë ta udhëheqë vetë kundër personaliteteve më të njohura dhe me ndikim në meset kulturore në Francë, pa u futur fare në metodat dhe vokabularin tradicional islamik duk e i sulmuar çifutët, i cili mund të çojë në akuzat e njohura kundër semitizmit. Por, ai pati sukses që nëpërmes retorikës njerëzore t’i çojë ata në këndin e mbrojtjes së mbylljes në vetvete dhe interesimin për interesat e komunitetit të tyre, në vend të interesimit për vlerat universale siç është drejtësia, liria dhe barazia.

Kështu pra shohim se Tarik Ramdani sulmohet nga ekstremistët myslimanë si i “dyshimtë” dhe po lëshon pe para presioneve të evropianëve, ndërkohë që sulmohet nga e djathta evropiane si njeri “i pabesë”.

Qemajl Morina

THE PHENOMENON OF TARIQ RAMADAN

(Summary)

Just recently, Albanians had the opportunity to get to learn more about the scholar, intellectual, philosopher and Islamic preacher, who is internationally renowned, Tariq Ramadan. Recently he toured a number of Balkan countries, which he called the “future of Europe”. The first stop was Bosnia, to be followed by Sandjak, Macedonia and Albania, an area which is called by many orientalists “the Green Transverse”, a symbol of the existence of Muslims in that part of Europe since the time of the Ottoman Empire (as compared to the western part of Europe in which the Muslims ruled for almost 8 centuries (732-1492), and created a powerful state in Andalusia (Spain), which was the cradle of European Renaissance and Humanism). Following the “Reconquista”, Muslims, under the pressure of the inquisition, vanished. Nonetheless, traces of Islamic culture and civilization remain as proof of their existence.

كمال مورينا

ظاهرة طارق رمضان

(خلاصة البحث)

قبل ايام أتيحت الفرصة للشعب الالبانى ليتعرف عن قرب بالعالم و الفيلسوف و الداعية الاسلامى الكبير طارق رمضان الذى كان فى جولة فى بعض دول البلقان و التى اطلق علبها "دول مسقبل اوربا". بدأت جولة طارق رمضان ببوسنا و انتهت بالبانيا . و هذه المنطقة تسمى من قبل اغلب المستشرقين الزاوية الخضراء" رمزا لتواجد المسلمين بهذه المنطقة من اوربا منذ عهد الدولة العثمانية مع الفرق بغرب اوربا حيث قام المسلمون بتأسيس دولة قوية لهم عرفت بالاندلس و استمرت قرابة ثماتية قرون (1492-732) و التى كانت ركيزة لنهضة اوربا الا انه مع استرداد المسيحيين الحكم فيها تحت ضغوط مختلفة لم يبق من السلميين الا اثارهم ...

Dr. sc. Nehat Krasniqi

BIBLIOTEKAT E PERIUDHËS OSMANE NË TROJET SHQIPTARE NË DRITËN E DORËSHKRIMEVE ARABIKE

Dihet botërisht se bibliotekat duke mbledhur e sistemuar diturinë, kurdoherë kanë qenë një lloj kujtese e njerëzimit, pa të cilën nuk do të kishte histori të racës njerëzore, ndërkaq historia nuk ka bërë sa duhet për to. Fare pak ka bërë sidomos historiografia shqiptare për ndriçimin e historisë së bibliotekave në trojet e veta etnike. Ndërsa, gjurmimi i bibliotekave të ngritura, sipas traditës orientale islame, gjithandej Shqipërisë etnike, gjatë periudhës pesëshekullore osmane, që është edhe objekt i këtij punimi, vetëm e vetëm është prekur. Edhe pse ky punim, duke ndarë për trajtim vetëm këtë lloj bibliotekash, mund të duket si reduksionist, në esencë me të është synuar të kontribuohet në ndriçimin e historisë së bibliotekave shqiptare në përgjithësi, duke u nisur nga parimi se pa njohjen e pjesëve, nuk mund të njihet tërësia dhe anasjelltas. Natyrisht, përparësi në trajtim u kemi dhënë bibliotekave të ngritura nga personalitetet shqiptarë vendës dhe këto, siç do të shofim në vazhdim, përbëjnë pjesën dërrmuese të bibliotekave të ngritura në trojet shqiptare gjatë kësaj periudhe.

Burimet parësore, që kemi shfrytëzuar për këtë punim, janë materialet bibliotekare që janë ruajtur në këto biblioteka, si dhe materialet e këtyre bibliotekave që sot ruhen të koleksionuara në biblioteka tjera, të cilat deri në ditët tona kanë ardhur si dorëshkrime. Trashëgimia dorëshkrimore me alfabet arab, e krijuar, e prurë, e përdorur dhe e koleksionuar në trojet shqiptare, gjatë periudhës osmane, paraqet një thesar kulturor historik, të paçmueshëm. Këto dorëshkrime duke qenë materiale bibliotekare shumëvalente, përveç tjerash janë burime të rëndësishme informacioni edhe për historinë e bibliotekave tona në këto troje. Nga këto dokumente bibliotekare, burimet më relevante për historinë e ngritjes së bibliotekave dhe të institucioneve, kulturore, edukative arsimore, fetare dhe të tjera, janë *vakëfnametë*. Informacione të rëndësishme për bibliotekat, gjejmë po ashtu, edhe te shënimet për vakëfimin e dorëshkrimeve në biblioteka, si dhe te shënimet për pronarët e tyre. Prandaj, dorëshkrimet arabike janë dëshmi me interes, jo vetëm për praninë e bibliotekave të caktuara, por edhe për strukturën përmbajtësore të koleksioneve të tyre.

Mbështesë të rëndësishme, për këtë punim, gjithashtu kemi pasur rezultatet e publikuara kërkimore shkencore, të autorëve shqiptarë dhe të huaj që janë marrë me këtë çështje, si Luk Karafili alias Bardhyli[1], Gl. Elezović[2], H. Kaleshi[3], M. Mujezinović[4], I. Eren[5], I. Erünsal[6] etj.

---

[1] Bardhyli, **Historija e bibljotekave në Shqipëri**, Në: Hylli i Dritës, Shkodër, (viti 1937-1940).

[2] Gliša Elezović, **Turski spomenici u Skoplu**.-Separat iz Glasnika Skopskog naučnog društva, I/1925, sv.1-2, Skoplje, 1926; Po ai, **Tursi Spomenici**, knj. I, sv. 1. Beograd, 1940.

[3] Hasan Kaleshi, **Prve orijentalne biblioteke u jugoslovenskim zemljama**, Në: Bibliotekar, god. XIII, br. 4, Beograd, 1961; Po ai, **Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku**. Prishtinë 1972; Hasan Kaleshi & Mehmed Mehmadovski, **Tri vakufnami na Kačanikli Mehmed Paša**, Skopje, 1958.

[4] Mehmed Mujezinović, **Kolekcija orijentalnih rukopisa biblioteke Mehmed- pašine džamije u Prizrenu**, Në: Antikitete të Kosovë e Metohis. Vellimi II-III, Prishtinë,1963.

[5] Ismail Eren, **Prilozi bibliografijiobjavljenih radova o orijentalnim bibliotekama u Jugoslaviji**, Në: Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, Knjiga II-III, Sarajevo, 1974.

[6] Ismail E. Erünsal, **Türk Kütüphaneleri Tarihi. II**: Kuruluştan Tanzimat'a kadar Osmanlı vakıf kütüphaneleri, 2.baskı, Ankara, 1991. Po ai, 'Kütüphane', Në: **Islam Ansiklopedisi**, cilt 27, Ankara, 2003.

****

Me pushtimin osman të trojeve shqiptare, nga fundi i shek. XIV dhe fillimi i shek. XV filluan ndryshime rrënjësore në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të popullsisë shqiptare. Kjo popullsi, që në vitet e para të shtrirjes së pushtetit osman në këto troje, filloi të marrë fenë islame dhe të integrohet në strukturat shtetërore osmane, në ushtri, administratë, kulturë, arsim, edukim, zanate etj. Popullsia shqiptare myslimane e edukuar dhe e arsimuar brenda sistemit edukativ arsimor osman, mori pjesë në jetën kulturore, në krijimtari letrare, në ndërtimtari e arkitekturë, në art dhe në fusha tjera të veprimtarisë intelektuale të shoqërisë osmane. Ajo gjithashtu qe bartëse kryesore e ngritjes së institucioneve kulturore, edukative arsimore, fetare e të tjera, në këto troje, gjatë periudhës pesëshekullore osmane. Kështu kjo popullsi në rrjedhë të kohës huazoi, përpunoi dhe krijoi një kulturë specifike që mund të përkufizohet si kulturë shqiptare me frymë orientale islame.

Rol të veçantë dhe parësor, në rrjedhat e përgjithshme zhvillimore të kulturës shqiptare me frymë orientale islame, dhe të bibliotekave, si pjesë përbërëse e kësaj kulture, gjatë periudhës osmane, ka pasur fisnikëria shqiptare, inteligjencia dhe ylemaja, respektivisht, kleri shqiptar mysliman, të cilët përbënin shtresën drejtuese të vendit. Roli i kësaj shtrese, dhe sidomos i dyerve të mëdha të fisnikërisë shqiptare, si **Mahmutbegollët** e Pejës, **Vlorajt** e Kaninës, Vlorës e Beratit, **Asllan-pashajt** e Libohovës, Gjirokastrës e Tepelenës, **Bushatllinjtë** e Shkodrës, **Biçakçinjtë** e Elbasanit, **Hoxhollët** e Dibrës, **Kurtpashajt (**ose **Kryezitë**) e Gjakovës, **Rrotllat** e Prizrenit, **Rexheppashajt (**ose **Derallët**) e Tetovës, **Gjinollët** e Prishtinës e Gjilanit, **Bargjinollët** e Tiranës, **Toptanët** e Krujës e Tiranës, **Ngurzajt** e Beratit, **Abdurrahmanpashajt** e Peqinit, **Vrionët** e Beratit e të Fierit, **Zejnlpashajt** e Ohrit, **Alihajdarbegollët** (ose **Alltunët)** e Kavajës, **Delvinajt** e Delvinës e Kardhiqit, **Alizotajt** e Janinës, **Libohovajt** e Libohovës, Gjiraokastrës e Janinës, **Kokajt** e Delvinës, **Ali Pashë Tepelena**, **Shabanpashajt** e Gucisë, **Vërlacët** e Elbasanit, **Alipashajt** e Ulqinit, **Dragajt** e Mitrovicës, etj., ka qenë vendimtar dhe i pazëvendësue-

shëm, si në zhvillimin ekonomik të vendit, po ashtu edhe në themelimin, vakufimin, mirëmbajtjen dhe financimin e institucioneve kulturore, arsimore e fetare, përfshirë këtu edhe bibliotekat[7].

Bibliotekat në dokumentet arabike janë quajtur **kytyphane (kütüphâne),** që është një kompozitë me prejadhje arabo perse, e përbërë nga emri arab në shumës **kytyp (kütüp < ar. kutub),** që do të thotë libra, dhe emri pers **hâne,** që do të thotë shtëpi.

Gjatë periudhës së sundimit osman në trojet shqiptare, janë formuar disa lloje bibliotekash, si:

a) bibliotekat private
b) bibliotekat e xhamive
c) bibliotekat e teqeve,
d) bibliotekat e mektebeve,
e) bibliotekat e medreseve dhe
f) bibliotekat publike (ose të vakëfeve).

Bibliotekat private

Bibliotekat më të moçme të periudhës osmane në trojet shqiptare, siç rezulton edhe nga shënimet e pronësisë së dorëshkrimeve të ndryshme arabike të koleksionuara nëpër biblioteka dhe arkiva të ndryshme, kanë qenë bibliotekat private të personaliteteve nga shtresa drejtuese vendëse, si pashallarë, beglerë, myftilerë, kadilerë, myderrizë, imamë, mualimë etj. Koleksionet e ruajtura të dorëshkrimeve arabike, katalogët e tyre dhe burime tjera si biografitë e poetëve (tezkiret'uş-şuarâ), biobibliografitë dhe antologjitë e letërsisë osmane, ofrojnë të dhëna për mbi 400 poetë e shkrimtarë shqiptarë që kanë krijuar qindra vepra në të tri gjuhët e kulturës osmane, në osmanisht, persisht dhe në arabisht, e nga gjysma e dytë e shek. XVII disa prej tyre krijuan edhe në gjuhën shqipe me alfabetin arabo-osman. Të gjithë këta kishin bibliotekat e tyre, kush më të madhe e kush më të vogël.

[7] Nehat Krasniqi, **Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam në trojet shqiptare gjatë periudhës osmane**, Në: Vjetar XXXV-XXXVI, Prishtinë: Arkivi i Kosovës, 2006.

Po ashtu qindra mësimdhënës shqiptarë që punuan myderrizë në medresetë e vendit, kishin bibliotekat e tyre. Rrjedhimisht, biblioteka private në trojet shqiptare gjatë periudhës osmane ka pasur shumë, por këtu do t'i veçonim vetëm ato biblioteka që janë ruajtur si dokumente, apo siç i quajmë ndryshe materiale bibliotekare, të tyre dhe dokumente të shkruara për to.

Ndër bibliotekat më të rëndësishme private të krijuar në Shqipërinë e periudhës osmane, është ajo e familjes fisnike Vlora. Kjo familje ka dhënë me dhjetëra qeveritarë të Sanxhakut të Vlorës dhe të sanxhaqeve të tjera shqiptare. Jusuf pashë Vlora, sanxhakbej i Vlorës, gjatë viteve 1670-1682 ka qenë dashamir i madh i fjalës së shkruar dhe i librit përgjithësisht. Sipas të dhënave që jep Ekrem bej Vlora, biblioteka e tij kishte 3000 vëllime libra e dorëshkrime[8]. Pinjolli tjetër i familjes Vlora, "Dervish" Ismail Pashë Velabishti (1722-1763), sanxhakbej i Vlorës midis viteve 1750-1763[9] dhe poet, krijoi një nga bibliotekat private më të pasura të kohës në Shqipëri[10].

Rol me rëndësi në themelimin dhe pasurimin e bibliotekave në Prishtinë kanë luajtur familja e Gjinollëve, familja e Junus efendiut, ish-myftiu i Prishtinës, Hysejn haxhi Sadiku dhe personalitete të tjera, vulat e të cilëve gjenden në dorëshkrimet që kanë arritur deri në ditët tona. ....

Në koleksionet e dorëshkrimeve arabike në Kosovë, si në Koleksionin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në Arkivin e Kosovës, në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë, kemi evidencuar mbi 50 volume dorëshkrimesh të ndryshme që mbajnë faksimilin në formë vule të rrumbullakët, ku shkruan: "Min kutubi Hysejn Efendi el-Myfti bi-medineti Prishti-

8 Ekrem Vlora, **Shënime mbi historinë e myslimanizmit në Shqipëri**, në: "Jeta myslimane shqiptare", nr. 1, Detroit 1959, f. 5.

9 Ekrem Vlora, **Kalaja e Kaninës**, (Estratto dalla Rivista "Shëjzat" (Le Pleiadi), Roma, 1961, f. 42. Të dhëna për Ismail Velabishtin na sjllin edhe: Mehmet Syrejai në "**Sicil-li Osmani**", Sh. S. Frashëri në **"Kamus al-'Alam",** Myfit bej Libohova në monografinë **"Ali pashë Tepelena",** Shani Zade **"Mehmet Sadik efendi Tarihi"** etj.

10 Paraardhësit e tij deri te i ati Mahmud Pasha , sanxhakbej i Vlorës gjatë viteve 1734-1737, kanë pasur interesim për librin.

na" (Nga librat e Hysejn efendiut, myfti në qytetin e Prishtinës). Hysejn Efendi Prishtina (vd. 1830) qe dijetar, myfti, arsimtar dhe poet i shquar prishtinas i gjysmës së dytë të shek.XVIII[11].

Dëshmi materiale dhe të shkruara dokumentojnë se biblioteka private kanë pasur disa nga personalitetet e dallara të familjes fisnike të bushatllinjve të Shkodrës, si: Kara Mahmud Pashë (vd 1796), Ibrahim "Halili" Pasha (vd. 1809), Mehmed "Asaf" Pashë Shkodra (1768-1802), sundimtari i fundit bushatlinj i Pashallëkut të Shkodrës, Mustafa "Sherifi" Pashë Shkodra (1797-1860) e tj. Me rendësi të veçantë kulturore ishte biblioteka e Mehmed "Asaf " Pashës. Ajo permblidhte veprat e poetëve më të shquar persian dhe jopersian që kanë krijuar në persishte si: Urfiu, Sadiu, Hafizi, Selmani, Hasani, Enveri, Talibi, Fejziu, Saibi, Shefketi, Xhamiu, Zahiri, Hakaniu si dhe divane në osmanishte, të poetëve: Baki, Nef'i, Jahja, Fehim, Sabri, Vexhdi, Naili, Mezaki, Shehri, Xhevri, Nabi, Nedim, Nahifi, Ragib Pasha e të tjerë[12].

Në fund të shek. XVII në Shkodër është dalluar Biblioteka e Myftiut të Tabakëve[13]. Themeluesi i saj është myftiu dhe poeti shkodran Myrteza "Raxhi" Shkodra, (vd. 1718)[14]. U lind në Shkodër, në një familje arsimdashëse, që nga gjiri i saj dolën myderrizë, myftinjë e poetë të shquar, të cilët dhanë kontribut të rëndësishëm në jetën arsimore e kulturore të Shkodrës dhe më gjerë. Të paktën tri gjenerata nga kjo familje ishin poetë, "Raxhi" Shodra, i ati "Zaifi" dhe i biri "Safi"-u. Që të tre kishin emrin e njëjtë Murteza, por, pseudonime poetike të ndryshme. Sipas biobibliografit Ali Emiri, Murteza "Raxhi" Shkodra ka qenë njëri nga shkruesit, respektivisht kaligrafët më aktivë të kohës. Ai ka kopjuar shumicën e mexhmuave (përmbledhje poetike) të

11 Vitin e vdekjes së Hysejn efendi Prishtinës, të birit të haxhi Sadikut, e kemi gjetur në nishanin e varrit të tij, në vendin ku në vitin 2003 është ndërtuar objekti i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ky nishan tani gjindet i mënjanuar prapa xhamisë Alaudin në Prishtinë.

12 Ali Emiri, Vep. e cit. f. 8; Sadettin Nüz'het Ergun, Vep. e cit. f. 97.

13 Në publikimin e Shoqatës së Punonjësve të Bibliotekave të shqipërisë **Bibliotekat në Shqipëri**, Biblioteka e Myftiut të Tabakëve është prazantuar si bibliotekë e krijuar në fillim të shekullit XIX por, është cekur se mendohet që kjo bibliotekë të ketë qenë edhe më e hershme. Vep e cit. f. 6.

14 Ali Emiri, **Işkodra Vilayeti Osmanlı Şairleri**, Millet Kütüphanesi, Trh. 1190, fl. 33.

Shkodrës. Po ashtu, sipas tij, “Raxhi” Shodra ka poseduar një bibliotekë të pasur. “Në Stamboll kamë parë”, shkruan Ali Emiri, “qindra libra, në shpinën e të cilëve gjendej shkrimi, nënshkrimi dhe faksimili i këtij që po i shkruhet biografia”[15]. Bibliotekën e Myftiut të Tabakëve e pasuroi i biri i Murteza “Raxhi” Shkodrës, Murteza “Safi” Shkodra (vd. pas vitit 1775), i cili nga tradita njihet si Myrteza efendi Shoshi[16].

Burimet osmane flasin për një bibliotekë private të rëndësishme që posedonte myderrizi, myftiu dhe poeti i shquar shkodran, Ahmedi Shkodra (vd. 1737)[17]. Biografi i tij i parë Ali Emiri, kishte pasur në dorë shumë dorëshkrime nga biblioteka e Ahmedi Shkodrës, në Shkodër dhe jashtë saj[18].

Njëra nga bibliotekat private më të pasura që eshtë ruajur mjaft mirë deri sot, është biblioteka e familjes Nahi nga Gjakova. Kjo bibliotekë edhe pse ka filluar të formohet nga gjysma e dytë e shek. XIX, duke qenë pronë e një familjeje myderrizësh të Medresesë së Madhe të Gjakovës, ka koleksionuar dorëshkrime shumë të vjetra dhe të vlefshme. Trashëgimtarët e saj në vitin 2001, sipas amanetit të babait të tyre, Hasan efendi Nahit, këtë bibliotekë që numëron 852 njësi bibliografike - dorëshkrime, libra dhe revista, bashkë me raftet ia dhuruan Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Bibliotekat e xhamive

Xhamia historikisht ka luajtur rol shumë më të gjerë dhe më kompleks sesa roli i saj si faltore apo si vend ku kryhet rituali i faljes (namazit). Ajo ka qenë institucioni themelor islam, me të cilin lidhej ngushtë jeta fetare, arsimore edukative, kulturore, politike dhe shoqërore e myslimanëve qysh në fillimet e saj. Këtë rol xhamia ka vazhduar ta luajë edhe te ne, gjatë tërë periudhës së sundimit osman. Në çdo xhami ka pasur dollapë, ku janë vendosur libra, të cilët, përveç imamit, predikuesit **(hatib)** dhe ligjëruesit **(vaiz),** kanë mundur t’i lexojnë dhe t’i kopjojnë pjestarët e komunitetit që frekuentonte aty.

[15] Ali Emiri, **Işkodra Vilayeti Osmanlı Şairleri,** Millet Kütüphanesi, Trh 1190, fl. 33.
[16] Hamdi Bushati, **Shkodra Dhe Motet, Vëllimi I,** Shkodër, 1998, f. 596- 597.
[17] Ali Emiri, Vep. e cit. f. 6; Sadettin Nüz’het Ergun, Vep. e cit. f.385.
[18] Ali Emiri, Po aty.

Njëra nga bibliotekat e këtij lloji, dokumente bibliotekare të së cilës janë ruajtur deri sot, është biblioteka e Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë, e njohur edhe si xhamia e vjetër, e themeluar në kohën e Sulltan Bajazititi në vitin 1389 dhe e përfunduar në periudhën e parë të sundimit të Muratit II (1421-1451)[19]. Vepra në dorëshkrim me titullin “Sherh rahati el-kulub”, e autorit Pir Muhamed, i biri i Mustafës, i biri Halilit i biri haxi Aliut nga Prishtina, e shkruar në vitin 1559 dhe e vakëfuar nga vetë autori, në këtë xhami, në vitin 1561, është dokument i vlefshëm që dëshmon praninë e një biblioteke në Prishtinë, të paktën që nga viti 1561[20] .

Bibliotekat e teqeve

Teqetë janë institucione fetare edukative të veçanta, në të cilat dervishët dhe myhibët e një tarikati të caktuar, mblidhen për t’u njohur me idetë dhe mësimet e tesavufit (misticizmit islam), për t’u edukuar në frymën e atyre mësimeve dhe për të bërë lutjet dhe seancat e ziqrit nën drejtimin e shehit të tyre. Në teqe devishët dhe myhibët edukohen në frymën e tesavufit, sipas shpjegimeve të themeluesit (Pirit) të tarikati të caktuar.

Në trojet shqiptare, gjatë periudhës osmane, janë formuar biblioteka shumë të vlefshme në kuadër të teqeve. Ato me kohë janë bërë vatra të rëndësishme të krijimit dhe të komentimit të letërsisë së tesavufit. Në këto vatra ka lindur letërsia shqiptare e divanit dhe letërsia shqipe alhamiado. Recitimi i ilahive, nefeseve, nateve dhe elegjive ishin pjesë e pandarë në jetën e dervishëve dhe muhibëve. Kjo ka ndikuar që nga gjiri i tarikatëve të ndryshëm të dalin shumë poetë.

Nga bibliotekat e rëndësishme të teqeve, për të cilat janë ruajtur dëshmi materiale ose të shkruara deri sot, janë: Biblioteka e Teqesë

[19] **Kosova dikur e sot,** Beograd, 1973, f. 468.
[20] Sadik Mehmeti, **Dorëshkrimet Orientale në Arkivin e Kosovës,** Prishtinë, 2008, f. 123-130.

Qendrore Halveti në Prizren, Biblioteka e Teqesë së Madhe Halveti në Rahovec, Biblioteka e Teqesë së Madhe në Gjakovë, Biblioteka e Teqesë Kaderi në Prizren, Biblioteka e Teqesë bektashiane e Harabati Babait në Tetovë, Biblioteka e Teqesë së Sheh Hysejn Beratit, e shumë të tjera.

Biblioteka e Teqesë Qendrore Halveti në Prizren, e njohur edhe si Teqija e Saraçhanes, është formuar pas ngritjes së Teqesë nga Sheh Osman Baba (vd. 1752), në vitin 1713[21]. Kjo bibliotekë aktualisht ruan edhe 49 dorëshkrime, disa nga të cilat janë të kohës së formimit të saj.

Biblioteka e Teqesë së Madhe Halveti në Rahovec është formuar pas ngritjes së Teqesë nga Sheh Sylejman Baba (vd. 1771) në vitin 1732[22]. Koleksioni i dorëshkrimeve që kemi evidencuar në këtë bibliotekë, numëron 196 njësi. Në këtë koleksion ka shumë dorëshkrime që janë shkruar nga pasardhësit e Sheh Sylejman Babës, nga të cilët kanë dalë dijetarë e poetë të dëshmuar.

Bibliotekën e Teqesë së Madhe të Saadive në Gjakovë, e ka formuar shehi i parë i saj, Sylejman "Axhiz", baba nga Shkodra, pas vitit 1714 kur edhe është ndërtuar nga Murad Pasha, i biri i Adem Pashë Gjakovës, siç konfirmon vetë shehi i parë i saj, me një tarih (kronogram) në Divanin e tij[23]. Ndërsa është vakëfnuar në vitin 1732. Sheh Sylejmani duke qenë edhe vetë krijues letrar, kishte sjellë nga Stambolli një bibliotekë të pasur, e cila ka vazhduar të pasurohet edhe më tej, nga pasardhësit e tij. Për fat të keq, ajo u dogj nga një pasardhës i vonshëm i tij, pas okupimit serb të Kosovës.

Biblioteka e Teqesë Kaderi në Prizren, është ngritur nga Hasan Baba në vitin 1646 dhe konsiderohet si bibliotekë e teqesë së parë ka-

[21] Koleksioni i dorëshkrimeve të Teqes së Saraçhanes, **D.T. 24,** fl. 12.
[22] Po aty.
[23] Në kopjen e **Divanit** të Axhiza Babës që ruhet në Teqen e Sheh Banit në Gjakovë, f.118-119, është poezia epigrafike të cilën autori ia ka kushtuar ndërtuesit të Teqes së Madhe, Murad Pashës. Data e ndërtimit të saj del nga kronogrami: *"Allah gani"* i cili sipas llogaritjes ebxhedike jep vitin 1126 H. që është ekuivalent me vitin 1714 sipas erës sonë.

deri në Ballakan[24]. Edhe sot janë ruajtur një numër i vogël dorëshkrimesh të saj.

Biblioteka e Teqesë bektashiane në Tetovë, e njohur si Teqeja e Harabati Babës (Harabati Baba tekkesi) është ndërtuar aproksimativisht nga mesi i shek XVIII. Këtë bibliotekë e ka formuar babai i parë i saj Harabati Baba (vd. në vitin 1780), kurse për pasurimin dhe zhbillimin e saj, është kujdesur dera fisnike e Derallëve nga Teova, duke filluar nga Koxha Rexhep pasha. Ai në vitin 1790 e meremetoi dhe e rigjallëroi këtë objekt të vlefshëm të Tetovës.

Biblioteka halvetiane e Teqesë së Sheh Musa efendiut, është ngritur në Prizren në vitin 1575.

Bibliotekë e rëndësishme e teqeve ka qenë edhe biblioteka e Teqesë së Sheh Hasanit në Berat. Sipas gjurmuesit të parë të saj, Luk Karafili, alias Bardhyli, Në këtë bibliotekë kishte shumë dorëshkrime të vlefshme për historinë e Beratit dhe të kombit tonë, ndër to edhe dorëshkrimi (mbase Divani) shqip i Nezimit[25]. Kjo teqe, sipas burimeve osmane të kohës, në të vërtetë është Teqeja e Sheh Hysejn Beratit dhe është ngritur në vitin 1746. Vitin e ngritjes së saj e ka shënuar poeti i mirënjohur i alhamiados shqipe Nezim Berati, bashkë me një poezi kushtuar ngritjes së saj.[26]

****

Teqetë qendrore (asitane) të tarikateve të ndryshëm, në qytetet shqiptare, gjithësesi kanë pasur bibliotekat e tyre. Ato kanë qenë më të pasura me me libra, sesa teqetë varëse.

[24] Jashar Rexhepagiq, **Dervishët dhe teqetë...** Vep. cit., f. 183.
[25] Bardhyli, **Historija e bibljotekave në Shqipërië**, Në: Hylli i Dritës, Shkodër, nr. 6, qershor 1938, f. 290.
[26] Biblioteka Kombëtare në Tiranë, **An IX/10 F.** fl. 94a-94b.

Bibliotekat e mektebeve

Mektebet, ose mejtepet, siç i ka quajtur populli ynë, kanë qenë shkolla fillore. Por, bibliotekat e mejtepeve, përveç materialeve bibliotekare që u përgjigjeshin nevojave të mësimdhënësve dhe të nxënësve të tyre, kanë koleksionuar edhe materiale tjera, që përdoreshin nga inteligjencia e kohës.

Bibliotekat më të vjetra të mejtepeve, të ndërtuara në trojet shqiptare si objekte të veçanta arkitektonike, që janë dokumentuar deri tash, janë këto:

Biblioteka e mejtepit të Sinanudin Jusuf Çelebi Ohrit, të birit të Mahmud Kadiut, e ngritur në Ohër, para vitit 1491[27] ;

Biblioteka e mejtepit të Ishak Çelebiut (vd. 1512), e ngritur pranë xhamisë së tij në Manastir në vitin 1508[28];

Biblioteka e mejtepit të Suzi Prizrenit (vd. 1524), e ngritur në Prizren para vitit 1513[29];

Biblioteka e mejtepit të Mehmet Kukli-begut në Bresanë të Opojës, e ngritur para vitit 1538[30];

Biblioteka e mejtepit të Koxha Sinan pashës, e ngritur në Kaçanik para vitit 1586, e shumë të tjera.

Këto biblioteka kanë qenë të vendosura në objekte njëkatshe, kati përdhesë i të cilave ka shërbyer si shkollë, ndërsa në katin e parë janë vendosur bibliotekat.

Biblioteka e mejtepit të Halil Efendiut, në Gjakovë është njëra nga bibliotekat më të pasura, që ka ruajtur një koleksion të pasur dorëshkrimesh, një sasi e të cilave tani ruhen në BKUK. Për dallim nga të tjerat, objekti në të cilin është vendosur kjo bibliotekë është përdhesë dhe ka shërbyer edhe si faltore.Viti i saktë i ngritjes së kësaj biblio-

[27] Hasan Kaleshi, **Najstariji vakufski**…, vep. cit., f. 115.
[28] Mehmed Tevfik, **Manastir vilayeti tarihçesi, Manastir 1327 h./ 1909**, f. 40.
[29] Hasan Kaleshi, **Prve orijentalne biblioteke ...** Vep. cit, f. 282.
[30] Nehat Krasniqi, **Mehmet Kuli-begu legatori më meritor për zhvillimin ekonomik dhe kulturo-arsimor të Opojës në shek. XVI,** Në: “Penda”, nr.1, Prizren 1995, f. 13-14.

teke nuk dihet, por dihet se themeluesi i saj, Halil efendiu i biri i haxhi Muhamed efendiut nga Gjakova, ka vdekur në vitin 1774.[31]

Bibliotekat e medreseve

Çdo medrese e ngritur në trojet shqiptare gjatë periudhës osmane ka pasur bibliotekën e vet[32]. Volumet e dorëshkrimeve që përdoreshin dhe ruheshin në këto biblioteka u përkisnin jo vetëm disiplinave të ndryshme fetare, si dogmatikë (akaid), jurisprudencë islame (fikh), egzegezë kur’anore (tefsir), traditë islame (hadith), por edhe leksikografisë, filologjisë, letërsisë, matematikës, astronomisë, mjekësisë, pedagogjisë logjikës etj. Volume dorëshkrimesh të këtilla njerëzit tanë, kanë blerë nëpër qendra të mëdha kulturore të orientit islam. Një numër i konsiderueshëm e tyre, është kopjuar edhe nga studentët dhe kaligrafët vendës. Rrjedhimisht, bibliotekat e medreseve kanë vend dhe rëndrësi të veçantë në historinë e bibliotekave në Shqipërinë etnike.

Biblioteka më e vjetër e këtij lloji, e themeluar në trojet shqiptare gjatë periudhës osmsne, është ajo e Medresesë së Is’hak beut në Shkup, e ngritur rreth vitit 1411 dhe e vakëfuar në vitin 1444[33]. Kjo medrese, e njohur si Ishakija e Shkupit, ka qenë institucioni arsimor më prestigjoz në Ballkan (Rumeli). Në këtë medrese kanë dhënë mësim dijetarë të shquar të kohës, disa prej të cilëve kanë qenë vendës. Myderrizi i parë i Ishakijes së Shkupit ka qenë Shuxhaudin Iljazi, i njohur si “dijetari i Shkupit”, i cili ka vdekur në kohën e mbretërimit të sulltan Muratit II (1421-1451). Sipas të dhënave shumë me interes që ofron enciklopedisti Tashkyprylizade[34] shohim se Shuxhaudin Ilja-

[31] Kasim Dobrača, **Katalog arapskih, turskih i perzijskih rukopisa**, II, Sarajevo, 1979, f. 572.
[32] Hasan Kaleshi, **XV.asrından XVII asrın nihayetine kadar yugoslav topraklarında şark medenijeti,** Në: Çevren, Priştine, 1976, no. 9, f. 30.
[33] Vakëfnamen e Is’hak beut, e ka publikuar për her të parë Glisha Elezoviqi, në veprën e tij **Tursi Spomenici**, knj. I, sv. 1. Beograd, 1940. Me pak përmirësime e ka ribotuar edhe Hasan Kaleshi, **Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku.** Prishtinë 1972. f.89-109.
[34] Taşköprülü-zade Isāmu d-din Ebu l’hayr Ahmed Efendi, **Eş-şekāiku N-Numānîye fi ‘Ulema’i d-Devleti l-‘Osmaniye,** Istanbul, 1985, f. 108.

zi ka dhënë mësim në medresenë Ishakije të Shkupit dyzet vjet rresht, që do të thotë se kjo medrese është hapur qysh para vitit 1411. Deri në vitin 1561 në këtë institucion të lartë arsimor kanë dhënë mësim dhe kanë krijuar vepra disa dijetarë si Shuxhaudin Iljazi, Ibnu'l Muidi[35], i cili ka lënë edhe disa trajtesa të shkruara, ka vdekur dhe është varrosur në Shkup; Lutfullah Shkupjani[36], Shejda efendi Shkupi, Nihani Arnauti i Prizrenit (vd. 1519)[37], Ishak Çelebiu (vd. 1533) e të tjerë. Koleksioni fillestar që e dhuroi për këtë bibliotekë themeluesi i saj Is'hak beu, numëronte 24 volume dorëshkrimesh[38]

I biri i Ishak beut, Isa beu, para vitit 1469 formoi bibliotekën deri atëherë më të pasur në trojet shqiptare, pranë medresesë së tij në Shkup. Në këtë bibliotekë Isa beu vakëfnoi mbi 330 volume dorëshkrimesh[39]. Në vakëfnamenë e tij të protokoluar në vitin 1469 për her të parë në trojet shqiptare është përmendur bibliotekari (muhafizi-i kutub), të cilit i ka caktuar edhe pagën 2 aspra në ditë.

Në vitin 1508 Is'hak Çelebiu, i biri i Isa Fakih Manastirit, vakëfnoi një koleksion dorëshkrimesh prej 39 volumesh për bibliotekën e Medresesë së tij që ngriti në Manastir. Në dokumentin e vakëfnamesë janë shënuar edhe titujt e tyre [40].

Në shek. XVI janë ngritur biblioteka të medreseve në të gjitha qytetet shqiptare të asaj kohe. Në Prizren, Mehmed pashë Jahjapashaj ka ngritur medresenë e njohur si Medreseja e Mehmet pashës, në vitin 1573. Kjo medrese ka pasur bibliotekën nga më të pasurat në trojet shqiptare. Edhe sot janë ruajtur mbi 400 volume dorëshkrimesh, të saj, midis të cilave edhe një volum i dhuruar nga i famshmi, Koxha Sinan pasha i Topojanit të Lumës[41].

35 Po aty, f. 320.
36 Po aty, f. 364.
37 Po aty, f. 424.
38 Shih titujt e tyre te: Hasan Kaleshi, **Najtariji vakufski…,** vep. cit. f. 105 – 107.
39 Titujt e këtyre volumeve, bashkë me vakënamen e Isa beut, i ka publikur Glisha Elezoviqi, në veprën e tij të cituar, **Turski Spomenici**, f. 79-126.
40 Hasan kaleshi, **Najtariji vakufski…,** vep. cit. f. 186 – 192.
41 Mehmed Mujezinovic, **Kolekcija Orijentalnih rukopisa biblioteke Mehmed-Pasine dzamije u Prizren,** në; "Starine Kosova", br. II-III, Pristina, 1963, f. 199.

Biblioteka e Medresesë së Vjetër të Pejës (Medrese-i Atik), është ngritur nga Mehmet Beu, para vitit 1516[42].

Sipas të dhënave që na ofron Evlija Çelebiu,[43] deri në gjysmën e dytë të shek. XVII janë hapur medrese në çdo qytet, madje, edhe në disa qyteza shqiptare. Vushtrria kishte 1 medrese, Prishtina kishte disa medrese (nuk e saktëson numrin), Lezha kishte disa medrese (nuk e thotë numrin), Shkodra kishte 7 medrese, Bushati 1 medrese, Delvina 3 medrese, Gjirokastra 3 medrese, Përmeti 1 medrese, Roshniku i Beratit 1 medrese, Berati 5 medrese, Vlora 3 medrese, Kavaja 2 medrese, Peqini 3 medrese, Elbasani kishte disa medrese (nuk e thotë numrin), Struga kishte 1 medrese, Ohri 2 medrese, Resnja 2 medrese, Pogradeci 2 medrese, Starova 1 medrese etj. Sipas burimeve të tjera osmane, del se Shkupi kishte 13 medrese, Prizreni 5 medrese, Gjakova 2 medrese, Peja 2 medrese, Gjilani 1 medrese, Tirana 1 medrese, kurse Dibra kishte 10 medrese[44].

Në shekullin XVIII u ngritën medrese të reja në qendrat shqiptare. Njëra nga medresetë tona të shquara, të themeluara në dekadën e parë të shek. XVIII, është Medreseja e Madhe (Medrese-i atîk), e Gjakovës. Kjo medrese, sipas të dhënave që kemi në dispozicion, është ngritur nga pinjolli i derës fisnike të Kurtpashëve - Kryezive të Gjakovës, Murad Begu (pastaj Pasha) i biri i Adem Pashës, në vitin 1707[45]. Një numër dorëshkrimesh që i ka dhuruar kësaj biblioteke Murad Begu,

42 Jashar Rexhepagiq, **Nevoja e studimit të arsimit të lartë tek ne dhe disa sugjerime**, në "Edukata Islame", nr. 74, Prishtinë, 2004, f. 137; I njejti, **Dervishët dhe Teqetë…** Vep cit. f. 102.
43 Robert Elsie, **Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mal i Zi, Ohër**. / përkthyr nga Abdurrahim Myftiu, Tiranë: Shtëpia botuese "55", 2008.
44 Ekrem Hakkı Ayverdi, **Avrupa'da Osmanlı Mimārî Eserleri,** III cild, 3 kitab, Istanbul 1981, f. 338-346.
45 Autorë që janë marrë më parë me historikun e kësaj medreseje, kanë dhënë vite tjera të ngritjes së saj, Madzida Becirbegovic, **Prosvjetni objekti islamske arhitekture**, në: "Starine Kosova", VI-VII, Prishtina, 1972-1973, f. 90, ka dhënë vitin 1794. Vitin e ngritjes së kësaj medreseje e kemi gjetur në Divanin e Sylejman Axhiza Babës, në kopjen që ruhet në Teqenë e Sheh Banit, një fotokopje të së cilës e kam në dorë.

vetë i kishte kopjuar[46], ndërsa shumë dorëshkrime të tjera, i ka blerë dhe i ka dhuruar për bibliotekën e medresesë së tij[47].

Në Prishtinë, qysh nga koha e Sulltan Ahmedit III (1703-1730), ka punuar Medreseja e ngritur nga një pinjoll i familjes fisnike të Gjinollëve, Besharet Begu. Myderrizi i kësaj medreseje Ali Efendi Haskojliu (Hasköy në burimet osmane është quajtur Bellaçevci, tani Bardhi i Madh) në vitin 1719, për bibliotekën e kësaj medreseje ka vakëfnuar një dorëshkrim që aktualisht ruhet në Arkivin e Kosovës[48].

Në Berat në fillim të shek. XVIII, zonja Ajshe (Ajshe Kadën, e bija e Mahmud Pashës vd. 1160/1747[49]) dhe motra e Ismail Pashë Velabishtit, me bashëshortin e saj, Sali beun, ngritën dhe vakëfnuan Medresenë e Madhe të Beratit[50].

Gjatë kohës së sundimit të Mehmet pashë Bushatit (Plaku) në Sanxhakun e Shkodrës (1757-1775), ai përveç tjerash, ngriti në Shkodër institucionin e parë arsimor edukativ të lartë, të njohur si Medreseja e Qafës[51]. Edhe i biri i Mehmed Pashë Plakut, Kara Mahmud Pasha (sundoi 1775-1796), ngriti në Shkodër, pranë Pazarit të Vjetër, Medresenë e Madhe[52].

[46] Një dorëshkrim i kopjuar nga ai sot është pronë e **Bibliotekës së Gazi Husrev –Begut në Sarajevë (nr.700)**

[47] Njërin nga dorëshkrimet më të vjetra që ka sot Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, i cili mban titullin "*El- Hidaje fi Sherhi'l- Bidaje*" dhe është kopjuar në Sivas në vitin 1347, Murad begu, siç vërejmë nga shënimi i tij përsonal në kolofon, i vulosur me myhyrin e tij, e kishte blerë në Prizren, nga Jusuf efendi Prizreni, në vitin 1708. Në anën e brëndshme të kapakut të parë të këtij dorëshkrimi, është një shënim i njërit nga myderrizët e parë të Medresesë së Madhe të Gjakovës, Yvejs efendi. Ky dorëshkrim tani eshtë koleksionuar në **BKUK-Koleksioni i Dorëshkrimeve, D.A. 186**.

[48] Sadik Mehmeti, **Dorëshkrimet Orientale në Arkivin e Kosovës**, Prishtinë,2008, f. 72.

[49] Nezim Frakulla, **Divan ve mecmua-i eşâr**, B.K. në Tiranë, An IX/10 F, fl. 90 b.

[50] Ferid Duka, **Aspekte të urbanistikës dhe të arkitekturës së qytetit të Beratit gjatë shek. XVI-XVIII,** f. 55. Këtë medrese e ka vakëfuar zonja Ajshe dhe vakëfnameja ruhet në AQSH. dos. 15, fl.54; dos 10, fl.16.

[51] Hamdi Bushati, **Bushatllinjtë,** Shkodër: "Idromeno",2003, f. 87.

[52] Hamdi Bushati, **Bushatllinjtë,** Vep. Cit. f. 136.

Në Gjirokastër, më 8 janar të vitit 1767, Muhtar Aga vakëfnoi medresen e tij, të njohur si Medreseja e Muhtar Agës[53].

Mahmud pashë Rrotlla, i biri i Tahir pashës, ndërmjet viteve 1806-1831, ka ngritur një medrese në Prizren (lagjeja Bylbyldere), që njihej me emrin Medreseja e Mahmud Pashës[54].

Edhe vëllai i tij, Emin pashë Rrotlla, po ashtu ka ngritur një medrese në Prizren. Medreseja e Emin Pashës ka qenë njëra nga medresetë më të shquara të kohës. Kjo medrese është themeluar në vitin 1831, por ndërtimi i saj është përfunduar në vitin 1855, pas vdekjes së vakëfit të saj. Myderrizi i parë i kësaj medreseje ka qenë Mehmet Tahir efendiu, autor i veprës poetike historike "Menakib", autor i shumë kronogrameve, përfshirë dhe kronogramin që edhe sot është ruajtur në murin e kësaj medreseje[55].

Në Tepelenë, Ali Pashë Tepelena, në vitin 1814, ka ngritur një Medrese, një mekteb dhe një xhami[56]. Ali Pashë Tepelena edhe në fshatin Hajlak, ka ngritur një kompleks që përbëhej nga një medrese, një mekteb dhe një xhami[57].

Në Tiranë, para vitit 1825, poeti dhe myteselimi i Tiranës, Haxhi Ed'hem Beu, ka ngritur një medrese[58].

Në fillim të shek. XIX, rreth vitit 1807, u ngrit Medreseja e Vogël e Gjakovës. Myderrizi i parë i kësaj medreseje, ka qenë Tahir efendi Boshnjaku - Gjakova, i njohur edhe si shkrimtar, poet, dhe njëri nga intelektualët shqiptarë më të angazhuar me shkrime dhe veprimtari pedagogjike, në gjysmën e parë të shek. XIX[59]. Myderrizë tjerë të kësaj medreseje kanë qenë: Ali efendi Mici, Hasan efendi Shllaku, Haxhi

[53] Ekrem Hakki Ayverdi, **Vepra të Arkitekturës Osmane në Shqipëri**./ Përktheu Mehdi Gurra, Tiranë: AB- HORIZONT, 2001, f. 50.

[54] Hasan Kaleshi & Ismail Eren, **Prizrenac Mahmud-paša Rotul, njegove zadužbine i vakufnama**. Otisak iz Starina Kosova, knjiga VI-VII, Priština, 1972-1973, f. 23 -60.

[55] Nehat Krasniqi, **Kronika "Menakib"e Tahir efendiut, burim i rëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës turko-osmane**. Në: "Edukata Islame", nr. 57, Prishtinë, 1995, f. 59 - 113.

[56] Ekrem Hakki Ayverdi, **Vepra të Arkitekturës...** Vep. Cit. f. 87.

[57] Po aty, f. 88.

[58] Nehat Krasniqi, **Roli i Fisnikërisë Shqiptare...** Vep. cit. f. 220.

[59] Shih më gjërësisht për të, në: Edukata Islame. Prishtinë, 2009, nr. 88, f. 31-37.

Ali - Myrteza Luzha, Haxhi Emin efendi Hoxha, Haxhi Jusuf efendi Çarkaxhiu etj. Të gjithë këta kishin formuar bibliotekat e tyre private

Bibliotekat publike

Mbështetur në të dhënat e deritashme që kemi në dispozicion, mund të themi se biblioteka e parë, që është themeluar si institucion në vete, e ndarë nga medreseja, është biblioteka e ngritur nga Mehmet pashë Kaçaniku, i biri i Koxha Sinan pashë Topojanit, e ngritur në Shkup në vitin 1601. Ai kësaj biblioteke i dhuroi koleksionin e parë që numëronte 50 volume dorëshkrimesh[60]. Bibliotekarit i caktoi pagën dy akçe në ditë dhe e ngarkoi me detyrimin e kompensimit të çdo libri të humbur.

Biblioteka e parë publike në Shkodër u ngrit nga Mahmud pashë Bushatliu para vitit 1796[61]. Kontribut të veçantë për pasurimin dhe mirëmbajtjen e kësaj biblioteke ka dhënë edhe Mustafa Pashë Shkodra, sundimtar i fundit i Pashallëkut të Shodrës në vitet 1812-1831. Një pjesë e konsiderueshme të dorëshkrimeve të kësaj biblioteke, sot ruhen në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë dhe në Bibliotekën e qytetit në Shkodër[62].

Bibliotekën e parë publike në Prizren e ngriti mytesarrifi Said pashë Rrotlla, i biri i Tahir pashës, në vitin 1805 dhe e legalizoi me vakëfnamenë e protokoluar në gjykatën e Prizrenit në vitin 1807[63]. Bibliotekar të parë të kësaj biblioteke, Said pasha emëroi Ali Agën, për të cilin ndërtoi një dhomë të veçantë. Biblioteka, siç shihet në tekstin e vakëfnamesë, është pasuruar kryesisht nga koleksionet private të familjarëve të themeluesit, nga koleksioni i të atit, Tahir pashës, i xhaxhait të tij Rustem pashës, dhe nga koleksioni i vëllait të tij Mahmud Pasha. Pasurimi i kësaj biblioteke nga familjarët e themeluesit, ka va-

[60] Hasan Kaleshi & Mehmed Mehmedovski, **Tri vakufnami na Kačanikli Mehmed Paša**, Institut za nacionalna istorija, Skopje, 1958. f. 40 – 50.
[61] Hamdi Bushati**, Bushatllinjtë, Pajisur me shënime, ilustrime dhe një Suplement nga Nexhmi Bushati,** Shkodër: Shtëpia e Artit "Idromeno", 2003, f. 136 – 137.
[62] Hamdi Bushati, **Bushatllinjtë**, Vep. Cit. f. 136-137.
[63] Ankara, Vakıflar Genel Müdürlüğü, **Def. 581/2, sayf. 441, sır. 418.**

zhduar edhe pas vdekjes së tij. Këtë e dëshmon një dorëshkrim i dhuruar për këtë bibliotekë nga vëllai i Said Pashës, Emin pashë Rrotlla, në vitin 1839, i cili tani ruhet në Koleksionin e dorëshkrimeve të BKUK-së. Kjo bibliotekë tani funsionon si Biblioteka e Kompleksit Përkujtimor të Lidhjes Shiptare të Prizrenit.

Biblioteka e parë publike në Pejë, e emërtuar si Biblioteka e Bolla-zades është ngitur në vitin 1805/ 1806[64]. Këtë bibliotekë e ka ngritur mytesarrifi i Dukagjinit, Numan Pasha, i biri i Kahreman pashë Begollit.

Me bibliotekat e kësaj periudhe dhe me kulturën dorëshkrimore, deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur vendin e saj gjithnjë e më shumë po e zinte kultura shtypshkrimore, janë të lidhura ngushtë edhe tri veprimtari apo profesione: ai i bibliotekarit (**hafiz-i kytyb**) kalibrafistit apo bukurshkruesit (**hattat**), profesioni i dekoruesit artistik dhe i miniatruistit (**ressam**) dhe profesioni i libërlidhësit (**muxhel-lit**).

****

Bibliotekat e kësaj periudhe, sikurse edhe institucionet tjera edukative arsimore dhe fetare, janë ngritur ekskluzivisht sipas sistemit të vakufit, kryesisht nga donatorët dhe legatorët vendës, sepse administrata osmane interesohej vetëm për objektet e karakterit ushtarak dhe strategjik[65]

Trashëgimia kulturore shqiptare, e shkruar dhe e koleksionuar në bibliotekat e periudhës osmane, deri kah mesi i shek. XVII, ka ardhur në gjuhën osmane, perse dhe arabe, me alfabetin arabo-osman. Ndërkaq, si rrjedhojë e islamizimit më masiv të shqiptarëve në shek. XVIII dhe të përshpejtimit të zhvillimeve të jetës ekonomike kulturore në vend, jeta kulturore shqiptare, duke u shoqëruar me përdorim gjithnjë e më shumë të gjuhës shqipe, në fushën letrare e fetare, përparoi në dinamikë, në përmasa të shtrirjes, në sasi dhe në cilësi. Këtë e dësh-

[64] Ismail Eren, **Prilozi bibliografiji** ... Punim i cit. f. 249.
[65] Hasan Kaleshi, **Prve orientalne biblioteke ...** Punim i cit., f. 280.

mon qartë, prezenca në rritje të vazhdueshme e teksteve shqipe me alfabet arab në dokumentet bibliotekare të këtij shekulli.

Trashëgimia dorëshkrimore që është ruajtur në këto biblioteka, përmban një lëndë tejet të vlefshme për studime albanologjike. Në këtë trashëgimi gjenden të dhëna me interes, jo vetëm për autorë shqiptarë të veprave letrare dhe të fushave tjera të dijes dhe të veprimtarisë intelektuale, në gjuhën osmane, perse dhe arabe dhe shqipe, por edhe për kopjuesit e tyre, pronarët, kaligrafët, libërlidhësit, si dhe për institucionet kulturore dhe edukative-arsimore ku janë shkruar, ku janë kopjuar, apo ku janë koleksionuar ato.

Në këtë punim kemi përfshirë vetëm ato biblioteka për të cilat janë ruajtur dëshmi konkrete të pakontestueshme, qoftë nga vetë dokumentet bibliotekare që kanë ruajtur ato, ose qoftë nga burimet relevante që flasin për bibliotekat e periudhës së përkufizuar, ndërsa në kushtet aktuale të nivelit të arritjeve të përgjithshme albanologjike, si dhe të shkallës së ruajtjes së burimeve parësore dhe artefakteve, një studim shterues i kësaj teme është i pamundshëm.

Siç dihet, rrethanat historike nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar pas pavarësisë së Shqipërisë nga sundimi osman, kanë qenë tejet të disfavorshme për ruajtjen e trashëgimisë historike dhe kulturore shqiptare. Okupimi serbo-malazez i pjesës më të madhe të trojeve shqiptare, si dhe okupimi grek i Shqipërisë së jugut, gjatë Luftërave Ballkanike, u përcollën me shkatërrime dhe dëmtime të pakompensueshme të kësaj trashëgimie. Rrjedhimisht, një numër i madh bibliktekash dhe koleksionesh bibliotekare të periudhës osmane si kronika, divane, sixhile të sher’ijeve, vakufname, ixhazetname, hilafetname e të tjera, janë zhdukur. Zhdukja e tyre fatkeqësisht, ka vazhduar edhe gjatë regjimeve komuniste në Shqipëri, në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, forcat serbe kanë shkaktuar dëme të konsiderueshe edhe në trashëgiminë bibliotekare. Me gjendjen reale që ka rezultuar nga këto rrethana që u përmendën, është vështirë të krijohet një përfytyrim më real për historinë e bibliotekave të periudhës osmane në trojet shqiptare.

Nga ajo që u shtjellua më lart, si **përfundim** mund të themi:

1.) Në këtë periudhë, për herë të parë në trojet shqiptare, libri filloi të dalë jashtë institucioneve fetare dhe të komunikojë me masat e gjera të popullatës.

2.) Tipologjia e bibliotekave të kësaj periudhe, sikurse edhe tipologjia e disiplinave dhe fushave shkencore të dokumenteve që kanë ruajtur ato, ka shënuar përparim dhe zhvillim të dukshëm, krahasuar me periudhën pararendëse.

3.) Në këtë periudhë ka zënë fill tradita e ngritjes së bibliotekave publike, si institucione kulturore edukative të pavarura në trojet shqiptare.

4.) Një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve bibliotekare të kësaj periudhe, është produkt dhe rezultat i punës intelektuale të inteligjencies shqiptare, kurse një pjesë tjetër e rëndësishme e tyre, kanë qenë pronë e kësaj inteligjencie.

5.) Edhe pse këto biblioteka i kanë shërbyer kryesisht komunitetit mysliman, dëshmi të drejtëpërdrejta e të tërthorta tregojnë, se dokumente jofetare të këtyre bibliotekave janë përdorur edhe nga pjesëtarë të komuniteteve tjera fetare të Shqipërisë etnike.

6.) Historiografia shqiptare dhe albanologjia përgjithësisht, këto biblioteka sikurse edhe institucionet tjera kulturore arsimore shqiptare të periudhës osmane si mektebet, medresetë, teqetë etj., i ka lënë në margjina të interesimeve shkencore, duke i shtyrë drejt tëhuajsimit dhe duke dëmtuar kështu vetë kulturën dhe kujtesën kombëtare shqiptare.

7.) Pa ndriçimin, studimin dhe rivlerësimin e bibliotekave të kësaj periudhe, nuk mund të shkruhet historia e bibliotekave në Shqipërinë etnike.

Dr. sc. Nehat Krasniqi

OTTOMAN PERIOD LIBRARIES IN THE TERRITORIES INHABITED BY ALBANIANS

(Summary)

It is a well-known fact that libraries are the memory of mankind (by collecting and systemizing knowledge), without which there would be no history of the human race. On the other hand, historiography has done very little as regards them. Albanian historiography has done very little to shed light on the history of libraries in its ethnic territories. Furthermore, it has dealt only superficially with the issue of libraries, which were built according to Islamic (oriental) tradition throughout ethnic Albania, during the five centuries of Ottoman rule. Despite the fact that this paper, which has as its main focus this kind of libraries, may seem reductionist, in essence it aims at shedding light to the history of Albanian libraries in general based on the principle that without knowing the parts one cannot know the whole and vice versa.

نهاد كراسنيكي

المكتبات بالاراضى الالبانية فى عهد الدولة العثمانية على ضوء المخطوطات العربية

(خلاصة البحث)

من المعروف أن المكتبات عن طريق جمع وتنظيم العلوم باستمرار كانت ذاكرة للانسانية بدونها لم يكن تاريخ للجنس البشرى مع الاسف الشديد فان التاريخ لم يقم باالواجب نحوها . يمكن القول بان التاريخ الالبانى لم يفعل شيئا لالقاء الضوء على المكتبات بالاراضى الالبانية و عندما نتكلم عن المكتبات الاسلامية التى تم تأسيسها بالاراضى الالبانية فى عهد الدولة العثمانية و الذى هو محور هذه الدراسة قد تم ذكره فقط .

TEFSIR

Enes Kariq

KOMENTIMI I KUR'ANIT DHE IDEOLOGJITË E SHEKULLIT NJËZET[*]

Hyrje

Vallë! A nuk mund të bashkohen myslimanët për t'u bërë më të shkathët dhe më të guximshëm, siç janë bashkuar për këtë popujt tjerë, e me atë bashkim të vendosin edhe ata një mur mbrojtës, i cili do t'i pengonte këto vërshime shkatërruese, të cilat janë drejtuar ndaj tyre nga të gjitha anët. Me këtë qëndrim timin unë nuk kërkoj që ai që merr vendime për të gjitha punët të jetë një person, sepse kjo mund të jetë vështirë të arrihet, por deshiroj që sunduesi i të gjithë myslimanëve të jetë Kur'ani, kurse feja të jetë shembull - model i bashkimit të tyre. (Xhemaludin Afgani).[1]

Ana perëndimore e botës u bë Perëndim

Periudha e shekullit trembëdhjetë dhe katërmbëdhjetë, sipas Hixhretit - llogaritjes Islame të kohës (shekulli XIX dhe XX sipas kalendarit gregorian) në komentimet e Kur'anit si dhe në shkencat tjera

[1] Xhemaludin el-Afgani "el-A'malul-kamileh", përgatiti Muhamed Immareh, Kajro 1968.

Islame ka sjellë ndryshime të mëdha deri më atëherë të papara. Ato ndryshime, gjithsesi kanë qenë pasojë e provokimeve dhe tronditjeve të thella politike, ekonomike, ushtarake etj., në kohën e depërtimit të Përendimit në botën tradicionale Islame në epokën e njohur me emrin e përgjithshëm: "Asrul - Istimar" (Periudha e Kolonializmit).

Në periudhat e ndryshme historike, të para shekullit XIX dhe XX, bota Islame shpeshherë ka pritur dhe përcjellë tallaze filozofike dhe ushtarake nga ana e botës përendimore (p.sh. dallga filozofike në formë të helenizmit grek dhe latin ose ushtarake në formë të fushatës së kryqëzatave). Megjithatë, ato dallgë kanë qenë të përkohshme, karakteristikë e të cilave ka qenë se ato kanë ardhur nga ana perëndimore siç kemi thënë në relacion të vendit Islam (Darul-Islam). Mirëpo, nga shekulli XIX dhe XX, në skenën botërore është Përendimi, dhe se bota Islamike do të ketë punë me Perëndimin, jo më perëndimin si botë, por me Përendimin si ideologji, doktrinë, strategji, kolonialistë dhe sunduesi ushtarako-ekonomik.[2]

Ky fakt ka sendërtuar ndikim të fuqishëm në komentimin e Kur'anit. Për herë të parë komentuesve myslimanë të Kur'anit dikush tjetër, dikush që është jashtë tyre dhe botës tradicionale të tyre, u diktoi në mënyrë të rreptë, tema të panjohura deri me atëherë në komentimin e Kur'anit.

Nëse tefsiri i periudhës klasike, si Tefsir i personifikuar me emrat: et-Taberij-(vd.923) ez. Zamahsheri (v.1144) er.Razi (vd.1209) Ibn Arabi (v.1240) Ibn Kethir (vd.1373)etj, është marrë me tematizimin e

[2] Mbi ngritjën e Përendimit në krahasim me botën tradicionale Islamike kanë shkruar shumë autorë. Me këtë rast po e theksoj veprën e shkëlqyeshme të Marshallit G.S Hodgston: Rethinking World History, Cambridge University Press 1993, pastaj vepra: Muslims and the West, të cilat i redaktuan Zafar Is-hak Ansary dhe John L. Esposito,në botim të Islamik Research Institute, Islamabad dhe enter for Muslim-Christian Understanding, Georgetown University, Washington D.C, 2001. Po e veçojmë edhe orientalistin Benard Lewis i cili në librat e shumta të tij e ka përshkruar në mënyrën e vet ngritjen e Përendimit shif. p.sh. veprën e tij "Islam and the west" bot. Oxford University Press, New York 1993, si dhe veprën e tij "Muslim Discovering of Europe" Kaptinën e kësaj vepre Contact and impact e kemi përkthyer në gjuhën Boshnjake në publikimin me titull: "Ljudska prava u konstekstu islamske – zapadne debate" (Të Drejtat njërëzore në kontekst të debateve Islame-Përendimore) bot. Pravni Centar Sarajevë 1996.

përmbajtjeve dhe planeve të shenjta dhe religjioze të fjalëve Kur'a-nore, qoftë kur ka të bëjë mbi tematizmin e Porosive Kur'anore për-mes transmetimit të fjalëve të shenjta dhe veprave të Muhamedit a.s., shokëve të tij dhe gjeneratave të mëvonëshme ose që ka të bëjë me ndriçimin, komentimin dhe eksterialrizimin e teksteve të shënjta Kur'-anore lidhur me gramatikën, sintaksën, semantikën, dogmatikën juris-prondencën, filozofinë etj. Tefsiri i shek. XIX dhe XX, gjithnjë e më tepër merret me ardhjen e Përendimit si sundues në botën tradicionale Islame, dhe ardhjen e ideologjisë perëndimore në vendet myslimane, si dhe me krizën ekonomike, politike, ushtarake, administrative, insti-tucionale myslimane etj. Komentuesit klasikë të Kur'anit (p.sh. Tabe-riu Zemahsheri, er-Razi, Ibni Arabi, Ibni Kethir) në komentimet e tyre të Kur'anit kanë shpjeguar Fjalën e Zotit parimisht në përputhje me provokimet shpirtërore interne dhe personale të cilat i ka shtruar para komentatorëve në fjalë bota tradicionale Islame dhe jeta në të. Në shek. XIX e XX, me ardhjen e Perëndimt si sundimtar, ndryshmi i theksimit në tefsir është i dukshëm: Duke u marrë me përmbajtjet e shenjta Kur'anore dhe themelet e fesë Islame në Kur'an, tash, do të thotë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe në shek. XX ai nga-dalë, por sigurt, lëviz në ato lëmi dhe ato plane fetare të cilat në rend të parë merren me rregullimin e kësaj bote. Komentimi i tillë i Kur'a-nit është pasojë e faktit se intelektualët myslimanë në shek. XVIII e XIX, kanë përjetuar shok duke u bërë të vetëdijshëm se myslimanët e kanë humbur këtë botë. Tani është dashur të shpjegohet bota në një kontekst të ri, kontekst që nuk ishte primar i yni. Ndryshimin që këtu po e nënvizojmë mes komentimit klasik dhe bashkëkohor të Kur'anit, disa e quajnë komentim modern të Kur'anit, dhe vërehet që nga para-qitja e teksteve që merren me krizën shoqërore, politike, shtetërore, ekonomike, ushtarake, institucionale, dhe ekzistenciale të myslimanë-ve. Thënë shkurt, tefsiri i periudhës klasike myslimane, ka pasur krye-sisht të dy botët stabile, këtë botë dhe botën e ardhshme. Tefsiri i periudhës klasike myslimane nuk është marrë, sidomos në plan të parë me shtetin dhe shoqërinë, ngase komentuesi klasik i Kur'anit, ka jetu-ar gjatë asaj kohe kryesisht në shtet dhe shoqëri stabile. Për dallim

nga klasiku, komentuesi bashkëkohor i Kur'anit nuk e kishte stabil këtë botë, ajo për komentuesin modern të Kur'anit ishte lëkundur nga themeli. Komentuesi bashkëkohor i Kur'anit në rend të parë ishte i de-tyruar të merret me shtetin dhe shoqërinë, drejtësinë sociale, me çësh-tjen e sovrantetit me marrëdhëniet e sovranitetit hyjnor dhe njërëzor, me çështjen e pushtetit dhe organizimin politik me anët ideologjike të botës (Përendimi përballë Lindjes) me pozitën e gruas në shoqëri, emancipimin e saj, me çështje e shekullarizmit, me problemet e pra-pambeturisë dhe të përparimit, me krizën e instucioneve etj.

Derisa komentuesit klasikë të Kur'anit më tepër insistonin në mo-ral dhe shpjegonin botën shpirtërore dhe shoqërinë e botës së ardh-shme, në këtë mënyrë që për të zgjuar, ruajtur dhe shpëtuar fenë e muslimanëve, të cilët jetonin në shoqëritë stabile të Islamit tradicional dhe të kësaj bote, komentuesit bashkëkohorë e shpjegonin këtë botë, dhe angazhoheshin për të shpëtuar nga të gjitha krizat, kështu që në rend të parë për ta shpëtuar besimin dhe fenë e myslimanëve e me atë edhe identitetin kulturor e fetar dhe dinjitetin e tyre në këtë botë. Thë-në shkurtimisht nga fundi i shekullit XIX zënë fill:

a) Tefsiri politik (et-Tefsirus-Siyasijj)
b) Tefsiri shoqëror (et-Tefsirul-ixhtimaijj)
c) Tefsiri tematik (et-Tefsirul-Mevduijj)
d) Tefsiri ideologjik (et-Tefsirul-Medhhebijj)

Kurse me kalimin e kohës këtyre tefsireve do t'u bashkangjitet edhe:

e) Tefsiri shkencor (et-Tefsirul-ilmijj) përkatësisht komentimi shke-ncor i Kur'anit.

Natyrisht këto pesë lloje tefsiresh bashkohorë janë kryesore, e ku-rrsesi nuk janë llojet e vetme të cilat i ka lindur takimi i Përendimit dhe botës tradicionale Islame. Tefsiri bashkëkohor, në realitet mund të na shërbejë si literaturë e shkëlqyeshme për të kuptuar deri në çfarë mase Përendimi dhe botëkuptimi i tij "kanë ndryshuar fotografinë e gjakut" të komentuesve myslimanë të Kur'anit.

Si të definohet e kaluara kreative

Kur Përendimini në fund të shek. XIX dhe në fillim shek. XX politikisht dhe ekonomikisht e mundi botën tradicionale Islame, mendimtarët myslimanë, duke pyetur se ç'ka ndodhur në realitet, u përpoqën së pari të përgjigjen në pyetjet vijuese:

Cila është veprimtaria jonë e kaluar? Si shpjegohet ajo e kaluar në mënyrë efikase? Cili është kuptimi praktik në studimin e të ashtuquajturës "e kaluara e lavdishme dhe triumfale" e Islamit dhe myslimanëve?

Këto pyetje dëshmojnë së paku, për dy gjëra:

E para, depërtimi i Përendimit i ka detyruar myslimanët për t'u marrë me të kaluarën e tyre dhe të pyesin: "Nëse e kaluara e jonë ka qenë e drejtë e besojmë se po, atëherë qysh Përendimi e mbizotëroi botën Islame, të kultivuar në të kaluarën e tillë të lavdishme".

E dyta, marrja me të kaluarën i ka bindur myslimanët se tradita Islame në mënyrë kulturore dhe shpirtërore ka mbetur e gjallë përkundër humbjeve ekonomike dhe politike që ua ka shkaktuar Përendimi shoqërive myslimane. Pra, rezistenca intensive e myslimanëve, megjithatë gjatë shekullit XIX e XX përballë paraqitjes së përgjithshme të Përendimit, i ka pasur rrënjët e veta, në rend të parë, në fenë myslimane si kulturë dhe frymëzim i gjallë. Shumë mendimtarë myslimanë, duke shtruar pyetje në formë: "Çka duhet bërë, kanë shkruar vepra të çmueshme, të cilat sot i konsiderojmë materiale dhe teori të Islamit bashkëkohor (madje në shumë raste edhe moderne) dhe të komentimit bashkëkohor të Kur'anit. Ato vepra njëkohësisht janë tregues të çmueshëm se në çfarë mënyre intelektualët myslimanë janë përballuar me ideologjitë e shekullit XX. Një numër i mendimtarëve islamë me mendimet e tyre teorike kanë sendërtuar shëtitje të çmueshme ideore dhe interpretuese në të kaluarën myslimane. Kështu që kanë zënë fill vepra të shumta të shkruara në përputhje me "metodologjinë" (al-Awdah) - "e kthimit në të kaluarën e lavdishme të myslimanëve", me qëllim

për të ardhur deri te teoria dhe mësimet shpëtimtare për të tanishmen e mjerë myslimane dhe të ardhmën e pasigurt të tyre.[3]

Krahas "metodologjisë së kthimit", e cila shkonte prapa në të kaluarën, ekzistonte edhe një numër i madh i mendimtarëve të cilët e konsideronin se myslimanët para së gjithash duhet të orientohen me fytyrë kah e tashmja dhe e ardhshmja dhe aty të kërkojnë material dhe mjete të përtëritjës së tyre (Texhdid). Përtëritja civilizuese dhe institucionale e myslimanëve, mund të jetë edhe nëpërmjet Europës dhe fryteve të saj në arsim, shkencë dhe kulturë, konsiderojnë shumë autorë myslimanë. Kështu ka lindur një literaturë e çmueshme përtrirëse, e orientuar kah ardhmëria.

Termi "Reformë" (Islah) i unifikon si veprat e shkruara sipas metodës së "kthimit" ashtu veprat e shkuara sipas metodës së përtëritjes. Ata që i përmbahen metodës së "kthimit" e reformonin shoqërinë me material dhe zgjidhje nga e kaluara (triumfale e myslimanëve). Ata komentues të Kur'anit të cilët i janë përmbajtur metodologjisë së "përtëritjes" dhe reformës përpiqeshin të reformojnë dhe të përtërijnë civilizimin e shoqërisë Islame nga e tanishmja madje edhe nëse ajo pjesërisht është evropiane, përëndimore e që kjo do të thotë jomyslimane.

Në këtë trajtesë do të përmendim emrat dhe qëndrimet teorike të disa mendimtarëve myslimanë nga shekulli XIX e XX, të cilët janë marrë me çështjet e teorive shpëtimtare dhe çlirmtare. Shumica e këtyre mendimtarëve janë marrë me traditën (at-Turath) e të parëve shembullorë dhe protagonistëve klasikë të tyre (as-salef). Ndonëse në materialin Islam hasim deri te përgjigjet tejet elastike se çka është as-salef, megjithatë të gjitha përgjigjet mund të sillen në mendimin e përgjithshëm të pranuar se katër shekujt e parë të Islamit e kanë dhënë korpusin kryesor të at-Turathit ose lëndën kryesor të traditës Islame, pas të cilave qëndron vula e të parëve shembullorë. (as-salafus-salihi) Gjenerata e shokëve të Pejgamberit (as-sahabe), pastaj gjenerata që

---

[3] Veprat e Sejjid Kutbit, shpesh janë të shkruara në perputhje me metodologjinë e "Kthimit" në të kaluarën. Muhamed Reshid Rida, gjithashtu në fazën e fundit të jetës së tij intelektuale ka shkruar në përputhje me metodologjinë e "kthimit".

pason ata (at-Tabiun) dhe gjenerata që e pason drejtpërdrejt këtë gjeneratë (tebeit-tabiin), andaj këto tri gjenerata përmbajnë vetë thelbin e "Selefus-salihëve". Megjithatë, për selefus-salihun ka shumë probleme. Mund të themi nuk është e kontestueshme se shumica e myslimanëve i respektojnë gjeneratat e para shembullore të myslimanëve, por çështja është në atë se në çfarë mënyre do të mund të na ndihmojë praktika e atëhershme, neve myslimanëve të sotmë. Natyrisht, nuk duhet posaçërisht të nënvizohet se gjeneratat nga katër shekujt e parë të Islamit, nuk kanë qenë të vetëdijshëm për një status të tillë të quajtur "Es-selefus-salih" (të parët shembullorë). Një status të tillë ata do ta fitojnë veç pas shekullit të gjashtë, shtatë, madje pas edhe një mijë vjet. Për shembull në veprat e Ahmed Ibni Hanbelit (vd.855), të cilin sot e rradhitin në personalitetet qendrore të Selefit, është e pamundur të gjendet argument tekstual që ai është udhëhequr nga drejtimi ose është mbështetur në drejtimin ideor, të cilin ai do ta kishte emëruar me termin (Es-Selef)[4].

As Ibni Tejmijje (vd.1328) nxënësi i mevonshëm i Ahmed ibni Hambelit nuk e ka definuar në mënyrën gjithpërfshirëse termin "Selef" edhe pse shpesh e ka përmendur, madje nganjëherë në kuptimin e një drejtimit të vetëm të të menduarit sipas të cilit, gjeneratat e mëvonshme duhet t'i përshtatin të gjitha mendimet e tyre. Bashkëkohësi i ynë Ebu Zehre, në një libër të tij, vërteton se vetë Ibni Tejmijje në një vend e definon "ulemaus-selef" në mënyrën vijuese: "Dijetarët që i takojnë "selefit" janë ata që besojnë në Kur'an dhe për Kur'anin kanë mendim të tyre, mirëpo ata i kundërshtojnë të gjitha sektet Islame (më parë të përmendura)[5].

Me fjalë tjera sipas Ibni Tejmijje "selef" është metodë e të menduarit, përkatësisht të menduarit antisektar në Islam, e jo një grup njerëzish, i cili ka menduar me atë metodë, aq më tepër ai nuk ka qenë një medhheb i themeluar. Si do që të ketë qenë në shek. XIX e XX reformatorët, revivalistët, fondamentalistët, tradicionalistët, modernistët myslimanë të gjithë me rend, shumë shpesh kanë përmendur termin "selef" pak a shumë ngjashëm me kuptimet që janë sjellë nga ajo që "selef" shënon katër ose pesë gjenerata të myslimanëve, fjalëve, veprave dhe shembullit, të cilave duhet t'u përmbahemi. Pastaj se "selef" është një kohë dinamike, do të themi ajo kohë apo ajo periudhë e cila i ka mundësuar Islamit dalje të fuqishme në skenën botërore e deri të mendimi se termi "selef" dhe "selefijj" tregon në metodë specifike, e cila rreptësisht i përmbahet komentimit besnik të Kur'anit dhe Hadithit (sunetit) në mënyrë siç i kanë komentuar ato tekste dhe praktikën e cila kërkohet me ato tekste, gjeneratat e para myslimane.

[4] Muhamed Salih el-Marakayshi1898-1935 Tefkir Muhamed Reshid Rida min hilal Mexhel-letil-Menar.

[5] Cituar sipas Ebu Zehrës: Ibni Tejmiijeh: hajatuhu ve asruhu, arauhu ve fikhuhu bot. Darul-Fikril-arabijj Kajro.

Për mendimtarin bashkëkohor sirian El-Butij. "es-Selefus-salih" si ndonjë medhheb i definuar nuk ka qenë asnjëherë. Ajo ka qenë vetëm një periudhë e bekuar në mendimin formativ Islam, siç thotë el-Buti, e kurrsesi medhheb (drejtim ose shkollë) "Es-Selefijjetu" merhaletun zemenijjeh mubarekeh la medhhebun islamijj [6].

Afgani, Abduhu, Rida- takimi me ideologjitë perëndimore të shek. XIX e XX dhe reformat e përtëritjes nga e tanishmja

Nuk ka dyshim se definimit modern të termit "es-selef" më së tepërmi i ka kontribuar shkolla reformatore e mendimit me emrin "el-Menar", që do të thotë ndriçues. Muhamed Abduhu (1849-1905) dhe Muhamed Reshid Rida (1865-1935) e kanë definuar "es-selefus-salih" në kuptimin e mendimtarëve të lirë të hershëm në Islam, njerëzit dhe gjeneratat të cilat e kanë rrefuzuar taklidin apo imitimin e verbër dhe e kanë pranuar Ixhtihadin apo përpjekjen e konfirmuar me mend dhe logjikë që në bazë të teksteve të Kur'anit dhe traditës, në mënyrë permanente për të gjetur zgjidhjet të reja të cilat i imponon jeta.[7]

[6] Ky është nëntitull i librit: "Es-Selefijjetu" merhaletun zemenijjeh mubarekeh la medhhebun islamijj, i aut. Seid Ramadan el-Butij Damask, 1988.

[7] Shif tekstin tim: Komentimi i Gjozës i Kur'anit dhe çështja e "es-selefus-salih" bot. në: zivot i djelo Husein ef. Gjoze, Sarajevë 1998.

Shkolla në komentimin e Kur'anit me emrin "el-Menar" më se tepërmi i është dhënë, nëse jo në fushën e krijimitarisë së traditës, atëherë në atë të krijimtarisë së komentimit dhe interpretimit iluminist dhe dinamik të traditës. Mirëpo, edhe vetë komentimi dinamik i traditës në një mënyrë është krijm i traditës. Nga fletët e komentimit të Kur'anit që quhet el-Menar, ka rrjedhur metoda e leximit dinamik të Islamit dhe historisë së tij. Muhamed Abduhu dhe nxënësi i tij Muhamed Reshid Rida, bashkë me mësuesin e tyre Xhemaludin Afgani (1835-1898) kanë qenë propaganduesit më në zë dhe më të famshëm të zgjimit të myslimanëve dhe të traditës Islame.

Xhemaludin Afgani në shumë paraqitje intonime të tij të zjarrta, vërtetonte se institucionet ekzistuese myslimane janë në agoni dhe se myslimanët kanë vetëm një sundues, e ai është Kur'ani! (sultan xhemiuhum el-Kur'an). Këto fjalë të Afganit janë tejet të rëndësishme, sidomos nëse na kujtohet se ai ka vdekur në vitin 1898. Mendimi se "sulltani i të gjithë myslimanëve është Kur'ani" tregon haptas se Xhemaludin Afgani nuk e pranonte sulltanin ekzistues të atëherëshëm të Perandorisë Osmane. Gjithashtu, ky qëndrim i Afganit është tejet revolucionar dhe se nuk është në përputhje me mendimin tradicional Islam, ngase për asnjë themelues tradicional të shkollës juridike në Islam, as për Ebu Hanifen, Ahmed Ibni Hambeli, as për Shafiun dhe Malikun … nuk ka qenë karakateristike për ta shpallur qëndrimin se Kur'ani është halifi i myslimanëve.

Pra, Afgani bashkë me Abduhun dhe Ridan themeluan një traditë Islame për epokë të re, duke komentuar të kaluarën Islame në mënyrë dinamike. Duke qenë Afgani promotor i Ixhtihadit, ai në themeluesit e katër shkollave tradicionale Islame, i shihte muxhtehidët. Metoda me të cilën Afgani dhe Abduhu e lexonin historinë e gjithmbarshme Islame është e thjeshtë: Myslimanët kur kanë qenë të fuqishëm atëherë kanë qenë progresivë, e kur kanë qenë progresivë kanë qenë muxhtehidë. Kur myslimanët janë dobësuar ata kanë mbetur prapa, e kur kanë mbetur prapa, ata i ka mbizotëruar taklidi ose imitimi i verbër.!!!

Në kohën e qëndrimit të tij në Paris, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, Afgani ka zhvilluar polemika të rrepta me Ernest Renanin, filozofin francez të kulturës. "Në këtë mënyrë Afgani ua ka përkujtuar myslimanëve të tij bashkëkohorë, të parët e tyre të lavdishëm në fushën e shkencës dhe filozofisë, duke demantuar me këtë rast orientalistin franqes Renanin dhe qëndrimet e tij rreth asaj se ai (Islami) është armiku i logjikës dhe njohurive shkencore dhe se Islami është fe që refuzon dialogun me shkencën moderne[8].

Konkluzioni i Afganit thotë: Myslimanët në të kaluarën kanë arritur famë sepse kanë qenë dinamikë dhe se e kanë praktikuar ixhtihadin. Me këtë ai porosit se nëse veç duhet t'i kthehemi të kaluarës dhe të kërkojmë ndihmën e rilindjes nga e kaluara, atëherë duhet t'i kthehemi të kaluarës dinamike. Për të kaluarën e tillë, Afgani ka besuar që në realitet, ajo madje s'ka kaluar. Me një koncepcion aktiv të tillë të së kaluarës myslimane, ai ka dëshiruar të arrijë një qëllim të rëndësishëm: ndalimin e ideologjisë së orientalizmit. Kjo ideologji e Përendimit, në fillimet e saj themeluese e komentonte Lindjen Islame si një objekt të papërfunduar, i cili përfundimin e vet nuk mund të arrijë nga vetvetja, por plotësimin e vet do t'a arrijë me veprimin e Përendimit. "Ideologjia e orientalizmit sidomos në dhjetëvjetshin e parë të saj e ka arsyetuar ideologjinë e kolonializmit[9].

Me qëllim të kundërshtimit praktik të orientalizmit, në planin politik Afgani ka propozuar "Ligën Islame" të përgjithshme (el-xhamiatul-islamijjeh) me "Ligën Islame" ai mendon në organizatën politike gjithëmyslimane dhe gjithislame. Nga kjo me Afganin lidhet termi "Panislamizëm" që është përgjigje Islame ndaj kolonializmit, por edhe ndaj ideologjive dhe mësimeve, siç janë "pansllavizmi", "panturanizmi" etj. Sintagma "Liga Islame" është shpikje e Afganit, ndërsa nga komentuesit e mëvonshëm të Kur'anit gjatë shek. XX ajo do të shfrytëzohet si themel i botëkuptimit gjithislamik e panislamik për shpëtimin e botës Islame nga litargjia dhe depresioni. Afgani i ka lutur

---

[8] Muhamed Salih, el-Marakayshi, ibid. faq. 86.

[9] Shif. gjër. Edward Said, Orientalism, New York bot. Vintage Books 1978. Në gjuhën boshnjake këtë vepër e ka përkthyer Dr. Reshid Hafizoviq. bot. "svjetlost" vet. 2000, Sarajevë.

bashkëkohësit e tij myslimanë për t'u bashkuar dhe për ta mbrojtur bashkimin e tyre. Të dëgjojmë fjalët e tij:

"Vallë, a nuk mund bashkohen myslimanët për t'u bërë më të shkathët dhe më të guximshëm, siç janë bashkuar për këtë popujt tjerë dhe ta vendosin me atë bashkim, një mur mbrojtës, i cili do të pengonte këto vërshime shkatërruese, të cilat janë drejtuar ndaj tyre nga të gjitha anët. Me këtë qëndrim timin unë nuk kërkoj që ai që merr vendime për të gjitha punët të jetë një person, sepse kjo mund të jetë vështirë të realizohet, por dëshiroj që sunduesi i të gjithë myslimanëve të jetë Kur'ani, kurse feja të jetë shembull-model i bashkimit të tyre."[10]

Muhamed Abduhu kryesisht ishte nxënës i Afganit dhe gjatë shumë vitesh bashkëpuntor i tij besnik. Posaçërisht është interesant bashkëpunimi i tij në botimin e revistës "el-urvetul-vuthka". "Lidhja e pashkëputur".[11]

Ajo që Abduhu ka marrë nga Afgani është komentimi dinamik (aktiv) i burimeve Islame. Nuk ka dyshim se veprimtaria e Abduhusë në komentimin e Kur'anit "el-Menar" kryesisht është fryt edhe i ndikimit të Afganit në të.

Kur është fjala për komenitim dinamik të Kur'anit (komentimi i Kur'anit nga koha e vet e në kontekst të problemeve shoqërore, kulturore dhe civilizuese të së tanishmes, me qëllim që me komentim të tillë të Kur'anit të ndikohet në ndryshimin e gjendjes, në mënjanimin e status quos së keqe), mendoj se Muhamed Abduhu ka bërë ndikim të madh në një numër të shumtë të komentuesve ideologjikë të Kur'anit në shek. XX siç kanë qenë psh. Hasan el-Ben-na (1892-1949) Sejjid Kutb (1906-1966) etj.

Fjala kryesore, të cilën e ka thënë Muhamed Abduhu në parathënien e komentarit el-Menar, sipas mendimit tonë është:

[10] Muhamed Ikballi (1877-1937) nën ndikimin e Afganisë ka kërkua formimin e organizatës së popujve myslimanë. Në këtë mënyrë Afgani dhe Ikballi janë paraprijës të konferencës Islamike të sotit.

[11] Revista "el-urvetul-vuthka" ka dalur në fund të shek. XIX, në Paris në gjuhën arabe.

"Mund të themi se xhahiljeti-injoranca e sotit është më e madhe (më e fuqishme) sesa injoranca dhe devijuesit (nga rruga e drejtë) në kohën e Pejgamberit a.s."[12]

Kjo fjalë e Abduhusë, në realitet, do të ketë jehonë të posaçme në veprat e Sejjid Kutbit, pastaj në veprat e vëllait të tij, Muhamed Kutbit dhe në levizjen e "Ihvanul Muslimin"- Vëllezërit myslimanë. Vepra madhështore "xhahilijjetul-karnil-ishrin"- Injoranca e shekullit njëzet (nga Muhamed Kutbi) edhe me vetë titullin dëshmon për ndikimin e Abduhusë në të ashtuquajturat lëvizjet majtiste do të thotë radikale fondamentaliste të shek. XX në botën arabe dhe Islame. Ndërsa tani shtrohet pyetja: Si ka mundur Muhamed Abduhu gjithashtu të bëjë ndikim të madh në shumicën dërrmuese të mufesirëve të orientuar në mënyrë reformiste dhe përtritëse të shek. XX? Përgjigjja qëndron në sintagmën e revistës që quhet el-Menar ose (mexhel-letul-Menar). Këtë revistë e ka themeluar i famshmi Muhamed Abduhu, kurse është me rëndësi të veçantë të theksohet se Muhamed Reshid Rida në periudhën 1898-1935, ka qenë personalitet i shquar dhe gati mund të thuhet se ka qenë redaktor kryesor dhe strategu i dytë i kësaj reviste. Si të vlerësohet nga distanca e sotme revista el-Menar? Në përgjigjen e kësaj pyetje, para së gjithash duhet pasur parasysh se shkolla e mendimit el-Menar dhe tefsiri-komenti Kur'anor el-Menar, e kanë vlerën e tyre sot, para së gjithash, si dëshmi e cila gjerësisht dhe në mënyrë argumentuese dëshmon se si reformatorët dhe intelektualët e arsimuar myslimanë janë veshur, në një anë, me ideologjitë përendimore në fund të shek. XIX e në fillim të shek. XX dhe me ngjarjet e vrullshme, të cilat i ka shkaktuar Perëndimi në botën myslimane, në anën tjetër. Revista el-Menar në këtë pikëpamje në faqet e saj paraqiste konstatimet e saj dhe apelonte për zgjimin e myslimanëve dhe bashkimin e tyre. Ndërkaq, revista (shkolla e mendimit), komenti i Kur'anit el-Menar, kishte variantet e veta për shkak se koha në të cilën dilte ajo ka qenë jo e përhershme, e ndryshueshme, mund të themi edhe jostabile.

[12] Tefsirul-Menar, vëll. I, Parathënie, Kajro 1346. H.faq.27.

Ja një nga shembujt e shumtë “të paqëndrueshëm” në revistën el-Menar, dhe nga pena e M. Reshid Ridasë, më 31 tetor 1921 në tekstin: “Shenjat e Allahut për myslimanët me paraqitjen e Kemalistëve”. Muhamed Rashid Rida e lavdëron Mustafa Kemalin (Ataturkun e mëvonshëm) për shkak të fitores që e kishte korrur kundër armiqëve të tij grekë dhe se atë e quan hero të Islamit dhe shërbëtor të Islamit e të myslimanëve, i cili është ndarë nga ekstremistët e fanatizmit Turan ndër unionistët.

Megjithatë, admirimi i Reshid Ridasë, me Mustafa Kemalin ka qenë tejet i shkurtër. Kur në etapën e parë ai e kufizoi hilafetin (qeverisjën fetare) vetëm në çështje shpirtërore, dhe anuloi gjykatat e sheriatit, administratën e vakëfit, mësimin fetar në shkolla dhe posaçërisht kur e suprimoi hilafetin dhe e ndau fenë nga shteti, atëhere Reshid Rida e kuptoi qartë se Mustafa Kemali në realitet është “armik i Islamit dhe fesë”, për shkak se ai ka bërë në këto veprime të tij “mëkate” më të mëdha. Këtë ai e vërteton në revistën “el-Menar” të 4 majit 1924. Reshid Rida, madje konstaton se pushteti i lëvizjes “Turqia e Re” dhe qeveria e udhëheqësit të saj Mustafa Kemalit, është “ateiste-e pa fe” aq më tepër ajo është edhe “më e keqe për nga shtypja dhe çrregullimet, sesa mbretëria e sulltan Hamitit” Reshid Rida gjithashtu pohon se pushteti i Mustafa Kemalit po vepron në “largimin e popullit turk nga Islami”.

Nuk është ky shembull i vetëm ku nga distanca e sotme mund ta vërtetojmë “jokonsekuencën” e reformatorëve dhe përtëritësve bashkëkohorë Islam. Mirëpo, është e padrejtë që për shkak të atyre jokonsekuencave ata t’i ekspozohen kritikës. Përkundrazi, në vend se të kritikohen, larg është më e nevojshme dhe me përparësi të kuptohet tërë paqëndrueshmëria dhe lëkundjet e periudhës kohore në të cilën reformatorët islamë dhe myslimanë kanë vepruar gjatë shekullit XX. Bota e tyre tradicionale stabile ishte rrënuar, ndërsa nga Përendimi vinin ideologjitë shkatërruese dhe ushtritë-okupuese, të cilave nuk ka mund t’u gjindet përgjigjje e shpejtë dhe efikase. Prandaj, po e shqyrtojmë shkurtimisht çështjen për çka ka shkruar revista “el-Menar”? Përgjigja në këtë është me rëndësi të veçantë ngase ajo që quhet tefsir

politik në shek. XX, në realitet ka lindur në faqet e el-Menarit. Nuk ka asnjë revistë reformuese myslimane në fillim të gjysmës së shek. XX, e cila ka pasur ashtu veprim të fuqishëm dhe ndikim të mëvonshëm, siç ka pasur revista “el-Menar”.

Duke filluar nga supozimi se Abduhu edhe Rida e komentuan Kur’anin me ngjarjet e kohës se vet, revista “el-Menar” në faqet e saj ofronte kronologjinë e llojit të vet të asaj që ndodhi në fund të shek. XIX dhe gjatë katërdhjetë viteve të parë të shek. XX. Mirëpo, në mënyrë që ajo kronologji është komentuar me Kur’an, por natyrisht në el-Menar, asgjë më pak as Kur’ani vetë nuk u komentua me ato ngjarje të furishme. Vërtet, ka me qindra ngjarje politike të asaj kohe, të cilat revista e Abduhusë dhe Ridasë “el-Menar” i ka trajtuar, por në mënyrë të ofrimit të një komentimi Islam dhe kur’anor të atyre ngjarjeve. Kjo në realitet ka qenë metodë e tyre e aplikimit të komentimit të Kur’anit në kohën e tanishme dhe sugjestion se si dhe në çfarë mënyre mufessirët duhet të merren me Ixhtihad, në periudhën bashkëkohore.

Këtu nuk ka vend e aq më pak nevojë që të ritregohet përmbajtja e revistës “el-Menar”. Mëgjithatë, do t’i sjellim vetëm disa tema të cilat u botuan në faqet e saj në periudhën nga viti 1898-1935. Temat siç janë:

et-Teassub-(Eksremizmi). el-ingliz-ve kasvetuhum ales-sudanijjin (angelzët dhe mizorët e tyre ndaj sudanezëve). es-Sudan ve fransa (Sudani dhe Franca). el-Mes’eletush-Sharkijeti (Çështja Lindore). Evruba vel-Islam, (Evropa dhe Islami). Euruba vel-Islahul-Islamijj (Evropa dhe reformat islame). Fransa vel-Islam (Franca dhe Islami). el-vifakul-islamijj el-innglizij (Marrëveshja Islamo-angleze). el-vifakul-fransi el-ingiliz (Marrëveshja francezo-angleze). Fransa bil-xhezairi (Franca në Algjer). el-inglizi vel-biladul-arab (Anglia dhe tokat arabe). el-kavaninul- inglizi fil-hind (Ligjet angleze në Indi). sejjiatul-ingliz bil-istimar (keqveprimet e anglezëve në kolonializëm). Menafiul- evrubijjine ve mudarruhum (dobit e Evropianëve dhe dëmet e tyre); Thikatul-muslimin bil-evrubijjin (Shpresat e myslimanëve në evropianët); el-Hataru aled-devletil-uthmanijje minel-jehud (Rreziku i

shtetit Osman nga çifutët). el-Alemul-Islamijj vel-istimarul-evrubijj (Bota Islame dhe kolonializmi evropian). Iëtidau italia ala Tarabulus (Agresioni Italian në Tripoli-Libi). etj, kanë qenë të komentuara gjerësisht në faqet e revistës el-Menar. Gati secila nga këto tema karakterizohej me thirrjen e myslimanëve për bashkim, përkatësisht me ankesat ndaj përçarjes së myslimanëve. Për ne është me rëndësi të veçantë se el-Menar i ka përcjellë edhe luftërat ballkanike 1912-1913 siç e shohim nga artikulli el-Harbus-Sali bijjeti fil-Balkan (lufta e kryqëzatave në Ballkan). Natyrisht, revista el-Menar është brengosur për ardhmërinë e myslimanëve, andaj paraqitet teksti: Fil-Islam ve mustakbelil-muslimine (Për Islamin dhe ardhmërinë e myslimanëve). Gjithashtu kjo revistë reformiste dhe moderne është marrë edhe me Luftën e Parë Botërore dhe pasojat e saj per Botën siç e shohim nga titulli: Akibetul harbil-medenijjetil-Evrubijjeti (Pasojat e luftës qytetare Evropiane). Është interesant se revista el-Menar nuk e pranon Luftën e Parë Botërore si luftë fetare. Reshid Rida mendon se Lufta e Parë Botërore, në realitet ka qenë luftë e civilizimit, andaj në një titull qartë thotë se nuk ka të bëjë me luftë të ithtarëve të fesë por të popujve të civilizuar: (Harbul umemil-medenijjeti lel-milelid-dinjjeti). Lojrat politike të vit. 1916, për ndarjen e tokave arabe sipas diktatit të Britanisë së Madhe dhe Francës, janë përshkruar në tekstin: “It-tifaku seneh 1916 ala kismetil-biladil-arabijeti”. (Marrëveshja e vitit 1916 për copëtimin e tokave arabe).

“El-Menar” shpeshherë i ka përshkruar “dobësitë të cilat i kanë shkaktuar te myslimanët medhhebet dhe ndarjet-sektet e tyre”. (Kur sot lexojmë debatet për heqjen e medhhebeve, duhet ditur se këtë debat e ka filluar Reshid Rida dhe rrethi i shkollës selefite afër tij). Gjithashtu el-Menar ka insistuar në anashkalimin e ngatërresave dhe intrigave, të cilat “të huajt” i nxisnin në radhët e myslimanëve. Në këtë aspekt, në faqet e el-Menarit “Evropa pushtuese kolonialiste tregohet si burim kryesor i vuajtjeve të botës myslimane”. Andaj, me këtë qëllim është analizuar politika evropiane, përkatësisht: “feja, forca dhe interesi në politikën e saj”. (Ed-dinu, vel-kuwetu vel-maslehatu fisijasetil-evruba). Nga një herë komentet e el-Menar-it janë marrë

edhe me “thirrjen apo apelin e Lindjes (drejtuar) njerëzve liridashës të Perëndimit. (Nidaush-shark liahraril-garb). Në el-Menar hasim edhe në temat e përziera politike, e kritike të fuqive kolonialiste dhe në dhënien e komentimit Islam të gjitha atyre. Anglezët, si strategët kryesorë të kolonializimit, janë shumë të pranishëm në faqet e “el-Menarit”. Këtë e shohim sipas temave siç janë këto: “Kejdus-sijasetil-britanijjeh fi biladil-arabijjeh” (Intrigat e politikës britanike në botën arabe); Et-tebshir vel-mubeshshirune (Misionarizmi dhe misionarët); “El-Hataru alel-Hixhaz vel-Islam” (Rreziku për Hixhazin dhe Islamin). “eth-Thevretus-surijjeh-vel-Hukumetul-Fransijjeh (Revolucioni i Sirisë dhe Qeveria Franceze). “inajetul-ingliz, bitensiri muslimi Sudan” “(Përpjekjet e anglezëve për konvertimin në krishterim të myslimanëve të Sudanit)”.(el-hataru alel-islam bisajtaretilingliz alel-hixhaz). “(Rreziku për Islam i pushtimit anglez të Hixhazit). Natyrisht edhe çështja e Palestinës dhe instalimi sionist e kolonialist i Izraelit, gjithashtu është njëra ndër temat e gjera në revistën el-Menar. Për shembull ajo jep Fetfanë (mendimin juridik të Sheriatit) që thotë se të ndihmuarit e hebrenjve në okupimin e Palestinës është i ndaluar.

Dobësimi dhe shkatërrimi i institucioneve të halifit dhe hilafetit në shek. XX gjithashtu është temë e përpunuar në mënyrë magjistrature në faqet e el-Menarit. Redaktori i saj Reshid Rida, për këtë shkruan studimin me titull “el-hilafetu vel-Hulefaë “ (Hilafeti dhe Halifët)”, në të cilën ballafaqohen vendimet (zgjidhjet) tradicionale dhe nevojat bashkëkohore. Në këtë kuptim është shkruar edhe teksti i tij:el-hilafetu vet-turku vel-arab” (hilafeti; turqit dhe arabët). Me këtë el-Menar aludon angazhimin e gjerë me çështjet nacionale e fetare të popujve myslimanë si dhe me problemet rajonale, e mund të themi edhe me organizimin e ymetit mysliman. (këto tema më vonë, posaçërisht do të jehojnë në veprat e Sejjid Kutbit).

Nga ky shkak redaktorët e “el-Menarit” e sidomos Reshid Rida, janë përpjekur që në kontekstin e ri historik ta shpjegojnë rëndësinë e fesë dhe të shtetit, të hilafetit dhe sulltanatit (mbretërisë): (ed-dinu ve-d-devletu ves-sultanetu). Revista el-Menar shfaq simpatinë e saj ndaj institucionit të hilafetit, për shembull R. Rida nuk lejonte të mallkohet

halifi Muavi, mirëpo ka folur edhe për qëndrimin indiferent të myslimanëve ndaj çështjes së hilafetit. Ai shqyrton edhe mundësinë e ndarjes së sulltanatit nga hilafeti “infisalus - sultaneti anil - hilafeti”, andaj ka folur edhe për kongresin e gjithmbarshëm islam dhe a do të marrë vendim eventualisht ai për zgjidhjen e institucionit të hilafetit “el-Hilafetu vel-mu’temerul-islamijj”. Në artikujt në vazhdim, redaktorët e el-Menarit i ktheheshin temës: “El-islam ve usululhukmi” (islami dhe principet e pushtetit) duke ia ekspozuar kritikës së rreptë filozofin Abdurr Rrazik bashkëkohësin e tyre, i cili kishte shkruar librin me titull: “El-islamu ve usulul-hukmi” (“Islami dhe principet e pushtetit”), në të cilën pohonte se islami është fe dhe ai nuk ka koncept të gatshëm, të përhershëm për pushtet, se çfarë forme të rregullimit shtetëror do të kenë myslimanët, ajo varet nga ixhtihadi i tyre, vërteton Abdurr Raziku.

Për dallim nga komentimet politike të lartpërmendura të Kur’anit në kontekstin e shkatërrimit të modeleve tradicionale të hilafetit dhe në kontekst të realitetit mizor kolonial, të cilin redaktorët e el-Menarit e shpjegonin në Kur’an, el-Menar ka pasur edhe një sasi tema të cilat kanë folur, mund të themi për çështjet e brendshme interne të myslimanëve. Kështu që el-Menar shkruante për temat në vijim: Esbabud dafil-myslimine (shkaqet e dobësisë së myslimanëve). “Exhvibetul-Menar an ihti-lafil-medhahibi” (Përgjigjet e el-Menarit mbi divergjencat e shkollave juridike myslimane); “Mustakbelul-islam vel-muslimin” “(Ardhmëria e islamit dhe myslimanëve)”. “el islam ve hurrijjetul akideti” (Islami dhe liria e besimit) “helil-hukumetul-musrijjeti islamijjeh em la” (A është pushteti i Egjiptit islamik apo jo). “Xhehlul-muslimin ve dala-luhum” (Injoranca e myslimanëve dhe devijimi i tyre). (el-bid’u vel- Harafatu indesh-shiati) “Risitë dhe bestytnitë te shiat” “el ikrahu alel-islami bis-sejfi“ (Detyrimi në Islam me shpatë) “el-eimmetul-erbeatu ve mukal-liduhum” (Katër imamët themeluesit e shkollave juridike dhe imituesit e tyre). “El babijjeh vel Behaijjeh” (Babitë dhe Behaitë). “et Taklidu vel-Medhahibu ve xhemul-muslimin alel-kitabi ves-suneti” (imitimi medhhebët dhe bashkimi i myslimanëve në Kur’an dhe synet). “Hakikatut-Tesavvufi ve mekanuhu minesh-sher-i. (Esenca e Tesavufit dhe vendi i tij në Sheriat). “es sijasetu ve rixhalud-din fi misr” (Politika dhe njerëzit e fesë në Egjipt). “Sebebu harbil-muteferenxhetil-muslimine lil-islam (Shkaqet e luftës së myslimanëve properëndimorë kundër islamit). “Vuxhubu tebligi daveti lil-islam” (Obligimi i kumtimit të thirrjes në islam). “el-Vehabijjune vel-Hixhaz” (Vehabinjtë dhe Hixhazi). “Diajetul-mesihijjetil-kadijanijje” (Propaganda krishteno-kadijane) “Xhem’ijjetush-shubabil-muslimin” (Organizata e vëllezërve myslimanë). “a’daul-islam el-muharibune lehu fi-hadhel ahd” (Armiqtë e islamit të cilët po e luftojnë atë në këtë shekull). “Sa’juna lit-telifi bejnesh-shiati vel-vehabijjeti (Përpjekja jonë për bashkimin në mes shiave dhe vehabinjve) “Ahvalu muslimi Rusia” (Gjendja e myslimanëve të Rusisë). “es-sunnetu ve shiatu ve daruretuhum ala it-tifakihima“ (Sunitët dhe shiatë dhe domosdoshmëria e marrëveshjes së tyre).

“Eth-thevretu vel-inkilabul-ledhi ahdethehul-Kur’an fil-besheri” (Revolucioni dhe transformimi që ka nxitur Kur’ani te njerëzimi). “Xhemalul-islamil-mehxhur evil-mexhhul” (Bukuria e islamit - të braktisur apo të panjohur). “El-islam ve vethenijjetul-Hindi” (Islami dhe idhujtaria hinduse). Istitradu fi aslil-islami ve ma tare alejhi min fesadin” (Largimi nga themelet islame dhe çfarë çrregullimesh ka shkaktuar ai). “El-Islahu vet texhdidul islamijj” (Reforma dhe përtëritja islame). “Ed-dinu vel medenijjetu fish-shark” (Feja dhe qytetërimi në Lindje-Orient). “El besheru ve haxhetuhum iler-risaleh” (Njerëzimi dhe nevoja e tyre për mesazhin hyjnor-fenë). “Ed-dinu ved-devletu” (Feja dhe shteti). “Ed-dinu, tarifuhu ve gajetuh” (Feja, definicioni dhe qëllimi i saj). “Ed-dinu vel-aklu” (Feja dhe logjika). “Esh-sheriatu, vet-taibatu, vel-hakku, vel-batil” (Sheriati, natyra, e vërteta dhe e pavërteta). “El-kadau vel-kader” (Caktimi hyjnor dhe fati). “Es-sultanani ed-dinijjeti ved-dunjavijjeti” (Dy pushtete: fetare dhe i kësaj bote). ”El-havariku inden-nesara” (Bestytnitë tek krishterët). “Ed dinu fi nadhril-aklis-sahih” (Feja sipas logjikës së shëndoshë). “El-aklu, vel-kalbu, ved-din” (Mendja, zemra dhe feja). “El-imanu ve meratibul-jekini” (Besimi dhe shkallët e bindjes). “El-hurijjetu ve istiklalul-fikri” (Liria dhe pavarësimi i mendimit).

“Eddinu vel-ilhadu vel-ishtirakijjeh” (Feja, ateizmi dhe socializmi). “Faidetud-dini bish-shedaidi” (Dobitë e fesë në momentet e vështira) “es-sultanuddinij fil-islami ven-nasranijeti” (Pushteti fetar në islam dhe në krishterim”. “Diajetul-ilhadi fi misr” (Propaganda e ateizmit në Egjipt). “Nakdu esasi medhhebi darvin” (Kritika e bazave të darvinizmit). “Tatbikul-kur’ani ala medhhebi darvin“ (Aplikimi i Kur’anit në darvinizëm). “el-vuXhud velmaddetu“ Ekzistenca dhe materia”. “ettebshiru vettensir bimisr” (Misionarizmi dhe konvertimi në krishterim në Egjipt).”Butlanu tevilinnususi linadharijetil-aklijeti vel-ilmijeti” (Demantimi i komentimit të tekstit të shenjtë në përputhje me pikëpamjet logjike dhe shkencore). “el-vehabijetu ve-davetul - Menar ilesselefi“. “Vehabizmi dhe thirrja e El-Menarit në respektimin e gjeneratave të para të myslimanëve”. “zevaxhushiijj bissunijjeti“ “Martesa e shiitit me syniten). “Halunnisail-muslimati fi hadhel asr (Gjendja e grave myslimane në këtë kohë). “zevaxhul-muslimi bi gajril-muslimeti“ Martesa e myslimanit me jomyslimanen”. “Thevretul-meretil-ibahijjeti vehataruha alel-usreti“ (Rrebelemi i gruas së shfrenuar dhe rreziku-dëmi i saj për familjen) “ilmul-ahlaki ve ilmul-ixhtimai “Etika dhe sociologjia”. “ulul-emri fi zemanina” (Udhëheqësit (fetar apo shtetëror) në kohën tonë”.

Nga ky numrim kalimthi i titujve tematikë të cilët i ka trajtuar revista “el-Menar” në një periudhë të gjatë, shohim se temat e ekspanzionizmit, kolonializmit, militarizmit, europacentralizmit, darvinizmit, reformizmit, scijentizmit etj., kanë qenë tejet të pranishme në debatet e atëhershme të R. Ridasë dhe mësuesit të tij M. Abduhusë. Këto flasin se ideologjitë perëndimore të shekullit XIX dhe XX i kanë shokuar (tronditur) intelektualët myslimanë. Ata pastaj filluan të merren me këto “izme” perëndimore, kjo gjendje vazhdon edhe sot. Madhështia e R. Ridasë dhe M. Abduhusë është në atë që kanë provuar të definojnë dhe të ruajnë kriteret islame në shpjegimin e ideologjive perëndimore, dallgët e të cilave kanë arritur në botën tradicionale islame në shekullin XIX dhe XX.

Tradita të cilën e ka inicuar revista “el-Menar” në interpretimin e Islamit dhe Kur’anit në periudhën bashkëkohore është e gjerë, e pasur

dhe e shumëllojshme. Si çdo revistë fillestare, edhe “el-Menar” shumë pikëpamje të veta në interpretimin e Kur’anit dhe Islamit në kontekstin bashkëkohor i ka dhënë në mënyrë mjaft parimore dhe në moto, mund të themi, duke mos i precizuar se si është kuptimi përfundimtar i tyre. Për këtë arsye shkolla e Abduhusë dhe Ridasë, më vonë u zhvillua në të “djathtë”, të “majtë”, “të qendrës”, në “fondamentalizëm”, “radikalizëm tradicional”, “modernizëm dhe reformizëm radikal” etj. Të gjithë, më vonë, janë thirrur në revistën “el-Menar”, dhe komentimin e Kur’anit të el-Menarit por nuk janë thirrur në mënyrë të njëjtë. Për shembull shtresa e Ulemave nga universiteti i Ez-herit (Meragi, Sheltut, Abdulhalim Mahmud etj) janë thirrur në ato vende të el-Menarit, të cilat i kanë lavdëruar imamët tradicionalë, themeluesit e shkollave juridike dhe Ixhtihadin e tyre. Mirëpo, shtresa e Ylemave të Ez-herit nuk janë thirrur në kritikën e el-Menarit drejtuar Ylemave të shekullit XIX - XX dhe inercionit të tyre.

Lëvizja e myslimanëve të rinj dhe e ihvani myslimanëve (Vëllezërit myslimanë) në Egjipt, janë thirrur prapë në ato vende të el-Menarit, të cilat kanë pasur përmbajtje të kritikës radikale ndaj shtresave të Ylemave dhe institucioneve tradicionale të Ylemave të prapambetur. Kritika e Sejjid Kutbit shtresave të Ylemave, faktikisht vendlindjen e saj e ka në faqet e revistës el-Menar dhe të komentit të Kur’anit të saj. Në anën tjetër, reformistët dhe modernistët laikë (Taha Husein, Ahmet Emin, etj.) janë thirrur në pranimin e Abduhusë të “Gjërave te mira” nga Evropa, kështu që me thirrjen selektive në pretendimet e Abduhusë, kërkonin zbatimin radikal të modernizimit në Egjipt dhe në vendet myslimane në përgjithësi.

Taha Husein, Musa Salamah, Ahmed Emin dhe reformizmi radikal

Për dallim nga Afgani, Abduhu dhe Rida, shumë myslimanë të moderuar zakonisht, nuk kanë investuar mund të veçantë që e kaluara myslimane të interpretohet në mënyrë dinamike dhe efikase. Në vend të kësaj, kërkonin që e kaluara Islame, nëse nuk harrohet, bile asaj t'i jepej statusi i shkallës së dytë në hulumtimet e sëmundjeve shoqërore të myslimanëve të kohës së tanishme. Shumë janë si Ahmed Emini, Taha Husein dhe Salamah Musa, që e braktisën "Lindjen e prapambetur Islame" dhe kërkonin zbatimin e arsimit, shkencës, kulturës dhe civilizimit europian në Egjipt dhe vendet tjera arabe dhe myslimane.

Këta mendimtarë e ashpërsuan luftën mes "përparimit dhe prapambeturisë" (El-ma'reketu bejnet-tekaddumi vet-tehal-lufi) ata pa rezervë u orientuan kah progresi, ndërsa kjo në kontekst të modernizimit mysliman, gjithnjë do të thotë kthim kah Europa dhe ardhmëria. Për Taha Husein dhe ithtarët e tij Europa u bë sinonim për progres dhe përparim. Për këtë arsye Taha Husein, Salamah Musa, Ahmed Emin dhe shumë mendimtarë tjerë egjptas dhe myslimanë, të cilët kanë qenë të afërt në mendime dhe angazhim me këta tre intelektualë të lartpërmendur, në mënyrë ironike nga kundërshtarët e tyre, komentuesit panislamist të Kur'anit janë quajtur "nxënësit e perëndimizmit"[13].

Dhe me të vërtetë është vështirë të gjenden ideologë përendimorë të perëndimizimit, të cilët kanë folur me aq zell mbi nevojën e perëndimizimit të Lindjes Islame si Taha Husein, Salamah Musa dhe Ahmed Emini. Evropën ata e shikonin me krenari, e konsideronin simbol të madh të progresit dhe të përtëritjes "Remzut-tekaddumi vet-texhdidi". Andaj Salamah Musa, i krishterë egjiptas, i cili ka marrë pjesë në

[13] Shih, p.sh. komentin "el-Ma'reketu bejnet-tekaddumi vet-tehal-lufi", në revistën kuvajtase al-Muxhtema. Nr. 1463 nga 11-17.VIII viti 2001. Në këtë koment, fjala është në kritikën e ashpër kundër Taha Huseinit, Salamah Musa dhe Ahmed Eminit.

kampanjën e perëndimizimit shkruan: "Ene kafirun bish-shark, mumi-nun bil-garbi" "Unë e mohoj Lindjen, unë besoj në Perëndim".[14]

Ahmed Emini në trajtesën e tij (vahdetul-alemi) "Bashkimi i botës" ka shkruar se si bota bashkëkohore toleron vetëm një civilizim, atë europian, ngase civilizimin lindor e ka goditur shkatërrimi dhe ai po "zhduket"[15].

Taha Husein, sidomos në librin e tij "Fish-shi'ril-xhahilijj" "Poezia e kohës së injorancës" mbron qëndrimin se librat e shenjtë duhet të studiohen në përputhje me propozicionet e disiplines historike të teksteve perëndimore. P.sh. në atë libër ai thotë si vijon:

"Tevrati mund të na rrëfejë për Ibrahimin dhe Ismailin edhe Kur'ani gjithashtu na rrëfen për ta, mirëpo vetëm pse këta dy shënojnë në Tevrat dhe Kur'an nuk mjafton për të vërtetuar se ata (Ibrahimi dhe Ismaili) kanë ekzistuar historikisht"[16]

Ky qendrim i pathënë dhe i padëgjuar deri më atëherë nga myslimanët, i Taha Huseinit në dallimin e së vërtetës fetare dhe historike në mësimet e shenjta me arsye ka hasur në kritika të ashpra. Muhamed Husein me ton kritik thotë "Kelamun la jusifu bi ekal-le min en-nehu kufrun bi kutubil-lahi ve resulihi" (Këto fjalë nuk mund të konsiderohen më pak sesa mohim të librave të Zotit dhe profetëve të tij)[17].

Taha Husein, vërtet ka gjetur ithtarë të vet në mesin e nacionalistëve arabë dhe egjiptas, si profesor në universitetin e Kajros dhe ministër për kulturë, me të cilin lidhen projektet e Egjiptit për modernizimin në arsim. Taha Husien kërkoi aplikimin e programeve arsimore evropiane.

[14] Musa Salamah ka shkruar disa artikuj të intonuar në përkrahje të ardhjes së kulturës dhe civilizimit perëndimor në Lindjen Islame me titull: "el-jevm vel-gad", dhe i ka publikuar në Kajro viti 1925-27.

[15] Këtë diskutim të tij Ahmed Emini e ka botuar në revistën: "Mexhel-letur-Rabitatish-sharkijjeti" nr. 2-15, dhjetor 1928.

[16] Shih: Taha Husein: Fish-shiril-xhahilijj, bot. i Kajros.

[17] Dr. Muhamed M. Husenin: el-it-tixhahatul – vatanijeh fil-adabil-muasir. "vëll. ll. faq. 78, Kajro.

Myslimanët indo-pakistanezë dhe problemi i ideologjive perëndimore

Ahmet Khan Bahadur (1817-1898) Chiragh Ali (1844-1895) Sejjid Amir Ali (1849-1928) Mumtaz Ali, janë emrat më të njohur të intelekualëve të nënkontinetit indo-pakistanez të cilët në mënyrë teorike direkt janë pëballur me ndikimin e ideologjive perëndimore dhe janë përpjekur për të dhënë në to përgjigje reformuese dhe moderne. Mirëpo, emri i Muhamed Ikballit në veçanti është superior sipas angazhimit dhe gjerësisë si dhe sipas fuqisë me të cilën ka dhënë përgjigje islame ideologjive perëndimore. Muhamed Ikballi u lind në vitin 1877, në Sialkotë në qytetin e Pakistanit të sotëm afër kufirit me Indinë. Është shkolluar në vendlindje, ndërsa arsimin universitar e kreu në Lahore, ku studioi filozofinë pranë islamologut Britanez T.W. Arnoldit. Sipas shënimeve biografike dhe veprave për Muhamed Ikballin, ai, në vitnin 1905 udhëtoi për në Evropë, ku në studimet pasuniversitare studioi filozofinë pranë Mac Taggartit. Në Mynhen ka doktoruar në tezën: The Development of Metaphysics in Persia (zhvillimi i metafizikës në Persi). Pastaj ai banoi në Londër, ku një kohë të shkurtër studioi shkencat juridike dhe punoi në fushën e jurisprudencës dhe avokaturës. Ikballi në vitin 1908 kthehet në Lahore, ku u mor me ligjërata dhe instruksione në kolegjin shtetëror, por kohë pas kohe u mor edhe me punë juridike. Në vitin 1922 ai gradohet në kalorës (do të thotë me emrin Sir) për shkak të kontributit të tij në poezi. (Fazlu Rahman në një tekst të tij për Ikballin thotë: 60% të poezisë së tij Ikballi e ka shkruar në gjuhën persiane, kurse 40% në gjuhën urde). Nëse i përcjellim ngjarjet e rëndësishme tjera nga biografia e Ikballit duhet përmendur se në vitin 1922, ai është zgjedhur në kuvendin ligjvënës të Penxhabit, kurse në vitin 1930 ka mbajtur fjalimin e tij historik, përkatësisht ligjëratën presidenciale në përvjetorin e kuvendit të Ligës myslimane në qytetin Allahabad, ku sipas Fazlu Rahmanit ka potencuar se “viset veripërendimore të Indisë me shumicë myslimane duhet të fitojnë autonominë për të mundur myslimanët që t’i drejtojnë

çështjet e tyre sipas normave islame, ide e cila më vonë mori formën e Pakistanit”. Në këtë fjalim Ikballi kërkoi që myslimanët e botës ta formojnë Ligën e përbashkët islame. Për këtë çështje, ai me Xhemaludin Afganin janë paraprijës të kongresit gjithislam në Jerusalem, përkatësisht të organizatës së Konferencës islamike.

Gjatë viteve të mëvonshme të jetës së tij, Ikballi u sëmur dhe pas muajit prill 1936 nuk u paraqit në opinion. Vdiq më 21 prill 1938, ndërkaq varri i tij gjendet në xhaminë mbretërore në Lahore. Sot, Muhamed Ikballi mësohet së pari si poet islam, filozof islam, mendimtar bashkëkohor islam dhe mbrojtës i “mendimit dhe këndimit të çlirimit mysliman”.

Në mendimin e Ikballit, siç thotë Fazlu Rrahmani, vërehen etapat: ai ka qenë platonik, nacionalist indian dhe romansier i së kaluarës, i cili u këndoi këngë dhe himne Himalajeve, brenda mirëkuptimit shoqëror dhe dashurisë universale. Në Evropë Ikballi e zbuloi islamin në kuptimin e plotë të fjalës, ngase ishte i shokuar me përvojën e tij të standardeve të dyfishta të Evropës, të cilat e kombinonin moralin liberal dhe demokracinë në shtëpi (vend të vet) me eksploatimin kolonial në vend të huaj dhe eksploatimin kapitalist të klasës punuese madje edhe në vend të vetin”.

Ikballin e ka goditur deri në asht dobësimi i vlerave njerëzore në “kohën e makinerisë” dhe shkatërrimi “institucionit të familjes”. Mirëpo, Ikballi nuk ka shikuar në modernizmin e tij në mënyrë të njanshme. Edhe Lindja e ka anën tjetër të medaljes, e cila ia errëson fytyrën e saj. Me një rast Ikballi do të thotë se Përendimi është diçka në formë të verës me pamje të bukur, por pa shije e pa erë të mirë. Ndërsa, Lindja në formë të verës që ka shije dhe erë, por pamje të vrazhdtë. Duke parë ”siç thotë Fazlu Rrahmni, se si janë “shoqëritë lindore, posaçërisht ato myslimane në ëndërrim dhe gjumë të thellë” në këtë pikë Muhamed Ikballi zbuloi për vete islamin e vërtetë të Kur’anit dhe të Muhamedit as, islamin i cili është dinamik e jo statik. Në dinamizmin e islamit, Ikballi zbuloi impulsin kreativ, i cili e drejtoi materialin e vrazhdtë historik në rrjedhën pozitive të moralit”.

Muhamed Ikballi, në mendimin e tij filozofik, pajtohet me filozofinë dinamike, e cila është “shprehur në termat bergsoniane të filozofisë vitale ose filozofisë së jetës”. Ikballi kapet për termet siç janë khudi (personalja) pastaj ”ashk” (dashuria e absorbuar ose elani vital”. Ekzistojnë mendime se Muhamed Ikballi ka marrë motive nga filozofia vitale përendimore, me qëllim që bashkëkohësit e tij myslimanë t’i zgjojë në një dinamizëm shoqëror të llojit të vet, në një islam dinamik, të cilin pas Ikballit shumëkush do ta quajë Islam i gjallë. Siç vërteton Fazlu Rrahman: “Ndonëse Ikballi, në zhvillimin e tij të hershëm intelektual nuk ka qenë optimist ndaj zgjimit të bashkësisë islame në tërësi”, megjithatë, ai nga instrumentimi i pasur kuptimor islam përvetësoi kuptimin e Ixhtihadit, të cilit ia caktoi rolin e mjetit të zgjimit të bashkësisë (myslimanëve). Ixhtihadi sipas Ikballit, jo vetëm që është term juridik mysliman, i cili nënkupton mendimin e pavarur juridik, jo të pavarur nga Kur’ani dhe syneti i Profetit a.s. po nga modelet e klishetizuara të mendimeve të autoriteteve juridike myslimane gjatë historisë islame. Ikballi shpeshherë kapet për termin e Ixhtihadit për ta përshkruar shfrytëzimin e “mendimit të ri kreativ dhe krijues në korniza të islamit”.

Si në poezinë e Ikballit ashtu në veprën kryesore në prozë (The Reconstruction of Religious Thought in Islam) “Përtëritje e mendimit islam “(sidomos në kreun e pestë), siç vërteton Fazlu Rrahmani Ikballi është përpjekur të nxisë myslimanët në krijimin e ardhmërisë së re përmes Ixhtihadit, që tekstualisht do të thotë: angazhimi i vetvetes, vetëpërpjekje, vetëmohim”. Në këtë kuptim Ikballin e ka tërhequr mendimi, e sidomos aktiviteti përtëritës e reformues i Xhemaludin Afganisë dhe Muhamed Abduhusë. Për këtë shkak vepra “ Përtëritje e mendimit islam” mund të lexohet edhe si përgjigje e aktiviteteve politike shoqërore të Afganisë dhe Abduhusë, si dhe lekturë e kontinuitetit të veprimtarisë së tyre, madje edhe si jehonë antike e një klasiku të madh mysliman Gazalisë dhe Ihjau Ulumidinit të tij (ringjallja e diturive fetare).

Në gjurmët e poezisë islame dhe rrugët e saj, Ikballi është trashëgimtar i Xhelaludin Rumis, në filozofinë islame ai i pason Suhrave-

rdin, ibni Sina dhe ibni Miskavej. Në filozofinë e historisë islame e vazhdon mendimin e Ibni Haldunit, në teologjinë islam (Ilmul-kelam) Ikballi është pasues i mendimit të Esharisë, ndërkaq në sufizëm ai është nxënës i denjë i Gazalisë dhe Ibni Arebisë. Në mendimin e çlirimit mysliman, siç e kemi parë Ikballi së pari është student (dhe bashkëkohas i ri) i Xhelaludin Afganisë dhe Muhamed Abduhusë. Nga kjo shihet se simpatitë e tij kryesore Ikballi i ka shprehur ndaj atyre personaliteteve myslimane, të cilët i kanë dhënë impulse të mëdha Ixhtihadit.

Veprat e Muhamed Ikballit janë të shumta dhe kanë ndikim të madh në mendimin e tanishëm mysliman, e sidomos në botën e kulturës persiane dhe indo-pakistaneze. Megjithatë, kur është në pyetje Perëndimi dhe hemisfera kulturore perëndimore, Muhamed Ikballi më së tepërmi është kategorizuar si mendimtar bashkëkohor islam. Henry Corbin, në paraqitjen e Muhamed Ikballit, sheh krejtësisht një kaptinë të re të mendimit filozofik islam, faqet e së cilës hapin horizonte të reja. Aktualitetit të shumëfishtë të Muhamed Ikballit, nuk i kontribuojnë aq shumë Ikballistët e as Ikballizmi (në realitet ato gati as që ekzistojnë), por para së gjithash i kontribuojnë veprat e shumta të tij me porosi të fuqishme.

Dy poemat e mëdha të Muhamed Ikballit, njëra me titull “Shikvah” (Elegjia), dhe tjetra “Xhevab” (Përgjigje), posaçërisht janë transmetuar dhe dëgjuar me vëmendje në tërë zonën kulturore të botës myslimane të Persisë dhe Indo-Pakistanit. Në “Elegjinë” Muhamed Ikballi shpreh pikëllimin mbi gjendjen e botës islame. Në “përgjigjen hyjnore (me përshpëritje poetit Ikball)” janë paraqitur shkaqet përse myslimanët kanë arritur deri në atë gjendje të përbuzjes së thellë. Dalja nga rruga qorre është në Ixhtihad ose në interpretimin dinamik të burimeve islame. (Sejid Kutbi pas shumë viteve në veprat e tij ka folur mbi “el-fikhul-harekijj” (Mendimin dinamik).

Përveç këtyre poemave gjithashtu janë të njohura edhe veprat Asrar-i khudi (sekretet personale e bot. 1916) pastaj Rumuz-i bikhudi (simbolet porsonale) dhe Payami mashrik (mesazhet e Lindjes). Muhamed Ikballi në mesazhet e Lindjes është nën ndikimin e Gëtes (Go-

ethe), i cili ka qenë udhëheqës i tij perëndimor ashtu siç ka qenë Mevlana Xhelaludin Rrumiu, mësuesi lindor i Gëtes. (F.Rrahman).

Në të gjitha këto veprat të tij Ikballi iu drejtohet myslimanëve, të cilët dëshrojnë të zgjohen dhe të armatosën intelektualisht në ballafaqim me ideoligjitë dhe izmat perëndimore. Megjthatë, vepra më madhështore e Ikballit në gjuhën persiane, sipas mendimeve të shumta, është “Xhavid-name” (libri i Xhavidit), të cilën e shkroi në vitin 1932 dhe ia kushtoi djalit të vet “Xhavidit”. Xhavid-name flet për “një udhëtim shpirtëror të Ikballit nëpër sferat qiellore” në përcjellje të Rumisë, në të cilin, siç thotë F.Rrahman “ka diskutuar me mendimtarët dhe poetët myslimanë dhe jomyslimanë për problemet fetare, politike dhe shoqërore”. Në opusin e tij të madh poetik në gjuhën urde, fuqimisht dallohet poema “ Bal-i xhibril” (krahu i Xhibrilit”)[18].

Në poezinë e tij Muhamed Ikballi përvetësoi motive të shumta islame psh: (“Zabr-i kalim’ është ”shkopi i Musait”. Pastaj “Bang-i Dara” është “zëri i kambanës së devesë” (i cili udhëheq besimarët te karvani i Profetit a.s. që udhëtonte kah Meka si dhe xhamia e Kordovës) etj. Sipas Fazlu Rrahmanit, poezinë e Ikballit të përshkruar me sintagme islame nuk duhet komentuar si romantizëm e aq më pak si elegji për të kaluarën e lavdishme të islamit, por si zë të poetit kah

[18] Këtë vepër të Ikballit më së miri ia ka prezentuar erudicionit europian dhe në përgjithësi atij përendimor, gjermanja Annemarie Sechimmel, e cila gjithashtu që 10 vite palodhshëm është duke punuar në prezantimin e veprave të Xhelaludin Rrumis lexuesve përendimorë. Ajo me rastin e përkthimit të veprës “Krahu i xhibrilit” ka shkruar studimin madhështor në gjuhën angleze mbi idetë fetare të Sir Muhamed Ikballit (Gabriel’s Wing: A study in to the religious ideas of Sir Muhamad Iqball, Leiden 1963). Kur jemi te veprat e Ikballit dhe Annemarie Schimmel, së paku kalimthi duhet të përmendet se kjo profesoreshë e studimeve islame e ka përkthyer në gjermanisht edhe veprën e Ikballit: (“Payam-i mashrik” me titull: Beotschaft des Ostens-Wisebaden 1963). Po theksojmë edhe përkthimin e saj të Xhavid- names në gjermanisht me titull (Javid-namah, Das Buch der Ewigkeit, Myneh 1967) dhe veprën: “Muhamed Ikball, Persicher Psalter, Cologne 1968) Përveç Annemaries, veprat, mendimet dhe poezitë e Muhamed Ikballit në mënyrë shumë të suksesshme ua kanë prezantuar lexuesve përendimor: Johann Christoph Burgel, Alessandro Bausani dhe Syed Abdyl-Vahid.

islami dinamik. Poezia e Ikballit është përkthyer në anglisht, gjermanisht, holandisht, arabisht, rusisht, çekisht, italisht, spanjollisht…)[19].

Në Iran Ikballin e duan shumë dhe ai gjithnjë është më i dashur. Në fillim atë nuk e donin ngase gjuha e tij persishte nuk ka qenë mjaft klasike, mirëpo përkundër të gjthave, tashmë kemi pasur shënimin e veprave të Ikballit në Meshhed.

Arabët nuk e njohin mjaft Ikballin, në mesin e tyre janë të rrallë ata që interesohen për të. Në mesin e atyre të rrallëve që bëjnë përjashtim numërohet Shejh Ahmed Zeki Jamani. Në arabisht janë përkthyer vetëm disa vepra të tij. Më duhet të shtoj se ato vepra të Ikballit janë të ndaluara në Arabinë Saudite. Në Turqi, Ikballi është shumë i dashur, prej që është përkthyer Xhavid namja e tij kemi disa përkthime. Në Indonezi dhe Indi, natyrisht Ikballi është poet shumë i popullarizuar dhe i njohur.

Me veprat e tij Ikballi ka frymëzuar një numër të madh të reformatorëve arabë, Turq, dhe Indo-Pakistanz myslimanë[20].

[19] Me siguri edhe vet mendimi dhe poezia e Ikballit ka kontribuar shumë që ai sot me përkushtim të lexohet. Me rastin e takimit dhe bisedës time me Annemarie Schimmel në Kajro në prill në vitin 1996, ajo ka përmendur lexime dhe komentime të ndryshme të veprave të Ikballit në vet Pakistanin duke thënë: ”Në Pakistan atë e duan dhe për të thonë se ai është i dyti pas vet Kur’anit, aq e ngritin lart! Atje unë shkoj sa herë që janë përvjetorët e Ikballit. Ta dini se në ditët e ceremonive për Ikballin kam vërejtur duke interpretuar at në shumë mënyra kështu që në çdo vjet keni një interpretim tjetër sipas klimës politike në vet Pakistanin. Në një vit ai trajtohet poet antiperëndimor, në vitin e dytë propërendimore, në vitin e tretë si poet mistik të sufizmit, në vitin e katërt Ikballi konsiderohet si poet antisufistë!... (Intervista me Annemarie Schimmel është bot. në “Ljiljan” maj 1996 Sarajevë, si dhe në librin; ”Ljudska Prava u kontekstu Islamsko-zapadne debate” Pravni centar 1996 Sarajevë.

[20] Aspektet Mongole të mendimit dhe të këndimit Ikballian kanë përjetuar një elaborim shumë të pasur. Kështuqë në veprën e Muhamed Munavverit “Iqbal and Quranic Wisdom Delhi 1987” hasim në kaptina të tipit: ”Ikballi dhe ideja e Takdirit - fatit, ikballi për kuptimin Kur’anor të historisë etj., brenda të cilave ai lexohet në përputhje të filozofisë moderne. Në këtë pikëpamje është karakteristike sidomos vepra e Maz-herudin Sidikut “Concept of Muslim Culture in Iqbal. Islamabad 1970” në të cilën gjejmë kaptinat me titiuj: “Ikballi për racionalizmin mysliman”, “Ikballi për problemin e Ixhtihadit”, “Ikballi për demokracinë islame”, etj.

Në botën arabe është përkthyer vepra e Ikballit “ Reconstruction of the Islamic Thought’ - “Texhdidut-tefkirid-dinijj fil-islam” – Përtëritje e mendimit fetar në islam”[21]

Shënim për fund

Komentimi i Kur’anit në shek. e XX-të ka dhënë rezultate të mira në mbrojtjen e islamit nga sulmet e ideologjive përendimore, të cilat mund të thuhet se kishin triumfuar mbi krishterimin tradicional. Komentuesit e Kur’anit dhe shkrimtarët islamë, arabë indo-pakistanezë, turq etj., i ballafaquan teoritë dhe mësimet e veta me ideologjitë perëndimore. A do të thotë kjo se në këtë proces të definimit të përgjigjeve të ideologjive perëndimore, në anën e myslimanëve gjithashtu kanë filluar dhe kanë lindur ideologjitë personale të tyre dhe mendimet ideologjike?

Natyrisht përgjegjja është pohuese. Në “Dhilalin”e Kutbit është ndërtuar diskursi ideologjik i panislamizmit. Në veprën e “Sheltutit: Tefsirul-Kur’anil-kerim” “gjthashtu kemi diskursin ideologjik që lind në kohën e projektit të “socializmit arab”. Aq më tepër edhe në Tefsirin predikues të Esh-Sharavisë, kemi aty këtu diskursin ideologjik, edhe pse Shejh Esh-Sharavi është vaiz dhe hoxhë popullor. Kështu që ai në tesfirin e tij i përmend “Komitetet Qendrore të komunistëve” dhe thotë: “Anëtarët e komiteteve qendrore në shtetet komuniste jetojnë në bollëk dhe luks, kurse i tërë populli jeton në mjerim, ngase ata që i nxjerrin ligjet, i pasojnë epshet e veta dhe intereset e tyre i vendosin përmbi çdo interes tjeter...”[22].

Janë të panumruara shumë vepra, në të cilat gjatë shekullit XIX dhe XX myslimanët janë përpjekur për t’i dhënë përgjigjet e tyre, dhe në këtë mënyrë për t’i prapuar pretendimet dhe supozimet e ardhura të ideologjive përendimore. Kjo përmbledhje e jonë e teksteve përmend me qindra personalitete dhe me dhjetëra apo me qindra vepra të cilat i kanë shkruar myslimanët në kohën e dobësimit definitiv të tyre dhe

[21] Shih përkthimin të cilin e ka bërë Abass Mahmudi, bot. Kajro 1955.
[22] Shif “Tefsirush – Sharavi”, vëll. I . bot. Ahbarul Jevmi, faqe 59, Kairo, 1991.

letargjisë. Kjo përmbledhje në faqet e saj gjithashtu ofron lekturë, të cilën e kanë shkruar njerëzit e mundur dhe të shtypur, të cilët me mendimet e tyre donin të krijonin “Teologjinë e fuqishme Islame të çlirimit”.

Përktheu nga boshnjakishtja:
Hajrullah Hoxha

Enes Kariq

THE INTERPRETATION OF THE QUR’AN AND THE IDEOLOGIES OF THE TWENTIETH CENTURY

(Summary)

Introduction

I wonder why Muslims cannot unite in order to be stronger, as other peoples have done, in order to build a wall around them to protect them from the devastating floods that hit them from all sides. Through such views I do not request that all decision-making be assigned to just one person, as this would be difficult to achieve, but, I wish that all Muslims be guided by the Qur’an, whereas religion serves as an example-model for their unification (Jamaluddin Al-Afghani).

أنس كاريش

تفسير القران الكريم و ايدولوجليات القرن العشرين

(خلاصة البحث)

مدخل

هل يمكن ان يجتمع المسلمون ليصبحوا اكثر مهارة و اكثر شجاعة مثل ما اجتمع بقية الشعوب الذين كونوا حائطا منيعا الذى يحميهم من كل الهجمات التى وجهت ضدهم من كل الجهات . بهذا الموقف انا لا اطالب بان الشخص الذى يتخذ القرار ان يكون شخصا واحدا لان هذا بصعب تحقبقه و لكننى اريد بان القران الكريم ان يكون ان حكما لجميع المسلمين و يكون ديننا هوالنموذج الامثل لجميع المسلمبن .

(جمال الدين الافغانى)

JURISPRUDENCË ISLAME

Mr. Ejup Haziri

VEÇORITË KRYESORE TË LEGJISLACIONIT ISLAM

LEGJISLACIONI HYJNOR

Legjislacioni islam ka disa karakteristika dhe veçori që e dallojnë atë nga legjislacionet tjera. Ky legjislacion është gjithëpërfshirës dhe i përjetshëm derisa të ekzistojë njerëzimi.[1]

Prej veçorive sublime të këtij legjislacioni janë disa veçori e karakteristika që janë të llojllojshme, por që të gjitha së bashku bashkohen rreth një veçorie bazike, e që është veçoria e hyjnitetit.[2]

Hyjnorja, siç shprehen dijetarët arabë, është e ndërlidhur me shprehjen (Rab-Hyu) Zot, që nënkupton përkatësinë e saj nga Allahu i Madhëruar, por kjo veçori ka të bëjë edhe me njeriun si diçka hyjnore nëse ai ruan lidhjen me Zotin, njeh (e praktikon) fenë e Tij, (beson) librin e Tij, dhe këto ua mëson edhe të tjerëve.[3] Në këtë kontekst

[1] El-Alim, Jusuf Hamid, *El-Mekasid el-ametu Li-sh Sheriati-l Islamijeh*, bot.I-rë, el-Ma'-hed el-Alemij lil Fikri-l Islamij, Virgjinia-Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 1412h-1991 m, fq. 42.
[2] Kutb, Sejid, *Hasaisu-t Tesavvur el-Islamij ve Mukavvematuhu*, bot. XIII-të, daru-sh shuruk, Kajro-Egjipt, 1415h-1995m, fq. 41.
[3] Kardavi, Jusuf, *El-Hasais el-Ametu lil Islam*, bot. V-të, mektebetu vehabijeh, Kajro-Egjipt, 1419h-1999m, fq. 7.

Allahu ka potencuar në Kur'an: ***"S'është e drejtë as nuk i takoi asnjë njeriu që t'i ketë dhënë Allahu librin, urtësinë dhe pejgamberllëkun, e pastaj ai t'u thotë njerëzve: "Bëhuni robër të mi*** *(adhuromëni mua)* ***e jo të Allahut"! Por*** *(ju thotë):* ***"Bëhuni dijetarë të mësimeve të Zotit, ngase u keni mësuar njerëzve librin dhe e keni studiuar atë."***[4]

Kjo nënkupton se ky besim e legjislacion është hyjnor, ku bërthama e tij nuk bazohet te dikush tjetër, përpos Allahut të Madhëruar, e kjo e dallon atë me mendimet filozofike që i ka krijuar mendja njerëzore rreth së vërtetës hyjnore, të vërtetës së globit (gjithësisë), apo të vërtetës njerëzore, ashtu sikurse e dallon atë nga besimet e ndryshme pagane (politeiste) që i themeloi ndjenja, përfytyrimi, iluzioni dhe imagjinata njerëzore.[5]

Ky legjislacion është i vetmi legjislacion hyjnor i mbetur origjinal nga legjislacionet paraprake, ku e vërteta e tij është hyjnorja qiellore, ashtu siç ishin edhe ato paraprake, por që më vonë i përfshiu shtrembërimi dhe falsifikimi i qëllimshëm nga persona dhe klane të caktuara, dhe kështu legjislacioni Islam mbeti hyjnor dhe i vetmi legjislacion i paprekur, ashtu siç mbeti i pangatërruar mes së vërtetës dhe të kotës, ndërkaq lidhur me këtë vjen konfirmimi i qartë ku thuhet: ***"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij."***[6]

Burimi i këtij legjislacioni është Allahu që e bën këtë legjislacion hyjnor, për dallim nga legjislacionet e ndryshme që burim kanë njeriun. E ky legjislacion është i pastër nga mangësia, saqë nuk ka lënë (gjë) të vogël e as të madhe përpos se ka bërë hulumtime rreth tyre dhe ka sqaruar dispozitën e tyre.[7]

Pra, ajo që e dallon këtë legjislacion është hyjnorja, origjinën nga vetë Krijuesi, e jo nga mundi dhe angazhimi i njeriut, por legjislacion

[4] Kur'ani, Ali Imran: 79.
[5] Kutb, Sejid, *Hasais-ut Tesavvur el-Islamij ve Mukavimatuhu*, bot.XII-të, Dar-ush-Shuruk, Kajro-Egjipt, 1413h-1992m, fq. 43.
[6] Kur'ani, Hixhr: 9.
[7] Esh-Sherif, Muhamed Abdulgafar, *Buhuth Fikhijeh Muasareh* 1-10, bot. I-rë, dar ibn hazm, Bejrut-Liban, 1420h-1999m, fq. 113.

i zbritur te njeriu dhe për të, ku dëshmojnë fakte e argumente të sigurta për të. I Lartëmadhërishmi ka potencuar: ***“Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin*** *(Kur’anin)****. Ti nuk ke ditur çka është libri*** *(Kur’ani)* ***as ç’është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë. Në rrugën e Allahut, të cilit i takon çka ka në qiej dhe çka ka në tokë, e ta dini se të gjitha çështjet janë me vullnetin e Allahut.”***[8] Në tjetër vend thotë: ***“O ti i dërguar! Komunikoje atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën*** *(kumtimin në tërësi),* ***atëherë nuk e ke kryer detyrën*** *(revalatën-risalen)****...”***[9] Po ashtu thotë: ***“Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit.”***[10] Gjithashtu ka thënë: ***“Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për*** *(të pranuar)* ***Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu Allahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë.”***[11]

Veçoria e hyjnisë në legjislacionin islam dhe rregullat e tij, nuk i ka lënë hapësirë myslimanit që ta kundërshtojë apo t’ia kthejë shpinën, qoftë gjykatës apo të gjykuarit. Sa i përket gjykatësit (udhëheqësit) i Madhërishmi ka potencuar: ***“...E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mohues.”***[12] Në ajetin vijues thotë: ***“...E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti Allahu, ata janë mizorë*** *(të padrejtë)****.”***[13] Më pas thotë: ***“...E kush nuk gjykon sipas asaj që Allahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit.”***[14]

Ndërsa për të gjykuarin (masën e gjerë) thotë: ***“Kur u thuhet atyre: “Ejani*** *(për të gjykuar)* ***te ajo që e zbriti Allahu dhe te i dërguari!” i sheh se si dyfytyrëshit ta kthejnë shpinën.”***[15] Ai thotë: ***“Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmjet tyre tek Allahu dhe te i dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: “Dëgjuam dhe respektuam!” Të tillët janë ata të shpëtuarit.”***[16] Gjithashtu thotë: ***“Kur Allahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.”***[17]

[8] Kur’ani, Shura: 52-53.
[9] Kur’ani, Maide: 67.
[10] Kur’ani, Kasas: 56.
[11] Kur’ani, Enam: 125.
[12] Kur’ani, Maide: 44.
[13] Kur’ani, Maide: 45.
[14] Kur’ani, Maide: 47.
[15] Kur’ani, Nisa: 61.

E gjithë këto ajete kur’anore dëshmojnë se burimi i këtij legjislacioni është Allahu dhe se ky legjislacion është hyjnor.

Si ta mbjellim hyjnoren në shpirt e jetë?

Kësaj çështjeje, dijetari i njohur, Jusuf Kardavi, i jep një shpjegim të qartë dhe mjaft të arsyeshëm, ndaj sjellim disa fragmente nga shpjegimet e tij:

Legjislacioni Islam është një sistem hyjnor, që hyjnoren përpiqet ta mbjellë në shpirtin dhe në jetën e çdo besimtari.

1. Metoda e adhurimit

Një nga metodat për ta mbjellë hyjnoren në shpirtin e besimtarit bëhet përmes adhurimeve të detyrueshme, siç janë pesë kohët e namazeve ditore, të cilat për shpirtin janë të domosdoshme mu si veprimtaritë fizike për trupin dhe të cilat e mbajnë besimtarin të mbërthyer me marrëveshjen e bërë me të Gjithëfuqishmin. Çdoherë që njeriu thellohet në thellësitë e punëve dhe të preokupimeve ditore, myezini e thërret ezanin duke shqiptuar fjalët Allahu Ekber Allahu Ekber, Hajje ales-salah, Hajje ales-felah (Allahu është më i madhi-Allahu është më i madhi! Ejani në namaz! Ejani në shpëtim) dhe kështu besimtari, duke qëndruar disa minuta para Allahut dhe duke u lidhur me Të, duke u lutur për mirësi për veten dhe ummetin, shpëton për një çast prej kësaj bote të kokëdhembjeve dhe kënaqësive. Në ato çaste besimtari kalon

[16] Kur’ani, Nur: 51.
[17] Kur’ani, Ahzab: 36.

nga bota lëndore në atë frymore, nga egoizmi në altruizëm, e lut Zotin e vet me gjuhën kolektive[18]: ***“Udhëzona*** *(përforcona)* ***në rrugën e drejtë!”***[19]

Po ashtu, agjërimi, i cili çdo vit përsëritet nga një muaj në kohë të ndryshme, çdo ditë që nga agimi e deri në mbrëmje e privon njeriun nga shijimet epshore, nga kënaqësia e ushqimit, pijes dhe marrëdhënieve intime, e edukon njeriun, e stërvit në devocion, në përkryesinë e adhurimit të Allahut. Në një hadith kudsij thuhet: *“Agjërimi është për Mua dhe Unë e jap shpërblimin për të! Kjo për arsye se robi e lë ushqimin dhe pijen për mua, nuk kënaqet me gruan e vet dhe me gjërat tjera tërheqëse vetëm për ta fituar pëlqimin Tim!”*

Në saje të zeqatit besimtari e mund koprracinë, e pastron mallin dhe shpirtin e vet, i falënderohet të Lartëmadhëruarit për dhuntitë e shumta. Lidhur me këtë Kur’ani thotë*:* ***“Merr prej pasurisë së tyre*** *(të atyre që pranuan gabimin)* ***lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh*** *(të mirat)* ***dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta. Allahu dëgjon e sheh.”***[20]

Besimtari i cili vendos ta kryejë obligimin e haxhit, ndahet nga vendlindja dhe familja e tij duke u shpërngulur te Allahu, duke e sakrifikuar veten dhe pasurinë e tij, duke i duruar për hir të Allahut, mundimet e rrugës për në tokën e shenjtë, për në shtëpinë e Allahut...[21]

Adhurimet nuk e kryejnë funksionin e vet, nëse myslimani lidhet vetëm për disa momente me Krijuesin e tij e më pas të shkëpusë lidhjen me të, të kujtojë se është i përjetshëm në këtë botë dhe t’i ndjekë dëshirat epshore.

Filozofia e adhurimeve qëndron në të mbjellit në shpirtin e kryerësit të tyre frikërespektin ndaj Allahut, në të përforcuarit qëndrueshmërinë çdoherë që dobësohet, në të ndriçuarit atij rrugën çdoherë që shuhen dritat.[22]

---

[18] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 28-29.
[19] Kur’ani, Fatiha: 6.
[20] Kur’ani, Tevbe: 103.
[21] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 29-30.
[22] Op. Cit.:fq. 30-31.

2. Metoda e adhurimeve etike

Një mënyrë tjetër e mbjelljes së hyjnitetit në zemrën e besimtarit është ajo e etikës, e cila e përkufizon jetën e besimtarit: duke filluar nga ngrënia, pirja, veshmbathja, stolisja, fjetja, grahja e kafshëve dhe udhëtimit, mënyra e qëndrimit ulur, ecja si dhe shumë pika tjera të natyrës individuale dhe shoqërore.

Legjislacioni Islam i shfrytëzon këto momente të jetës njerëzore që ta lidhë besimtarin me Allahun.[23]

Besimtari e fillon ditën e tij me emrin e Krijuesit të tij, kur ulet pranë tryezës, e falënderon Atë, kur vesh rrobat e falënderon Atë për të mirat dhe furnizimet e Tij të pakufishme: ***“Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit*** *(njerëzit)****, u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata*** *(i lartësuam)* ***ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.”***[24]

Edhe atëherë kur bëhet gati për ngasje veture, fillon me fjalët e tij: “Të uleni mbi to dhe atëherë, pasi të jeni vendosur mbi to, ta përkujtoni të mirën që ua dha Zoti juaj e të thoni: ***“Falënderuar qoftë Ai që i krijoi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë.”***[25] Kur ia nis udhëtimit e thotë këtë lutje: *“O Allahu im! Ti je shoqërues në këtë udhëtim dhe mbrojtës i familjes sime, na shoqëro në udhëtimin tonë dhe na i ruaj familjet.”*[26] Ndërsa kur të kthehet prej udhëtimit, prapë e falënderon Krijuesin e tij me këto fjalë: *“U kthyem (nga udhëtimi) me pendim, adhurim e përkushtim, duke e falënderuar Krijuesin tonë.”*[27]

Besimtari edhe para se të bjerë të flejë e bën këtë lutje: *“Me emrin Tënd o Zoti im, bie në gjumë dhe me emrin Tënd ngrihem.”* Ndërsa kur të zgjohet nga gjumi, e fillon falënderimin me këto fjalë: *“Falë-*

---

[23] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 32.
[24] Kur’ani, Isra: 70.
[25] Kur’ani, Zuhruf: 13.
[26] Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. i hadithit 3369.
[27] Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 1670, 2773, 2855. Hadithi është autentik.

nderimi i takon Allahut, i Cili na ngjalli (na ktheu sërish në jetë), pasi ishim të vdekur dhe tek Ai do të tubohemi që të gjithë.”

Besimtari mysliman s’e harron të Lartëmadhëruarin në asnjë moment të jetës së tij, nuk e harron lidhjen me të, elementi hyjnor është prezent kudo që të sillet e të shkojë.[28]

3. Metoda e edukatës

Njëra nga metodat më të rëndësishme dhe më me ndikim për mbjelljen dhe përforcimin e hyjnores në qenien e besimtarit është ajo e edukimit.

Themelet e edukatës, së pari vihen në shtëpi e më pas në shkollë duke e mbjellë ndjenjën e hyjnores në mendjet aktive dhe ndërgjegjet e fëmijëve.

Prindërit kanë përgjegjësi mbi fëmijët e tyre, ata do të pyeten për atë përgjegjësi, ndërsa lidhur me këtë i Madhërishmi ka thënë*:* ***“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”***[29] Ndërsa i Dërguari i Allahut ka thënë: ***“Secili nga ju është bari dhe përgjegjës për kopenë e tij...”***[30]

Së këndejmi, babai është përgjegjësi kryesor për fëmijët e tij, por edhe nëna është shoqëruese dhe përgjegjëse në ruajtjen e familjes, sidomos fëmijëve. Madje në shumë raste ajo ka ndikim më të madh te fëmijët sesa bashkëshorti i saj.

Po ashtu edhe shkolla bart një pjesë të përgjegjësisë për edukimin e fëmijëve me shkëndija hyjnore. Ky institucion s’duhet të kënaqet vetëm me shtimin e të dhënave dhe afiniteteve shkencore e artistike te nxënësi, as me shtimin e njohurive për rrethin dhe jetën në përgjithësi. Përndryshe, fëmija do të mbetet i shmangur dhe injorant ndaj shumë çështjeve të rëndësishme, të cilat e sfidojnë dhe i nxjerrin pyetje të cilave s’ua gjen dot përgjigjen si p.sh.: Nga kemi ardhur? Ç’është qëllimi i jetës? Ku shkojmë pas udhëtimit në këtë botë? A bart ndonjë

[28] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 33.
[29] Kur’ani, Tahrim: 6.
[30] Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 844, 2232, 2371. Hadithi është autentik.

mision ndërmjet ardhjes dhe shkuarjes, ose ndërmjet jetës dhe vdekjes? Cili është ai mision? Çfarë shpërblimi ka nëse e kryen drejtë dhe çfarë dënimi ka nëse e mospërfill atë mision?

Besimi në Allahun, është ai i cili u ofron përgjigje këtyre pyetjeve, përgjigje këto të cilat i kënaqin mendjet, qetësojnë ndërgjegjet, hapin gjoksat. Besimi Islam është një besim i veçantë, i pastër nga çdo lajthitje, mashtrim, huti e kontradiktë.[31]

LEGJISLACIONI REALIST

Karakteristika e dytë që e dallon këtë legjislacion nga tjerët është veçoria e realizmit. Me këtë kuptojmë se ky legjislacion nuk është bazuar në imagjinata e as përfytyrime, por në vërtetësi realiste, ku nënkuptohet gjithësia si një ekzistencë e vërtetë, që Allahu e ka krijuar atë dhe çdo gjë ka caktuar e krijuar me masë, sikurse që nënkuptohet realizmi i jetës së njeriut, i cili është i shoqëruar me të mira e të këqija, ashtu siç nënkuptohet realizmi i krijesës njeri, krijesë e çuditshme që gërshetohet brenda saj elementi qiellor me atë tokësor.

Ky realizëm vepron përherë me ekzistencën reale në jetën e njeriut, e në të njëjtën kohë është realizëm model apo model realist, ngase ka për qëllim ngritjen e shkallës apo përsosjen e njerëzimit drejt realizmit.[32]

Ky realizëm bashkëvepron me të vërtetën hyjnore, ashtu siç bashkëvepron me të vërtetën kozmike dhe të vërtetën njerëzore.

Realizmi hyjnor i këtij legjislacioni është vërtetësia e fakteve të qarta që flasin për Krijuesin, si një Zot i vetëm e suprem, me të gjitha cilësitë absolute, ku me shenjat e Tij në gjithësi, ka dëshmuar për Veten e Tij.

“Atëherë, Allahun lartësojeni kur të vijë mbrëmja dhe kur të agojë mëngjesi. Falënderimi i takon vetëm Atij prej gjithë çka ka në qiej e në tokë, edhe në mbrëmje edhe ditën. Ai krijon të gjallin prej të vdekurit dhe të vdekurin prej të gjallit, Ai e ngjall tokën pas vdekjes së

[31] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 34-35.
[32] Kutb, Sejid, *Hasais-ut Tesavvur el-Islamij ve Mukavimatuhu*, fq. 163.

***saj, e po ashtu edhe ju do të nxirreni** (të gjallë prej varrezave). **Nga faktet** (e fuqisë) **e Tij është edhe ajo, se Ai ju krijoi prej dheu, e mandej ju** (u zhvilluat në) **njerëz që veproni të shpërndarë. Dhe nga faktet** (e madhërisë së) **e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën** (gratë), **ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë. Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz....Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e në tokë dhe Ai është mbizotëruesi, i urti.”**[33]*

Përveç realizmit hyjnor, ekziston edhe realizmi i gjithësisë dhe realizmi njerëzor, ku ky i fundit është i përbërë nga mishi dhe eshtrat, mendja, trupi e shpirti, i cili ka lindur dhe do të vdesë, ka fillim dhe fund, do dhe urren, shpreson dhe frikësohet, ngrihet dhe bie poshtë, beson dhe mohon, udhëzohet dhe humb, ndërton tokën apo e shkatërron atë, këto janë realizmat e njeriut realist dhe veçoritë e tij të ndryshme.[34] Allahu i Madhëruar ka potencuar: ***“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur** (këqijat)**, e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”**[35]*

Pra, ky legjislacion na flet për shumë vërtetësi realiste që i shohim, ndiejmë dhe besojmë, duke filluar nga ajo që është më realiste, ekzistenca e Krijuesit, e më pas gjërat realiste tjera.

Ky legjislacion realist, na flet dhe na thërret në besimin në një Zot të vetëm, thërret në besimin në të dërguarit e Allahut, besimin në botën e përtejme, në shpërblim e ndëshkim.

Nga realizmi i legjislacionit Islam është edhe ajo që Islami nuk ka mjaftuar vetëm me aspektin fetar apo moral për ruajtjen e të drejtave të njerëzve, mirëpo ka përcaktuar edhe sistemin e ndëshkimeve, ku shpeshherë nuk mjaftojnë vetëm këshillat dhe sugjerimet, por për ta

[33] Kur’ani, Rrum: 17-27.
[34] Kutb, Sejid, *Hasais-ut Tesavvur el-Islamij ve Mukavimatuhu*, fq. 173.
[35] Kur’ani, Huxhurat: 13.

parandaluar veprimin duhet praktikuar masën e ndëshkimit, me qëllim që ta ndalohet e keqja dhe të pengohet ai për kryerjen e një krimi të ngjashëm, ashtu siç i pengon të tjerët që të veprojnë ngjashëm me të.[36]

Legjislacioni erdhi me dy lloje ndëshkimesh; e para: ato që ka përcaktuar edhe masën ndëshkuese, duke mos lënë hapësirë për masë shtesë e as për mangu, dhe e dyta: masat edukative që i janë lënë në dispozicion udhëheqësit të myslimanëve.

Gjithashtu nga idealizmi i këtij legjislacioni është edhe ajo që ekzistimi i luftës[37] konsiderohet akt legjitim apo domosdoshmëri në rast mbrojtjeje, sikurse që akt legjitim është edhe divorci[38] dhe poligamia.[39]

Për të qenë më të qartë do të sjellim dy pika të rëndësishme, ku del në pah realizmi i këtij legjislacioni:

Legjislacion realist në adhurime

Legjislacion Islam në të gjitha çështjet është realist, ai edhe atëherë kur e ka obliguar besimtarin me diçka, e ka obliguar brenda mundësisë së tij, ndërkaq lidhur me këtë i Plotfuqishmi thotë: ***“Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij...”**[40]* Kjo nënkupton se obligimet janë përherë brenda mundësive të kufizuara të njeriut, e i Madhërishmi ka respektuar mundësitë e njeriut: ***“...nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi...”**[41]*

Adhurimet apo obligimet që Krijuesi ka përcaktuar janë të natyrave të ndryshme, por Krijuesi nuk ka përcaktuar që ne të jemi tërë kohën në adhurime, thënë ndryshe ta kalojmë tërë kohën në adhurime. Ka përcaktuar kohë për adhurim, por krahas kësaj ka përcaktuar që të

[36] Kardavi, Jusuf, *Med’hal Lidiraseti-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 120.
[37] Islami nuk e përkrah luftën dhe nuk nxit për të, por e lejon kur është më se e nevojshme ajo, apo atëherë kur nuk ka rrugëdalje tjetër pos saj.
[38] Meqenëse divorci është një akt i urryer, por i lejuar, ngase në situata të padurueshme të martesës ai bëhet i domosdoshëm.
[39] Op. Cit.:fq. 121-122.
[40] Kur’ani, Bekare: 286.
[41] Kur’ani, Haxh: 78.

jemi të lidhur me jetën, në punë, angazhim dhe gjëra tjera, ashtu siç ka përcaktuar të jemi të lidhur më Krijuesin, ka përcaktuar të jemi të lidhur edhe me shoqërinë dhe me atë që na rrethon, nuk ka kërkuar vetëm të lidhemi me këtë botë, por edhe me botën tjetër, jo vetëm me anën materiale por edhe me atë shpirtërore.

Enes ibn Maliku thotë: *"Tre njerëz erdhën te shtëpitë e bashkëshorteve të të Dërguarit të Allahut, që të pyesin për adhurimin e tij*[42], *e kur ata u njoftuan, atëherë thanë: "E ku jemi ne nga i Dërguari i Allahut, të cilit i janë falur mëkatet e mëhershme dhe të mëvonshme." Njëri prej tyre tha: "Sa më përket mua, do të falem gjatë gjithë natës", tjetri tha: "Unë do të agjëroj tërë kohën, e nuk do të prish (asnjë ditë)." Përderisa i treti shtoi: "Unë do t'i largohem grave e nuk do të martohem asnjëherë." Më pas erdhi i Dërguari i Allahut dhe u tha: "Ju jeni ata të cilët keni thënë kështu e kështu, për Zotin, sa më përket mua, unë ia kam frikën Atij më së shumti dhe jam më i devotshmi ndaj Tij, mirëpo unë agjëroj dhe ha, falem e fle dhe martohem, e kush largohet nga tradita ime ai nuk është prej meje."*[43]

Kështu ky legjislacion nuk ka urdhëruar që njerëzit të jenë përherë në adhurim, mirëpo ka lënë hapësirë për pushim, punë, angazhim dhe gjëra tjera, krahas adhurimeve si falja e namazit ditor, apo agjërimi si adhurim vjetor e haxhi si adhurim jetësor[44], ka lënë hapësirë të bollshme për punë tjera. Mirëpo, në raste tjera ka vënë lehtësime të ndryshme për njeriun, për të sëmurin që nuk mund të falë namazin në këmbë mund ta falë ulur apo i shtrirë, po ashtu i sëmuri ka të drejtë të mos agjërojë, sikurse gjidhënësja dhe shtatzënia. Përveç këtyre, udhëtarit i lejohet të prishë agjërimin, sikurse që i lejohet të shkurtojë namazet gjatë udhëtimeve, e krejt këto janë indikacione të qarta se ky legjislacion është realist në adhurimet e obliguara të tij dhe të gjithë këta shembuj janë argumente se ky legjislacion me adhurimet e tij është

[42] Sipas Ibni Haxherit (Fet'hu-l Bari) kanë pyetur për adhurimin e tij të fshehtë në shtëpinë e tij, ngase adhurimi i tij në xhami e vende tjera ka qenë i njohur.
[43] Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 4675. Hadithi është autentik.
[44] Oblëigim një herë një jetë

realist dhe i lehtësuar: ***"...Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju..."***[45]

Legjislacion realist në ligjvënie

Legjislacioni Islam është realist në të gjitha sferat, por në pamundësi për të diskutuar mbi të gjitha, do të mjaftohemi me adhurimet dhe ligjvëniet, e për adhurimet diskutuam më lart.

Legjislacioni Islam është shumë real në të gjitha përcaktimet e gjërave të lejuara dhe të ndaluara.

Ka lejuar gjërat e bukura që natyra e njeriut anon kah to, e ka ndaluar gjërat e urryera që janë në kundërshtim me logjikën dhe arsyen e vetë njeriut. Kështu, për ilustrim, ka ndaluar alkoolin, si sasinë e pakët të tij apo të shumtë, ngase ai ka një efekt shumë negativ te mendja dhe logjika e personit që e përdor, sikurse që ka ndaluar bixhozin, fallin dhe veprat tjera djallëzore: ***"O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës*** *(për fall)* ***janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar."***[46]

Prej ushqimeve ka lejuar ato që janë të mira dhe që janë në natyrshmërinë e pastër të njeriut për përdorim, kurse ka ndaluar ato që janë të dëmshme dhe që sjellin efekte negative në vetë njeriun

> ***"Juve u janë ndaluar*** *(t'i hani):* ***ngordhësirat, gjaku, mishi i derrit, ajo që theret jo në emrin e Allahut, e furma, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara*** *(nga briri i tjetrës),* ***ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therni*** *(para se të ngordhë),* ***ajo që është therur për idhuj dhe*** *(u është e ndaluar)* ***ta kërkoni me short fatin. Kjo është mëkat ndaj Allahut."***[47]

Ka ndaluar prostitucionin si njëri ndër mëkatet më të turpshme dhe të pahijshme që cenon rëndë moralin, nderin dhe dinjitetin e njeriut. Për më tepër, ai bëhet shkak për shthurjen dhe prishjen e familjes,

[45] Kur'ani, Bekare: 285.
[46] Kur'ani, Maide: 90.
[47] Kur'ani, Maide: 3.

si edhe për përhapjen e degjenerimit dhe degradimit moral tek individët dhe te shoqëria njerëzore.[48]

Ka ndaluar edhe shpifjen për imoralitet ndaj burrave dhe grave të ndershme dhe të devotshme, ngase është mëkat i madh, sepse ai bëhet shkak për prishjen e lidhjeve familjare. Kjo shpifje mund të shkaktojë ndarjen e burrit nga gruaja dhe shkatërrimin e bazave të familjes.[49]

Vjedhja nuk është gjë tjetër veçse dhunim dhe keqtrajtim i pasurisë, e cila është ndër gjërat më të shtrenjta për njeriun, ndaj edhe këtë e ndaloi Ligjvënësi në mënyrë të prerë.

Nga ana tjetër, ka lejuar shumë gjëra që janë të nevojshme për njeriun, si stolitë e ndryshme, veshjet e bukura, rregullimin, disa lojëra[50], gëzime familjare, dasma, festat, të cilat janë brenda kornizave të këtij legjislacioni.

Ka lejuar për gratë bartjen e arit dhe rrobat e mëndafshta, duke marrë në konsideratë natyrën e gruas dhe dashurinë e saj pas stolive të ndryshme.

Ka lejuar martesën ngase ajo është bërthama e familjes[51], prej së cilës rrjedh njerëzimi dhe ka ndaluar jetën e partnerëve dhe të dashnorëve, ngase jeta e ndërrimit të partnerëve dhe dashnorëve është jetë pa moral dhe jonjerëzore, dhe e cila sjell të këqija të panumërta: ***"Dhe nga faktet*** *(e madhërisë së)* ***e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën*** *(gratë)*, ***ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."***[52]

Ky legjislacion nuk preferon ndarjen (divorcin), tekstet e tij thërrasin me slogane kundër divorcit ***"Çoni jetë të mirë me to. Nëse i***

[48] Sabik, Sejid, *Fikhus-Suneh-Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s.*, botoi: AIITC, Tiranë, 2007, vëll.II, fq. 431
[49] Op. Cit.:fq. 431.
[50] Si garat me kuaj, garat në vrapim apo disa tjera, por nuk duhet të jenë të shoqëruara me diçka të ndaluar.
[51] Ata, Abdulkadir Ahmed, *Hadha Halalun ve Hadha Haramun*, dar el-Fediletu, Kajro-Egjipt, fq, 204.
[52] Kur'ani, Rum: 21.

urreni ato, bëni durim pse ndodh që Allahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni."[53]

Divorci është një veprim i urryer dhe i padëshiruar, por kur jeta bëhet e padurueshme dhe kur shteren të gjitha mundësitë e pajtimit bashkëshortor, atëherë ai lejohet dhe në disa raste bëhet edhe ilaç efikas, megjithëse në esencë është akt i urryer. Nga Abdullah ibn Omer transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: ***"Gjëja e lejuar të cilën më së shumti e urren Allahu është divorci."***[54]

Pra, ky legjislacion në tërësi dhe në çdo pikëpamje është real, ngase ka inkorporuar në tërësinë e vet elementet e arsyes për vetë njeriun, duke iu përshtatur natyrës së tij.

LEGJISLACIONI MORAL (EDUKATIV)

Sikurse këtë legjislacion që e dallon hyjnorja dhe realizmi ndaj legjislacioneve tjera që i krijoi dhe formuloi njeriu, ky legjislacion dallohet prej tjerëve me veçorinë e moralit dhe edukatës, në të gjitha sferat dhe fushat e tij. Ky është legjislacion moral me tërë atë kuptim që bart fjala - moral. E nuk është për t'u çuditur ngase i Dërguari i Allahut, të cilit i zbriti ky legjislacion[55] thoshte: ***"Me të vërtetë jam dërguar për përsosjen e vlerave të moralit."***[56]

Morali është pjesë përbërëse në formimin e të gjitha çështjeve të jetës dhe përmirësimit të shoqërisë, e pa moral nuk mund të (mbi)jetojë shkenca, kultura dhe as përparimi teknologjik, ndërkaq argument për këtë është ajo që ne po e shohim sot, ku bota po vuan nga kriza morale.[57]

Legjislacioni Islam ka përkujdesjen më të mirë për rregullat dhe dispozitat morale, saqë secila dispozitë inkorporon në vete rregulla

[53] Kur'ani, Nisa: 19.
[54] Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. i hadithit 2008; Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. i hadithit 1863.
[55] Kardavi, Jusuf, *Med'hal Lidiraseti-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 102.
[56] Bejhekiu në Sunenin e tij, nr. i hadithit 20571. Hakimi ka thënë se hadithi është autentik, e imam Dhehebiu është pajtuar me të.
[57] Sherif, Muhamed Abdulgafar, *Buhuth Fikhijetun Muasaretun*, vëll.I-X, fq. 122.

moralo-etike, në të kundërtën me legjislacionet e formuluara nga vetë njeriu, të cilat nuk përmbajnë dispozita morale e as që interesohen për moral, bile bëjnë edhe një ndarje mes rregullave të moralit dhe rregullave ligjore. E këtu na mjafton një shembull për të parë dallimin në aspektin e moralit mes legjislacionit islam dhe atij laik[58]. Juristët myslimanë pohojnë se nëse një i huaj (jomysliman) hyn në rajonin e shtetit islam me një marrëveshje garancie për një periudhë të caktuar, nuk lejohet që ai të dëbohet (internohet) në shtetin e tij nëse ai kërkohet gjatë asaj kohe nga shteti i tij, madje ai nuk duhet të dorëzohet edhe nëse kërkohet shkëmbimi i tij me një të burgosur mysliman në shtetin e jomyslimanit. Kjo duhet të pengohet me çdo kusht, madje edhe atëherë kur ai shtet e frikëson shtetin islam me luftë të hapur. Juristët myslimanë e komentojnë këtë dispozitë kështu: "Ky i huaj (jomysliman) ka hyrë në rajonin e shtetit islam me marrëveshje garancie (Eman)[59], andaj shteti islam ka për detyrë që të kujdeset për të derisa ai të mbetet i sigurt duke mos e prekur atë asnjë e keqe, e po të bëhej dorëzimi pa pëlqimin e tij te shteti i tij që e kërkon, atëherë ky rast do të ishte mashtrim, e që në islam nuk lejohet një gjë e tillë. Pengimi për dorëzimin e tij mbetet në fuqi edhe atëherë kur shteti i tij shpall luftë ndaj banorëve të shtetit islam, kështu legjislacioni islam është superior në shkallën e tij duke praktikuar parimet e moralit edhe në situata të vështira dhe delikate, gjë që nuk ka të ngjashëm me të në legjislacionet që i formoi njeriu, qofshin legjislacionet e vjetra apo të reja, e nuk është për t'u çuditur ngase legjislacioni islam është nga Allahu, e ajo që vjen prej Tij është e vërtetë, e pastër dhe e drejtë e pakontestueshme.[60]

[58] Zejdan, Abdulkerim, *Usulu-d-Da'veti*, bot.III-të, Muessesetu-rr-Rrisaletu, Bejrut-Liban, 1414h-1993m, fq. 54-55.
[59] Është një marrëveshje në mes kryetarit të shtetit mysliman dhe në mes një personi apo disa personave që nuk i takojnë fesë Islame, që u lejon atyre vendbanim të përhershëm në shtetin islam, u lejohet atyre çfarë ju lejohet edhe muslimanëve, kanë të drejta të plota siç kanë myslimanët në atë vend, por krahas kësaj ata duhet paguar një taksë tepër simbolike (xhizje) për ruajtjen, sigurinë dhe mbrojtjen e tyre.
[60] Op. Cit.:fq. 55.

Realizimi i moralit islam

Pra, Legjislacioni Islam është një sistem i përgjithshëm moralo-etik ndaj gjitha çështjeve dhe sferave që e rrethojnë njeriun, e në Islam nuk paramendohet një sferë e zbrazët nga morali, por morali është dominant ndaj gjitha çështjeve, ashtu siç kishte potencuar Ibn Kajjim Xhevziu: "Feja islame është në tërësi moral."[61]

Legjislacioni Islam ka porositur myslimanin me këshilla morale ngase ky i fundit e shton dashurinë dhe vëllazërinë mes myslimanëve, si dhe kontribuon në afërsinë e zemrave mes njerëzve, zhduk urrejtjen dhe smirën mes tyre si dhe inkorporon elementin e vëllazërisë mes shtresave, racave dhe vendeve të ndryshme: ***"...Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër..."[62]*** S'ka dyshim se vëllazëria sjell dashurinë reciproke dhe shton mirësitë e ndryshme. Besimtari duhet të jetë udhërrëfyes i së mirës për të tjerët ashtu siç duhet të jetë këshillues i mirë për të parandaluar të keqen për të tjerët.

Në rast se ndokush i ka bërë keq tjetrit, atëherë ka paraparë që t'i falet ose t'i kthehet në të njëjtën mënyrë dhe masë, duke mos tejkaluar kufijtë, mirëpo edhe në këtë aspekt e ka favorizuar drejtësinë dhe mënjanimin e ndjenjave armiqësore gjatë hakmarrjes. Por, nuk duhet harruar se kjo fe ka nxitur në falje dhe durim ndaj keqbërësit, duke theksuar se falja dhe durimi ndaj tij vlerën e ruajnë vetëm nëse janë pasojë e fisnikërisë e jo të ngushtësisë ose detyrimit.[63] I Lartëmadhëruari ka urdhëruar: ***"Ndëshkimi i së keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek Allahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët."[64]*** Gjithashtu thotë: ***"Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju; e nëse duroni, pa dyshim ai është më i mirë për ata që durojnë."[65]***

[61] Xhevziu, ibn Kajjim, *Medarixhu-s-Salikine*, fq. 307.
[62] Kur'ani, Ali Imran: 103.
[63] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 181.
[64] Kur'ani, Shura: 40.
[65] Kur'ani, Nahl: 126.

Ky legjislacion ka urdhëruar dhe porositur që kooperimi dhe bashkëpunimi të jetë për të mirën dhe për të mbarën e jo për të keqen apo mëkatin, ndërkaq lidhur me këtë ka theksuar qartë: ***"Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi."***[66]

Nga realizimi i moralit islam është edhe fakti se ai i ka pranuar dallimet mes njerëzve. Të gjithë njerëzit nuk janë të barabartë në aspektin e besimit, as në aspektin e respektimit të urdhëresave hyjnore dhe largimit prej harameve, e as në aspektin e lidhshmërisë ndaj shembujve më lart.

Morali islam nuk thotë se njerëzit e devotshëm janë të pagabueshëm, të mbrojtur nga çdo mëkat, as se ata janë engjëj me fletë, por e pranon realitetin se njeriu është i përbërë nga lënda dhe shpirti, e pranon të vërtetën se tek ai ndonjëherë mbisundon shpirti, e ndonjëherë lënda. Dallueshmëria e të devotshmëve qëndron në pendesën dhe kthimin e njeriut kah Allahu[67]: ***"Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë*** *(mëkat)* ***të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetvetes, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i fal mëkatet përveç Allahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar*** *(në të keqen).****"***[68]

Legjislacioni Islam ka vënë të dërguarit e Allahut shembuj të moralit dhe të mirës, e ne kemi shembullin më sublim dhe modelin më të bukur, të Dërguarin e fundit, për të cilin shpallja mbi shtatë qiej konfirmoi virtytet e larta morale të tij: ***"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!"***[69] Ndërsa bashkëshortja e tij kur u pyet për moralin e tij, tha: ***"Morali i tij ishte Kur'ani."***[70] Me fjalë tjera ishte i edukuar me edukatën dhe moralin e Kur'anit, duke punuar e vepruar gjithnjë sipas këshillave të tij, ndaj ishte model për mbarë njerëzimin: ***"Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut..."***[71]

66 Kur'ani, Maide: 2.
67 Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 182.
68 Kur'ani, Ali Imran: 135.
69 Kur'ani, Kalem: 4.
70 Ahmedi në Musnedin e tij, nr. i hadithit 23460.
71 Kur'ani, Ahzab: 21.

LEGJISLACIONI HUMAN (NJERËZOR)

Njëra nga veçoritë e legjislacionit islam është humaniteti apo njerëzorja, që nënkupton se ky legjislacion është ligjësuar për shkak të njeriut, për të ngritur vlerat e tij si dhe për ta ruajtur nga denigrimi dhe prozhmimi. Kështu i janë bërë legjitime njeriut disa rite që ta shuajnë etjen e tij shpirtërore, ngase njeriu nuk përbëhet vetëm nga ana trupore që e ngop ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet seksuale, mirëpo krahas kësaj ai ka nevojë edhe për anën shpirtërore.[72]

Ky legjislacion është legjislacion human për mbarë njerëzimin, e jo vetëm për arabët siç pandehin disa skeptikë dhe injorantë, edhe pse i dërguari Muhamed ishte arab dhe gjuha që zbriti ishte në gjuhën e popullit arab, por kjo nuk e bën këtë legjislacion lokal, por ai është mbarënjerëzor, edhe po të mos zbriste në gjuhën arabe, do të zbriste në ndonjë gjuhë tjetër:

"Ai, që ia shpalli Furkanin *(Kur'anin, dallues të së vërtetës nga e pavërteta)* ***robit të vet*** *(Muhammedit)* ***që të bëhet pejgamber i botës*** *(këshillues),* ***është i madhëruar."***[73]

I Dërguari i Allahut u dërgua për mbarë njerëzimin, e jo për një popull të veçantë: ***"E Ne të dërguam ty*** *(Muhammed)* ***vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat."***[74] Po ashtu thuhet: ***"Thuaj*** *(Muhammed):* ***"O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju..."***[75]

Qëllimi i legjislacionit mbarënjerëzor është shikimi që ky legjislacion ua bënë banorëve të këtij rruzulli, si një tërësi e përbashkët dhe e pandarë.[76]

Njerëzorja për të cilën jemi duke folur buron nga elementi hyjnor, që legjislacionin hyjnor e bëri edhe njerëzor, të kapshëm dhe të praktikueshëm për njeriun, gjë që plotësisht përshtatet me natyrshmërinë e vetë njerëzimit.

72 Kardavi, Jusuf, *Med'hal Lidiraseti-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 132.
73 Kur'ani, Furkan: 1.
74 Kur'ani, Enbija: 107.
75 Kur'ani, Araf: 158.
76 Kardavi, Jusuf, *Med'hal Lidiraseti-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 134.

Vetë urdhëresat e këtij legjislacioni janë humane dhe për njeriun, e këtu del në pah se ky legjislacion i kushton rëndësi të posaçme njeriut dhe aspektit njerëzor, ku shumë urdhëresa dhe obligime të legjislacionit kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërnjerëzore, të drejtën e individit, të drejtat e shoqërisë, të drejtat civile dhe të drejtat penale, që në kuptim të përgjithshëm janë raporte reciproke mes njerëzimit.

Nëse për një çast ndalesh dhe mendon për njërin nga adhurimet e mëdha, siç është zeqati, do të vëresh se në esencë është adhurim njerëzor. Pra, merret prej njerëzve të pasur dhe u jepet hallexhinjve. Zeqati, para së gjithash paraqet pastrim e dëlirësi, e më pas pasurim dhe lirim.[77]

Agjërimi është edukim i vullnetit të njeriut në durim dhe në ballafaqim me mundimet, është edukatë e të ndierit dhembjet e tjetrit dhe përpjekje për barazi. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut këtë muaj e ka quajtur “Muaji i durimit”[78] dhe “Muaji i barazisë”.

Haxhi paraqet një kongres hyjnor-njerëzor, në të cilin i Lartmadhëruari i ka ftuar robërit e vet besimtarë: ***“****(Vijnë)* ***Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin Allahun në ato ditë të caktuara*** *(në shenjë falënderimi)* ***dhe për atë që i ka furnizuar me kafshë. Hani pra prej tyre*** *(kurbanave)* ***dhe ushqeni të ngushtuarin e të varfrin.”***[79]

Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut çdo vepër të bërë nga besimtari e ka ngritur në pozitë të adhurimit nga i cili rrjedh dobi fizike ose shpirtërore për vetë ata.[80]

Ky legjislacion e konsideron njeriun krijesë njerëzore-humane, e jo siç pandehin ideologji dhe filozofi të ndryshme, ku njeriu humb vlerën e vet, saqë nganjëherë ai paraqitet hyjnor si zot, duke i atribuuar atij elemente hyjnore, e herë tjera kur njeriu konsiderohet si kafshë produktive apo kafshë e civilizuar. Me fjalë tjera, legjislacioni islam e konsideron njeriun ashtu siç është, duke mos e ngritur njeriun në gra-

[77] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 76.
[78] Shih: Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. 1731.
[79] Kur’ani, Haxh: 28.
[80] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 77.

dë të hyjnitetit e as që e zbret atë në gradë të shtazës. Për këtë i Madhërishmi ka potencuar: ***“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.”***[81]

Me urtësi të përsosur i Madhërishmi e ngriti krijesën njeri duke e bërë në formën më të bukur: ***“Ai krijoi qiejt dhe tokën me urtësi të përsosur dhe Ai juve u dha formën, e formën tuaj e bëri të bukur dhe vetëm te Ai është e ardhmja.”***[82]

Si ta mbjellim humanizmin në zemrat tona?

Njeriu, si qenia më e përsosur dhe më e dalluar në rruzullin tokësor, duhet të marrë shkëndijat e humanizmit që dalin nga legjislacioni human, për t’i realizuar ato në jetën e tij, që të jetojë me ndershmëri si krijesë njerëzore.

Kësaj krijese i Plotfuqishmi ia besoi mëkëmbësin në sipërfaqen e tokës, e që me të rezulton se kjo krijesë është fisnikëruese dhe e fisnikëruar: **“**(*Përkujto Muhammed)* ***Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj*** *(po përcaktoj)* ***në tokë një zëvendës!” Ata thanë: “A do të vësh në të atë që bën çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!”***[83]

Akoma më fisnikërues është fakti se kësaj krijese Allahu ia përuli dhe ia nënshtroi çdo gjë tjetër duke e bërë në shërbim të saj. E padyshim që ky ishte një nder i madh për këtë krijesë, ndërkaq lidhur me këtë i Madhërishmi ka potencuar: ***“Allahu është Ai, që për ju e nënshtroi detin që me lejen e Tij të lundrojnë anijet nëpër të, që të kërkoni begatitë e tij; ndaj, falënderone. Dhe për ju nënshtroi gjithë ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë, njëmend për njerëzit që mendojnë thellë, në to ekzistojnë argumente.”***[84]

[81] Kur’ani, Tin: 4.
[82] Kur’ani, Tegabun: 3.
[83] Kur’ani, Bekare: 30.
[84] Kur’ani, Xhathije: 12-13.

Krahas këtyre dhuntive, myslimani duhet të mendojë gjatë për këto mirësi të panumërta, por mbi të gjitha duhet të mundohet që të jetë i njerëzishëm në raport me njerëz dhe me krijesat tjera, e të mos jetë shkatërrimtar dhe injorant ndaj të tjerëve, pa marrë parasysh pozitën dhe statutin e tij. Ai duhet të jetë human dhe ndihmues ndaj të tjerëve sa herë që e kërkon nevoja, madje nëse e kërkon nevoja duhet të largojë edhe ferrën apo gurin që i pengon kalimtarët, ngase me këtë e tregon humanizmin e tij dhe shpërblimi për këtë vepër të vogël nuk do të mungojë, sikurse që duhet të tregohet i njerëzishëm në lëmoshë ndaj skamnorëve, ndihmë ndaj atyre që kanë nevojë, pajtim mes të ngatërruarve, urdhërim për të mirë e ndalim nga e keqja, t'ia largojë brengat besimtarit, madje duhet të tregohet i njerëzishëm edhe atëherë kur takon vëllanë apo shokun e tij, të tregohet i buzëqeshur, ashtu siç potencoi i Dërguari i Allahut: *"Buzëqeshja ndaj vëllait tënd është lëmoshë."*[85]

Me fjalë tjera duhet të jetë i mirë dhe i dobishëm për të tjerët, duke iu ndihmuar dhe lehtësuar atyre punët, e të mos jetë keqbërës dhe ngatërrimtar. Duhet të aplikojë urdhëresat njerëzore dhe humane në jetën e tij me qëllim që të jetojë i njerëzishëm me veten, familjen, rrethin dhe shoqërinë e vet.

LEGJISLACIONI GJITHËPËRFSHIRËS (UNIVERSAL)

Prej veçorive të Legjislacionit Islam është edhe veçoria universale apo gjithëpërfshirëse, e cila përfshin secilin segment të jetës, madje kjo e dallon këtë legjislacion nga fetë, botëkuptimet filozofike dhe pikëpamjet e ndryshme.[86] Ky universalitet përfshin kohën në tërësi, përfshin jetën dhe qenien njerëzore në tërësi.[87] Nuk merr vetëm këtë jetë e të lërë botën tjetër, sikurse që nuk merr vetëm çështjet ekonomike,

[85] Ibni Hibani në Sahihun e tij, nr. i hadithit 475, 530.
[86] Kardavi, Jusuf, *Med'hal li Ma'rifeti-l Islam-Mukavematuhu, Hasaisuhu, Ehdafuhu, Mesadiruhu*, bot.II, Mektebetu Vehabijeh, Kajro-Egjipt, 1422h-2001m, fq. 153.
[87] Kardavi, Jusuf, *El-Hasais el-Ametu Li-l-Islam*, bot.V-të, Mektebetu Vehabijeh, Kajro-Egjipt, 1419h-1999m, fq. 95.

shoqërore apo politike e të braktisë ato morale...kurrsesi...është legjislacion gjithëpërfshirës për tërë qenien e njeriut dhe universal për secilën çështje madhore e të rëndësishme.[88]

Ky universalitet përfshin aspektin e adhurimeve, i cili rregullon raportet e njeriut me Zotin e tij, e që ndryshe njihet si *"Fikh-ul-Ibadat"*, që përfshin pastërtinë, namazin, agjërimin, haxhin, sakrificën, premtimet, betimet, zotimet etj., gjë që nuk njihet në legjislacionet që i formuloi njeriu.

Gjithashtu ky legjislacion përfshin aspektin familjar, i cili rregullon raportet familjare, si fejesa, martesa, divorci, përkujdesja, furnizimi, testamenti, trashëgimia, e të ngjashme, raporte këto që përqendrohen në formimin e familjes, ruajtjes dhe përkujdesjes së saj. Në legjislacionet laike kjo quhet e "drejta familjare"

Legjislacioni Islam përfshin edhe aspektin e transaksioneve, ndërrimeve dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore si shitblerja dhe llojet e saj, huaja, qiraja, kompania e përbashkët, konkurrenca, pengu etj.

Ashtu sikurse që përfshin aspektin ekonomik, që ka të bëjë me pasurinë, shpërndarjen dhe rregullimin e saj, po ashtu ka të bëjë me organizimin e thesarit (bejtu-l mal), sqarimin e resurseve dhe shpërndarjet nga zeqati, plaçka e luftës, preja e luftës, e të ngjashme me to.[89]

Përveç kësaj, ky legjislacion përfshin edhe aspektin e ndëshkimit të krimeve, të cilat i ka përcaktuar Ligjvënësi si ndëshkimet (hudud) dhe shpagimet (kisas), e që ndryshe njihet si e drejta civile (fikh-ul ukubat).

Sikurse që përfshin edhe aspektin e vërtetësisë së provave dhe procedurave gjyqësore, të cilat ndërlidhen me gjyqësinë, si dhe aspektin e ligjeve, aspekteve kushtetuese dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.[90]

Me fjalë tjera, Legjislacioni Islam është sistem gjithëpërfshirës për gjitha çështjet e jetës dhe veprimet e njeriut, e ky përshkrim ndaj këtij

[88] Kutb, Muhamed, *El-Islamu Kebedilun an-il Efkar ve-l Akaid el-Mustevredetu ve Ebhathun Uhra*, bot. I-rë, Mektebetu-s Suneh, Kajro-Egjipt, 1413h-1993m, fq. 40.
[89] Kardavi, Jusuf, *Med'hal Lidiraseti-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 142.
[90] Op. Cit.:fq. 143.

legjislacioni është përshkrim real, i vërtetë dhe i qëndrueshëm, pra është universal me tërë fjalën.[91]

Hasan el-Benna, lidhur me këtë veçori të Legjislacionit Islam ishte shprehur: "Është një mision përfshirës që shtrihet deri në pafundësinë temporale, që i përmbledh horizontet e të gjitha bashkësive njerëzore; një mision i cili në aspekt të thellësisë i përfshin si çështjet e kësaj, ashtu edhe të botës tjetër."

Ky legjislacion është mision i të gjitha kohëve dhe për të gjithë brezat, e nuk është i kufizuar me një shekull ose periudhë të caktuar. Sikurse që nuk është i kufizuar as me ndonjë bashkësi, popull ose shtresë të caktuar. Është një mision përfshirës, i cili i drejtohet çdo komuniteti, çdo race, çdo klase shoqërore, e cila nuk jep pretekste që ndonjë etnitet të pretendojë se është popull i zgjedhur dhe se të gjithë popujt duhet t'i nënshtrohen atij.[92] Madje ky legjislacion nuk është mision i një shtrese shoqërore, e cila e gëzon të drejtën t'i nënshtrojë shtresat tjera, të cilat do të punojnë konform leverdisë dhe pasioneve të veta, t'i mbajë nën prangat e hegjemonisë së vet.

Ky legjislacion është një mision i qartë që vlen për të gjitha fazat e jetës së njeriut; është udhëzim hyjnor që e shoqëron njeriun gjatë tërë jetës së tij, që nga fëmijëria, puberteti, rinia, pjekuria dhe pleqëria, në të gjitha këto faza, pa marrë parasysh vendin dhe kohën, njeriut i ofron një metodë të përkryer për rregullimin e jetës, të cilën e do dhe e pëlqen Allahu.[93] Madje ky universalitet dhe kjo gjithëpërfshirje e orienton njeriun në të gjitha veprimet e njeriut, qofshin ato shpirtërore apo trupore, individuale apo shoqërore, fetare, politike, ekonomike dhe morale.

---

[91] Zejdan, Abdulkerim, *Usul-ud-Da'veti*, fq. 52.
[92] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të Islamit*, fq. 117.
[93] Op. Cit.:fq. 119.

Legjislacion gjithëpërfshirës në çdo pikëpamje

Legjislacioni Islam ka një vizion të gjerë e të hapët që kultivon direktivat e tij në mënyrën më të mirë të mundshme.

Është sistem i plotë që jep shpjegime për gjitha çështjet e rëndësishme të ekzistencës së njeriut, që njeriun nuk e ka lënë pa informata për gjërat esenciale, duke përfshirë secilën lëmi. Ky legjislacion përveç asaj që u tha sipër flet edhe për forcat e armatosura, mjetet luftarake...: ***"E ju përgatituni sa të keni mundësi force,*** *(mjete luftarake)**, e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre*** *(që tradhtojnë)* ***e me të,*** *(me përgatitje)**, ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini*** *(se kush janë)**, e Allahu i di ata."***[94]

Flet dhe jep indikacione për shëndetin publik, mjafton të cekim rastin e liderit Talut[95], të cilin Ligjvënësi e zgjodhi për shkak të diturisë dhe fuqisë trupore (fizike): ***"...Ai tha: "Allahu e zgjodhi atë sundues tuajin dhe e pajisi me dituri të gjerë e me fuqi trupore"!..."***[96] Në këtë kontekst është edhe thënia e të Dërguarit të Allahut, i cili ka thënë: ***"Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu sesa besimtari i dobët, por në të dy ka mirësi."***[97]

Flet për shkencën si mënyra më e mirë për t'u lidhur me fuqinë dhe forcën, duke e bërë shkencën obligim për secilin individ. Lexo se çka thotë në shkëndijat e para që i zbritën njerëzimit: ***"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi*** *(çdo gjë)**. Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur*** *(në mitrën e nënës)**. Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi*** *(njeriun)* ***të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte."***[98] ***"...Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim."***[99] I Dërguari i Allahut përca-

---

[94] Kur'ani, Enfal: 60.
[95] Ky lider në librat e çifutëve dhe krishterëve njihet me emrin Saul.
[96] Kur'ani, Bekare: 247.
[97] Muslimi në Sahihun e tij, nr. i hadithit 4816; Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. i hadithit 4158.
[98] Kur'ani, Alak: 1-5.
[99] Kur'ani, Zumer: 9.

ktoi që politeistët e zënë robër në betejën e Bedrit duhet që njëri prej tyre të mësojë fëmijët e myslimanëve për të mbetur pastaj i lirë.

Legjislacioni Islam rëndësi të posaçme i jep kodit moral, etikës dhe parimeve morale. Ligjvënësi qartazi ka deklaruar: ***"Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten."***[100] Ligjvënësi e ka përcaktuar se reforma e shoqërisë mbështetet në reformën e moralit: ***"...Allahu nuk e prish gjendjen e një populli*** *(nuk ua largon të mirat)* ***përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre..."***[101]

Për ngritjen e një populli dhe shteti duhet të bëhen reforma në çështje ekonomike, e legjislacioni islam nuk e neglizhon as këtë aspekt, por ka direktiva të qarta: ***"Mendjelehtëve*** *(të papjekurve)* ***mos u jepni pasurinë tuaj që Allahu e bëri për ju mëkëmbje, e ata ushqeni nga ajo, veshni dhe u thoni fjalë të mira."***[102] Lidhur me balancimin mes shpenzimeve dhe të hyrave (të ardhurave) thotë: ***"Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe*** *(mos u bë koprrac)****, e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë*** *(nga shpenzimi i tepërt)****."***[103]

Ky legjislacion flet edhe për institucionet publike, ku jep indikacione për respektin individual, shoqëror, familjar, shtetëror dhe marrëdhëniet mes qeverisë dhe popullit të saj, si dhe mes dy qeverive apo dy shteteve.[104]

Legjislacioni Islam mbron minoritetet dhe u jep të drejta të plota atyre që jetojnë në vendin islam, madje me një tekst që do ta citojmë do të shohim se çfarë porosit Ligjvënësi ndaj armiqve dhe kundërshtarëve, tekst i cili nuk do koment: ***"Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë."***[105] Madje, ky legjislacion ka ndaluar miqësinë vetëm me ata që i luftojnë myslimanët për shkak të fesë dhe që i dëbojnë apo bëhen ndi-

[100] Kur'ani, Shems: 9-10.
[101] Kur'ani, Rad: 11.
[102] Kur'ani, Nisa: 5.
[103] Kur'ani, Isra: 29.
[104] Benna, Hasan, *Toward the light*, fq. 7.
[105] Kur'ani, Mumtehine: 8.

hmues për dëbimin nga shtëpitë e tyre: ***"Allahu ua ndalon t'u afroheni atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes dhe të Allahut."***[106]

Përveç kësaj, ky legjislacion nuk ndalon kooperimin dhe bashkëpunimin mes Lindjes (myslimanëve) dhe Perëndimit (jo-myslimanëve) në fusha të ndryshme, si sigurimi, marrëveshja, traktate etj., e për traktat Ligjvënësi ka paraparë që ai të zbatohet dhe për të do të ketë përgjegjësi: ***"...Premtimin zbatonie, pse për premtimin ka përgjegjësi."***[107]

Për të mos u zgjeruar më tepër, me fjalë të shkurtra mund të konkludojmë se ky legjislacion flet për reforma praktike, politike, gjyqësore, administrative, që njihen si synime të rëndësishme, sikurse që flet për synimet edukative, sociale, ekonomike, si dhe për shumë synime tjera.

- vijon -

[106] Kur'ani, Mumtehine: 9.
[107] Kur'ani, Isra: 34.

Mr. Ejup Haziri

MAIN CHARACTERISTICS OF ISLAMIC LEGISLATION

(Summary)

Divine legislation

Islamic legislation has a number of characteristics which make it different from other legislations. Islamic legislation is wide-ranging and eternal.

Its main characteristic is its divinity.

According to Arab scholars, the divine is connected to the word God, but it also has to do with humans as something divine (if they maintain their connection to God), practice his religion, believe in his book and teach these to others. Within this context Allah stated in the Qur'an: **"It is not possible for a mortal that after Allah gave him the Book, the wisdom and prophethood, then he could say to mankind: Be my slaves rather than Allah's. (He would say): Be worshippers of the Lord because of your teaching the Book and your reading (it yourselves).**"

أيوب حازيرى

الخصوصيات الرئييسية للتشريع الاسلامى

(خلاصة البحث)

التشريع الالهى :

التشريع الاسلامى لديه بعض الخصوصيات تميزه عن بقبة التشريعات فهذا التشريع هو شامل و دائم الى ان يبقى الانسان على وجه الارض.

من المميزات المهمة لهذا التشريع و هى متعددة و لكنها تجتمع حول ميزة واحدة اساسية و هى الاولهية و كما يعبر عنها العلماء و تمت صلتها الى الله سبحانه و تعالى و هذه الميزة لها صلة بالانسان الذى لديه شىء من الاولهية اذا حافظ صلته بالله اذا عرف و طبق دين الله و اذا امعن بكتابه و قام بتعليمها الى الاخرين و فى هذا المعنى يقول الله تبارك و تعالى فى سورة آل عمران الاية 79:

مَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُؤْتِيَهُ اللَّهُ الْكِتَابَ وَالْحُكْمَ وَالنُّبُوَّةَ ثُمَّ يَقُولَ لِلنَّاسِ كُونُوا عِبَادًا لِي مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَكِنْ كُونُوا رَبَّانِيِّينَ بِمَا كُنْتُمْ تُعَلِّمُونَ الْكِتَابَ وَبِمَا كُنْتُمْ تَدْرُسُونَ

STUDIME

Akademik Enes Kariq

AL-MUQADDIMA
VEPRA KRYESORE E IBN HALDŪNIT

Tarif Khalidi[1] pohon se gjatë shtatë shekujve të parë të kulturës dhe qytetërimit islam në planin e studimeve historike janë dalluar "katër objekte apo fusha epistemike apo epistematike", të cilat në mënyrë kronologjike janë paraqitur me këtë radhitje:

a) Tradita e shenjtë dhe transmetimet e saj - *Hadîth* (حَديث),
b) Letërsia, tekstet e bukura, argëtuese dhe këshilluese - *Adab* (أدَب),
c) Literatura urtake, teozofike dhe filozofike - *Hikma* (حكْمَة), dhe
d) Shqyrtimet shtetërore, politike dhe shoqërore - *Siyâsa* (سيَاسَة).

Tarif Khalidi thekson se kultura arabe-islame, nëpërmjet (dhe me ndërmjetësimin) e këtyre "katër objekteve apo fushave epistemike" është përpjekur "ta kundrojë të kaluarën", "t'i shkruajë kohët e shkuara" dhe të kërkojë kuptimin e brendshëm të ngjarjeve të kaluara.

Në planin e epistemës së *hadîthit* (حَديث) udhëheqës janë Muhammad ibn Is'hâq (vd. 151/761), pastaj Ahmad ibn Yahyâ al-Baladhurî (vd. 279/892), deri sa në foremësimin e epistemës së *adabit* (أدَب)

[1] Shih Tarif Khalidi, *Arabic historical thought in the classical period* (Mendimi arab historik në periudhën klasike), seria Cambridge Studies in Islamic Civilization, botimi Cambridge University Press, Cambridge, 1996.

emrat më të rëndësishëm janë 'Amr ibn Bahr al-Gâhiz (vd. 255/868) dhe 'Abdullâh b. Muslim Ibn Qutaybe (vd. 276/889).

Tarif Khalidi, më tej pohon se në profilimin e fushës epistemologjike të *hikmes* (حكْمَة) dallohen emrat e 'Alî ibn al-Husayn al-Mas'ūdît (vd. 345/956), 'Abdu'l-Qâhir al-Bagdâdîut (vd. 429/1037) dhe Abù Muhammad 'Alî ibn Sa'îd ibn Hazmit (vd. 456/1064). Është e kuptueshme që fushën e katërt epistemiologjike të *siyâses* (سيَاسَة) Tarif Khalidi e ka mbajtur para së gjithash për Ibn Haldūnin e famshëm (vd. 808/1406) dhe *al-Muqaddimen* e tij.

Ndër të gjitha veprat e Ibn Haldūnit *al-Muqaddima* veçohet si kontributi më i rëndësishëm, më i stërholluar dhe më burimor i tij për mendimin e pjekur dhe, sipas disave, të vonshëm mysliman në shtatë shekujt e parë të kulturës dhe qytetërimit islam. *Al-Muqaddima* është arritje e cila ka bërë që Ibn Haldūnin ta numërojnë ndër lëvizësit e mendimit botëror (جَعَلَهُ مِنْ رُوَّادِ الْفِكْرِ الْعَالَمِيِّ).[2] Hannâ al-Fâhùrî dhe Halîl al-Garr pohojnë se kjo vepër e Ibn Haldūnit është "pasqyrë e gjallë e jetës shoqërore në mjedise të ndryshme": (وَكَانَت الْمُقَدِّمَةُ صُورَةً حَيَّةً لِلْحَيَاة الاجْتمَاعيَّة فى مُخْتَلف الْبيئات ...).[3] Po këta autorë pak më tutje thonë se Ibn Haldūni ka kaluar pesë muaj për shkrimin e versionit të parë të *al-Muqaddimes*, e pastaj i është kthyer kësaj vepre në disa raste, duke e përkryer, pastruar dhe plotësuar kapitujt e saj (ثُمَّ عَادَ عَلَيْهَا بَعْدَ ذلكَ بالتَّهْذيبِ وَالتَّنْقيحِ وَالزِّيَادَةِ).[4]

Në kuptimin formal *al-Muqaddima* është, në fakt, libri i parë apo hyrës apo përmbledhje e shqyrtimeve propedeutike dhe gjerësisht të shtruara parimore për historinë e tij të përgjithshme, të cilën Ibn Haldūni e quajti me fjalët *Kitâbu al-'Ibar wa dîwânu al-mubtadâ' wa al-habar fî ayyâmi al-'arab wa al-'agam wa al-barbar wa man âsarahum min dawî' al-sultâni al-akbar*.[5] (M. Talbîu e shënon veprën e Ibn

[2] Krhs.: Hannâ al-Fâhùrî dhe Halîl al-Garr, po aty, fq. 477.
[3] Krhs.: po aty, fq. 477.
[4] Krhs.: po aty, fq. 477.
[5] كِتَابُ الْعِبَرِ وَ دِيوَانُ الْمُبْتَدَأ وَالخَبَرِ فِى أيَّامِ الْعَرَبِ وَالْعَجَمِ وَالْبَرْبَرِ وَمَنْ عَاصَرَهُمْ مِنْ ذَوِى السُّلْطَانِ الأكْبَرِ

Haldūnit Librin e këshillave *apo Kitâbu al-'Ibar* me sintagmën *his universal history,* "historia e tij universale-botërore").[6]

Një botim i Kajros të *al-Muqaddimes* shprehimisht pohon se *al-Muqaddima* është "pjesa e parë e Librit të këshillave...": (الْجُزْءُ الأَوَّلُ مِنْ كِتَابِ الْعِبَرِ). Por, botimi i Bejrutit i *al-Muqaddimes* nga viti 1981 nuk përmban kurrfarë vërejtjesh redaktoriale apo të redaksisë se *al-Muqaddima* është pjesa hyrëse e *Librit të këshillave,* por ky botim, sipas të gjitha gjasave, është përgatitur si i veçantë, sigurisht për arsye komerciale.

Tashmë siç kemi thënë, *al-Muqaddima* përbëhet nga shqyrtimet e larta propedeutike, në të cilat Ibn Haldūni flet për pikëpamjet e tij mbi historinë njerëzore dhe shoqërinë njerëzore, mbi qytetërimin, ekonominë, mbi shtetet, sunduesit ... Tashmë më herët kemi theksuar se Ibn Haldūni e ka shkruar versionin e parë të *al-Muqaddimes,* sikur edhe disa fletore të tjera të *Librit të këshillave,* gjatë periudhës prej katër vjetëve (prej 1375 deri 1379, sipas kalendarit gregorian), derisa jetonte në pallatin e Ibn Salâmës.

Numri më i madh i hulumtuesve pohon se atëherë Ibn Haldūni i ka shkruar vetëm projektet e para apo versionin preliminar të historisë së tij të përgjithshme apo *Kitâbu'l-'Ibar*, por redakturën e parë themelore të historisë së tij të përgjithshme e ka bërë pas kthimit në Tunizinë e lindjes. M. Talbîu pohon se *Librin e Këshillave* apo *Kitâbu al-'Ibarin* Ibn Haldūni gjithnjë e ka plotësuar dhe përpunuar:

Ai pa pushim, deri në fund të jetës së tij, e ka përshkruar-plotësuar këtë vepër të tij themelore, e sidomos *al-Muqaddimen*.[7]

Al-Muqaddima është gjetur, zbuluar dhe gjithnjë e më shumë është lexuar dhe hulumtuar gjatë tre shekujve të fundit (XVIII, XIX dhe XX), sidomos në Evropë. Praktikisht, mund të konfirmohet se rëndësia grandioze e *al-Muqaddimes* është zbuluar pikërisht në kontinentin evropian. Për shembull, M. Talbîu vëren se rëndësia dhe vlera e *al-Muqaddimes,* së pari janë zbuluar në Stamboll në periudhën e von-

[6] EI, po aty, p. 826.
[7] EI, po aty, p. 828.

shme të Perandorisë Osmane, kur është vërejtur tashmë shkatërrimi i kësaj perandorie:

Historiani osman Na'imâ (vdiq 1128/1716) e lavdëron Ibn Haldūnin në hyrje për veprën e tij dhe ofron pasqyrën e ideve të tij. (Përkthimin e parë në gjuhën turke të një pjese të *al-Muqaddimes* e ka punuar *shayh al-islâm* Piri-zade Mehmed Ef., në vitin 1143/1749. Përkthimin më të ri, të tërësishëm në gjuhën turke e ka bërë Zakir Qâdîri Ugan, dy vëllime, Stamboll, viti 1954. Megjithatë, Ibn Haldūni është zbuluar në Evropë, aty është kuptuar rëndësia e *al-Muqaddimes* së tij, nga ana e d'Herbelotit (*Bibliotheque Orientale,* 1697), Silvestre de Sacyit (*Chrestomatie arabe,* 1806.), von Hammer-Purgstallit (*Ueber den Verfall des Islam..*, 1812.) dhe sidomos nga Quatremerei i cili, në vitin 1858, e bëri botimin e parë të tërësishëm të *al-Muqaddimes* - një botim tjetër të saj e ka publikuar Nasr al-Hùrînî po atë vit në Kajro, e bazuar në një dorëshkrim tjetër, i cili përmban përkushtim të veçantë për sulltanin e Fesit, Abū Fârisin (ka sunduar në periudhën 796-799 hixhrij 1394-1397 gregorian. Rëndësinë e *al-Muqaddimes* e ka zbuluar edhe de Slane, i cili, pas disa vitesh pas vitit 1858 e bëri përkthimin e parë francez të saj (*Le Prolegomenes,* Paris, 1863-1868. Pas kësaj ekziston një varg i pandërprerë botimesh dhe studimesh për *al-Muqaddimen,* edhe në Lindje edhe në Perëndim, që është dëshmi e interesimit në rritje për mendimin e Ibn Haldūnit, kurse para do kohe kishte aq shumë botime dhe studime për *al-Muqaddimen* sa janë bërë të domosdoshme punimet bibliografike për ta (i kanë punuar H. Peres dhe W. J. Fischel). Përkthimi më i ri në gjuhën angleze nga F. Rosenthali (në tri vëllime, New York-London, 1958) ka përparësi sepse është bërë në bazë të dorëshkrimit të Stambollit (Atif Efendi, 1936), i cili përmban shënimin e *Ibn Haldūnit* i cili thotë se dorëshkrimi "është kontrolluar shkencërisht" nga ai personalisht. Gjithashtu duhet theksuar edhe përkthimin portugalez, të cilin e ka bërë Khoury në tri vëllime, Sao Paolo, 1958-1960, dhe përkthimin francez të V. Monteilit...[8]

[8] EI, po aty, p. 828 - 829.

Autografi i Ibn Haldunit (lart majtas në kënd)
Nga MS. C (Atif Effendi 1936)

Nga ky citat më i gjatë njihet së paku pjesa e kujdesit të madh intelektual, të cilin Evropa ia ka kushtuar *al-Muqaddimes*. Të shtojmë këtu së paku kalimthi edhe disa fakte për përkthimin e *al-Muqaddi-*

mes, sikur edhe të pjesëve të tjera të librit *Kitâbu al-‘ibar* në disa gjuhë evropiane.

Historiani turk Ahmet Xhevdet Pasha (vdiq 1895) e përktheu pjesën VI të *al-Muqaddimes në gjuhën turke*, respektivisht e përfundoi dhe tërësisht e kompletoi përkthimin e Piri-zadesë të *al-Muqaddimes në turqishte*.[9] Gjithashtu, tërheqim vëmendjen se me përkthimin e veprës *Kitâbu al-‘ibar* të Ibn Haldūnit është marrë edhe hsitoriani turk, Abdulatif Subhi Pasha (vd. 1886). Në turqishte e përktheu pjesën e II dhe III të kësaj vepre.

Kur janë në pyetje përkthimet franceze të *al-Muqaddimes* apo, studimet për të në gjuhën frënge, ka nevojë që krahas emrit të De Slaneas dhe Etienne Quatremereas (i cili e botoi *al-Muqaddimen në* Paris në vitin 1858 në gjuhën arabe, në tre vëllime) të theksohen edhe emrat vijues: F. F. Schulz, Sylvestre de Sacy, Garcin de Tassy, Coquebert de Montbret, A. Noël des Vergers...

Në gjuhën gjermane veprat e Ibn Haldūnit veçanërisht i kanë prezantuar dhe studiuar Joseph von Hammer, W. Tiesenhausen, R. Rochricht, Annemarie Schimmel dhe Erwin Rosenthal.

Ndërmjet këtyre specialistëve gjermanë të cilët janë marrë me Ibn Haldūnin e veçojmë Annemarie Schimmel, e cila në vitin 1951 e botoi një përmbledhje të teksteve nga *al-Muqaddime* me titull: *Ibn Chaldūn, Ausgewählte Abschnitte aus der Muqaddima, aus dem Arabischen übersetz und eingeleitet*, Tübingen, 1951, një pjesë të këtij libri e ka përkthyer në gjuhën boshnjake Salim A. Hadžić në revistën tuzllase “*Hikme”t.*[10]

Janë punuar edhe disa studime apo përkthime më të vogla në gjuhën latine nga vepra e *Kitâbu al-‘ibar* të Ibn Haldūnit. Për shembull, C. J. Tornberg ka shkruar studimin *Notitia de populo Berberorum ex Ibn Khaldūno in primordia dominationis Murabitorum*, i publikuar në Nova Acta R. Soc. Scient. Upsal., XI, 1839, pp. 315-336, sikur edhe pp. 398-400.

---

[9] Krhs.: ‘Abdurrahmân Badawî, po aty, fq. 173.
[10] Shih: Annemarie Schimmel, *Ibn Haldūn – filozof povijesti*, Hikmet, VIII, nr. 9, Tuzla, 1995, fq. 402-404.

Nga C. J. Tornberg është edhe vepra *Ibn Khaldūni narratio de expeditionibus Francorum in terras islamismo subjectas, ex codicibus Bodleianis editit*, i publikuar në *Nova Acta regiae societatis Upsaliensis*, XII, 1844.

Në gjuhën angleze *al-Muqaddimen* pjesërisht dhe me studime hyrëse e kanë përkthyer shumë sosh. Kështu D. B. Macdonald ka shkruar veprën *Ibn Khaldūn: A Selection from the Prolegomena of Ibn Khaldūn*, Leiden, 1905. (reprinti është publikuar më 1948).

Ky libër ka shënime të shumta, sikur edhe fjalorin terminologjik anglisht-gjermanisht të Ibn Haldūnit. R. A. Nicholson i ka inkuadruar pjesë të vogla nga *al-Muqaddima* në veprën e tij *Translations of Eastern Poetry and Prose*, Cambridge, 1922. Në këtë punimin tonë në shumë vende të tjera posaçërisht e përmendim Charles Issawiun dhe Franz Rosenthalin, të cilët kanë dhënë kontribute të mëdha në prezantimin dhe përkthimin e *al-Muqaddimes* për lexuesit anglez.

Të përmendim këtu se veprën e Ibn Haldūnit *Kitâbu al-'ibar* veçanërisht e kanë hulumtuar P. de Gayangos (*The History of the Mohammedan Dynasties in Spain*, London, 1840) dhe H. Cassels Kay (në veprën e tij *Yaman, its early medieval history*, London, 1892, gjendet kapitulli *"The History of Yaman extracted from the General History of 'Abd ar-Rahmân ibn Khaldūn").*[11]

Gjithashtu, disa personalitete e kanë studiuar dhe përkthyer *al-Muqaddimen* dhe *Kitâbu'l-'ibar* në gjuhën italiane.

Michele Angelo Lanci, në bazë të pjesëve të dorëshkrimeve të Ibn Haldūnit, të cilat ruhen në bibliotekën e Vatikanit, ka shkruar një vepër për shkathtësinë e shkrimit. Vepra e tij në gjuhën italiane quhet: *Dissertacione storico-critico su gli omireni e loro forme di scrivere trovate nei Codici Vaticani. Appresso e un articulo di Eben Caliduno intorno all'arabesca paleografia.* Vepra u paraqit në Romë në vitin 1820.

J. Graberg af Hemso ishte aventurieri i parë kur janë në pyetje dorëshkrimet e veprave të Ibn Haldūnit. Ka udhëtuar shumë në kërkim të

[11] Krhs.: 'Abdurrahmân Badawî, po aty, fq. 209 - 210.

tyre dhe më në fund ka shkruar një shqyrtim për historinë e Ibn Haldūnit. Me fjalë të tjera, në Firencë, në vitin 1834, u botua vepra e J. Graberg af Hemsovit, me titull *"Notizia intorno alla famosa opera istorica d'Ibn KHaldūn, filosofo affricano del sec. XIV. Dedicata all'-Em. Mo D. Giac. March. Brigole"*.

Gjithashtu, njëfarë G. di Asti Arri është marrë me librin *Kitâbu al-'ibar*, dhe se në Paris, në vitin 1840, ka publikuar përkthimin e pjesës së dytë të kësaj vepre të Ibn Haldūnit në gjuhën italiane me titull: "*Ebn Khaldoun da Tunisi: Storia generale degli Arabe e di alcuni celebri popoli loro contemporanei dalla loro origine fino al Kalifato di Moavia"*.

Siç thekson Abdurrahmân Badawîu,[12] një historian i madh nga Sicilia, Michele Amari, ka përkthyer në gjuhën italiane pjesë të *Kitâbu al-'ibar*, sidomos ato pjesë lidhur me Sicilinë. Studimi i tij *"Altri frammenti Arabi relativi alla Storia d'Italia"*, është publikuar në Romë në vitin 1889.

Kur janë në pyetje shekujt XIX dhe XX, në botën arabe Ibn Haldūnit nuk i është kushtuar kujdes më i madh, së paku kështu ka qenë deri në vitet e pesëdhjeta të shekullit XX.

Me këtë rast është me interes të theksojmë Sâti'al-Husarîun e shkathët, i cili në veprën e tij *"Studime për al-Muqaddimen e Ibn Haldūnit"* (دِرَاسَاتٌ عَنْ مُقَدِّمَة ابْنِ خَلْدُونَ) me keqardhje pohon se mjedisi intelektual arabo-musliman nuk i kushtoi kujdes më të madh kësaj vepre. Për më tepër, ai pohon se të gjitha botimet lindore të *al-Muqaddimes*, të cilat ai i ka konsultuar, thuajse janë pa shpjegime dhe komente: (فَجَميعُ الطَّبْعَات الشَّرْقِيَّة تَكَادُ تَكُونُ خَالِيَةً مِنَ الشُّرُوحِ وَالتَّعْليقَات), për dallim prej përkthimit francez të *al-Muqaddimes*, i cili ka qindra e qindra shpjegime dhe komente (وَالتَّرْجَمَةُ الْفَرَنْسِيَّةُ مَمْلُوءَةٌ بِمئات وَمئات مِنَ الشُّرُوحِ وَالتَّعْلِيقَات).[13] Pastaj kritika e Sâti' al-Husarîut, me të drejtë kthehet kundër shumë lëshimeve të redakturës, parregullsive dhe gabimeve të shtypit në botimet

[12] Krhs.: 'Abdurrahmân Badawî, po aty, fq. 200 - 202.

[13] Al-Husarî, Sâñî', *Dirâsât 'an Muqaddimati bni Haldùn*, izd. Dâru l-Ma'ârif, Kajro, 1951., fq. 3.

arabe të *al-Muqaddimes.* Për shembull, nganjëherë ka botime me fjalë krejt të paqarta. Kështu tërësia:

قَالَ كَبِيرُهُمْ أَفْلاَطُونُ إِنَّ الإلهِيَّات لاَ يُوصَلُ فيهَا إلى أينين

Është krejt e paqartë, sepse fjala (أينين) në tërësinë e sipërme nuk do të thotë asgjë! Në vend të kësaj fjale duhet të qëndrojë fjala *al-yaqîn* (الْيَقِين), dhe përkthimi do të thoshte: *I pari i tyre Platoni pohon se nëpërmjet shkencave hyjnore nuk arrihet deri te e besueshmja - e vërteta!* [14]

Gjithashtu, Sâti‘ al-Husarîu po në këtë vend thekson se disa botime arabe përmbajnë gabime të rënda logjike, të themi, tërësia (الْعُلُومُ الآلِيَةُ), që do të thotë shkencat përgatitore apo shkencat propedeutike, gabimisht është shkruar në formën (الْعُلُومُ الإلهِيَّةُ), që do të thotë *shkencat hyjnore*![15]

Kështu e ka humbur krejtësisht kuptimin, e cila është intenduar nga Ibn Haldūni!

Sâti‘ al-Husaarîu, me dëshpërim dhe pezm, thekson edhe shembullin se sintagma e Ibn Haldūnit الْحَقِيقَةُ الْمُتَعَقِّلَةُ (e vërteta *racionale*, *fakti racional*, *i arsyes*) është shkruar gabimisht në formën الْحَقِيقَةُ الْمُتَعَلِّقَةُ (“fakti i lidhur/ i varur”).

Por, nuk ka qenë i shkujdesur dhe arrogant vetëm akcesi redaktorial dhe redaktues ndaj *al-Muqaddimes* në disa qarqe akademike arabe. As personaliteti i Ibn Haldūnit nuk kaloi më mirë në mendimin modernist dhe nacionalist arab.

Në qarqet reformatore dhe moderniste arabe gjatë shekullit XX nuk kanë qenë të rrallë ata të cilët e kanë sulmuar rreptë veprën e Ibn Haldūnit *Kitâbu al-‘ibar* (duke e inkuadruar këtu, natyrisht edhe hyrjen e asaj vepre apo të *al-Muqaddimes*). Sulmet i udhëhoqën Tâhâ Husayn (vd. 1971), Salâmah Mūsâ, Ahmad Amîn e të tjerë.

Problemi thelbësor në kritikat e tyre të mendimit dhe pikëpamjes së Ibn Haldūnit mbi historinë përbëhet nga perceptimi i tyre (i gabueshëm) i fjalës *arabi* (الْعَرَبُ) në *al-Muqaddimen e tij*. Me fjalë të tjera,

[14] Al-Husarî, Sâñî‘, po aty, fq. 3.
[15] Al-Husarî, Sâñî‘, po aty, fq. 3.

Ibn Haldūni me këtë fjalë tregon për arabët (banorët e Arabisë), të cilët janë nomadë. *Nuk tregon në ata të cilët ishin arabë të qyteteve, banorë arabë qytetarë apo të urbanizuar*. Sipas Ibn Haldūnit, gjatë historisë arabët nomadë kanë depërtuar në qytete dhe, meqë nuk ishin të denjë për të arriturat qytetëruese, shumë qytete dhe shtete shpesh, nën drejtimin e tyre, i janë lënë rrënimit dhe shkatërrimit. Për përfundimet e tilla në *al-Muqaddime* nacionalistët arabë iu kanë nënshtruar kritikave të rrepta.

Me fjalë të tjera, vërtet ka shumë vende në *al-Muqaddime*, ku Ibn Haldūni shtron pikëpamjen e tij për fiset nomade arabe. Ai pohon se janë “bashkësi e egër, të cilët u përmbahen shprehive të egra”: (أُمَّةٌ وَحْشِيَّةٌ باسْتِحْكَامِ عَوَائد التَّوَحُّش), egërsia tek ata në të vërtetë “është bërë natyrë dhe gjë e lindur”: (فَصَارَ لَهُمْ خُلُقًا وَ جبلَّةٌ), së këndejmi, tek ata është bërë shprehi kundërshtimi nga sistemi i pushtetit: (وَ كَانَ عِنْدَهُمْ مَلْذُوذًا لمَا فيه مِنَ الْخُرُوجِ عَنْ رُتْبَةِ الْحُكْمِ), nuk dëshirojnë “t’i nënshtrohen rendit, politikës” (و عدم الأنقياد للسِّيَاسة), kurse natyra e tyre nomade është e kundërt me qytetërimin dhe me këtë konfliktuohet: (وَ هذه الطَّبيعَةُ مُنَافيَةٌ للْعُمْرَانِ و مُنَاقضَةٌ لَهُ).[16]

Mirëpo, Tâhâ Husayn, Salâmah Mūsâ, Ahmad Amîn dhe shumë letrarë dhe reformatorë arabë, pastaj nacionalistët dhe reformatorët arabë, kanë konsideruar se Ibn Haldūni është pjesëtar i lëvizjes *ash-shu‘ūbiyyah* (الشُّعُوبِيَّةُ)[17] i cili, në fakt, siç mendojnë ata, është përpjekur t’i zvogëlojë vlerat kulturore dhe qytetërore të arabëve si *popull*, e jo si *nomadë.*

Tâhâ Husayni madje në tekstet e tij për Ibn Haldūnin ka shtruar dyshimet në prejardhjen e tij arabe (إعْلاَنُ الشَّكِّ فى نَسَبه), kurse nën ndikimin e Tâhâ Husaynit, përkthyesi i tij nga gjuha frënge, Muhammad ‘Abdullah ‘Inâni, përndryshe studiues i veprës së Ibn Haldūnit, Ibn Haldūnit, shprehimisht ia mohon prejardhjen arabe, dhe thotë:

[16] Fragmentarisht e cituar apo gjerësisht e perifrazuar nga faqet e *al-Muqaddimes,* Bejrut, 1982, fq. 262-272.
[17] *Ash-Shu‘ûbiyya* është lëvizje e cila është paraqitur në kohën klasike islame, e cila përfaqësonte barabarësinë e popujve të tjerë muslimanë me arabët. Kjo lëvizje nuk ua pranonte arabëve ndonjë përparësi të veçantë në raport me popujt e tjerë muslimanë.

يَنْتَمِي فِي الْوَاقِعِ إِلَى الشَّعْبِ الْبَرْبَرِيِّ

"Ibn Haldūni i përket në fakt popullit berber!"[18]

Tâhâ Husaynin dhe Muhammad ʻAbdullah ʻInânin në këtë e kanë kontestuar Sâtîʻ al-Husarîu, pastaj Fu'âd al-Bustânîu dhe shumë të tjerë.[19]

Tâhâ Husayni në disa raste ka kontestuar edhe vlerat morale të Ibn Haldūnit, sa që do të mund të mendohej, siç pohon Karwi, se letrari egjiptian e ka shkruar veprën e tij për Ibn Haldūnin, me qëllim të kontestimit të thjeshtë dhe shtrembërimit të biografisë së tij.[20]

Do të na çonte larg nëse do t'i theksonim të gjithë shembujt pa dyshim të shëmtuar, të cilët Tâhâ Husayni i shtron dhe i përmend lidhur me Ibni Haldūnin. Por, disa këtu do t'i theksojmë. Ai për Ibn Haldūnin shumë herë thekson se ishte sedërmadh (حُبُّ الذَّات), se i ishte nënshtruar egoizmit (الأَنَانِيَّةُ), se ishte skajshmërisht i pangopur: (لَهُ أَطْمَاعًا لاَ حَدَّ لَهَا) etj. Tâhâ Husayni shton edhe më se Ibn Haldūni kishte prirje për mashtrim dhe tradhti (الْخِيَانَةُ), gjoja i ka sakrifikuar edhe besimin edhe moralin që t'i kënaqë dëshirat e tij etj. Gjoja, kësi sakrifikimi të besimit dhe të fytyrës nuk ka shënuar tërë historia myslimane! [21]

Për më tepër, Tâhâ Husayni pohon se Ibn Haldūni autobiografinë e tij (*al-Taʻrîf*) e ka shkruar vetëm nga shkaku i të folurit të vetëpëlqyer për veten![22]

---

[18] Muhammad ʻAbdullah ʻInân, *Ibn Haldûn, hayâtuhu wa turâthuhû'l-fikriyyu*, Kajro, 1953., fq. 142.

[19] Krhs.: Karw, po aty, fq. 50 – 51.

[20] حَتَّى يَكَادَ الْقَارِئُ يَعْتَقِدُ أَنَّ طه لَمْ يُؤَلِّفْ كِتَابَهُ إِلاَّ للطَّعْنِ فِي ابْنِ خَلْدُونَ وَ تَشْوِيهِ سِيرَتِهِ ...

Krhs.: Karw, po aty, fq. 51-52.

[21] وَ إِنَّهُ لَمْ يُوجَدْ فِي تَأْرِيخِ الْمُسْلِمِينَ رَجُلٌ مِثْلَ ابْنِ خَلْدُونَ مَضَحِّيًا بِالدِّينِ وَ الأَخْلاَقِ فِي سَبِيلِ أَطْمَاعِهِ ...

[22] انّهُ لَمْ يَكْتُبْ تَرْجَمَتَهُ إِلاَّ حُبًّا فِي التَّحَدُّثِ عَنْ نَفْسِهِ ...

Sipas: Tâhâ Husayn, *Falsafatu bni Haldūna '-gtimâ'iyyah*, Kajro, 1925, fq. 23-24. (Falënderim të veçantë i shprehim Osman Llavićit, bibliotekistit të Bibliotekës së Gazi Husrevbegut në Sarajevë, i cili na dha në disponim këtë vepër).

Ahmad Amîni në veprat e tij *Duha al-Islâm* dhe *Fajru al-Islâm* pranon gjykimin se Ibn Haldūni ka qenë "pjesëtar ekstrem i *shuʻūbiyyatit'* (شُعوبِيًا مُتطرِّفًا), por pak më vonë lëshohet në vlerësimin e statusit të Ibn Haldūnit te Zoti i dashur:

وَ لَكِنَّهُ فِي رَأْيِنَا كَانَ مُسْلِمًا حَقًّا حُرَّ التَّفْكِيرِ فِي حُدُودِ الدِّينِ ...

"...Sipas mendimit tonë, Ibn Haldūni ka qenë mysliman i vërtetë, intelektual i lirë në kufij të fesë!"[23]

Salâmah Mūsâ, nga ana e tij, pohon se Ibn Haldūni e ka "zvogëluar rëndësinë e qytetërimit arab" (تَنَقُّصُهُ لِحَضَارَةِ الْعَرَبِ).[24] Në vazhdim, pak më tutje, por po në këtë faqe, Salâmah Mūsâ me pezm shton se shkaku i raportit të tillë të Ibn Haldunit ndaj qytetërimit arab është verbëri e thatë (أَعْمَى كَامِلَ الْعُمْيِ) dhe jo vetëm kjo se "Ibn Haldūni ka qenë berber, i cili i urrente arabët!" (أَنَّهُ الْبَرْبَرِيُّ يَكْرَهُ الْعَرَبَ). Pas kësaj, Salâmah Mūsâ shkon edhe më tej dhe Ibn Haldūnin e paraqet si vjedhës, i cili "ka vjedhur tërë atë që e kanë shkruar *Vëllezërit e dëlirë* (إِخْوَانُ الصَّفَاءِ), dhe këtë ia ka përshkruar vetes!"[25]

Është e kuptueshme që nuk mund t'i theksojmë të gjitha akuzat që skena nacionaliste arabe i ka shtruar kundër Ibn Haldūnit. Abū al-Qasim Muhammad Karw me mjaft arsyeshmëri ka treguar se Ibn Haldūni në *al-Muqaddime* (sikur edhe në tërë opusin e tij të *Kitâbu al-ʻibar*) kurrë nuk e përdor fjalën *al-ʻarab* (الْعَرَبُ) në trajtën dhe sintagmën e saj moderne ideologjike *'al-ummah al-ʻarabiyyah'* (الأُمَّةُ الْعَرَبِيَّةُ) apo *ummeti arab!* Përkundrazi, në *al-Muqaddime* fjala *al-ʻarab* (الْعَرَبُ) është sinonim për nomadët apo atë që në arabishte edhe shprehet me fjalën *al-badw* (الْبَدْوُ) - beduin! Karwi në librin e tij *Arabët dhe Ibn Haldūni* (الْعَرَبُ و ابْنُ خَلْدُونَ) në më shumë se njëqind faqe ka treguar se fjalët *badwun* (بدْوٌ) dhe *hadrun* (حَضْرٌ) qëndrojnë në kundërshtim apo

---

[23] Ahmad Amîni ka shkruar një pasqyrë bashkëkohore të periudhave të qytetërimit islam në disa vëllime dhe me titujë karakteristik: *Fajru'l-Islâm (Agimi islam), Duha'l-Islâm (Mëngjesi islam), Dhuhru'l-islam (Mesdita islame).* Këtë vepër e theksojmë sipas: Karw, po aty, fq. 92-93-94.

[24] Cituar sipas: Karw, po aty, fq. 93.

[25] ثُمَّ إِنَّهُ سَرَقَ كُلَّ مَا كَتَبَهُ إِخْوَانُ الصَّفَاءِ وَ عَزَاهُ إِلَى نَفْسِهِ .

Cituar sipas: Karw, po aty, fq. 93.

në opozitën linguistike kuptimore, e para i shënon nomadët, kurse e dyta popullsinë qytetëruese apo të civilizuar, brezat qytetare. Fjalët e gjuhës klasike arabe *al-'arab* (الْعَرَبُ) dhe *al-badw* (الْبَدْوُ) shpesh përdoren si sinonime, kurse dëshmia më e mirë është vetë përdorimi kur'anor i fjalës *al-a'râb* (الأعْرَابُ) në kuptimin e *beduinëve*, njerëzit të cilët vetëm formalisht e kanë pranuar islamin, por që në islam nuk kanë jetuar aq gjatë ("besimi islam nuk iu ka hyrë në zemra!") që me të të qytetërohen, fisnikërohen.[26]

Abū al-Qasim Muhammad Karwi në shumë vende në librin e tij në mënyrë të argumentuar ka treguar se tek Ibn Haldūni nuk ka të bëjë me anësinë berbere (النَّعَرَةُ الْبَرْبَرِيَّةُ) dhe urrejtjes ndaj arabëve dhe sulmit mbi ta (التَّهَجُّمُ عَلَى الْعَرَبِ), porse në pyetje është instrumentariumi konceptual ndjeshëm i ndërtuar, brenda të cilit *al-'arab* i shënon beduinët (*al-badwu*).

Marshall G. S. Hodgson, autori i veprës *Heroizmi i Islamit*, të historisë më të mirë të kulturës dhe qytetërimit islam në tri vëllime të mëdha, nga ana e tij në mënyrë rezolute pohon se Ibn Haldūni me termin *arabët* mendon për *beduinët:*

When a pre-Modern Arabic writer, such as Ibn Khaldūn, said something uncomplimentary about 'arabs, he was usually speaking only of the Bedouin.

(Kur ndonjë autor paramodern arab, siç është Ibn Haldūni, të thotë diç që nuk është lajkatare për arabët, ai zakonisht flet vetëm për beduinët).[27]

Këta disa shembuj tregojnë se është e nevojshme, nëse për këtë te ne në Bosnjë kurdoherë vjen koha, që të hulumtohet dhe krahasohet historia dhe perceptimi i veprës së Ibn Haldūnit në botën arabe dhe islame edhe në Perëndim. Nuk e kemi për qëllim këtu as për së afërmi

[26] قَالَتِ الأعْرَابُ آمَنَّا قُلْ لَمْ تُؤْمِنوا وَ لكِنْ قولوا أسْلَمْنَا وَلَمَّا يَدْخُلِ الإيمَانُ فِي قُلُوبِكُمْ
"Beduinët thanë: "Ne kemi besuar!" Thuaj: "Ju nuk keni besuar ende, por thoni: ne jemi dorëzuar, e ende nuk po hyn besimi në zemrat tuaja!" Krhs.: Kur'an, *al-Huxhurât*, XLIX, 14.

[27] Marshall G. S. Hodgson, *The Venture of Islam, Conscience and History in a World Civilization*, 1. The Classical Age of Islam, Chicago/London, 1977, p. 62.

ta përcaktojmë historinë e *al-Muqaddimes* në qarqet kulturore evropiane apo arabe. (Jemi të vetëdijshëm se tash për shumë prej nesh për diç të tillë nuk mungon hapësira, por mungon koha, por edhe dija).[28]

Përktheu nga gjuha boshnjake:
N. Ibrahimi

[28] Shkëputje e kapitullit 9 nga vepra: Enes Karic, Ibn Haldun – Uvod u citanje Al-Muqaddime, 1429 h/2008, e cila pritet të botohet në të ardhmen në gjuhën shqipe.

Enes Kariq

AL-MUQADDIMA THE MAIN WORK OF IBN HALDŪN

(Summary)

According to Tarif Khalidi, during the first 7 centuries of Islamic culture and civilization Arabic historiography was subject to the influence of 4 major epistemic discourses in a chronological succession:

a) Hadîth or the sacred traditions (حَدِيث),
b) Adab or belles lettres (أدَب),
c) Hikma or the natural and social sciences (حِكْمَة), and
d) Siyâsa or political theory and practice (سِيَاسَة).

According to Tarif Khalid, through these epistemic discourses Arab-Islamic culture tries to “study the past” and to find its inner meaning.

The most distinguished names in hadith oriented historiography (حَدِيث) are Muhammad ibn Is’hâq (151/761) and Ahmad ibn Yahyâ al-Baladhurî (279/892) whereas, the most distinguished names in adab oriented historiography (أدَب) are ‘Amr ibn Bahr al-Gâhiz (255/868) and ‘Abdullâh b. Muslim Ibn Qutaybe (276/889).

انيس كاريش

"المقدمة " أهم كتاب لابن خلدون

(خلاصة البحث)

يقول طاريف خالدى بان خلال القرون السبعة الاولى تم ظهور سبعة مجالات و التى حسب التسلسل ظهرت على النحو التالى:

أ) احاديث النبى (صلعم) و نقلها (حديث).
ب) الآداب و النصوص الجميلة للتسلية و العظة (الآداب) .
ج) الحكم و الفلسفة (الحكمة) .
د) شوؤن الدولة و السياسة و الاجتماع (سياسة) .

طاريف خالدى يقول بان الثقافة العربية و الاسلامية عن طريق هذه المجالات الاربع استطاعت ان تنظر الى الماضى و ان تكتب عنها و تطلب التفسير الداخلى عن الاحداث الماضية .

PËRVJETOR

Ramadan Shkodra

Me rastin e 20-vjetorit të vdekjes

MYDERRIZ HASAN EFENDI NAHI - ARSIMDASHËS E PATRIOT I SHQUAR

Një ndër intelektualët, myderrizët, arsimdashësit e patriotët e shquar të popullit tonë të shekullit 20, nuk ka dyshim se ishte edhe Hasan ef. Islami, i njohur dhe i popullarizuar me emrin Hasan efendi Nahi-Xhahenemi, i cili tërë jetën e tij ia kushtoi arsimimit, edukimit dhe fisnikërimit të popullit në përgjithësi, kurse gjeneratave të reja në veçanti.

Megjithëqë pati fatin që të jetonte dhe të vepronte në kohë të vështira e kthesash të mëdha, dhe të përballej me regjime të ndryshme, Hasan ef. Nahi më përkushtim, devocion e urtësi, pasion e dashuri, iu përkushtua dhe i qëndroi afër popullit dhe bashkëvendësve të tij.

Biografi

Hasan ef. Nahi u lind në Gjakovë në një familje të madhe e me zë, nga babai Islami dhe nëna Xhemilja më 12 mars 1905. Të parët e tij dalloheshin në kultivimin e traditës fetare e kombëtare. Babai i tij, Islam efendiu ishte myderriz shumëvjeçar i Medresesë së Madhe të Gjakovës, kurse gjyshi i tij haxhi Jaha ka qenë hoxhë e personalitet i nderuar dhe i respektuar në Gjakovë e rrethinë.

Shkollimi

Hasan Nahi mësimet e para i mori në Gjakovë, së pari mbaroi Mektebin katërklasësh, e më pastaj për dymbëdhjetë vjet mësoi në Medresenë e Madhe të Gjakovës, të cilën e përfundoi me sukses dhe mori ixhazetnamenë. Në medresenë e Madhe të Gjakovës dhanë mësim myderrizë e pedagogë të shquar, të cilët këtë institucion e kishin shndërruar në një vatër të arsimit dhe edukimit kombëtar e fetarë dhe nga e cila dolën një plejadë e tërë e intelektualëve dhe personaliteteve që do të bëhen prijës të shumë proceseve me rëndësi jetike për popullin shqiptar.

Meqë Hasan efendiu gjatë mësimeve në medrese kishte treguar suksese dhe ishte dalluar në mësime, sidomos në lëndën e gjuhës arabe, pas kryerjes së saj u emërua si asistentë/ligjërues i sintaksës së gjuhës arabe në këtë medrese.

Student në Kajro

Mirëpo, Hasan efendiu nuk mbeti me kaq, por dëshira e madhe që të kryente studimet e larta e çoi në Misirin e Largët të Mehmet Ali pashës. Kështu në vitin 1930 Hasan Nahi së bashku me bashkëvendësit e tij mulla Tahir Brovinën dhe Mulla Asllanin u regjistrua në Universitetin “Al-Azhar”, në Fakultetin “Kismi Ali”, që do të thotë “Shkalla më e lartë e dijenive fetare”.

Gjatë studimeve në Kajro Hasan efendiu u tregua i përkushtuar e i zellshëm, dhe arriti që studimet t’i përfundonte në afatin më optimal dhe diplomoi në vitin 1934.

Në Kajro, përveç të tjerash, Hasan efendiu u njoh dhe u shoqërua me shumë studentë gjithandej trojeve shqiptare dhe nga vendet e tjera të Ballkanit, të cilët, më vonë, pas kthimit në vendet e tyre, do të luanin rol me rëndësi në jetën shoqërore, fetare dhe politike, si fjala vjen Sadik Bega nga Shqipëria, Bedri Hamidi nga Shkupi, Mumin efendiu nga Kumanova, Mehmed Hanixhiq, Kasim Dobraqa e Besim Korkuti nga Bosnja. Hasan efendiu gjatë kësaj kohe u njoh dhe u miqësua

edhe me poetin e njohur turk me prejardhje shqiptare Mehmet Akif Ersojin.

Kthimi në atdhe

Pas përfundimit të studimeve Hasan ef. Nahi, me gjithë mundësitë dhe rrethanat që të mbetej në Kajro, dashuria për vendlindjen dhe për Atdheun e bënë që të kthehej dhe dijet që kishte marrë t'i vinte në shërbim të popullit të tij. Për këtë Hasan efendiu thoshte: **"Kisha vetëm një dëshirë: Të jam në Kosovë dhe ta ushtroja profesionin tim në interes dhe në dobi të popullit tim".**

Hasan efendiu sejar-vaiz

Me t'u kthyer nga Kajroja, Ulema Mexhlisi me qendër në Shkup më 1935, Hasan ef. Nahin do ta emërojë në detyrën e Sejjar-Vaizit. Në këtë detyrë Hasan efendiu do të qëndroj për tri vjet ku dha një kontribut dhe u shqua për mënyrën e shpjegimit dhe të komentimit të mësimeve të fesë islame. Një rëndësi të posaçme Hasan efendiu në derset, vaziet dhe ligjëratat e tij, si nëpër qyrsi, hytbe e xhami, po ashtu edhe nëpër odat shqiptare dhe kudo që vente, i kushtoi ngritjes së vetëdijes së masave të gjëra popullore për arsimim dhe edukim. Këtë e shpjegonte me binomin fe e atdhe dhe me nevojën për t'u shkolluar në gjuhën kombëtare.

Ligjëratat e Hasan efendiut kudo që shkonte përcilleshin me interesim të madh nga ana e besimtarëve. Mënyra e shpjegimit, e ligjërimit, afërsia me popullin, sjellja e tij me modesti e urti dhe sidomos ligjërimi në gjuhën shqipe, bënë që Hasan efendiu të mos ngelte një hoxhë dhe alim lokal i një vendi, por ai u bë i njohur gjithandej Kosovës dhe më gjerë.

Hasan efendiu myderriz në Medresenë e Ferizajt

Kjo mbase ndikoi që më 1938 qytetarët e Ferizajt të kërkonin nga Hasan ef. Nahi që të merrte detyrën e myderrizit në medresenë e Ferizajt.

Mësimet në kohën sa ishte myderriz Hasan ef. Nahi, do t'i ndiqnin shumë nxënës jo vetëm nga Ferizaj dhe rrethina e tij, por vinin nxënës edhe nga Shkupi, sepse këtu mësimi bëhej në gjuhën shqipe.

Hasan efendiu myderriz në medresenë e Mehmet pashës në Prizren

Në prill të vitit 1943, Komuniteti Mysliman Shqiptar me seli në Tiranë, i cili organizonte dhe mbikëqyrte jetën fetare edhe në Kosovë, do ta emëroj Hasan ef. Nahin myderriz kryesor dhe drejtues të medresesë "Mehmed Pasha" të Prizrenit. Në këtë detyrë ai do të qëndroj deri në vitin 1948 kur kjo medrese me një traditë afro katër shekullore në mënyrë arbitrare dhe me ca arsyetime banale do të mbyllej nga pushteti socialist komunist që dalë ngadalë po nguliste thonjtë në Kosovë.

Për mbylljen e medresesë, myderriz Hasan Nahi, thoshte: **"Më thanë, se nuk na duhej një shkollë e tillë në Kosovë, mjaft e keni një në Sarajevë. T'i veshë drynin një medreseje të tillë do të thoshte: Ndal diturive fetare në gjuhën shqipe".**

Hasan efendiu kryemyfti i Dukagjinit

Në qershor të viti 1943 Komuniteti Mysliman Shqiptar me seli në Tiranë, Hasan ef. Nahin do ta emëroj Kryemyfti të Zonës së Dukagjinit. Detyrë kjo të cilën do ta kryej deri në vitin 1946 kur edhe suprimohet ky funksion.

Pas mbylljes së medresesë "Mehmed Pasha" më 1948, Hasan ef. Nahi do të shpallej nga pushteti si person i papërshtatshëm dhe nuk do

t'i lejohej të ushtronte ndonjë funksion tjetër përveçse të imamit, për se deri më 1958 Hasan ef. Nahin e gjejmë si imam në Gjakovë.

Në një studim të mbështetur në dokumente arkivore të historianit Hakif Bajrami jepen të dhëna për planet sekrete të UDB-së për likuidimin dhe shpërnguljen me dhunë të ulemave të Kosovës, ndër të tjerash, edhe për Hasan ef. Nahin, ku thuhet;

"Prej të gjithë ylemave, si ideologu më "i rrezikshëm", që me mësimet e tij nuk do të lejonte që shqiptarët të shpërngulen në Anadolli, ishte cilësuar Hasan efendi Nahi (Hoxhë Xhehnemi). Pse të mos e themi se për likuidimin e tij ishte angazhuar krimineli Voja Vojvodiq, që punonte në Pejë, por që i kishte agjentët e vet kudo. Po mençuria e efendi Hasan Nahit do të triumfojë".

(Dituria Islame nr. 86, Prishtinë 1996, fq. 26)

Hasan efendiu përkrahës e sensibilizues i shkollës shqipe

Gjatë kësaj kohe Hasan efendiu do të vihet me tërë qenien në përkrahje dhe të masivizimit të arsimit në gjuhën shqipe. Ai për këtë nuk la asnjë rast dhe as vend pa e përmendur rëndësinë, vlerën dhe nevojën e shkollimit në gjuhën amtare.

Dhe jo vetëm kaq, por përveç se kishte ngritur zërin kundër mbylljes së medresesë "Mehmet Pasha" në Prizren, ai fuqishëm kishte dalë në mbrojtje të Gjimnazit të Gjakovës dhe shkollës shqipe në përgjithësi në vitet e pesëdhjeta.

Kështu në qershor të vitit 1956 në një tubim me struktura e pushtit të asaj kohe, e që për synim kishin që gjimnazin e Gjakovës ta bënin shkollë profesionale (teknike). Hasan efendiu atë kohë qe i pari që ashpër e kundërshtoi këtë nisëm të pushtetarëve të atëhershëm. Hasan efendiu në bashkëbisedim me pushtetarët e atëhershëm, argumentoi fuqishëm se Gjakovës dhe shqiptarëve në përgjithësi, si popullsia më e prapambetur, asokohe, në Jugosllavi, u nevojitej pikërisht gjimnazi, si shkollë që do të krijonte kuadro të afta për të vazhduar studimet në Universitete.

Ndërsa gjatë viteve 60-70, Hasan efendiu përkrahu fuqishëm klasën intelektuale shqiptare në odisejaden e tyre për të siguruar të drejtën e shqiptarëve për të pasur një universitet ku do të shkolloheshin shqiptarët e ish-Jugosllavisë në gjuhën e tyre amtare.

Sa ishte i përkushtuar Hasan efendiu në përkrahjen e shkollës shqipe më së miri mund të kuptojmë nga shënimi në të përditëshëm e asaj kohe "Rilindja" të datës 2 tetor 1970, në një kronikë për kontributin e Hasan efendiut për shkollën shqipe shkruan:

"Hasan efendi Nahi dha 10 mijë dinarë për shkollat". Kronika ka të bëjë me një aksion të kohës për të ndihmuar përhapjen e shkollave shqipe nëpër Kosovë. Për këtë arsye, në këtë kronikë shkruan: "Që në ditën e parë të regjistrimit të huasë për ndërtimin e objekteve shkollore, Hasan ef. Nahi profesor i gjuhës arabe në medresenë e mesme "Alaudin" në Prishtinë i regjistroi 10.000 dinarë të rinj. Hasani që është shumë i nderuar, jo vetëm prej besimtarëve por edhe nga të gjithë ata që e njohin është i njohur si dashamirë i flaktë i arsimit". Më tutje, në kronikë, thuhet: "Qëllimi kryesor, thotëHasan efendiu, ka qenë t'i këshilloj, ndihmojë dhe udhëzojë besimtarët që fëmijët e tyre t'i shkollojnë, t'u japin dritë e dije". Autori i kronikës nuk lë pa përmendur faktin se Hasan efendiu ka shkolluar të gjithë fëmijët e vetë.

Hasan efendiu myderriz
në medresenë "Alauddin" në Prishtinë

Më 1958, Hasan ef. Nahi do të caktohet profesor për lëndën e Kuranit dhe lëndët e tjera fetare në medresenë e Ulët të Prishtinës. Gjatë kësaj kohe Hasan efendiu përveç angazhimit të tij si myderriz, u angazhua pareshtur për shndërrimin e medresesë nga ulët në medrese të mesme, e barasvlershme me gjimnazet e kohës.

Mirëpo, puna dhe aktiviteti i Hasan efendiut nuk kishte mbetur pa u rënë në sy strukturave të atëhershme politike, të cilët e përcillnin me shumë kujdes çdo aktivitet të myderriz Hasan efendiut, por i cili me asnjë çmim nuk hiqte dorë nga pikëpamjet dhe misioni i tij.

Si pedagog në medrese Hasan ef. Nahin do ta shquajnë përkushtimi i tij ndaj nxënësve dhe sjelljet prindërore ndaj atyre si dhe metodologjia e mësimdhënies. Është i fundit nga brezi i hershëm i ulemave që në mësime aplikonte një metodë klasike, një si akademi, me rastin e mësimdhënies.

Detyrën e profesorit në medresenë "Alauddin" të Prishtinës, do ta kryej për 20 vjet rresht, deri në korrik të vitit 1978. Gjatë kësaj kohe Hasan efendiu kishte arritur t'i nxirrte tri gjenerata me nxënës që vinin po thuajse nga të gjitha rrethet e Kosovës, nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Sanxhaku, gjenerata këto që edhe sot e kësaj dite njihen si gjeneratat e Hasan ef. Nahit.

Gjatë punës së tij në medrese dhe nga përvoja me nxënës, Hasan ef. Nahi kishte vënë re nevojën e patjetërsueshme se shqiptarët duhet të kishin edhe një fakultet ku Islami do të mësohej në gjuhën shqipe. Ky vizion dhe dëshirë jo vetëm e Hasan efendiut, por e gjithë ulemasë së gjeneratës së tij, u bë realitet në fillim të viteve të nëntëdhjeta.

Hasan efendiu përkthyes i Kuranit

Hasan ef. Nahi ishte i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm se besimtarëve myslimanë shqiptarë u duhej përkthimi i Kuranit në gjuhën e tyre, në mënyrë që t'i kuptojnë më mirë e më drejtë mësimet dhe porosit e Allahut xh.sh. Prandaj, megjithëqë i shtyrë në moshë dhe në pension, por i vetëdijshëm për rëndësinë që ka përkthimi i Kuranit në gjuhën shqipe, më 1978 nisi të përkthente në gjuhën shqipe ajetet e para të kaptinës "El-Fatiha" për të vazhduar deri në ajetin e fundit të kaptinës së fundit të Kuranit Fisnik, përkthim ky që doli nga shtypi më 1988. Përkthimin e Kuranit, myderriz Hasan ef. Nahi e kuptonte si një obligim fetar dhe kombëtar. Për këtë çështje në hyrje të përkthimit të tij të Kuranit, do të shkruaj: "**Është detyrë e dijetarëve fetarë për ta përkthyer Kuranin në gjuhën e popullit të vet.**"

Përkthimi i Kuranit në gjuhën shqipe nga Hasan ef. Nahi njihet si një ndër përkthimet më popullore në trojet shqiptare dhe i cili ka përjetuar disa ribotime në Kosovë dhe Shqipëri dhe lexuesit shqipfolës nga Instituti i mendimit dhe Qytetërimit Islam i është ofruar edhe në versionin audio vizual në format DVD.

Hasan efendiu ndërroi jetë më 5 shkurt 1991, në Prishtinë, duke u ndarë kështu nga familja e tij e dashur, nga ish-nxënësit e tij që aq shumë e deshën dhe i deshi, u nda nga xhematlinjtë e tij që aq shumë e respektuan dhe e nderuan. Hasan ef. Nahi u nda nga kjo botë në të cilën mbolli shumë fidanë shpresëdhënës e frytësjellëse dhe të cilës i dha shumë punë të hairit e të bereqetshme, ashtu edhe siç jetoi ashtu edhe vdiq, i dalluar në kuptimin e plotë të fjalës, i thjeshtë e modest dhe admirues i zjarrtë i arsimit dhe i së vërtetës, popullor në çdo pikëpamje, me virtyte e cilësi të larta prej myderrizi, dijetari e intelektuali të nderuar.

Hasan ef. Nahi pas vetës kishte lënë një bibliotekë të pasur me libra e dorëshkrime në gjuhë të ndryshme, disa prej tyre të trashëguara nga ish të parët e tij myderrizët e Medresesë së Madhe të Gjakovës.

Vdekja e Hasan ef. Nahit ishte humbje e madhe për të gjithë ne, por në të njëjtën kohë vepra dhe kontributi i tij mbeten një kandil i pashuar dhe një pishtarë që prore ndriçon.

Hasan ef. Nahi edhe njëzet vjet pas vdekjes së tij është edhe sot një frymëzim i gjallë për ish-nxënësit e tij dhe për të gjithë ata që e njohën, madje jo vetëm për ato që la fjala dhe pena e tij, por edhe për karakterin dhe personalitetin e shquar unikal e origjinal.

Literatura:

- Autobiografi e Hasan efendi Nahit, e shkuar më 25 shtator 1989. Një kopje të autobiografisë më ka dhuruar i biri i Hasan efendiut, Faik Nahi në janar të vitit 2011.
- Sadik Bega, Reportazh mbi vizitën e Kryetarit të Komunitetit Mysliman shqiptar në Kosovë, Kultura Islame nr.3-4 Tiranë, fq.74-82.
- Elez Osmani, Puna, suksesi dhe kuadrot e dhënë ma zgjasin jetën (intervistë), Dituria Islame nr. 18, Prishtinë 1990, fq. 12-16.

- Resul Rexhepi, Myderriz i nderuar, Dituria Islame nr. 22, Prishtinë 1991 fq. 14.
- Vehap Shita, I nderuari Hasan efendi hoxhë dhe mësues i popullit, Dituria Islame, Prishtinë 1991 nr. 22, fq. 16-17.
- Dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956, Dituria Islame nr. nr. 86, Prishtinë 1996, fq. 26.
- H. Jupa, Hasan efendi Nahi dha 10 mijë dinarë hua për shkolla, Rilindja 2 tetor 1970, fq.
- Mehmet Halimi, Medreseja e Ferizajt fliste shqip, "Bujku" 15 korrik 1996, fq. 6.
- Elez Ismaili, Ishte hoxhë dhe tribunë i popullit të vetë, El-Hilal, - Shkup, prill 1991, fq. 8.

Ramadan Shkodra

On the 20-th anniversary of the death of

MUDERIS HASAN EFENDI NAHI – SCHOLAR AND DISTINGUISHED PATRIOT

(Summary)

One of the most distinguished Albanian intellectuals, muderis, scholars and patriots in the XX-th century was Hasan ef. Islami, also known as Hasan efendi Nahi-Xhahenemi, who dedicated his whole life to the education and ennoblement of the Albanians in general, and the younger generations in particular.

Despite living in very difficult times and having to deal with different regimes, Hasan ef. Nahi was deeply committed to his nation.

رمضان شكودرا

في ذكرى المدرس حسن أفندى ناحى محب للتعليم و رجل وطنى مشهور

(خلاصة البحث)

لا شك أن حسن أفندى اسلامى يعتبر من اهم شخصيات القرن العشرين ليس فى كوسوفا بل فى الوطن الالبانى بأكمله اذ اشتهر بحبه للتعليم و الوطنية و التضحية لاجل الدين و الوطن . كان معرفا بلقبه حسن أفندى ناحى او جهنمى و قد كرس كل حياته لتعليم شعبه و خاصة الاجيال الجديدة .

مع انه عاش و عمل فى فترات زمنية صعبة و تحولات كبرى و تحت انظمة مختلفة الا انه بامان و اخلاص و تفان ادى عمله فى صالح شعبه و وطنه و ما كان ربه و يرضى ضميره .

PËRVJETOR

Akademik Feti Mehdiu

REFLEKSE KUR'ANORE NË POEZINË E MEHMET AKIFIT (Verzioni për prezentim....)

Kam kënaqësinë që me rastin e festimit të 90-vjetorit të himnit kombëtar turk (12 mars, 1921-2011) të paraqes para këtij auditori të nderuar disa venerime të mia për autorin e këtij himni, një muhaxher nga Kosova - Mehmet Akif Ersojin.

Jam i nderuar edhe nga fakti se këtu kemi të bëjmë me një poet - hafiz të Kur'ani kerimit dhe gjithashtu përkthyes të Kur'ani kerimit.

Mehmet Akif Ersoy është një poet i rrallë në literaturën Islame, i cili për krijimtarinë e tij poetike ka vjelë nektarin nga Kur'ani kerimi dhe i ka afruar lexuesit burimin konkret me sure dhe me ajet.

Dy shkrimtarë tjerë, që kanë zbatuar rrugë të ngjashme në veprat e tyre, Naim Frashëri, për të cilin mund të thuhet se ka qenë bashkëkohanik i Mehmet Akifit dhe Mehmed (Mesha) Selimoviq, i cil ka jetuar pas Mehmet Akifit, nuk i afronin lexuesit shënimet e plota konkrete. Ata vetëm sinjalizonin se janë ushqyer me Kur'an por nuk e jepnin as suren as ajetin dhe në përkrthimin e tyre ishin shumë të lirë.*

Shoqërimi i Mehmet Akif Ersojit me Kur'ani kerimin ka filluar qysh në fëmijrinë e hershme kur mësonte gjuhën arabe, Kur'an dhe gjuhën persishte, kurse në vitin 1894 kreu hifzin te hfz. Isa efendiu.

Ka shprehur respektin më të lartë sa i përket Kur'ani kerimit si vepër e patejkalushme në literaturën botërore nga të gjitha aspektet përfshirë këtu edhe çështjen e përkthyeshmërisë, të stilit, përsosmërisë poetike, juridike etj. Prandaj, edhe nuk e kishte pranuar, në fillim, propozimin që ta përkthejë Kur'ani kerimin në gjuhën turke.* Këto vlera të Kur'anit i kanë pranuar edhe studiues jomyslimanë.

Do të përmendim këtu mendimin e studjuesit John Naish, i cili në vitin 1937 me rastin e një botimi në Oxford që i referohej Kur'anit thoshte: *"Fjalitë e tij të theksueshme me stil konciz.... kanë atë fuqi shprehëse dhe energji eksplozive që është gati e pamundshme të ruhen edhe në përkthim"**

Mendim i shprehur i Mehmet Akifit se për t'i hyrë përkthimit të Kur'ani kerimit duhet të jesh dijetar i përkryer ose xhahil i guximshëm,* (*Bu ishi basharabilmek için ya alim - i kul, ya da cvahil-i cesur olmak lazim")* mund të arsyetohen vetëm me rrethanat konkrete kur jetoi ai, në një kohë kur mbretëronte fryma e revolucionit bolshevik në Turqinë e poetit Mehmet.

Për kohë të tjera,* duhet modifikuar vetëm kushtin e parë, do të thotë *"duhet të jesh dijetar i guximshëm"* sepse të tjerat janë në kompetencë të Krijuesit të gjithësisë.

Menjëherë në vitin 1895 Mehmet Akifi botoi një poezi që i kushtohej Kur'anit (Kur ana hitap)*

Në poezitë e Mehmet Akifit të përmbledhura në Safahat (unë këtu kam shfrytzuar botimin në gjuhën shqipe, Fletët, Shkup, 2009, me një vështrim jo të thelluar me botimin në gjuhën turke Safahat, Ankara, 2008), janë zgjedhur rreth 20 ajete dhe janë vënë në ballë të po aq poezive me përmbajtje të ndryshme dhe të patitulluara.* Të gjitha këto poezi në thelb kanë krijesën më fisnike - njeriun: rolin dhe përgjegjësinë e tij në shoqëri.

Poeti qysh në librin e parë, te poezia *Tevhid yahut feryafd*, e përkthyer në gjuhën shqipe: Besim në një Zot apo klithmë, i referohet sures Tin (sureja e 95 të me radhë). Me këtë M. Akifi i tërheq vërejtjen njeriut se ai krahas asaj që është krijesa më fisnike, është edhe krijesa

më e ulët. Poeti i referohet vetëm pjesës së dytë të ajetit: **Thumme redednahu,**

*Kur shpirtërat vetë vuajnë tmerrin e “thumme redednah”**

Për t’i treguar se:

As dhe një grimcë njeriu s’ka mundësi për të shkaëtrruar!
O Zot, ç’është kjo botë e mbushur plot çudi?!
I pafillimt është kufiri i botës engjëllore,
Në pafundësi humbet fundi i botës hyjnore!
Pushteti Yt, para të cilit s’ka gjë që të qëndrojë,
Në një çast e përshkon boshllëkun që s’di të mbarojë!

Në vitin 1913, Mehmet Akifi botoi disa poezi, moto e të cilave qëndron një a më shumë ajete të Kur’ani kerimit,* që u përmblodhën nën titullin *Zërat e së vërtetës** dhe *Kujtime** Përveç kësaj, ajete të Kur’anit në tërësi,* ose pjesërisht,* kemi edhe në poezi tjera të Mehmet Akifit.

Aty ku ajetet janë në funksion të motos, që janë vënë në ballë të poezisë konkrete, fillojnë me “Besmele...” dhe vijnë në origjinal, në gjuhën arabe por të transkribuar, dhe pastaj pason përkthimi në gjuhën shqipe.* Pas kësaj fillon poezia, ku në gjysmë të poezisë ose në fund, paraqitet edhe një herë ajeti i Kur’anit, por i shprehur më lirisht, sipas shijes së poetit.* p.sh.

Kështu fillon libri i tretë: Bismil-lahi.... **Kulil-lahumme malike-l-mulki, tu ti-l-mulke men teshau ve tenziu-l-mulke mimmen tesha**.... deri në fund...

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Thuaj: O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do , e lartëson atë që do ti dhe e përul atë që do. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë” Kur’ani, Al-u Imran: 26,*

Në strofën e dytë kemi: Ti je që jep, Ti je që merr, e gjithë bota Ty të përket
dhe në strofën e tretë: O zot, po të duash, Ti, dhe fisin më fisnik e poshtëron;
Personit më të ulët, virtyte i jep nëse dëshiron!

Qëllimi im në këtë shqyrtim është t’i hedh një sy reflektimit të Kur’ani kerimit në poezinë e Mehmet Akif Ersojit.

Kur’ani kerim këtu nuk reflektohet vetëm në ato poezi kur si moto qëndron ndonjë ajet i Kur’anit sikur te libri i tretë, libri i katërt ose libri i pestë, por porosia e Kur’anit reflektohet edhe në shumë raste tjera të poezisë së Mehmet Akifit.

*Në poezinë Natë, që ia kushton Mjeshtrit të urtë * Ferid Beut, vargjet:*
Miraxhi i sexhdes time shtrihet përdhe, ...
Sexhdeja ime, rënkimi im ta bëjnë të rënkojë tërë gjithësinë, ...
*O saki i pvdekësisë, **Elesti** yt u kujtoftë e u lartësoftë!*

janë thjesht reflektim i Kur’ani kerimit.

Edhe më i fuqishëm është refleksioni te poezija: Kur’anit* kur poeti vazhdon:

turqisht	shqip
Ahmet ki nebiyy-i bi-gümandır, Kur’an ile feyz-yab-i şandır. Fe’ atu... diyerek Resul-i Ekrem, Eylerdi muannidini mulazem. (*Safahat*, s. 560, Ankara)	Ahmedi që është profet i padyshim, Me Kur’anin mori begati e famë! Fe ‘tu duke thënë Profeti bujar, E bënte kokëngjeshurin të mbetej pa fjalë! *(Safahat, Shkup...* 629)
Ya Muhammed, de ki Ey mulkun sahibi olan All llah ım sen mulku diledigne verirsin, sen mulku dieledigiinin elinden alırsın sen diledigine azız edersın sen dıledıgını zelıl edersın hayır yalnız senın elındedır sen hiç şüphe yok ki her şeye kadirsin *Alı İmran 36* *Fq. 251.* Iste sana, anlarin kendi yolsuzluklari yuzunden ipëssëz kalan yurtlari! *Neml suresi, 52, s.254.*	Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!Thuaj: O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do , e lartëson atë që do ti dhe e përul atë që do. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde, vërtetë, Ti ke mundësi për çdo gjë” *Kur ani, Al-i Imran: 36, fq. 293.* 2.Me emrin e All-llahut, ... E këto janë shtëpitë e tyre të mbetura shkret për shkak të mizorisë së tyre... *Kur ani, Neml, 52, fq. 296.*

Edhe disa ilustrime nga poezitë e M. Akifit

Një i vetmuar jam, pa vatër e pa shtëpi; strehim a s'ka?
Kudo heshtje: të paktën një bërtitje "s'ka" a s'ka
Aq i madh qe krimi i tyre pse qenë myslimanë,
Saqë ndëshkimin në krahasim me të, të vogël e panë!
Kapu fort pas shpresës dhe ec, sido që të jetë!
Kush rron, rron me qëndresë e vendosmëri! ....
Mos thuaj: Mbaroi kjo punë, qëndresa nuk ka fund!
Mos u praps o popull i ndjerë, shpresën mos e humb! *
T'i bëhet fli ateizmit të pesë a dhjetë njerëzve pa mend?
*A duhet të zbehet ajo fytyrë e ndritshme e Kur'anit**
... O popull, zgjohu, injorancës tënde po i bëhesh fli!
Edhe Islamin po e merr me vete e po e shemb si ti!....
Por ç'do të thotë Allahun dhe ne të na heshtësh ti?
*Ajme! Ka frikë Allahun ai që ka dituri! " **
Një kohë edhe ne kemi qenë një bashkësi dhe si:
Kemi ardhëur në botë dhe kemi mësuar ç'do të thotë bashkësi!
Po ne? Vështro, tani, dhe mendo ç'paskemi qenë ne!
Si qyrkun, e kemi kthyer përsëprapthi edhe fenë!
*Dhe ashtu e kemi veshur. Shih: ajo çka shëtiti në shesh,**
Mos bjer o popull i mjerë në ngutjen e këtyre,
E njohim mirë ne diturinë e tyre të cunguar:
Lindjen s'e shohin, Perëndimin s'e njohin, s'e kuptojnë;
I vetmi kapital i tyre: fytyrë që nuk skuqet, sy që s'lotojnë!
Dil e sodit harenë ngjyra-ngjyra të pranverës;
Dhe dëgjoje rënien e bririt valë-valë në ditën e ringjalljes!
Me t'i lëshuar fuqi e Zotit tokës një gjak të blertë, një shpirt të blertë,...

Në librin e pestë fillon me ajete...

Se shpërblim i një dëshmori të tillë është fitorja;
*Gjaku do t'i shkojë humbur, o Zot, po s'ia dhe!**

Moralin as kultura, as ndërgjegjja s'e lartëson,
Ndjenja e virtytit te njerëzit nga frika e Zotit buron,
Po qe se nga zemrat është hequr frika e Zotit,
As kultura s ka ç të bëjë...*
Është gabim të presësh çdo të mirë të kësaj bote në ahiret,
*Bota tjetër nga kjo botë e veçantë s'do të jetë! **
N'sa vendqëndrimi i përhershëm i shpirtit të ndarë nga "ezeli"
Është "Ebedi" pse duhet trupat të takohen në rrugë?
*Po qe se pas "elest" - it * nuk vjen xhennet dhe xhehennem, **
Se ç' trimëri e madhe troket në zemër të Kur'anit!
Po ku është ajo ndërgjegje? Te kush ka të tillë besim? *
Nga thirrjet "Kul huvall-llahu ehad rënkojnë..
Kur thuhet Ai s' mendohet as Zoti , as dikush tjetër
*goja e njeriut, "samed" qindra idhuj në stomak! **
Kur individët thonë "un", "ti", uniteti prishet
Dhe atëherë për kombet kiameti fillon...
Dhe do të shohësh se ligji i Allahut nuk ndryshon! *
Shoqërinë thamë ta ndajmë në parti dhe u përçamë,
*U shembën shtyllat që e mbanin popullin të bashkuar në këmbë! **
Vetëm një zemër rron pa ideal, zemra e pabesim!
Të mbështetmi te Allahu? për shekuj u mashtruam!
Te Allahu, jo, te iluzionet që adhurove, u mbështete,
*Nëse u dogje, u dogje se e meritove.... **

Fati i përkthimit të Kur'ani kerimit nga Mehmet Akifi

I brengosur se përkthimi i tij do të keqpërdoret nga reformatorët e entuziazmuar bolshevistë duke i detyruar imamët që të kondojnë Kur'an në namaz në gjuhën turke*ky nuk deshi që përkthimi i tij të vehet në këtë shërbim të padenjë. Mehmet Akifi, në vitin 1936 kur u kthye i sëmurë nga Egjipti në Turqi, përkthimin e Kur'anit ia la myderriz Ihsan efendiut dhe i la porosinë: *"nëse kthehem, e marr, po të mos kthehem digje"** Deri në këtë shkallë e kishte sjellë fryma e bolshevizmit poetin-hafiz dhe përkthyes të Kur'ani kerimit.

Këtë brengë Mehmet Akifi e kishte të përbashkët me hfz Ali Korçën,* dhe të dy luftuan kundër asajë të keqeje të kohës.

Kjo dëshmohet nga përgjegja që i jepte Mehmet Akifi një lexuesi, i cili pyeste:

"Ka që thonë se bolshevizmi është i njëjtë me myslimanizmin, se myslimanët duhet të bëhen patjetër bolshevikë. **A është e drejtë kjo?"**

Kurse poeti i përgjigjej: "Myslimanizmi është tjetër bolshevizmi është tjetër. Ata që mendojnë se janë të njëjtë, ose nuk i kanë kuptuar dot parimet e Islamit, ose nuk e kanë parë të nevojshme ta analizojnë bolshevizmin. Nuk mund të merret me mend që duke pasur Kur'anin dhe hadithin, myslimanët të pranojnë parimet e bolshevizmit. Sa për formën që ka për të marrë në të ardhmen kjo shkollë e re, nuk mund të themi asgjë, sepse e ardhmja është një e panjohur që askush përveç All-llahut nuk mund ta zgjidhë"*

****

Sollëm disa shembuj nga vepra Safahat, në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe, në mënyrë që studiusit e veprës së poetit "Të popullit tonë, të gjuhës sonë dhe të pavarsisë sonë!" Memhmet Akifit, të shijojnë shprehjen e poetit në origjinal - në turqisht dhe në përkthim në gjuhën shqipe, në gjuhën e të parëve të poetit.

L i t e r a t u r a:

- Mehmet Akif Ersöy, **S a f a h a t,** Ankara, 2008. (Milletimizin, Dilimizin ve Istiklalimizin şairi MEHMET AKIF ERSÖY.

- F l e t ë t, safahat/ vepra poetike e plotë, Mehmet Akif Ersoj, Logos-A (Shkup, Prishtinë, Tiranë) 2009.

- Eşref Edib, **Mehmed Akif** - Hayatı Eserleri ve yetmiş Muharririn yzıları, hazırlayan Fahrettin Gün,s/a., s.l. shtëpija botuese BEYAN.

- Şukran Kurdakul, Edbiyatımızda şairler sözlüğü, Istanbul 1973.

- Elmalılı Hamdi Yazar, **Kur'an i kerim ve Turkçe meali,** 2000, Istanbul (temel Naşriyat).

- Kur'ani kerim ve açıklamalı meali, Istanbul, 1989 (Yeni Asya yayınları)

- Mithat Cemal Kuntay, **Mehmet Akif**, 5. Baskı, L-M yayınları.

- Edebiyat antolojisi, Istanbul, 1940 (1923 den sonra yetişen şairlerimiz).

- Mehmed Selimoviç, **Derviş ve ölum** - (çeviren Mahmut Kiratlı) varlık yayınlar, Istanbul, 1973.

- Naim Frashëri, **Vepra - 5,** Prishtinë, 1978. (**Mësime).**

Feti Mehdiu

QUR'ANIC REFLECTIONS IN THE POETRY OF MEHMET AKIF

(Summary)

On the 90th anniversary of the Turkish national anthem I have the pleasure (March 12, 1921 - 2011) to present in front of this distinguished audience a few observations of mine on its author, Mehmet Akif Ersoj, a muhajir from Kosova.

I am also honoured by the fact that we have to do with a poet - hafiz and a translator of the Qur'an.

Mehmet Akif Ersoy is a distinguished poet in Islamic literature, who collected the nectar of the Qur'an (for his works) and offered it to his readers through its suras and ayats.

فتحى مهدى

انعكسات قرآنية فى شعر محمد عاكف

(خلاصة البحث)

لى شرف كبيربمناسبة مرور تسعين عاما للنشيد القومى التركى (12 مارس 1921-2011) ان اقدم امام هذا الجمهور انطباعاتى عن مؤلف هذا النشيد احد المهاجرين من كوسوفا – محمد عاكف ارسوى .

و لى شرف ايضا باننا هنا امام حافظ للقرآن الكريم و مترجم لمعانيه فى نفس الوقت

.

محمد عاكف يعتبر من الشعراء القلائل فى الادب الاسلامى الذي ينهل من عطر القرآن الكريم و يقدم للقارىء نماذج حقيقية من السور و الايات القرآنية.

FILOZOFI ISLAME

Ibrahim Bajjumi Madhkour

STUDIMI I FILOZOFISË ISLAME

Për një kohë të gjatë filozofia islame ishte e mbuluar nga një re dyshimi dhe paqartësie. Disa njerëz e mohonin ekzistencën e saj, ndërsa disa të tjerë e pohonin atë. Kjo pasiguri vazhdoi gjatë gjithë shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ata të cilët e mohonin fort ekzistencën e një filozofie islame trilluan padituri dhe pohuan se mësimet e Islamit nuk janë lartësuar kurrë në ndihmën e filozofisë dhe shkencës gjatë gjithë shekujve të ekzistencës së saj. Frytet e vetme që ka dhënë Islami për pasuesit e tij kanë qenë despotizmi dhe dogmatizmi intelektual, thanë ata. Ata pohojnë se krishterimi, në krahasim me Islamin, ka qenë djepi i mendimit dhe diskutimit të lirë, duke përkrahur artin dhe literaturën, duke përkrahur shkencat, dhe duke u bërë një tokë pjellore për rritjen e filozofisë së re dhe duke e ndihmuar atë që të zhvillohet dhe të japë fryte.[1]

[1] Shih V. Cousin, Cours de l' histoire de la philosophie, f. 48-49, Paris l841.

1. Paragjykimi racor

Ata të cilët e sulmuan dhe e kundërshtuan filozofinë islame nuk ndaluan në çdo lloj argumenti që përmendën. Ata i zgjeruan opinionet e tyre të gabuara në karakteristika të përgjithshme racore, dhe e përforcuan atë çka thanë për filozofinë dhe mësimin e çështjeve politike. Është për t’u çuditur se megjithëse francezët politikisht iu kundërvunë diskriminimit racor, ata ishin në mesin e njerëzve të cilët mbollën farën e kësaj lloj sjelljeje, ndikimi i të cilës ka vazhduar deri në shekullin tonë. Për shembull, Renani ishte njeriu i parë që shprehu hapur pikëpamjen se raca semite është më inferiore ndaj racës ariane.[2] Ky gjykim i Renanit pati ndikim te disa nga bashkëkohësit e tij, dhe te disa nga pasuesit dhe studentët e tij, të cilët i përsërisnin pikëpamjet e tij dhe i botonin ato tej e përtej. Kjo ndodhi për arsye se Renani ishte në të njëjtën kohë një mjeshtër i gjuhëve semite dhe gjithashtu ishte më i ditur për temat islame sesa çdo studiues tjetër i kohës së tij.

Ngritja e nocioneve të “shpirtit semit” në kundërshtim me “shpirtin arian” nga Leon Gauthier gjatë pjesës së parë të shekullit të dymbëdhjetë nuk ishte asgjë tjetër veçse vazhdim i argumentit të përgatitur nga Renani. Sipas pikëpamjes së Gauthier, mendja semite është e aftë vetëm për të kuptuar detajet dhe të veçantat të cilat janë shqitur nga njëra-tjetra ose janë të ndërthurura dhe të paafta për të menduar çdo rregull ose marrëdhënie të kuptueshme ndërmjet detajeve. Me fjalë të tjera, “shpirti semit” do të thotë ndarje dhe përçarje, ose sipas fjalëve të Gauthier, *espirit separatiste*. “Shpirti arian”, në anën tjetër, është shpirti i bashkimit dhe sintezës, *espirit fusionniste*, siç e quan ai.[3]

Kjo situatë vazhdon që nga koha kur arabët qenë të aftë në mënyrë të qenësishme për të kuptuar vetëm faktet e veçanta dhe të veçuara, sepse ata do të ishin të paaftë për të formuar ndonjë teori, sugjerim, ligj apo hipotezë. Do të ishte e kotë në këtë rast që të shikohet për

[2] E. Renan, Histoire Generale de systeme comparedes langues semitiques.

[3] L. Gauthier, L'esprit semitique et l'esprit aryen, f. 66-67, Paris 1923, shih gjithashtu I. Madkour, La Place d' al-Farabi, f. 14, Paris, 1934.

ndonjë shqyrtim filozofik ose shkencor ndaj tyre. Kjo kryesisht është e vërtetë tani kur Islami ka ngushtuar horizontet e tyre intelektuale dhe ka mbyllur dyert ndaj çdo diskutimi spekulativ, kaq shumë saqë studentët myslimanë shpifin dhe tallen me shkencën dhe filozofinë.[4]

Ata të cilët i shprehën pikëpamjet e tilla kanë mbajtur qëndrimin që filozofia islame është vetëm një imitim i filozofisë së Aristotelit, dhe tekstet e filozofisë islame nuk janë asgjë më shumë se përsëritje e mendimeve greke në arabisht.[5]

Pikëpamjet e Renanit, të cilat sapo i përmendëm, u përhapën gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë. Fatmirësisht, gjatë ditëve kur zakonet, traditat, etika, morali dhe karakteristikat intelektuale të një kombi u mendua që janë produkt ose i kushteve gjeografike të tij ose të tipareve të trashëguara racore, kanë kaluar. Përpjekje të tjera në këtë mënyrë apo për të formuluar të ashtuquajturën “psikologjia kombëtare” ose “psikologjia e grupit” ka provuar pavlefshmëri të njëjtë.

Veç kësaj, kush ka pohuar se filozofia islame është një krijesë e mendimit arab? Është një fakt i vërtetuar mirë se shumë kombe si persianët, indianët, turqit, egjiptianët, sirianët, berberët dhe andaluzianët kontribuan në zhvillimin dhe pasurimin e filozofisë islame.

Qytetërimi islam në kulmin e tij, jo vetëm që nuk e pengoi rrugën e shkencës, por ai e miratoi dhe e përkrahu atë. Dhe larg nga pengimi i filozofisë, ai e mirëpriti dhe e përvetësoi atë. Ai i pranoi mendimet dhe pikëpamjet e çdo hije dhe ngjyre. Si mundet Islami, i cili e ftoi njerëzimin që të studiojë qiejtë dhe tokën dhe që të sodisin dhe meditojnë rreth mistereve të tyre, të kundërshtojë diskutimin dhe kërkimin dhe të kufizojë lirinë e mendimit? Edhe Renan, i cili shprehu pikëpamjet e tij rreth filozofisë dhe shkencës islame, të cilat i kemi përmendur më lart, ka pranuar në një vend tjetër se myslimanët i kanë trajtuar popujt e pushtuar me favore të padëgjuara kurrë më parë gjatë gjithë historisë. Për shembull, disa çifutë dhe të krishterë e pranuan Islamin, ndërsa të tjerë ruanin besimin e tyre të trashëguar dhe u ngritën në

4 Renan, "Le 'islamisme et la Science", dans Discours et Confe'rences, f. 337 Paris, 1887; Madkour, La Place d' al-Farabi, f. 54.

5 Renan, Averroe's et l'Averroesme, f. 79, II, Paris, botimi i tetë.

pozita zyrtare të larta dhe të nderuara në pallatet mbretërore të halifëve dhe sundimtarëve myslimanë. Për më tepër, ndonëse myslimanët dallohen nga çifutët dhe të krishterët përsa u përket besimeve dhe parimeve fetare, ata ende martohen me këto komunitete.[6]

Sigurisht, kjo nuk është hera e parë që ky historian dhe filolog francez ka pasur kundërshtime me vetveten. Në një vend ai ka mohuar ekzistimin e plotë të saj si një filozofi arabe (islame) duke thënë: “Gjëja e vetme që arritën të bënin arabët (myslimanët) ishte që të mësonin enciklopedinë greke të shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe të tetëmbëdhjetë.”[7] Pastaj ai vazhdon të kundërshtojë përgënjeshtimet dhe pohimet e tij që ka një filozofi të vetme islame, ku karakteristikave të veçanta të së cilës u duhet dhënë vëmendje. Ai pranoi se, “arabët (myslimanët), njësoj si latinët, nëpërmjet tërheqjes nga interpretimi i veprave të Aristotelit mësuan se si të formulonin një filozofi plot me karakteristika dhe elemente të veçanta në kundërshtim serioz me atë çfarë është mësuar në sallat e leksioneve.”[8] Pastaj, ai shtoi se “Lëvizja origjinale në filozofinë islame duhet kërkuar në shkollat e ndryshme të Mutekellimun (të dijetarëve myslimanë).”[9] Këto thënie kundërshtuese të Renanit dhe mospërfillja e dukshme në veprat e tij nuk qëndruan të fshehura nga Dugati, një nga bashkëkohësit e tij. Dugati besonte se cilësia e të menduarit siç është dëshmuar nga Ibn Sina nuk mund të përfundojë në asgjë tjetër sesa në interpretime dhe pikëpamje origjinale dhe të ndërlikuara: dhe shkollat e mendimit si ato të Mu’tazilitëve dhe Ash’aritëve nuk janë asgjë më tepër sesa krijime origjinale të mendimit islam.[10]

Në shekullin njëzet ajo çfarë është shprehur me hamendje dhe spekulime nga njerëz si Dugati është konsideruar si një fakt i pakundërshtueshëm dhe i provuar. Studiuesit gradualisht u bënë më të afërt sesa më përpara me temat islame, dhe të kuptuarit e tyre të karakteri-

6 Ibid, vol. I, f. 171. Shih gjithashtu Goldziher, Le dogme et la loi de 1' Islam, f. 29-34.

7 Renan, Shmangia e Averroes, f.11.

8 Ibid, f.89.

9 Ibid.

10 G. Dugat, Histoire des philosophes et des theologians musulmans, f. XV.

stikave origjinale dhe unike të mendimit islam u rrit gradualisht. Kur ata nisën që të mësonin më shumë rreth Islamit, gjykimi i tyre për t'u bërë më i drejtë dhe më i paanshëm. E vërteta e çështjes është se qëllimi dashakeqës i studiesve europianë të shekullit të nëntëmbëdhjetë ishte krejtësisht i qartë në trajtimin e tyre të çështjeve të ndryshme islame; sepse, ndërkohë që në njërën anë ata pranonin se "veprat e filozofëve myslimanë nuk janë studiuar në mënyrë të mjaftueshme, ndërkaq njohuria jonë rreth thelbit të tyre dhe përmbajtjes së shkrimeve të tyre është e mangët"[11]. Nga ana tjetër, ata thanë gjykimet më të përgjithshme dhe të mbytura për të dhe thanë se filozofia islame nuk është asgjë më shumë sesa një imitim i Aristotelit. Është mirë që të mbahet në mend se këta studiues nuk kishin hyrje të drejtpërdrejtë ndaj filozofisë islame sepse ata nuk kishin tekstet origjinale në dispozicion të tyre, ndërsa përkthimet latine nuk mund të jepnin një paraqitje të plotë dhe të saktë të shtrirjes dhe thellësisë së kësaj filozofie. Sot, megjithatë, ne mund të flasim me siguri të plotë për arritjet, të cilat i ka bërë qytetërimi islam lidhur me këtë dhe pohojmë përsëri se ka një numër të madh çështjesh në mendimin islam, të cilat nuk janë shqyrtuar dhe diskutuar ende.

Për sa i përket pyetjes nëse ne duhet ta quajmë këtë filozofi "islame" apo "arabe", pyetje të tilla nuk janë asgjë tjetër veçse argumente të pavlera mbi fjalët dhe emrat. Kjo filozofi u zhvillua dhe u rrit në një mjedis islam dhe u shkrua në gjuhën arabe. Mirëpo, fakti që këto mendime janë shkruar në gjuhën arabe nuk do të thotë se filozofia islame është një krijim me elemente arabe. Ne të cilët e kemi dënuar racizmin tashmë, nuk kemi pretenduar kurrë gjëra të tilla. Islami ka grumbulluar rreth tij kombësi të ndryshme dhe të gjitha ato kanë kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e mendimit të tij. Përderisa kjo filozofi quhet "islame", atëherë nuk mund të pretendohet se ajo është produkt i përpjekjeve intelektuale vetëm të myslimanëve, meqenëse një pretendim i tillë nuk do të qëndrojë përballë të dhënave historike të disponueshme. Dokumentet historike tregojnë se mësuesit e parë të myslimanëve ishin dijetarët nestorianë, jakobitë, çifutë dhe sabeanë, dhe dijetarët myslimanë bashkëpunuan me bashkëkohësit e tyre nestorianë dhe çifutë në hulumtimet e tyre filozofike dhe shkencore.

[11] G. Tennemann, Manuel de l' histoire de la philosophic (Përkthimi në frëngjisht nga V. Cousin), T. I, f. 358359, Paris 1839.

Sidoqoftë, unë jam i prirë që ta quaj këtë filozofi si "islame" për dy arsye. E para, Islami nuk është vetëm një besim, por gjithashtu është edhe një qytetërim; dhe subjektet e filozofisë islame, pavarësisht nga shumëllojshmëria e burimeve të saj dhe formimi kulturor i shkrimtarëve, janë rrënjosur në qytetërimin islam. Së dyti, problemet, bazat, dhe synimet e kësaj filozofie janë të gjitha islame, dhe ishte Islami ai që e formoi këtë filozofi të bashkuar nga mësimet dhe pikëpamjet e grumbulluara që i përkasin shumë kulturave dhe shkollave të ndryshme të mendimit.

2. Filozofia islame

Filozofia islame është unike në llojin e subjekteve dhe çështjeve me të cilat ajo merret, me llojin e problemeve që ajo përpiqet që t'i zgjidhë dhe metodat që ajo përdor për t'i zgjidhur ato.

Filozofia islame merret me çështje të tilla si problemi i unitetit dhe shumëllojshmërisë, marrëdhënia mes Zotit dhe botës, ku që të dyja kanë qenë tema të debateve dhe diskutimeve të nxehta ndërmjet teologëve për një kohë të gjatë.[12]

Një tjetër qëllim i kësaj filozofie ishte që të pajtonte shpalljen me arsyen, diturinë me besimin, dhe fenë me filozofinë, dhe për të treguar se arsyeja dhe shpallja nuk e kundërshtojnë njëra-tjetrën, dhe se feja do të pranohet nga një i pafe kur ai të jetë i ndriçuar nga drita e urtësisë së filozofisë. Ajo synon që të provojë gjithashtu se kur feja e përqafon ajo interpretohet me vlera filozofike vetëm si filozofi për të marrë ngjyrën fetare. Në përgjithësi, filozofia islame është një krijesë e mjedisit në të cilin ajo rritet dhe lulëzon, dhe ashtu siç është fare e qartë, ajo është një filozofi fetare dhe shpirtërore.

[12] Madkour, La place d'al-Farabi, f. 46 et suive.

a) Subjektet: Ndonëse filozofia islame është e orientuar në mënyrë fetare, ajo nuk ka kundërshtuar asnjërën nga çështjet më të mëdha filozofike. Për shembull, është diskutuar në mënyrë të gjerë problemi i të qenit dhe mbrojtjes së pozicionit të saj për çështje si koha, hapësira, shkaqet dhe jeta. Trajtimi i saj i epistemologjisë është unik dhe gjithëpërfshirës. Ai bën dallime mes vetvetes (*nefs*) dhe arsyes, cilësive të lindura dhe të fituara, saktësisë dhe gabimit, mes diturisë së pandehur dhe të padyshimtë. Ajo ka shqyrtuar çështjen e asaj çfarë është virtyt dhe lumturi dhe virtyteve të ndara në një numër kategorish dhe arriti në përfundimin se virtyti më i lartë është synimi i vazhdueshëm dhe realizimi i qartë i së vërtetës.

Mendimtarët myslimanë e ndanë filozofinë në dy kategori të përgjithshme të pranuara; teorike dhe praktike, ndërkaq diskutimet e tyre u shtrinë deri në tema të ndryshme si: filozofia natyrore, matematika, metafizika, etika dhe politika.[13] Në mënyrë të dukshme, mendimtarët myslimanë besonin se filozofia ka një shtrirje më të madhe nga ajo që shihet sot, ndërkaq lidhur me këtë vepra e tyre ishte e ngjashme me atë të filozofëve grekë, veçanërisht Aristotelit, të cilin ata e imituan dhe e ndoqën. Pra, filozofia islame u përzie me mjekësinë, biologjinë, kiminë, botanikën, astronominë dhe muzikën. Në të folurën e përgjithshme, të gjitha fushat e shkencës u menduan se nuk ishin asgjë tjetër vetëm se degë të filozofisë.

Duke marrë parasysh të gjitha sa u thanë, nuk do të ishte e tepërt të deklarojmë se filozofia islame i përfshin të gjitha aspektet e ndryshme të kulturës islame. Ajo duhet patjetër të mbahet në mend se gjatë periudhës kur filozofia islame po zhvillohej dhe po piqej, mësimi dhe kërkimi po zbatoheshin në një mënyrë enciklopedike dhe të gjithanshme. Veç kësaj, duhet mbajtur në mend se e gjithë shtrirja e mendimit filozofik islam nuk mund të arrihet tërësisht vetëm përmes studimit të teksteve filozofike. Në mënyrë që të arrihet një kuptim i plotë, është e nevojshme të zgjerohet territori i hulumtimit dhe kërkimit për të përfshirë diskutimin e teologjisë (*kelam*) dhe misticizmin (*tesavvuf*). Do

[13] Madkour, L'Organon d'Aristote, f. 49 et suive, Paris, 1934.

të ishte gjithashtu e nevojshme që të lidhet ndonjë diskutim mbi filozofinë islame me historinë e Ligjit Islam dhe parimet e jurisprudencës. Nuk është e jashtëzakonshme të zbulohen ide, koncepte dhe pikëpamje filozofike në të cilat gjenden gjoja tekste shkencore islame, të cilat merren me çështje të tilla si mjekësia, gjeometria, kimia dhe astronomia. Për më tepër, disa shkencëtarë myslimanë treguan më shumë guxim dhe liri në të shprehurit e pikëpamjeve filozofike sesa treguan ata që ishin specializuar në fushën e filozofisë. Gjithashtu, në mesin e diskutimeve mistike dhe teologjike islame, pikëpamjet dhe pozicionet janë ndeshur dhe të cilat në thellësinë dhe saktësinë e tyre të barabartë nuk gjendet askush në mesin e aristotelianëve. Këta mendimtarë myslimanë e kundërshtuan filozofinë e Aristotelit dhe luftuan kundër saj për shumë vite. Kjo luftë çoi në shfaqjen e një filozofie dhe mendimi islam të veçantë. Më vonë, në një metodologji të caktuar dhe forma të analizës së arsyeshme u futën në shqyrtim rreth themeleve të Ligjit islam dhe parimeve të jurisprudencës, të cilat kanë një ngjyrim filozofik tepër të qartë. Madje është e mundur që të zbulohet në veprimet, rregullat dhe metodat e tyre të ngatërruara, të ngjashme me ato që përdoren sot.

b.) Filozofia islame dhe skolastika e krishterë: Ajo çfarë kemi thënë deri tani mund të japë një ide të fushës së gjerë të mendimit filozofik në Islam. Dhe do të ishte gabim nëse do të kufizonim veten, siç bënë shkencëtarët europianë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, ndaj studimit të disa përkthimeve të përhapura në latinisht dhe hebraisht. Në të vërtetë, nëse thellësia dhe shtrirja e mendimit të filozofëve myslimanë do të bëhet e kuptueshme në mënyrë të qartë dhe të plotë, ajo do të përfundonte nga një kontroll i vetë burimeve origjinale.

Megjithatë, edhe pse të gjitha tekstet origjinale nuk janë botuar ende dhe nuk i janë nënshtruar studimit, është bërë e ditur mjaftueshëm për të na bindur ne se materiali i mbledhur nga mendimtarët myslimanë të Mesjetës ishte më i madh sesa ai që ishte mbledhur nga shkencëtarët e krishterë të asaj periudhe, se mendimtarët myslimanë zbuluan horizonte më të gjera, gëzuan më shumë liri të plotë dhe bënë shpikje dhe zbulime më të mëdha sesa homologët e tyre të krishterë.

Prandaj, nëse dikush do të fliste për një filozofi të krishterë, ose për atë që është më e njohur, skolastikën e krishterë, do të ishte me vend që së pari të flasë për filozofinë islame dhe për skolastikën islame, veçanërisht kur mendimi skolastik i krishterë i detyrohet shumë skolastikës islame për zhvillimin dhe shpjegimin e shumë prej problemeve dhe çështjeve të saj.[14]

Filozofia islame është për Lindjen ashtu siç është filozofia latine për Perëndimin. Ndërthurja e këtyre dy traditave filozofike plus kërkimet shkencore të kryera nga shkencëtarët çifutë e plotësojnë historinë e mendimit teorik të Mesjetës. Në mënyrë që vendi i vërtetë i filozofisë islame të mund të kuptohet qartë, dhe që të arrihet një mirëkuptim i plotë i fazave të ndryshme në zhvillimin e mendimit njerëzor, është e nevojshme të shqyrtojmë marrëdhënien e filozofisë islame me filozofitë antike, mesjetare dhe moderne.

c.) Filozofia islame dhe ajo greke: Ne nuk e mohojmë faktin se mendimi filozofik në Islam është ndikuar nga filozofia greke dhe se filozofët myslimanë kanë përvetësuar kryesisht pikëpamjet e Aristotelit. Ne nuk e mohojmë gjithashtu faktin se mendimtarët myslimanë e panë Platonin me çudi dhe e pasuan atë në shumë raste. Nëse një fjalë nuk përsëritet ajo vdes, dhe kush është ai që nuk ka qenë një nxënës shkolle i paraardhësve të tij? Ne, fëmijët e shekullit njëzet, mbështetemi ende në veprat shkencore të kryera nga grekët dhe romakët në një varg fushash të ndryshme. Megjithatë, nëse ne do të shkonim aq larg sa të emërtonim përdorimin dhe të lidhemi me korin e pëlqimeve të Renanit, i cili pohon se filozofia islame nuk është asgjë tjetër veçse një riprodhim i filozofisë së Aristotelit, ose e disa të tjerëve që thonë se ajo është një kopje e përpiktë e filozofisë neoplatonike, ne do të gabonim plotësisht.[15] E vërteta e çështjes është se filozofia islame është ndikuar nga një numër faktorësh, ku si rezultat i së cilës ishte lindja e ideve dhe pikëpamjeve të reja. Ashtu siç ajo është ndikuar nga mendimi grek, gjithashtu është ndikuar edhe nga traditat kulturore indiane dhe persiane.

[14] L. Gauthier, "Scolastique musulmane et sehoiastique chretienne", dans Revue d'Histoire de la philosophie, Paris, 1928.

[15] Renan, Averroe's, f. 88; Duhem, Le systeme du monde T. IV f. 321 et suive, Paris, 1917.

Shkëmbimi dhe adoptimi i ideve nuk përfshin gjithmonë bindjen e verbër. Disa individë mund të kontrollojnë një subjekt të veçantë, ndërkaq rezultati i gjurmimeve të tyre mund të shfaqet në një mori formash të ndryshme. Një filozof mund të përdorë disa nga idetë e filozofit tjetër, por kjo nuk e pengon atë që të krijojë ide të reja ose sisteme tërësisht të reja filozofike. Spinoza, për shembull, edhe pse ndoqi në mënyrë të qartë Dekartin, ishte krijues i një sistemi filozofik të pavarur nga ai, dhe Ibn Sina, edhe pse ishte një ndjekës besnik i Aristotelit, krijoi pikëpamje të patreguara ndonjëherë nga mësuesi i tij. Secili nga filozofët myslimanë jetoi në një mjedis të veçantë të ndryshëm nga mjedisi i tjetrit, dhe do të ishte gabim nëse ne do të mohonim ndikimin që këto rrethana të veçanta kanë pasur në idetë dhe pikëpamjet e tyre filozofike. Në këtë mënyrë, bota islame duhet të ketë një filozofi të përshtatshme për kushtet e saj shoqërore dhe parimet fetare. Duke ditur se si është natyra e kësaj filozofie, vetëm një shqyrtim dhe analizë e gjerë e ideve dhe parimeve të saj themelore do të na siguronte neve përgjigjen.

d.) Filozofia islame dhe filozofia moderne: Nuk është e mundur për ne që të diskutojmë në mënyrë të mjaftueshme marrëdhëniet e filozofisë islame dhe filozofisë moderne në këtë artikull dhe të flasim për vargun e ideve që i lidh bashkë këto të dyja. Kjo është e vërtetë veçanërisht që nga koha kur janë bërë përpjekje të përsëritura gjatë mesit të shekullit njëzet për të zbuluar parimet e filozofisë moderne dhe burimin e tyre në skolastikën e krishterë.

Sot, kur ne jemi të vetëdijshëm për marrëdhëniet mes filozofisë moderne dhe mesjetare, në njërën anë dhe ndikimin e filozofisë islame në mendimin mesjetar europian në anën tjetër, si mund të jetë e mundur që të injorohet ndikimi që mendimi islam ka pasur në filozofinë moderne? Në këtë studim ne do të diskutojmë për disa shembuj të këtij ndikimi dhe marrëdhënie. Siç do ta vërtetojmë, ngjashmëria mes filozofisë islame dhe filozofisë moderne është kaq e fortë saqë dikush mund të flasë për ekzistimin e një lloj lidhjeje familjare mes tyre.

Pa hyrë në hollësira ne mund të themi se historia e filozofisë moderne fillon me vlerësimin e dy çështjeve të rëndësishme: së pari, domethënien e aspektit, e cila merret me çështje që kanë të bëjnë me realitetin e jashtëm; së dyti është spekulimi, i cili është i lidhur me shkencat racionale. Me fjalë të tjera, përvoja e Bekonit në njërën anë dhe dyshimi i Dekartit në anën tjetër, kanë qenë subjekte diskutimi dhe debatesh në kohët moderne. Veç kësaj, është përmendur para se mendimtarët e skolastikës së krishterë dhe filozofët e Rilindjes të merreshin me eksperimentimin dhe i kushtuan vëmendje botës natyrore shumë kohë përpara Bekonit. Roxher Bekon, të cilin Renan e quan si “princi i vërtetë i mendimit gjatë mesjetës” nuk e kufizoi veten që të bënte eksperimente kimike, por e zgjeroi sferën e eksperimenteve të tij për të përfshirë botën natyrore. Nëse tani mund të tregohet se ai pati kontakt me veprat e shkencëtarëve myslimanë, ne mund të nxjerrim si përfundim se qasja e tij eksperimentale, ose më saktë burimi i eksperimentimit gjatë Rilindjes, ishin të dyja produkte të mendimit islam dhe mendimtarëve myslimanë, sepse ata ishin të vetmit që i përdorën observatorët dhe laboratorët për të zbuluar fakte shkencore.

Ashtu si dyshimi Kartezian, gjenden të dhëna se ai pati disa përparësi gjatë Mesjetës së krishterë dhe ne besojmë se çdo studim i origjinës së dyshimit të Kartezianit do të mbesë i mangët pa ndonjë përpjekje për ta zbuluar atë në filozofinë islame. Kush mund të thotë se dyshimi i Dekartit nuk është ndikuar tërësisht apo pjesërisht nga dyshimi i Al-Gazzalit? Edhe nëse e lëmë mënjanë çështjen e ndikimit, të dy filozofët kanë menduar në periudha paralele dhe të ngjashme. Diku tjetër gjatë diskutimeve tona ne kemi treguar se “kogito” e Dekartit nuk është frymëzuar tërësisht nga Shën Agustini dhe se ka shumë ngjashmëri mes asaj dhe idesë së “njeriut të varur në ajër” të Ibn Sinas.

Me pak fjalë, meqë skolastika e krishterë dhe çifute, e cila është e lidhur ngushtë me botën islame, është hallka që e lidh filozofinë islame me spekulimin filozofik modern, mundësia e transferimit dhe shkëmbimit të ideve nuk mund të mohohet.

Në të vërtetë, ajo duhet të arrijë me shpejtësi përgjithësimin, pa e hetuar dhe studiuar në fillim siç duhet çështjen, nëse ne duhet të themi se nuk ka pasur asnjë lidhje mes Lindjes dhe Perëndimit përsa i përket botës së mendimit dhe spekulimit filozofik dhe racional. Sot është provuar se ekziston një shkëmbim që nga kohët e hershme dhe ai është përsëritur gjatë Mesjetës. Atëherë, çfarë e ndalon një lidhje të tillë që të ekzistojë në kohët e sotme? Idetë dhe opinionet nuk mund të burgosen në kufijtë e caktuar gjeografikë, dhe lëvizja e tyre nuk mund të kufizohet. Ajo çfarë deri dje përmendej si sekreti i atomit, sot është njohuria shkencore e përbashkët në të gjitha pjesët e botës.

Pikëpamjet e filozofisë islame

Ne nuk mund të gjejmë ndonjë shembull të një studimi të plotë dhe të përfunduar të filozofisë islame në Lindje ose në Perëndim para mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Kjo ndodh për arsye se sa herë që studiuesi perëndimor e kthente vëmendjen e tij në studimin e çështjeve lidhur me Lindjen, ajo kishte të bënte kryesisht me aspektin ekonomik dhe politik që i interesonte atij, dhe jo me aspektin kulturor. Nëse ne ndeshemi me ndonjë rast të tillë të studimeve kulturore në shekullin tetëmbëdhjetë ose të pjesës së parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, ajo është e bazuar kryesisht në burimet latine. Sa për lindorët, ata kishin humbur aq shumë në vështirësitë ekonomike dhe politike gjatë kësaj periudhe saqë ata nuk kishin interes të mbanin të gjallë kulturën e tyre të hershme ose që të rigjallëronin trashëgiminë e tyre islame.

a) Lëvizja e Orientalizmit: Në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, orientalistët europianë u interesuan për studimet islame dhe u bënë pararojë të një lëvizjeje që u zhvillua me shpejtësi dhe arriti zenitin e vet gjatë çerekut të parë të shekullit të njëzet. Disa nga këta shkencëtarë europianë udhëtuan në Lindje dhe studiuan në shkollat e saj për të kuptuar më mirë jetën shpirtërore dhe intelektuale të Orientit. Europa dhe Amerika konkurronin me njëra-tjetrën për botimin e kulturës islame. Pastaj u themeluan në Paris, Romë, Londër dhe

Berlin shkolla ku mësoheshin gjuhët orientale dhe universitete, ku studioheshin lëndë islame. U ngritën shoqëri studimore dhe historike për qëllimin e vetëm që të shqyrtojnë dhe të kontrollojnë aspekte të ndryshëm të qytetërimit islam.

Në mënyrë periodike, u mbajtën seminare të ndryshme nga orientalistët, ku u bënë paraqitje dhe diskutime me vlerë. Në të njëjtën kohë, revistat dhe botimet kulturore dhe shkencore iu kushtuan studimit të çështjeve të Orientit. Këto debate, diskutime dhe shkëmbime pikëpamjesh, shkaktuan mjegullimin e paditurisë dhe ngatërrimin për t'u shpërndarë dhe faktet e çështjes për të kuptuar më qartë.

Kjo lëvizje orientaliste pati rezultate të mirëpritura. Tekste të panjohura në kohë u zbuluan. U botuan dorëshkrime të vyera të teksteve të ndryshme. Teknika të reja të botimit të librave të shoqëruara me shënime dhe tregues u përdorën në masë të gjerë, dhe një numër i veprave më të rëndësishme në bibliotekat e botës islame u përkthyen në gjuhët e gjalla europiane, si në italisht, frëngjisht, anglisht dhe gjermanisht. Botimi i veprave të tilla të përkthyera siç dihet nxitën interesimin dhe diskutimin në aspekte të ndryshme të qytetërimit islam si në politikë, ekonomi, histori, letërsi, interpretimet dhe shpjegimet e Kur'anit, shkencë dhe filozofi, ku që të gjitha pranuan trajtim të përmbledhur në artikuj të botuar në revista shkencore dhe u morën gjerësisht me libra.

Kërkimet dhe studimet u rritën në raport me nivelin e njohurisë dhe informimit që u bë i mundur. Studiues dhe gjurmues filluan të kishin prirje për të shpenzuar vite në kërkime shkencore për të qartësuar pikat e fshehura ose të kuptuara keq. Studiues intensivë çuan grupe të ndryshme shkencëtarësh që të specializohen në aspekte të ndryshme të qytetërimit islam. Disa prej tyre u bënë ekspertë në gjuhën arabe dhe literaturës islame, ndërsa të tjerë u bënë specialistë në teologjinë dhe jurisprudencën islame. Një grup i tretë u përqendrua në misticizmin islam, ndërsa një grup i katërt gjurmoi thellë në fushën e shkencës dhe filozofisë islame. Fryt i kësaj shtrirjeje dhe specializimi në fushën e studimeve islame ishte enciklopedia e Islamit, e cila u botua në gjuhën frënge, gjermane dhe angleze. Ky libër është prova e qartë e

njohurisë gjithëpërfshirëse të Islamit, të mbledhur nga orientalistët dhe interesi i tyre i madh në kulturën dhe qytetërimin islam. Enciklopedia e Islamit është në të vërtetë një burim i pasur dhe i rëndësishëm informacioni, i nevojshëm për çdo studiues të çështjeve islame.

Orienti ishte ndikuar gjithashtu nga puna e orientalistëve perëndimorë. Dijetarët e Orientit (Lindjes) përvetësuan shumë prej pikëpamjeve të tyre, përkthyen shumë nga tekstet e tyre dhe ndoqën rrugën e shtruar nga ata, u bënë partnerët e tyre në ringjalljen e lavdisë dhe madhështisë së kulturës lindore. Ata gjithashtu mbaruan atë që ishte lënë e papërfunduar nga orientalistët perëndimorë ose mbushën boshllëqet e lëna gjatë trajtimit të tyre të çështjeve të ndryshme. Këto kontribute, ndonëse të vogla në çdo rast, u shpërndanë në një hapësirë të gjerë, kështu që asnjë nga aspektet e kulturës islame nuk u injorua. Ajo çfarë është bërë deri tani është vetëm fillimi i një përpjekje që duhet të rritet dhe të zhvillohet.

b) Orientalistët dhe filozofia: Filozofia nuk u la jashtë drejtimit të përgjithshëm të përshkruar më lart. Tekstet e shkruara nga filozofët myslimanë, të cilat kishin mbetur në formën e tyre origjinale në dorëshkrim, u botuan dhe versionet origjinale arabe u krahasuan me përkthimet e tyre në hebraisht dhe latinisht, të cilat ishin ruajtur. Studimi i shënimeve dhe shpjegimeve të tyre dha një ndihmë të madhe në zgjidhjen e çdo problemi që mund të ketë ndodhur lidhur me kuptimin e tyre. Pa përpjekjet e orientalistëve, këta libra do të qëndronin në ndonjë kënd të një libroteke, të palexuara, duke mbledhur pluhur. Dhe nëse nuk do të ishte për faktin se ata kuptonin një numër të madh të gjuhëve të vjetra dhe moderne dhe kishin një metodologji të drejtë, veprat e botuara prej tyre nuk do të karakterizoheshin nga një kujdes dhe vërtetësi e tillë.

Puna e orientalistëve europianë nuk u kufizua në shtypjen dhe botimin e librave; ata u përpoqën të zbulonin dhe të studionin të gjithë horizontin e jetës intelektuale në Islam dhe për të shkruar rreth saj. Për shembull, ata shkruan rreth historisë së filozofisë dhe filozofëve myslimanë, rreth teologjisë dhe teologëve, sufizmit dhe sufistëve dhe përshkruan sektet dhe shkollat e ndryshme të mendimit që gjenden në

Islam. Ndonjëherë, ata studionin jetën, opinionet dhe pikëpamjet e një personi. Në kohë të tjera ata shkruan libra rreth termave dhe përcaktimeve shkencore, kështu që emrat e tyre ishin lidhur në mënyrë të pandashme me çështjen e specializimit të tyre. Për shembull, kush është ai që e ka dëgjuar emrin e Nikolson dhe nuk i sjell ndër mend tesavufin? Do të ishte jashtë qëllimit të këtij punimi nëse do të përmendim të gjithë orientalistët, së bashku me çështjet e specializimit të tyre, të cilat i bënë ata të famshëm. Mjafton të themi se orientalizmi zotëronte një forcë dhe gjallëri unike gjatë çerekut të parë të shekullit të njëzet, e cila gjithashtu përfshinte studimin dhe shqyrtimin e çështjeve spekulative. Pavarësisht nga e gjithë kjo, historia e filozofisë islame dhe pikëpamjet e mendimtarëve të saj më të shquar nuk janë kuptuar ende në mënyrë të mjaftueshme dhe kjo është hallka e munguar në zinxhirin e historisë intelektuale njerëzore. Ne ende nuk e dimë me saktësi se nga erdhi kjo filozofi, cila ishte mënyra e zhvillimit të saj dhe cilët faktorë shkaktuan lulëzimin e saj dhe cilat ishin shkaqet e rënies së saj. As puna e filozofëve myslimanë kurrë nuk është vëzhguar një nga një për të treguar se sa shumë secili prej tyre ka huazuar ose trashëguar nga paraardhësit e tij dhe sa nga filozofia e tij ishte rezultat i mendimit të vet origjinal. E vërteta e hidhur e çështjes është se yjet ndriçues të filozofisë islame janë të panjohur në vetë vendet e tyre dhe nga vetë popujt e tyre. Ajo çfarë e vërteton më mirë këtë është fakti se shumë nga ne lindorët dimë më shumë për Russonë dhe Spencer sesa për Al-Kindin dhe Al-Farabin! Dhe nëse Zoti nuk do të urdhëronte që një grup orientalistësh të bënte një studim rreth tyre, ne sot nuk do të dinim asgjë me vlerë rreth këtyre personaliteteve të mëdha.

Puna e orientalistëve, megjithatë, është shumë e pakët me qëllimin për t’u marrë në mënyrë të mjaftueshme me një çështje siç është filozofia islame. Për më tepër, në disa raste ata përmbajnë ose gabime gjuhësore ose teknike, ose janë të mangët në disa mënyra të tjera. Disa herë këto studime janë aq të shkurtër saqë nuk është e mundur të kuptohet synimi i shkrimtarëve të tyre. Ndoshta shkaku i të gjitha këtyre vështirësive është se disa nga shkencëtarët që e kanë shqyrtuar filozofinë islame nuk e kuptojnë gjuhën arabe në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk e njohin historinë e kulturës islame. Të tjerë, që nuk janë të mangët në ndonjë nga aspektet e lartpërmendura janë tërësisht të paditur nga historia e filozofisë islame. Sigurisht, që këtu ka përjashtime të ndritshme në këtë dobësi të përgjithshme. Dy shembuj nga vepra të tilla të mrekullueshme dhe informative janë përkthimi nga Van den Berg i Metafizikës së Ibn Rushdit, dhe Historia e Filozofisë Islame e De Bur. Një njeri nuk mund ta lexojë librin e Van den Berg pa e ndjerë se ai po lexon komentimin e një filozofi mbi filozofinë.[16] Ndërsa dikush tjetër nuk mund ta lexojë librin e De Bur pa ditur që ai e ka bërë atë një vepër shumë të madhe.[17]

Sigurisht, ka kaluar shumë kohë që nga botimi i librave të përmendura më lart dhe i veprave të tjera të orientalistëve. Kështu që ato kanë nevojë për një rishikim, dhe përfundimet e arritura prej tyre duhen rishqyrtuar në dritën e njohurisë shumë të lartë të mendimit islam që gjendet tani. Kjo është kryesisht e veçantë se që nga koha që kemi pasur sa më shumë hyrje për të arritur në dorëshkrimet origjinale, aq më e madhe ishte shpejtësia me anë të së cilës janë zgjidhur problemet tona dhe janë ndrequr gabimet tona.

Ndonëse historia e përpjekjeve për të mbledhur trashëgiminë e traditës islame dhe orvatjet për të ringjallur qytetërimin islam datojnë vetëm që nga fillimi i shekullit të dymbëdhjetë, është bërë një progres i madh dhe shumë materiale janë vënë në dispozicion të studiuesve. Sidoqoftë, nevoja për një analizë dhe diskutim të ri të bazuar në studimin e këtyre fakteve dhe burimeve materiale që janë të gatshme kohët e fundit është plotësisht i pamohueshëm.

c) Rruga para nesh: Ne duhet të vazhdojmë në rrugën që kemi ndjekur deri tani duke zbuluar plotësisht këtë hallkë të fshehur në zinxhirin e historisë intelektuale njerëzore, dhe për ta vendosur atë në vendin e vet të përshtatshëm. Deri tani, orientalistët kanë dhënë kontribute të rëndësishme dhe kanë bërë përpjekje të mëdha për ta kryer këtë punë. Është detyra jonë që të përpiqemi t’i parakalojmë ata; dhe

[16] S. Van den Bergh, Die Epitome der Metaphysik des Averroes, Leiden, 1924.

[17] T.J. De Boer, Geschichte der Philosophie im Islam, Stuttgart, 1901, tr. ang., par E.R, Jones, The History of Philosophy in Islam, London, 1903.

nëse jemi të paaftë për ta bërë këtë, të paktën ne duhet të ecim baras me ta. Nuk është e mjaftueshme për ne që ta bëjmë të famshëm një mendimtar apo shpikës duke i përmendur idetë apo shpikjet e tij; ne duhet të përpiqemi që të ringjallim veprat e tij. Të gjithë kombet e botës janë në garë me njëri-tjetrin duke u përpjekur që të botojnë veprat e shkencëtarëve dhe mendimtarëve të tyre.

Fusha e studimit tonë është e pafund dhe ka mundësi të panumërta për kërkime. Detyra jonë e parë është që të grumbullojmë dhe të botojmë shkrimet e filozofëve të Islamit; vepra të cilat kanë mbetur si dorëshkrime deri në ditët tona, ose janë botuar në një mënyrë të pakënaqshme. E them këtë sepse për sa kohë që nuk i kemi studiuar veprat e filozofëve dhe shkencëtarëve tanë në gjuhën origjinale në të cilën janë shkruar, ne nuk mund të kuptojmë thelbin dhe bërthamën e mësimeve të tyre.

Kur ne zbulojmë se traktatet e shkruara nga Al-Kindi (Alkindus) gjenden në librotekat e qytetit të Stambollit, ose se dorëshkrimet e veprave të Al-Farabit (Farabiu) janë të shpërndara në mesin e librotekave të Londrës, Parisit dhe Eskorial,[18] ose se nga vepra e famshme e Ibn Sinas, Shifa', botuesi ka shtypur vetëm vëllimin e parë, Logjikën,[19] atëherë ne kuptojmë rëndësinë dhe nevojën e grumbullimit të teksteve të filozofëve tanë dhe botimin e tyre. Është e tepërt të përmendet fakti se Ibn Rushdi është më shumë i njohur në botën latine sesa në botën islame, dhe disa orientalistë amerikanë i kanë botuar shkrimet e tij para disa kohësh.

Botimi i këtyre teksteve kërkon një kohë të gjatë. Prandaj, është e nevojshme që një numër i individëve dhe akademikëve të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në përmbushjen e kësaj detyre të rëndësishme. Universiteti i Kajros, një herë kishte pranuar një metodë interesante dhe të efektshme në të cilën ai mblodhi filmat e disa prej dorëshkrimeve dhe shtypi disa prej tyre. Për fat të keq, kohët e fundit ai ndaloi së bëri këtë. Mbase kjo ndodhi për shkak të luftës, por universiteti

[18] Madkour, La Place, f. 223225.
[19] Madkour, L' Organon, f. 1920.

duhet ta rifillojë këtë praktikë. Gjithashtu shpresoj se Universiteti i Aleksandrisë do t'i bashkëngjitet kësaj përpjekje, dhe në fund të gjithë universitetet e Lindjes do të plotësohen me njëri-tjetrin në kryerjen e kësaj detyre.

Këtu mund të shtohet një koment lidhur me librotekat e Stambollit. Në këto libroteka, trashëgimia e më shumë se gjashtë shekujve të kulturës islame është ruajtur. Natyrisht, atje mund të gjenden kopje të teksteve të cilat nuk ekzistojnë në asnjë vend tjetër në botë. Për shembull, një orientalist gjerman kohët e fundit ka gjetur disa vëllime të vlefshme në këto libroteka, ku në mesin e të cilave mund të gjendet Makalat al-Islamijin i Ash'ariut. Ky libër është një burim i rëndësishëm në fushën e historisë së doktrinave islame. Që nga botimi i librit të Asha'riut dhe Nihajat al-Akdam të Shahristanit, disa nga pikëpamjet që ne kemi pasur lidhur me teologjinë islame (*kelam*) dhe teologët (*mutekellimun*) kanë ndryshuar.

Nuk dyshoj se vëllezërit tanë turq janë të vetëdijshëm për vlerën e kësaj trashëgimie tepër të çmuar, dhe nëse vetë ata janë të paaftë për t'i botuar këto kryevepra, atëherë nuk duhet të ngurrojnë që t'i vënë ato në dispozicion të atyre të cilët e duan një gjë të tillë.

Përveç botimit të këtyre teksteve, ne duhet po ashtu të angazhohemi në hulumtimin dhe shqyrtimin e veprave të filozofëve myslimanë dhe t'i njohim ata pikërisht ashtu siç i njohim filozofët jomyslimanë. Ne duhet të përgatisim jetëshkrimet e mendimtarëve tanë, të përshkruajmë pikëpamjet e tyre hollësisht, të shpjegojmë faktorët që ishin të dobishëm në formimin e pikëpamjeve të tyre, të vlerësojmë qartë borxhin e tyre intelektual ndaj paraardhësve të dikurshëm dhe të tanishëm dhe të këqyrim ngjashmëritë që ekzistojnë mes ideve të tyre dhe atyre të bashkëkohësve të tyre.

Shpresoj se kjo ditë do të vijë kur ata do të shkruajnë për Al-Farabin ashtu siç po shkruajnë sot për Musa ibn Mejmunin, saqë ata u bënë shumë të njohur me veprat e Ibn Sinas, siç u njohën me shkrimet e Thoma Akuinit, dhe do të diskutojnë për Al-Gazzalin ashtu siç diskutojnë për Dekartin. Ajo do të jetë dita kur mund të thuhet në mënyrë

të pajustifikueshme se filozofia islame u ka dhënë famën dhe është lartësuar ashtu siç duhet dhe siç e meriton.

Ky artikull është marrë nga faqja:
http://www.al-islam.org/al-tawhid/study-philosophy.htm

Nga persishtja në anglisht e përktheu:
Shahjar SA'ADAT

Përktheu nga gjuha angleze:
Ermal BEGA

Ibrahim Bayyumi Madhkour

THE STUDY OF ISLAMIC PHILOSOPHY

(Summary)

For a long time Islamic philosophy was under a cloud of doubt and uncertainty. Some people denied its existence while others affirmed it. This uncertainty continued all through the nineteenth century. Those who denied the very existence of an Islamic philosophy feigned ignorance and maintained that the teachings of Islam opposed all free discussion and investigation, and therefore Islam has never risen to the aid of philosophy and science throughout the centuries of its existence.

The only fruits Islam has borne for its followers have been intellectual despotism and dogmatism, they said. Christianity, in comparison, has been the cradle of free thought and discussion, they maintained, patronizing art and literature, encouraging the sciences, and becoming a fertile ground for the germination of new philosophy and helping it to develop and bear fruit.

ابراهيم بيومى مذكور

دراسة الفلسفة الاسلامية

(خلاصة البحث)

كانت الفلسفة الاسلامية لمدة طويلة مغطة بغيوم مشكوكة و غير واضحة فبعض الناس كانوا ينكرون وجودها و البعض الاخر يؤكدون وجودها و استمرت هذه العملية طيلة القرن التاسع عشر . الفريق الذى كان ينكر وجود الفاسفة الاسلامية اخترعوا جهلا و قالوا بان العلوم الاسلامية لم تؤيد و لم تتطور بمساعدة الفلسفة و العلوم خلال طول فترة وجودها و الثمرات الوحيدة التى اعطى الاسلام لمعتنقيه هو الايمان المطلق و ليس غيره . هم يقولون بان بان المسيحية مقارنة بالاسلام كان مهدا للفكر و البحث الحر مؤيدا اللادب و الفن و كذلك العلوم و بذلك تحول الى ارض خصبة لنمو فلسفة جديدة.

EKONOMI ISLAME

Dr. Naceur Jabnoun

ISLAMI DHE MENAXHMENTI - (7)

LIDERSHIPI I OMER IBN HATABIT

Omer ibn Hatabi r.a. ishte hailifi i dytë i Muhamedit a.s. Ai konsiderohet nga shumë mendimtarë si themeluesi i administratës moderne. Ai ishte muslimani i vetëm, përveç Muhamedit a.s. që është zgjedhur nga Majkëll Hart[1] ndër njerëzit më me ndikim në histori. Në këtë kapitull, do të paraqesim një hyrje për Omerin duke përfshirë formimin kulturor, veçoritë e personalitetit dhe arritjet. Pastaj, do të konturojmë karakteristikat e lidershipit të tij.

1 - HYRJE PËR OMERIN

Në këtë hyrje, do të prezantojmë formimin kulturor të Omerit para se të bëhej mysliman, i ndjekur me veçoritë e përgjithshme të personalitetit, të cilat mund të nxirren nga biografia e tij, para dhe pasi që u bë musliman. Pastaj, do të hedhim pak dritë mbi arritjet kryesore të tij.

[1] Michael Hart, "The 100 Ranking of the most Influential Persons in History", Golden Book Center, KL (1979).

1) Sfondi kulturor

Omeri ishte nga fisi i Adi ibn Ka'abit, që ishte një prej dhjetë fiseve fisnike të kurejshëve. Ky fis nuk ishte i pasur e as i fuqishëm si fiset Beni Hashim (fisi i Muhamedit a.s.) apo Beni Umejja (fisi i Othmanit). Megjithatë, fisi i Omerit dallohej me diturinë, urtësinë dhe intelektin e tij. Dituria dhe urtësia e këtij fisi bëri që shumë pjesëtarë të tij të mbajnë pozita të ambasadorëve në qytetet e tjera dhe të arbitrave në konflikte.[2] Axha i Omerit, Zejd ibn Amr, i cili ishte një prej udhëheqësve të fisit të tij, ishte aq inteligjent dhe i mirinformuar sa që refuzoi adhurimin e idhujve dhe përqafoi Islamin (fenë e Ibrahimit). El-Hatab, babai i Omerit dhe udhëheqësi tjetër i fisit, ishte gjithashtu shumë inteligjent, i respektuar dhe i guximshëm.

Omeri lindi rreth vitit 586. Ishte një prej njerëzve paktë nga kurejshët që mësoi të lexojë. Kur Muhamedit a.s. i zbriti shpallja është transmetuar se ekzistonin vetëm 17 njerëz që dinin të lexonin.[3] Gjithashtu, Omeri shquhej edhe me aftësitë e tij fizike. Ishte shumë i gjatë dhe shumë i fortë. Ishte gjithashtu një kalorës i shkëlqyer dhe mundës i pamundshëm.

Si i ri, Omeri shquhej për vendosmërinë dhe nganjëherë edhe për ashpërsinë e tij. Emocionet dhe butësia nuk ishin shumë të dukshme në sjelljen e Omerit. Gjithashtu ishte shumë i ditur dhe shumë i edukuar. Mësoi përmendësh shumë poezi, dhe lexoi shumë në histori. Si shumë kurejshit, Omeri punoi në tregti. Derisa ishte përgjithësisht një tregtar shumë i suksesshëm, duke bërë më shumë udhëtime tregtare se çdokush tjetër, Omeri nuk arriti fitime të mëdha. Ai ishte i interesuar më shumë në arritjen e diturisë sesa në fitimin e parave. Dituria, Omerit i lejoi të jetë gjithashtu i dërguar apo ambasador i Kurejshëve në shumë pjesë të tjera të regjionit. Ky rol i ndihmoi Omerit të arrijë më shumë njohuri për njerëz dhe kultura të ndryshme. Dituria e Omerit forcoi ndjenjën e përgjegjësisë dhe shqetësimin për njerëzit e tij dhe

[2] Haikal, M.H., "Al-Farouq Umar", Dar al-Ma'arif, Cairo, (1994), fq. 35.
[3] Ibid, fq. 42.

çfarë do të ndihmojë mirëqenien e tyre. Kjo dituri kontribuoi te ndjenjat e fuqishme të tij rreth opinioneve dhe argumenteve të tij. Ishte shumë i disiplinuar dhe i nënshtruar nga ligji e rendi. Ishte shumë i ashpër ndaj atyre që devijonin nga normat e shoqërisë. Ishte shumë i paepur për unitetin dhe rendin e kurejshëve. Omeri ishte prej kundërshtarëve më të fortë të muslimanëve të hershëm, pasi që ndiente se ata po ndanin dhe po dobësonin popullin e tij. Muhamedi a.s. e luste Allahun xh.sh. që ta udhëzonte Omerin në Islam, pavarësisht kundërshtimit të tij ndaj muslimanëve e madje edhe shtypjes së tyre. Muhamedi a.s. thoshte:

“O Allah! Forcoje Islamin me më të dashurit te ti: Ebu Xhehlin (Omer ibn el-Hakim) apo Omer Ibn Hatabin”. (Tirmidhiu)

Muhamedi a.s. te Omeri shihte një njeri të fortë, mbi të cilin mund të mbështetej.

Kur Omeri kuptoi që muslimanët thërritnin në fenë e tyre me sjellje të mira, e nuk shkaktonin asnjë dëm, por madje, ishte objekt i torturës dhe i shtypjes, filloi të ketë mendime të tjera për fenë e re. Ishte gjithashtu i impresionuar nga besimi i fortë i muslimanëve, të cilët duruan dhe këmbëngulën para një shtypjeje jashtëzakonisht të ashpër.

2) Veçoritë e personalitetit

Omeri u bë udhëheqës i muslimanëve rreth të pesëdhjetave, që është një moshë gjatë të cilës njeriu arrin pjekuri të madhe, derisa vazhdon të ketë një fizik të fortë. Në fillim të këtij nënseksioni, do të përqendrohemi në veçoritë fizike të Omerit, pastaj do të vazhdojmë me veçoritë e sjelljes së tij.

Omeri kishte një trup të madh. Ishte aq i gjatë sa që dukej që kalëronte diçka, kur ecte me shokët e tij.[4] Kishte një fytyrë pak si të kuqe dhe të bukur. Kishte një zë të fortë dhe të bukur. Gjithashtu ishte tullac dhe flokët e mbetur në kokë shtriheshin në të dy anët. Ecte gjallërisht. Kishte muskuj të dukshëm të fuqishëm dhe duar e këmbë shumë

[4] At-Tamawi, “Umar and the Fundamentals of Modern Politics and Administration”, Dar al-Fikr, Cairo (1976), p. 23

të fuqishme. Ishte shumë i fortë dhe punonte me të dy duart. Fuqia fizike e Omerit i mundësonte të ishte një kalorës i shquar dhe kampion në mundje. Gjithashtu, kjo i mundësoi të jetë një luftëtar i shquar, para dhe pasi u bë musliman. Si udhëheqës, aftësitë e tij fizike së bashku me veçoritë e sjelljes i dhanë shumë nderim. Kjo i mundësoi gjithashtu të ndihmojë fizikisht shumë muslimanë dhe të bëjë përpjekje të mëdha në arritjen e interesave të muslimanëve.

Në nivel të sjelljeve, shquhej me ndjenjën e përgjegjësisë, e cila është shtjelluar kur do të flasim rreth karakteristikave të lidershipit të tij në pjesën tjetër. Omeri ishte i njohur për ashpërsi, para dhe pasi që u bë musliman. Zakonisht zgjidhte zgjidhjet më radikale se Muhamedi a.s. dhe Ebu Bekri r.a., halifi i parë, dhe kjo ashpërsi i shtyu disa prej sahabëve që t'i frikësohen lidershipit të tij. Kur Ebu Bekri ishte duke menduar të propozojë Omerin si pasardhës, kërkoi nga Abdurrahman ibn Avfi opinionin e tij për të. Ky iu përgjigj se kishte mendimin më të mirë për Omerin, por mendonte se ishte i ashpër. Ashpërsia e Omerit buronte nga zotimi i tij për disiplinë, ligj dhe rend. Omeri ishte njeri i dëshirës dhe i besimit të madh. Pavarësisht që ishte një pirës i madh i alkoolit, ishte i pari që përkrahu ndalimin e alkoolit. Muhamedi a.s. thotë:

“Shejtani gjithnjë ka marrë rrugë tjetër nga ajo e Omerit”.

Veç kësaj, Omeri nuk ishte i ashpër në çdo çështje. Ashpërsia e tij nuk ishte një fund, por më tepër shërbente si mjet për t'i shërbyer interesit të Islamit. Më mirë mund të quhet si fuqi apo vendosmëri. Muhamedi a.s. thotë:

“Njeriu më i mëshirshëm i ymetit tim është Ebu Bekri dhe njeriu më i ashpër në ymetin tim për hir të fesë së Allahut është Omeri”.

Thënia e mësipërme tregon që Omeri ishte i ashpër vetëm për hir të fesë së Allahut. Veç kësaj, Omeri vërente pak butësi në udhëheqësin e tij, Ebu Bekrin dhe dëshironte të ekuilibronte atë me ashpërsinë e tij. Në fakt, Ebu Bekri iu përgjigj Abdurrahman ibn Avfit duke i thënë: “Ai vepron kështu (është i ashpër) pasi që sheh që unë jam i butë, dhe nëse më pason mua, do të heq dorë nga një pjesë e madhe e saj (e ashpërsisë)”. Ky argument është përsëritur nga vetë Omeri gjatë

fjalimit të tij të inaugurimit, kur tha që ashpërsia e tij do të ulej. Gjithashtu tha që ashpërsia do të mbetej sa i përket mëkatarëve dhe të ligjve, megjithatë do të jetë më i butë me njerëzit e mirë dhe të sinqertë sesa ata janë me njëri tjetrin. Gjatë lidershipit të tij, Omeri shfaqi nivel të lartë shpirtbutësie ashtu siç ishte zotuar. Në të vërtetë, ishte shumë i ekulibruar në trajtimin e tij me njerëzit. Është transmetuar se ka thënë:

"Mos jeni të butë deri në atë pikë që të shtrydheni, dhe mos jeni të ashpër deri në atë pikë sa të jenë të shkatërruar".

Omeri ishte shumë trim dhe i guximshëm. Guximi i tij është demonstruar qartë gjatë betejave në të cilat morri pjesë, qofshin ato para apo pasi që u bë musliman. Gjithashtu, ai deklaroi Islamin publikisht, duke sfiduar kështu tiraninë e kurjeshëve. Është transmetuar që ka qenë muslimani i vetëm të ketë emigruar botërisht në Medine. Megjithatë, guximi i tij shoqërohej me racionalizëm. Omeri nuk do të fuste muslimanët në një betejë të humbur. Ishte shumë i matur për fuqinë dhe dobësinë e muslimanëve, dhe ishte shumë i fokusuar në shërbimin dhe ruajtjen e interesave të muslimanëve. Për shembull, Omeri, u largua nga Siria kur kuptoi për përhapjen e një epidemie. Kur sahabët e qortuan duke i thënë: "A po ik nga caktimi i Allahut?" Omeri iu përgjigj: "Unë ika nga caktimi i Allahut te caktimi i Allahut".

Gjithashtu, Omeri ishte shumë i zgjuar dhe zotëronte një intuitë të madhe. Formimi i dha shumë njohuri dhe përvojë, pasi që ishte shumë inteligjent, i zgjuar dhe i edukuar nga familja (shih nën pjesët e kaluara). Njëherë Omeri e përshkroi veten duke thënë: "Unë nuk jam tinëzar dhe tinëzari nuk mund të më mashtrojë mua". Intuita dhe zgjuarsia e Omerit janë manifestuar në shumë raste, duke përfshirë zbulimin e komplotit për vrasjen e Muhamedit a.s., emërimin dhe shkarkimin e guvernatorëve, dhe këshillat e tij për Muhamedin a.s. Në fakt, shpallja ka mbështet opinionin e tij shumë herë. Kjo përfshin ajetet që kanë të bëjnë me çështjet vijuese:

1. Zgjedhja e Qabesë në Mekë si orientim për namazet.
2. Trajtimin e robërve të luftës në betejën e Bedrit.
3. Mbulimin e grave të Muhamedit a.s.
4. Ndalimin e konsumimit të alkoolit.

5. Ndalimin e faljes për hipokritët e vdekur dhe shoqërimin e funeraleve të tyre.
6. Domosdoshmërinë e marrjes së lejes para hyrjes në dhomat private.

Muhamedi a.s. ka lavdëruar zgjuarsinë dhe intuitën e Omerit duke thënë:

"Allahu xh.sh. ka vendos të vërtetën dhe drejtësinë në gjuhën dhe zemrën e Omerit".

Omeri grumbulloi shumë njohuri, duke qenë këshilltar i afërt i Muhamedit a.s. dhe duke qenë në mesin e shumë pak sahabëve që dinin shkrim e lexim. Zëri i tij i fuqishëm dhe zotërimi i historisë e i poezisë e bën një gojëtar e negociator të aftë.

Fiziku, vendosmëria, guximi, dituria, oratoria, ndërgjegjja dhe drejtësia e Omerit, bëri që të fitojë shumë respekt dhe nderim, dhe nuk u la zgjidhje tjetër pasuesve të tij, pos t'i binden. Në të vërtetë, personaliteti i Omerit ishte shumë i dobishëm në unitetin dhe rregullimin e shtetit musliman që rritej shpejt.

3) Arritjet gjatë lidershipit të Omerit

Është e vështirë të numërohen arritjet e muslimanëve gjatë lidershipit të Omerit. Për qëllim të këtij libri, megjithatë, arritjet kryesore të epokës së Omerit mund të përmenden shkurtimisht ashtu si vijon:

- Pushtimi i Irakut dhe i Persisë.
- Nënshtrimi i Egjiptit dhe i pjesëve të tjera të Afrikës Veriore që ishin nën sundimin e romakëve.
- Nënshtrimi i Sirisë së Madhe, që përfshin Sirinë, Libanin dhe Palestinën, që ishin nën sundimin e romakëve.
- Ndërtimin e qyteteve të reja siç janë Kufa dhe Basra në Irak.
- Organizimin e vendit në shtete apo në provinca.
- Themelimin e institucioneve të reja siç janë policia, burgjet, zyra për ankesa, ku pranoheshin dhe shqyrtoheshin ankesat e bëra nga populli; agjencia për grumbullimin e taksave e cila ishte e pavarur nga guvernatorët (valitë); një konferencë vjetore që mblidhte muslimanët nga i gjithë shteti gjatë haxhit; shërbimin postal; dhe shu-

më divizione të tjera administrative për të siguruar shërbimet e nevojshme për ymetin.

- Adoptimi i një kalendari të ri, duke filluar nga data e emigrimit apo e hixhretit.
- Instalimin e një kanali që lidh lumin Nil me Detin e Kuq.

Disa nga këto arritje do të diskutohen me më shumë detaje kur do të prezantojmë risitë administrative të Omerit.

2 - KARAKTERISTIKAT E LIDERSHIPIT TË OMERIT

Në prezantimin e karakteristikave të lidershipit të Omerit, do të fillojmë me ndjenjën e tij të përgjegjësisë, që ishte motivi real për performansën e shkëlqyer. Pastaj, do të adresojmë stilin e tij të menaxhmentit pjesëmarrës. Nënseksioni i tretë do të mbulojë aplikimin e Menaxhmentit të Kualitetit Total në lidershipin e Omerit. Në nënseksionin e ardhshëm, do të prezantoj kuptimin e plotë të Omerit për procesin e kontrollit. Në fund, do të theksohen risitë kryesore administrative gjatë epokës së Omerit.

1) Omeri dhe ndjenja e përgjegjësisë

Omeri, si liderët e tjerë të suksesshëm, kishte një ndjenjë shumë të lartë të përgjegjësisë. Ndihej përgjegjës para Allahut xh.sh. për mirëqenien e çdo gjëje nën ndikimin e tij, duke përfshirë edhe kafshët. Njëherë Omeri tha që kishte frikë që një mushkë mund të rrëzohej në rrugët malore të Irakut dhe të thyente këmbët e tij, dhe Allahu xh.sh. do ta pyeste pse nuk ka shtruar rrugët në atë hapësirë. Aliu r.a., halifi i katërt thotë: “E pashë Omerin duke shpejtuar, prandaj e pyeta ku po shkonte”. Omeri iu përgjigj: “Po shpejtoj të zë një prej deveve të bamirësisë që ka ikur”. Pastaj Aliu thotë që kjo është shumë, pasi që po e bënte shumë të vështirë detyrën e pasuesve të Omerit. Omeri iu përgjigj duke thënë që nëse një dash do të humbte në rrethet e Eufratit

(lum në Irak), Omeri do të jepte llogari për të, në Ditën e Gjykimit”.[5] Ndjenja e përgjegjësisë së Omerit e bëri të interesohej shumë për njohjen e gjendjes reale të njerëzve të tij, duke pasur një politikë të derës së hapur dhe kureshtar për gjendjen e njerëzve të tij, qoftë formalisht apo joformalisht. Omeri themeloi një konferencë vjetore gjatë haxhit, ku muslimanët nga e gjithë bota i paraqitnin ankesat atij. Ai gjithashtu themeloi agjencinë për ankesa. Veç kësaj, Omeri ndryshonte pamjet e tij dhe u bënte vizita befasuese lagjeve të ndryshme të Medinës që të merrte informacione të dorës së parë sesi vepronin njerëzit e tij. Ishte mësuar që menjëherë të zgjidhte çdo problem me të cilin përballej. Bënte vizita të vazhdueshme në qytetet e tjera për të kontrolluar gjendjen e vështirë të pasuesve të tij. Ushtronte kontroll të ashpër mbi vartësit e tij. Ky proces i kontrollit do të prezantohet më vonë. Ndjenja e përgjegjësisë së Omerit bëri që të jetë një rol shembullor i rëndësishëm, veprat e të cilit flasin shumë më lart se fjalët e tij. Transmetohet të ketë thënë:

“Jam shumë i etur të kënaq çdo nevojë të vetme që mund të keni sa kohë që është e mundshme. Nëse nuk mund (të kënaqim nevojat e çdokujt), duhet të ndihmojmë njëri-tjetrin (të ndajmë atë që kemi) deri sa të arrijmë nivelin e njëjtë të minimumit të domosdoshmërive… dhe unë vetëm po ju mësoj përmes veprimeve”.[6]

2) Omeri dhe menaxhmenti participativ

Menaxhmenti pjesëmarrës është përfshirja e vazhdueshme e njerëzve në vendimmarrje. Më shumë se kulturë, ai është program. Pjesëmarrja është një detyrim në Islam. Ai realizohet përmes konsultimit, përmirësimit të së keqes dhe këshillës, që janë të gjitha të detyrueshme në Islam. Prandaj, pjesëmarrja ishte një kulturë që çdonjëri e ndante gjatë kohës së Muhamedit a.s. dhe katër pasardhësve të tij të drejtë. Megjithatë, praktika e kësaj detyre ndryshon gjatë gjithë historisë islame. Omeri është konsideruar të jetë kampion i menaxhmentit

[5] Transmetuar nga ibn el-Xhevziu, Ibid. fq. 26
[6] Op. cit p. 61

pjesëmarrës. Megjithëse menaxhmenti pjesëmarrës ishte kulturë e sahabëve të Muhamedit a.s., të cilët nuk kishin nevojë të ftoheshin apo të mësoheshin ta praktikonin atë. Omeri përforcoi këtë koncept duke krijuar një numër të programeve dhe institucioneve për të edukuar për të. Omeri nuk morri asnjë vendim të rëndësishëm pa u konsultuar me njerëzit e tij. Omeri konsultohej me njerëzit e vet në emërimin e guvernatorëve (valinjve) dhe komandantëve të ushtrisë. Gjithashtu, ndiqte opinionin e pasuesve të tij dhe vetë, nuk morri pjesë në beteja. Konsultimi përdoret edhe në administrimin e përditshëm për rritjen e burimeve të vendit. Kjo pasi që duke u mbështetur në konsultim, u themeluan departamente (devavin) të ndryshme administrative. Omeri, me të në Medine, mes sahanëve mbante njerëzit e kalibrit të lartë, në mënyrë që të përfitonte nga opinionet e tyre. Njerëzit që i emëronte si guvernatorë nuk kufizoheshin te këshilltarët e tij. Konsultimi nuk është ndaluar në nivelin e sahabëve të Muhamedit a.s. me përvojë të madhe e të kualifikuar, por ishte aq i gjerë sa që përfshinte çdokënd në shoqëri pavarësisht moshës, racës apo gjinisë. Kur këshilli i këshilltarëve dështoi të merrte vendim në lidhje me çështjen e ndarjes së tokës së Irakut dhe të Sirisë, Omeri thirri një mbledhje të përgjithshme publike në Medine për të marr vendim. Veç kësaj, Omeri organizonte një konferencë vjetore për muslimanët për të shpreh mendimin e tyre rreth çështjeve të përgjithshme dhe për të adresuar shqetësimet rreth mënyrës së qeverisjes. Elementet më të veçanta në procesin e vendimmarrjes gjatë kohës së Omerit ishin konsultimet me të rinjtë myslimanë, e veçanërisht konsultimet me disa nga armiqtë e tij. Omeri besonte se të rinjtë kishin mendje më të mprehta që u mundësonin të jepnin ide origjinale. Gjithashtu, e kuptonte që njerëzit më të mirë për ta informuar rreth armiqve, nuk kishte tjetër pos armiqve të tij.

3) Omeri dhe menaxhmenti i kualitetit total

Menaxhmenti i kualitetit total mund të definohet si angazhim strategjik për përmirësimin e kualitetit, duke kombinuar programet dhe metodat me një angazhim kulturor, për të hulumtuar përmirësimet shtesë që rrisin produktivitetin dhe ulin koston. Menaxhmenti i kualitetit total synon plotësimin apo tejkalimin e pritjeve të konsumatorëve. Dilworth[7] thekson që kualiteti total është kulturë, e jo program siç janë rrethet e kualitetit. Ai gjithashtu thekson që kualiteti total është total në kohë, në atë, që nuk përfundon kurrë, pasi që nuk ka nivel të kualitetit që është “mjaft i mirë”. Ky deklarim i Dilworthit është tregues i komponentit të rëndësishëm kulturor të kualitetit total në përmirësime të vazhdueshme. Megjithatë, shtylla e menaxhmentit të kualitetit total është kultura, angazhimi, pjesëmarrja dhe përmirësimi.[8] Pa këto komponentë kulturor vështirë se arrihet përmirësimi i vazhdueshëm kulturor.

Fakti që menaxhmenti i kualitetit total është kulturë më shumë se program nuk do të thotë që programet nuk nevojiten më shumë. Në fakt, kultura e kualitetit total duhet të përforcohet me programe të caktuara siç janë rrethet e kualitetit, ftesat e rregullta nga jashtë të konsulentëve, trajnimeve e hulumtimeve, dhe zhvillimit. Kultura dhe programet duhet të plotësojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin.

Veç kësaj, kualiteti total kërkon një shkallë të lartë të disiplinës dhe unitet të qartë të komandës. Autoriteti akoma mbetet esencial për arritjen e ndonjë detyre. Dilworth[9] thekson:

“Kur të vendoset një procedurë efiçiente që rezulton me kualitet të mirë, atëherë ajo duhet të ndiqet derisa të testohet e të aprovohet një mënyrë më e mirë. Ju mund të shihni që kreativiteti dhe sinqeriteti për

---

[7] Dilworth, J. B., “Production and Operation Management”, 5th ed. McGraw Hill, (1993), p. 346

[8] Jabnoun, N. “Rethinking Total Quality Management and Making it work”, Prentice Hall, Malaysia (1999).

[9] Dilworth, J. B., “Production and Operation Management”, 5th ed. McGraw Hill, (1993), p. 346

të ndryshuar janë të nevojshëm, por është kreativiteti në bashkëpunim me punën ekipore dhe disiplinën që arrin kualitet të mirë të qëndrueshëm dhe shpie te përmirësimet".

Një aspekt tjetër i menaxhmentit të kualitetit total qëndron në faktin që nuk është i lirë, por madje kërkon alokim të përshtatshëm të burimeve. Fraza "kualiteti nuk është i lirë" do të thotë që kualiteti është me përfitim, më shumë se shlyerje e pagesës. Kjo nuk do të thotë se duhet të shpërfillet në buxhet.

Kualiteti është shumë i theksuar në mësimet e Islamit. Muhamedi a.s. thotë:

"Allahu xh.sh. dëshiron që kur dikush nga ju të bëjë një punë, ta përsosë atë". (Bejhaki)

Gjithashtu, Muhamedi a.s. thotë:

"Allahu xh.sh. ka urdhëruar të mirën për çdo gjë. Kur të vrani, bëni në mënyrën më të mirë; dhe kur të therni (një kafshë për kurban) bëni të mirën, më të mirë. Prandaj, çdokush nga ju duhet të mpreh thikën e tij, dhe të bëjë që kafshës së therur t'i del shpirti në mënyrë të qetë". (Muslimi)

Ndjenja e përgjegjësisë së Omerit dhe vetëdijesimi gjithnjë për llogaridhënien para Allahut xh.sh. në Ditën e Gjykimit bëri që të jetë i saktë dhe shumë i ashpër në ndërmarrjen e ndonjë veprimi. Omeri ishte shumë i kujdesshëm veçanërisht në emërimin e liderëve. Liderët e zgjedhur nga Omeri ishin shumë të kujdesshëm. El-Burej[10] thekson që "Omeri kishte zakon të testonte performansën e guvernatorëve (valinjve) të tij, duke i emëruar në baza ad-hoc për dy apo tre muaj para emërimit të tyre të rregullt. Omeri ishte gjithashtu shumë i angazhuar për kualitet të lartë, nëse jo performansë perfekt në çdo veprim të jetës. Namazin nuk e fillonte derisa të sigurohej që të gjithë njerëzit prapa tij ishin në vijë të drejtë, dhe kishte caktuar një person të veçantë për këtë detyrë. Omeri nuk nxitohej të kryente një detyrë me kualitet të vogël. Nëse vërente që një proces i caktuar nuk shkonte siç duhej, do të ndërmerrte veprime të menjëhershme korrigjuese. Omeri e kish-

[10] Al-Buraey, M. "Management and Administration in Islam", (1990), p. 249

te zakon që të definonte qartë çka dëshironte nga guvernatorët (valinjtë) apo komandantët e ushtrisë, dhe u siguronte burimet e nevojshme për të arritur kualitetin e kërkuar të suksesit,[11] pasi që kualiteti nuk është i lirë.

Omeri emëroi Sharabil ibn Hasna r.a. për guvernator (vali) të Sirisë dhe pastaj e ndërroi me Muavije ibn Ebi Sufjanin. I pari e pyeti Omerin nëse ishte i zemëruar me të për ndonjë gjë. Omeri iu përgjigj: "Jo, ti je pikërisht ashtu si dëshiroj, por unë dëshiroj një njeri më të fortë se të tjerët".[12] Kjo ngjarje tregon që Omeri ishte i kënaqur me performansën e guvernatorit (valiut) së tij të parë, megjithatë, në momentin kur gjeti një guvernator (vali) më të fortë, vendosi ta ndërrojë atë. Omeri ndërmori një veprim të ngjashëm me guvernatorin e tij në Bahrejn Utbe ibn Azvan, i cili u ndërrua me el-A'la el-Hadrami. Ky qëndrim i Omerit është i ngjashëm me filozofinë e menaxhmentit të përmirësimit të vazhdueshëm që është përvetësuar në menaxhmentin e kualitetit total dhe në prodhimin bashkëkohor. Procesi i kontrollit për kualitet të ngjashëm të menaxhmentit do të diskutohet në nënseksionin tjetër. Është e rëndësishme të dimë që Omeri ia bëri të qartë popullit që ishte plotësisht i kënaqur me guvernatorët (valinjtë) e tij dhe i ndërroi vetëm pasi që kishte gjetur të tjerë që do të performonin më mirë. Kjo i dha popullit një vlerësim të kualitetit të përmirësuar, derisa mbyll derën para thashethemeve dhe keqinterpretimeve të mundshme të veprimeve të Omerit.

4) Omeri dhe procesi i kontrollit

Kontrolli është një prej katër komponentëve të procesit të menaxhmentit. Kontrolli mund të definohet si proces i sigurimit që aktivitetet aktuale përputhen me aktivitetet e planifikuara.[13] Fakti që kontrolli është procesi i katërt i menaxhmentit pas planifikimit, organizimit dhe

[11] Al-Aqqad A., M. Nahdat Misr, "Abquariyyatu Umar", Cairo, p. 85
[12] At-Tamawi, "Umar and the Fundamentals of Modern Politics and Administration", Dar al-Fikr, Cairo (1976), p. 270
[13] Mockler, R. J., "The Management control process", Englewood Cliffs, N. J: Prentice Hall. (1984), p.2

udhëheqjes, nuk do të thotë se është i fundit në rëndësi. Në fakt, procesi i kontrollit gjithashtu siguron disa masa të kualitetit në planifikim, organizim dhe në proceset udhëheqëse.

PROCESI THEMELOR I KONTROLLIT

Hapat themelor në procesin e kontrollit përfshijnë:[14]

1. Vendosjen e standardeve dhe mjeteve të matjes së performansës:

Kjo përfshin vendosje të qartë të objektivave dhe qëllimeve të organizatës në terma specifik të matshëm. Çdo paqartësi në formuli-min e objektivave dhe qëllimeve, procesin e kontrollit e bën të pamundshëm. Pastaj, standardet e performansës për çdo paketë të punës që shpie te qëllimet dhe objektivat, duhet të vendosen qartë. Komponentët kryesor të performansës janë koha, paraja dhe kualiteti apo performansa teknike. Vendosja e standardeve është esenciale për procesin e kontrollit, veçanërisht pasi që njerëz të ndryshëm zakonisht supozojnë përgjegjësitë e planifikimit dhe të kontrollit.[15]

2. Matja e performansës

Ky është supozuar të jetë proces i shpeshtë dhe i rregullt gjatë të cilit matet performansa aktuale. Sa më të shpeshta janë matjet, më shumë efektiv është procesi i kontrollit. Teorikisht, matjet duhet të jenë të vazhdueshme, megjithatë, kjo mund të jetë efektive nga aspekti i kostos.

[14] Sathe, V., “The Controller’s Role in Management”, Organization Dynamics 11, no. 3, winter (1983). Pp. 31-48.
[15] Linda Smircich, “Concepts of Culture and Organizational Analysis”, Administrative Science Quarterly, Sept. (1983), p. 342

3. Krahasimi i performansës aktuale me standardet

Qëllimi i matjes së performansës aktuale pa dyshim është zbulimi, është apo jo në përputhje me standardet e paracaktuar. Në rast që performansa përshtatet me standardet, atëherë duhet të vazhdojë pa asnjë modifikim. Përndryshe, duhet të ndërmerren disa veprime korrigjuese.

4. Ndërmarrja e veprimeve korrigjuese

Kur kuptojmë që performansa nuk është në përputhje me standardet, bëhet e domosdoshme ndërmarrja e veprimeve korrigjuese, përndryshe hapat e kaluar të procesit të kontrollit janë të kotë. Performansa duhet të ndryshohet për t’u përshtatur standardeve. Nganjëherë procesi i kontrollit mund të zbulojë që standardet të jenë shumë të ulët, apo shumë të lartë. Në rast të tillë, veprimet korrigjuese duhet të përbëhen nga ndryshimi i standardeve.

Problemi kryesor me procesin e kontrollit që është diskutuar më sipër është fakti që ai buron nga një kuptim tradicional i menaxhmentit. Roli i kulturës organizative apo i sistemit të vlerave dhe i besimeve të përbashkëta që për shembull japin norma të sjelljeve në organizatë,[16] nuk duhet të shkaktohen në procesin themelor të kontrollit. Kjo është disi e çuditshme, duke i dhënë rëndësi të spikatur teorisë së atribuar kohët e fundit të efektivitetit organizativ. Kjo teori e efektivitetit organizativ merr si bazë nocionin që vlerat, besimet dhe kuptimet që gjenden poshtë një sistemi shoqëror janë burimi primar i aktivitetit të motivuar e të koordinuar.[17] Në vitet e 80-ta, shumë libra mbi studimet dhe menaxhmentin organizativ, siç janë “Arti i Menaxhmentit Japonez”,[18] “Kulturat e korporatave”, dhe veçanërisht “Në kërkim të Përsosmërisë” janë bërë bestseller.

[16] Op. cit p. 2
[17] Pascalm R.T. and Athos, A.G., “The Art of Japanese Management: Applications for American Executives”, New York: Simon and Schuster, (1981).
[18] Ash-Sharqawi, Al-Farouq, “Umat ibn al-Khattab”, Cairom (1979).

Zhvillimi kryesor në fushën e menaxhmentit, të cilin procesi themelor i kontrollit nuk e merr parasysh është koncepti i menaxhmentit të kualitetit total. Ky koncept është shpjeguar në pjesën e fundit.

Procesi i kontrollit i praktikuar nga omeri

Omeri nuk shkoi te asnjë shkollë menaxhmenti për trajnim, por edukimi, urtësia dhe veçanërisht shoqërimi i tij me Muhamedin a.s. i lejoi të zotërojë artin e menaxhmentit. Omeri definonte qartë një mori kriteresh për emërimin e liderëve.[19] [20] Definonte gjerësisht rolet e komandantëve dhe të guvernatorëve (valinjve), dhe sigurohej që ata kishin ndjekur drejtimin e përgjithshëm të tij, duke u lejuar lirinë operacionale.[21] U siguronte disa nga të emëruarit e tij, për të cilët ndiente që detyrat e tyre ishin shumë të vështira, me burime shtesë, me qëllim që të ishin në gjendje të arrinin qëllimet e dëshiruara.[22]

Njëherë Omeri konsultoi shokët e tij, rreth një emërimi. Kërkoi nga ta mendim, sepse siç ishte shprehur ai, donte të zgjidhte më të mirin prej tyre dhe ta urdhëronte të vepronte me drejtësi. A e ka kryer Omeri pjesën e tij? Ata u përgjigjën duke i thënë: “Po”. Omeri i kundërshtoi “Jo”, derisa të kuptojë nëse i caktuari i tij e ka bërë atë me të cilën e ka urdhëruar ta bëjë.

Citati i mësipërm demonstron që Omeri e njihte plotësisht procesin e kontrollit. Ai tregoi që nuk do ta kishte kryer pjesën e tij, nëse nuk kishte kontrolluar të emëruarin i tij për të kryer atë që e kishte urdhëruar. Kjo tregon që detyra e parë e Omerit është t’i shpjegojë të emëruarit çfarë pret nga ai. Pastaj, duhet të kontrollojë nëse i emëruari është duke vepruar atë me të cilën është urdhëruar. Kontrollimi i Omerit mbi performansën e të emëruarve të tij është zbatuar përmes programeve të caktuara, siç janë konferenca vjetore e haxhit, vizitave personale agjentëve të inteligjencës dhe agjencisë së ankesave, e cila i

[19] Al-Aqqad A., M. Nahdat Misr, “The Ingeniousity of Umar”, Cairo, (1979).
[20] Ibid., p. 86.
[21] Ibid., p. 85.
[22] At-Tamawi, “Umar and the Fundamentals of Modern Politics and Administration”, Dar al-Fikr, Cairo (1976), p. 270.

pranonte ankesat e popullit për guvernatorë të ndryshëm. Gjithashtu, ajo është zbatuar joformalisht përmes kulturës së njerëzve, që është bazuar në ndalimin e të keqes dhe urdhërimin për të mirë. Në rastet kur të emëruarit nuk kanë zbatuar si duhet detyrat, Omeri nuk ka hezituar t’i ndërrojë. Në fakt, Omeri nuk merrte veprime të tilla vetëm për të përmirësuar ndonjë të keqe, por madje, ishe shumë i vendosur në marrjen e çdo vendimi që mund të përmirësonte një performansë tashmë të mirë. Omeri ishte i angazhuar për përmirësim të vazhdueshëm ashtu siç është përmendur në pjesën e fundit. Procesi i përmirësimeve është ndihmuar nga kultura e këshillës, ashtu siç thotë Muhamedi a.s.: *“Feja është këshillë”*, e programet e menaxhmentit pjesëmarrës të vendosur nga Omeri. Gjithashtu kjo është ndihmuar nga shprehjet kulturore mbi kualitetin, ashtu siç thotë Muhamedi a.s.:

“Allahu xh.sh. dëshiron që kur dikush nga ju të bëjë një punë, ta përsosë atë”. (Bejhaki)

Bazuar në diskutimin e mësipërm, mund të përmbledhim procesin e kontrollit të praktikuar nga Omeri ashtu si vijon:

1. Standardet duhet të qartësohen mirë.
2. Duhet të sigurohet inputi i domosdoshëm. Ky input duhet të përfshijnë burimet dhe shkathtësitë e domosdoshme, si dhe autoritetin e nevojshëm.
3. Hulumtim i vazhdueshëm për mënyrat e reja të përmirësimit të performansës dhe vendosja e standardeve të tij.
   Ky hulumtim duhet të zbatohet përmes një kulture të favorshme dhe disa programeve veçanërisht të përcaktuara. Programi duhet të jetë: angazhim për kualitet, pjesëmarrje dhe përfshirje. Programet në organizatat moderne mund të përfshijnë rrethet e kualitetit, ftesat e rregullta për konsulentët e jashtëm, trajnimi, hulumtimi e zhvillimi dhe kërkimet për konsumatorë.
4. Si performansa ashtu edhe outputi janë kontrolluar ngushtësisht përkundrejt standardeve përmes kulturës ekzistuese të angazhimit dhe përfshirjes, dhe disa aktiviteteve të përcaktuara, veçanërisht si masa të rregullta, kontroll i kualitetit statistikor dhe hulumtime mbi konsumatorët.

5. Nëse performansa dhe/ose outputi nuk janë në pajtim me standardet, atëherë veprimet korrigjuese duhet të ndërmerren.
6. Nëse performansa është në përputhje me standardet, atëherë kontrollohet mundësia e përmirësimit të performansës.
7. Nëse ekziston ndonjë mënyrë e përmirësimit të procesit, atëherë për t'i zbatuar ato, duhet të merret domosdoshmëria e veprimeve korrigjuese. Këto korrigjime duhet të përfshijnë performansën e tanishme, inputin dhe vetë standardet.

Duhet të përmendim që standardet janë dinamike në këtë rast pasi që ato ndryshojnë çdo herë që gjendet një metodë e re e përmirësimit.

Modeli i mësipërm i kontrollit është prezantuar në figurën 12 (në fund të kapitullit).

Në nënseksionin vijues do të mbulojmë risitë administrative gjatë periudhës së Omerit, si halif.

5. Omeri dhe risitë administrative

Do të dëshironim që së pari të definojmë administratën si detyrë për arritjen e qëllimeve të paracaktuar.[23] Sipas Shepardit,[24] risia ndodh kur një organizatë mëson si të bëjë diçka që nuk ka ditë të bëjë më parë, dhe pastaj vazhdon ta bëjë atë në mënyrë të pandërprerë, apo mëson që të bëjë diçka që nuk e ka bërë formalisht, dhe nuk vazhdon ta bëjë në mënyrë të pandërprerë. Nuk ka rëndësi nëse idetë e reja vinë nga brenda apo jashtë firmës, sa kohë që idetë janë të reja për firmën.[25] Megjithëse ekziston një numër i madh i literaturës mbi risitë, faktorët kryesor që shpijnë te risia mund të përmblidhen në kulturë, strukturën organizative, lidershipin dhe mjedisin. Kultura e sahabëve të Muhamedit a.s. ishte një terren shumë pjellor për risitë. Nuk kishte

[23] Hofer, C., W., and Schendel, "Strategy Formulation Analytical Concepts", West Publishing, St. Paul, (1978).

[24] Shepard, H. A., "Innovation Resisting and Innovation Producing Organization Organizations". Journal of Bussiness 40, (1967). Pp. 470-477.

[25] Mc Ginnis, M., A., and Ackelsberg, M.R., "Innovation of the Strategic Management Process", in the Strategic Planning and Management handbook, edited by King and Cleland, Van Nostrand Reynold Company, NY, (1987). P. 37.

asnjë status apo barriera organizative që mund të pengonin komunikimin dhe sugjerimin e risive të reja. Struktura e organizatës ishte organike. Gjithashtu, angazhimi i sahabëve të Muhamedit a.s. për mirëqenien e ymetit dhe përpjekja e tyre për të, u dha sukses të madh në zhvillimin e zgjidhjeve të reja për problemet dhe sfidat e tyre të reja. Omeri shërbeu si katalizator për këto risi dhe zhvillime, duke zgjeruar më tej sferën e pjesëmarrjes dhe organizimin e programeve speciale për të, ashtu siç është konturuar në nënseksionin mbi menaxhmentin pjesëmarrës. Veç kësaj, urtësia, lidershipi, guximi dhe vendosmëria e Omerit hapi rrugën për zhvillimin dhe implementimin e ideve të reja. Një arsye tjetër për zhvillimin e rëndësishëm administrativ gjatë kohës së Omerit ishte zhvillimi i pashembullt në punët e shtetit, pasi që vendi, burimet dhe sfidat e tij rriteshin më shumë.

Struktura organizative gjatë kohës së Muhamedit a.s. ishte shumë e thjeshtë. Muhamedi a.s. kishte unitetin e komandës dhe përdorte mënyrën pjesëmarrëse në vendimmarrje. Ai kishte një këshill konsultativ i përbërë nga katërmbëdhjetë anëtarë, shtatë prej të cilëve ishin nga Meka e shtatë të tjerë nga Medina. Megjithatë, sfera e konsultimit përfshinte të gjithë shtetasit. Gjithashtu, Muhamedi a.s. kishte ndarë administrativisht tokën muslimane në provinca më të vogla. Muhamedi a.s. kishte edhe një numër të sekretariateve, duke përfshirë një përgjegjës për vulosje, dhe një poet të veçantë për t'iu përgjigjur propagandës poetike të armiqve të tij, por këta njerëz ishin caktuar individualisht dhe nuk përfaqësonin institucionet apo departamentet. Sidoqoftë, gjatë periudhës së Muhamedit a.s. ishte krijuar kultura organizative dhe gjatë periudhës së tij, duken zhvillimet administrative.

Ebu Bekri udhëhoqi muslimanët për vetëm dy vite. Veç kësaj, ai ishte shumë i preokupuar me luftërat kundër hipokritëve (murtedëve). Kontributet e tij administrative ishin të kufizuara në emërimin e thesarmbajtësit, gjykatësit suprem dhe ndarjeve të ndryshme gjeografike nga ato që ekzistonin në periudhën e Muhamedit a.s.. Sidoqoftë, arritjet administrative të Ebu Bekrit ishin shumë kritike, pasi që ngritën themelet për zhvillimet e mëvonshme.

Departamentet e para publike në historinë islame ishin themeluar në kohën e Omerit. Këto departamente u quajtën devavin (shumës i fjalës divan). Pasi që u zgjeruan burimet e ymetit musliman, Omeri kërkoi sugjerime nga sahabët për menaxhimin dhe shërbimin më të mirë të nevojave të njerëzve. U sugjeruan shumë alternativa. Pastaj, më në fund u pajtuan të themelojnë disa departamente, si: departamenti i ushtrisë, departamenti i lëmoshave apo departamenti i listës së pagave. Departamenti i lëmoshave mbante një listë të të gjithë shtetasve, vlerësonte nevojat e tyre dhe u jepte sasi proporcionale të parave. Gjithashtu, ekzistonte edhe departamenti i dokumentimit, ku mbaheshin dokumentet e rëndësishme. Këto departamente u themeluan gjithashtu edhe në provinca të ndryshme. Et-Tamawi thekson që departamentet në Damask, Irak dhe në Egjipt përdornin gjuhën vendase të popullit të vendit (do të thotë gjuhën romake, persiane, përkatësisht kopte), që tregon që njerëzit që udhëhiqnin departamentet provinciale nuk ishin arabë.[26]

Omeri kishte urdhëruar ndërtimin e qyteteve të reja siç janë Kufa dhe Basra. Arsyeja për këtë vendim qëndron në klimën e qyteteve ekzistuese të Irakut që nuk përputhej me klimën me të cilën ishin mësuar arabët, dhe nuk ishte e shëndetshme për ta. Ai dëshironte të mbështeste mënyrën e njëjtë të jetesës të ushtarëve të tij. Dëshironte nga ata që të vazhdonin të jetonin së bashku në jetë asketike e në kushte të vështira dhe të ruante qëndrimet e tyre të guximshme e sakrifikuese. Kjo i ngjan konceptit modern të bazave ushtarake. Omeri kishte ndryshuar edhe ndarjen gjeografike të vendit në provinca të reja.

Ebu Bekri caktoi Omerin si gjykatës së muslimanëve. Pasi që kishte pranuar këtë përgjegjësi ligjore me vendosmëri, Omeri u bë pasardhësi i dytë i Muhamedit a.s. Si udhëheqës ekzekutiv, Omeri caktoi Aliun si gjykatës të pavarur. Ai gjithashtu caktoi gjykatës të ndryshëm në provinca të ndryshme. Këta gjykatës ishin plotësisht të pavarur nga guvernatorët (valinjtë) e tyre. Veç kësaj, Omeri kishte vendosur një

[26] At-Tamawi, “Umar and the Fundamentals of Modern Politics and Administration”, Dar al-Fikr, Cairo (1976), p. 310.

kushtetutë për gjykim. Kushtetuta konturonte direktivat dhe etikën e gjykimit.

Omeri kishte themeluar një agjenci për ankesa që kishte përgjegjësinë e shqyrtimit të rasteve ligjore, verdiktet e së cilës nuk binin palët e përfshira. Megjithatë, funksioni kryesor i kësaj agjencie ishte forcimi i ligjit kundër njerëzve të fuqishëm e autoritar dhe shqyrtimi i ankesave të njerëzve kundër guvernatorëve (valinjve). Kjo agjenci i ngjan rolit që kanë disa organizata bashkëkohore për të drejtat e njeriut, me përjashtim që këta të fundit nuk kishin autoritet detyrues.

Gjithashtu, administrata e Omerit ishte shumë efiçiente në mbledhjen e informatave, veçanërisht rreth armiqve të tij të luftës. Omeri kishte një zgjuarsi perfekt dhe kërkonte informacione nga çdo burim, duke përfshirë edhe armiqtë e tij. Zgjuarsia i mundësoi të dinte nëse armiku ishte duke tentuar të mashtronte apo jo. Omeri ishte efektiv në menaxhimin e informacioneve përmes departamentit të dokumentimit.

Omeri, i cili njihet me vet disiplinën e tij, ishte shumë i suksesshëm në delegimin e autoritetit. Ishte shumë preciz në shpjegimin e politikave të tij dhe nivelin e autoritetit të deleguar. Ajo që është më e rëndësishme, Omeri ishte i njohur me veprimin në përputhje me marrëveshjet mes tij dhe të deleguarve të tij. Një herë, Omeri mori një ankesë për njërin nga komandantët e ushtrisë, e që Ebu Ubejda e kishte deleguar të udhëhiqte. Omeri u përgjigj, “Kjo është brenda të drejtës së Ebu Ubejdës”.[27]

Omeri ishte i vetëdijshëm për fuqinë e njerëzve të tij, që rridhte kryesisht nga kultura e besimit, drejtësia, bujaria dhe guximi. Ai gjithashtu ishte i vetëdijshëm për kufizimet dhe dobësitë e tij praktike. Për shembull, e dinte që ushtarët e tij që vinin nga shkretëtira kishin përvojë të vogël me detin. Si rezultat, ishte kundër lejimit të tyre të përfshiheshin në beteja detare.

Në fund, procesi i kontrollit i përdorur nga Omeri, angazhohej në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Ai kontribuoi në forci-

[27] Muhammad Kurd, “Umar ibn al-Khattab”, p. 96.

min e kulturës tashmë ekzistuese pjesëmarrëse. Të gjithë këto janë prezantuar në seksionet e mëhershme.

Figura 12. Përshkrimi i Procesit të Kontrollit për T.Q.M., ashtu siç është praktikuar nga Omeri, mund të shihet në vijim.



Figura 12. Procesi i kontrollit për T.Q.M i praktikuar nga Omeri
Procesi TQM i kontrollit i Omerit.

Dr. Naceur Jabnoun

ISLAM AND MANAGEMENT - (7)

(Summary)

The leadership of Umar ibn Al-Khattab

Umar ibn al-Khattab (May Allah be pleased with him) was the second successor of Prophet Muhammad (PBUH). He is considered by many scholars as the founding father of modern administration. He was the only Muslim besides Prophet Muhammad (PBUH) to be chosen by Michael Hart among the one hundred most influential persons in history. In this chapter, we will present and introduction of Umar including his background, his personality traits, and his achievement. Then, we will outline the characteristics of his leadership.

ناصر جبنون

الاسلام و الادارة

(خلاصة البحث)

زعامة عمر بن خطاب

كان عمر ابن الخطاب ثانى خلفاء المسلمين و يعتبر من كثير من المؤرخين مؤسس الادارة الحديثة. هو يعتبر المسلم الوحيد الى جانب الرسول عليه الصلاة و السلام الذى تم اختياره من قبل مايكل هارت فى كتابه "مائة شخصية اكثر تأثيرا فى العالم". سوف نقدم فى هذا الفصل مدخلا عن عمر رضى الله عنه عن تكوينه و ثقافته و شخصيته ثم سوف نتطرق الى زعامته .

KUMTESË

Mr.Qemajl Morina

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT SIPAS REVISTËS "AL-XHINAN" TË BEJRUTIT 1878-1881[*]

Jehona e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk u ndie vetëm brenda kufijve të Evropës, por ajo kishte marrë dhenë. Trimëritë e popullit shqiptar, qëndresa dhe sakrifica e tij për tokën e të parëve kishin zënë faqe të tëra në lajmet dhe komentet e shtypit arab të asaj kohe. Në mesin e gazetave dhe revistave, që kishin përcjellë ngjarjet e kësaj ndodhie, gjatë viteve të bujshme 1878-1881, ishte edhe revista "Al-xhinan"[1], e cila botohej në Bejrut të Libanit, nga dijetari libanez, Butrus Al-Bustani. Në këtë kohë guvernator i Libanit ishte rilindësi ynë i

[*] Kjo kumtesë, është lexuar në Konferencën shkencore, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Instituti i Historisë në Prishtinë, më 10 qershor 2008, me rastin e 130-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

[1] "Al-Xhinan, është revistë politike, shkencore, letrare e historike, të cilën e themeloi dijetari i njohur arabo-libanez, Butrus al-Bustani, (botues i Enciklopedisë së parë arabe), në janar të vitit 1870. I biri i tij, Selim al-Bustani e mbante duke përgatitur shumicën e shkrimeve që botoheshin në të. Me vdekjen e themeluesit, më 1883, revista kaloi në pronësinë e të birit, Selim al-Bustanit, kurse pas vdekjes së tij më 1884, kaloi në pronësi të nipit, Nexhip al-Bustanit, deri në ndërprerjen e daljes së saj më 1887. Revista doli një herë në javë dhe gëzonte një reputacion të gjerë në rajonin e Lindjes së Mesme.

mirënjohur, Vaso Pashë Shkodrani, njëri prej kreatorëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Ashtu siç shihet nga libri i tij "E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët" (La verite sur l'Albanie et les Albanais) botuar në Paris, më 1879, përkthyer edhe në disa gjuhë të tjera evropiane, në të cilën krahas të dhënave historike mbi popullin shqiptar dhe qëllimet e luftës së tij, kritikon administratën burokratike osmane dhe paraqet kërkesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Vaso Pashë Shkodrani ishte guvernator i Libanit nga viti 1882, derisa vdiq më 1893.

Me Traktatin e Shën Stefanit që u nënshkrua më 3 mars 1878, mes Perandorisë Osmane dhe Rusisë, krahina të tëra shqiptare u ishin lënë Bullgarisë dhe shteteve fqinje.

Vlen të përmendet se revista "Al-xhinan" në numrin e saj të 5 prill 1878, shkruan se shqiptarët janë shumë të mllefosur nga kjo padrejtësi e madhe që po u bëhet. Të gjendur para një situate të këtillë ata kishin protestuar kundër kësaj padrejtësie të fuqive të mëdha si dhe ndaj fqinjëve lakmitarë të cilët tentonin që të zgjeronin kufijtë e tyre në dëm të shqiptarëve. Kështu në faqet e revistës "Al-xhinan", të Bejrutit, hasim protesta të tilla dërguar konsujve të shteteve të mëdha nga krahinat e ndryshme shqiptare. Populli i Dibrës proteston tek ambasadorët e Austro-Hungarisë dhe Anglisë kur merr vesh se do të mbesin në sundimin bullgar, duke vënë në pah ndër të tjera se: "Nuk gjendet në ato anë asnjë bullgar. I gjithë populli janë myslimanë e të krishterë të kombësisë shqiptare".

Protesta të tilla kishin ardhur edhe nga viset tjera shqiptare si nga Shkodra, Gucia, Plava, Malet e Shqipërisë Veriore, Prizreni, Prishtina, Manastiri etj. Po ashtu aty hasim protestën e dërguar nga Shqipëria Perëndimore, Kongresit të Berlinit, ku përveç tjerash thuhet: "Afër një milion shqiptar, gjysma prej tyre myslimanë dhe gjysma të krishterë kërkojnë më shumë të drejta se Traktati i Shën Stefanit, pasi që populli shqiptar është popull shumë i vjetër dhe meriton t'i gëzojë të njëjtat të drejta sikur bullgarët".

Humbjet e Perandorisë Osmane

Revista “Al-xhinan”, në numrin e saj, të tetë, të datës 15 prill 1878, u bën një rekapitullim humbjeve që kishte pësuar Porta e Lartë, si rezultat i marrëveshjes së Shën Stefanit, ku përfshiheshin edhe tokat shqiptare dhe popullata shqiptare. Serbia kishte fituar 164 mil 2 dhe 216.000 banorë prej tyre 92.000 myslimanë. Mali i zi kishte përfituar 58 mil 2 dhe 45.000 banorë, prej tyre 15.000 të besimit islam. Bullgaria e Re arrinte sipërfaqen prej 3562 mil 2 me një popullatë prej 3.822.000 banorë, prej tyre 1.430.000 të besimit islam. Prej tyre 80.000 turq, çerkezë, kurse të tjerët bullgarë të islamizuar.

Kështu, pra me këtë Porta e Lartë kishte humbur një sipërfaqe prej 2.938 mil 2 dhe një popullatë prej 4.457.000 banorë, prej tyre 1.530.00 të besimit islam, 920.000 turq dhe çerkezë, kurse të tjerët shqiptarë, boshnjakë, grekë dhe myslimanë. Shqipëria figuron në një sipërfaqe prej 992 mil 2 me një popullatë prej 1.690.000 banorë, shumica prej tyre të besimit islam[2].

Në këtë aspekt, vlen të përmendet statistika e vitit 1878, për numrin e meshkujve në vilajetet e Perandorisë Osmane, sipas raporteve zyrtare të Ministrisë së Arsimit.

Vilajeti i Kosovës, sipërfaqja 7.000 mil 2, numri i meshkujve 839,822;

Vilajeti i Janinës, sipërfaqja 5 mijë 2, numri i meshkujve 368.054;

Vilajeti i Shkodrës me numër të banorëve 133.189.

Në këtë statistikë nuk figuron Vilajeti i Manastirit.

Revista “Al-xhinan”, një vend të veçantë i kushton Kongresit të Berlinit, protokollin e të cilit e boton në tërësi, në numrin e saj të datës 15 gusht 1878[3], kurse dy javë më vonë, më 15 gusht 1878, redaktori i revistës Selim efendi al-Bustani i bën një analizë marrëveshjes së Shën Stefanit, ku thotë se “përmirësoi disa padrejtësi, por për fat të keq bëri padrejtësi edhe më të mëdha, duke ia dhuruar tokat shqiptare

[2] “Al-xhinan”, al-xhuzu-8, 15 prill 1878, f.350.
[3] “Al-xhinan’, al-xhuzu-14, 5 korrik 1878, f.467.

Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Aleanca, sllavo-greke, e përkrahur nga fuqitë e mëdha, po funksionon që të arrijë sa më shumë përfitime në dëm të shqiptarëve.

Kjo gjendje, sipas autorit, nuk mund të çojë deri te qetësimi i gjendjes në Ballkan, por mund të acarojnë gjendjen edhe më shumë. Për këtë, Porta e Lartë nuk duhet të marrë mbi vete obligime, të cilat ajo nuk është në gjendje t’i realizojë, nga rezistenca e popullatës, e cila nuk do të lejojë që tokat e tyre ku ata kanë jetuar shekuj me radhë të këmbehen për interesat e Fuqive të Mëdha”.

Revista “Al-xhinan”e datës 15 shtator 1878, në artikullin e saj me titull “Porta e Lartë dhe Greqia” i bën një vështrim rezistencës së shqiptarëve që kishin filluar kundër Greqisë për mbrojtjen e tokave të tyre, në jug të Shqipërisë, Thesalinë dhe Epirin. Këtë veprimtari të shqiptarëve, revista e quan “rezistenca e fuqishme e myslimanëve shqiptarë në Shqipërinë jugore[4]”.

Po kjo revistë, më 1 tetor 1878, në një artikull të gjatë me titullin “Vrasja e Mehmet Ali Pashës”, ia dedikon vrasjes së gjeneral Mehmet Ali Pashës, të cilin e quan si njëri prej gjeneralëve më të njohur të Perandorisë Osmane, shkruan se është vrarë në tokat shqiptare. “Kur Mehmet Ali Pasha arriti në Prizren, me qëllim për t’i bindë anëtarët e Lidhjes që t’i pranonin pikat e marrëveshjes së Kongresit të Berlinit, duke u shpjeguar anëtarëve të Lidhjes shkaqet që kishin bërë që Porta e Llartë të pranojë që Serbisë dhe Malit të Zi t’ua japë tokat shqiptare. Ai, në praninë e anëtarëve të Lidhjes kishte nxjerrë hartat për t’ua treguar kufijtë e ri me Malin e Zi dhe Serbinë.

Ky akt i tij kishte hidhëruar shumë patriotët shqiptarë dhe ata nuk kishin mundur t’i frenonin emocionet e tyre para komandantit të ushtrisë osmane. Me gjithë sugjerimet e anëtarëve të Lidhjes që ai të mos shkojë në Gjakovë, për shkak të tensionimit të gjendjes, për shkak të pranimit nga ana e Portës së Lartë që t’ia dhurojë tokat e shqiptarëve Malit të Zi dhe Serbisë. Ai pasi që kishte dërguar një delegacion për ta

[4] “Al-xhinan”, al-xhuzu-14, 15 shtator 1878, f.759.

vëzhguar situatën vendosi të shkojë, ku u vra nga kryengritësit shqiptarë, përfundon revista artikullin e saj.

Rezistenca e shqiptarëve për t'i mbrojtur tokat e tyre etnike, në të gjitha frontet, kishte zënë vend me rëndësi në faqet e revistës "Al-xhinan" të Bejrutit. Kështu artikujt me tituj si: "Porta e Lartë dhe Greqia", "Porta e Lartë dhe Mali i Zi", "Përpjekjet për dorëzimin e Ulqinit", pothuajse ishin të pashmangshëm në çdo numër. Kjo kishte bërë që lufta e popullit shqiptar të shihej me admirim nga shumë popuj të Lindjes dhe kishte ringjallur ndjenjat e tyre atdhetare.

Bota arabe sipas burimeve osmane, shqiptarët i njihte me emrin "arnaut", kurse vendin e tyre "Arnautlluk", ndërsa prej ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nisi t'i quante "Albanë"(shqiptarë), kurse "çështjen shqiptare" me emrin "El-Meseletu el-Albanijetu".

Nëse ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 130 vjet më parë kanë tërhequr vëmendjen e medieve të asaj pjese të botës, me të cilën kemi shumë gjëra të përbashkëta. Andaj, pyetja, e cila shtrohet para nesh sot është, se cili duhet të jetë misioni i institucioneve tona politike, kulturore e fetare për ta shtrirë ndikimin tonë në atë pjesë të botës, për interesin e Kosovës si dhe afirmimin e kombit tonë si tërësi.

Përkujtimi me dinjitet i 130-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ka për synim riaktualizimin e vlerave dhe mesazheve të asaj nga këndvështrimi aktual. Andaj, përkujtimi i ngjarjeve dhe datave të historisë, siç veprohet tani, nuk duhet të kuptohet si rutinë, ose vetëm si një nderim formal. E kaluara nuk mund të kuptohet e shkëputur nga e sotmja. Procesi shoqëror është një dhe i pandarë. Porositë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhen analizuar, me këtë rast në funksion të së sotmes dhe perspektives të së nesërmes.

Mr.Qemajl Morina

The Albanian League of Prizren According to "Al-Jinan"Review of Beriut 1878-1881

(Summary)

The remarkable prominence of the Albanian League of Prizren wasn't confined within European borders, as its glory spread beyond.

Courage of Albanian people, its resistance and sacrifice for the land of forefathers had filled pages with the news and commentaries in Arabic press of the time. Amongst newspapers and reviews that had followed developments of time period between 1878 and 1881, has by Lebanese scholar Al-Bustani. Precisely in town governed from our famous Renaissance author Vaso Pashë Shkodrani, also one of the founders of the Albanian League of Prizren.

Albanians resistance in defense of their ethnical territory on all fronts has dad a relevant presentation in Al-Jinan review of Beirut.

Articles titled "The Grand Porte and Greece", "The Grand Porte and Montenegro", "Efforts to surrender Ulqin", covered in pages of the review almost by each edition. This had cast admiration for the Albanian people's struggler by many of Middle East nations thus reviving patriotic sentiment.

كمال مورينا

رابطة بريزرن حسب ما وردت

بمجلة "الجنان" البيروتية 1878– 1881

(خلاصة البحث)

ان صدى الرابطة الالبانية فى بريزرن لم يسمع داخل حدود اوربا الا انه وصل الى كل مكان ان بطولات و تضحيات الشعب الالبانى احتلت الصفحات الرئسية فى الصحف العربية التى كانت تصدر فى ذلك الوقت . ان من بين صحف و المجلات التى تابعت الاحداث كانت مجلة الجنان و التى كانت تصدر فى بيروت و كان يشرف عليها العالم اللبنانى بطرس البسطانى . و كان فى ذلك الوقت حاكم لبنان واسو باش شكودرانى احد مؤسسى رابطة بريزرن .

QASJE

Dr. Abdul Hadi Misbah

A ËSHTË ZEMRA VEND I DASHURISË, URREJTJES DHE DEVOTSHMËRISË?

Zemra është përmendur në shumë ajete të Kur'anit fisnik dhe hadithe të Pejgamberit a.s. se ajo është vendi i imanit (besimit). Prej atyre ajeteve, fjala e Allahut të madhërishëm: ***"Ata janë që në zemrat e tyre** (Ai) **ka skalitur besimin",*** *(el-Muxhadele: 22).* Po ashtu edhe në ajetin: ***"E besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet Allahu u rrëqethen zemrat e tyre"***, *(el-Enfalë: 2).* Po ashtu ajeti tjetër: ***"E kush madhëron dispozitat e Allahut, ajo është shenjë e devotshmërisë së zemrave".*** *(el-Haxh-xh: 32).*

Definicioni i besimit në shumë hadithe të Pejgamberit a.s. ishte: *"Besimi (imani) është ajo që qëndron në zemër dhe vërtetohet me veprim"*. Në një hadith tjetër thuhet: *"Dine se në trup është një copë mishi, nëse ajo është e mirë, atëherë është mirë i tërë trupi, nëse ajo prishet, atëherë prishet i tërë trupi, ajo është zemra. Pejgamberi a.s. dha shenjë në drejtim të zemrës dhe tha: Besimi (imani) është këtu apo devotshmëria është këtu"*.

Të gjitha ajetet e Kur'anit zemrën e bënë vend të dashurisë, urrejtjes, devotshmërisë, besimit, të kuptuarit dhe të mençurisë, siç është ajeti i madhërishëm: ***"Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun,***

zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat stabilizohen". *(Err'ad: 28).*

Në një ajet tjetër shohim se Allahu i madhërishëm thotë: ***"Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin, dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë".*** *(el-A'rafë: 179).* Ashtu siç përmendet në Kur'an fjala "fuad" (zemër) që është sinonim i zemrës, siç është ajeti i Kur'anit fisnik: ***"Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit, dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi".*** *(el-Isra: 36).* Meqenëse besimi nuk është tjetër përveç për të padukshmen, dhe mu për këtë thuhet, ata të cilët besojnë në të padukshmen. Kështu shohim ajetin kuranor, i cili thotë: ***"Ti ia tërheq vërejtjen vetëm atij që pason Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm*** *(i papashëm prej njerëzve)." (Jasinë: 11).*

Prej tërë kësaj kuptojmë se besimi është kuptim racional në radhë të parë dhe nuk duhet të mbështet në ndonjë shqisë prej shqisave, apo në ndonjë mrekulli lëndore, siç është rasti me pemën e pandehur, në rrugë për në Egjipt- Ismailije, e cila tregon për primitivizmin tanë dhe sipërfaqësinë tanë në të kuptuarit e fesë dhe veprimin me të, siç ishte rasti me popullin e Musait a.s., për të cilët Kur'ani thotë: ***"Dhe kur i thatë: "O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim Allahun haptazi, e atëherë juve u rrëmbeu rrufeja dhe ju e shihnit".*** *(el-Bekare: 55).*

Meqenëse zemra nga aspekti i anatomisë dhe i mjekësisë nuk është tjetër përveç një pompë dhe se të kuptuarit, vetëdija, besimi dhe emocionet etj., janë prej detyrave të mendjes, që besojmë se në aspektin anatomisë vendi i tij është truri me të gjitha fshehtësitë e tij. Andaj është e logjikshme që truri të jetë qëllim me të gjitha ato shenja për të cilat thuhet se vendi i tyre është zemra. Mirëpo, ky është mendim i kufizuar, sepse ai anulon diçka që është shumë me rëndësi në brendinë tonë e ai është shpirti. Ekzistenca e diçkahit është një pjesë dhe të kuptuarit të tij është diçka tjetër. Në Kur'anin famëlartë kemi vende tjera në të cilat Allahu i madhërishëm u drejtohet mendjeve dhe atyre që mendojnë, si për shembull: ***"Me të vërtetë në krijimin e qiejve e të***

tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt”. *(Ali-Imran:190).* Fjala “zemra” në këtë kuptim përsëritet njëzetenjë herë. Kjo përsëritje nuk mund të jetë alegorike, por moskuptimi i duhur duhet të jetë e metë e paaftësisë së njohurive tona për të kuptuar natyrën e funksionimit të gjërave të ndryshme brenda nesh. Nëse truri është mjet nëpërmes të cilit praktikojmë përdorimin e të menduarit me anë të cilit, Allahu e dalloi njeriun prej qenieve tjera, kjo nuk do të thotë se truri është mendja. Mendja është prej veçorive të shpirtit, kurse truri është mjet për t’u shprehur për mendjen, ashtu sikurse që është ora mjet për t’u shprehur për kohën, por kjo nuk do të thotë se ora është vet koha.

Në librin “Pas vdekjes fillon jeta në një botë të padukshme”, të autorit dr. Semir esh-Shenavi, në të cilin shohim se autori thotë se me fjalën zemër në Kur’an, përveç aspektit material, ka për qëllim atë krijesë hyjnore që është shpirti, natyrisht se nuk mund të pranojmë se zemra dhe shpirti janë një, sepse shpirti braktis trupin, në ndërkohë që zemra mbetet në vendin e vet e heshtur edhe pas vdekjes. Andaj është më mirë të thuhet se zemra është qendra e shpirtit, por nuk është vet shpirti. Kjo është në përputhje të plotë me mendimin se zemra është vend i mendjes dhe të menduarit, ashtu siç thuhet në shumë ajete, sepse mendja është veçori prej veçorive të shpirtit, për të cilin mendohet se vendi i tij është krahnori apo zemra, për të cilin Krijuesi flet si një depo e qëllimeve dhe të dhënave (njohurive): ***“Thuaj: edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja ose e publikoni. Allahu e di atë”.*** *(Ali Imran: 29).* Meqenëse besimi si fe dhe vërtetim tek njeriu arrin nëpërmes mendjes dhe mendja është prej veçorive të shpirtit, për këtë Krijuesi i krijesave e ai është Allahu i gjithëfuqishëm kur këtë e legalizon me vepro dhe mos vepro, Ai merr parasysh trupin dhe shpirtin në të njëjtën kohë dhe secilit prej tyre ia jep atë që ka nevojë, që njeriu të mbetet në formën më të mirë ashtu siç e dëshiroi atë Krijuesi: ***“Vërtetë, Ne krijuam njeriun në formën më të bukur”.*** *(Et-Tinë: 4).*

Në realitet ekzistojnë mendime të ndryshme rreth definicionit të ruhut-shpirtit dhe “nefsit”, si dhe a janë ata dy një apo dy gjëra të ndryshme. Fjala “Err-rruh” (shpirt) është përmendur vetëm në tri ve-

nde në Kur’anin fisnik dhe ato janë: pajisjen me shpirt Ademit a.s., po ashtu pajisjen me shpirt Isait a.s., pastaj kur zbriti përgjigja në pyetjen e çifutëve rreth çështjes se çka është shpirti, në ajetin kuranor: ***“Të pyesin ty për shpirtin: Thuaj: “shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije”.*** *(el-Isra: 85).* Në vende tjera, përveç këtyre që përmendëm, vendi dhe qendra e tij është përmendur zemra apo krahrori.

Disa dijetarë mendojnë se fjala “En-nefs” është e njëjta që përfshin trupin dhe shpirtin dhe këtë e argumentojnë me ajetin kuranor: ***“Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni kah e shihni?”.*** *(Edh-dharrijat:21).* Po ashtu edhe : ***“Dhe, a nuk menduan ata me vetën e tyre“***. *(Errum: 8).* Pastaj ajeti: ***“Ditën, kur çdo njeri do të vijë duke mbrojtur veten dhe, kur çdo shpirt do të shpërblehet plotësisht për atë që ka bërë, atyre nuk do t’u bëhet padrejtësi!”*** *(En-nahl: 111)* Po ashtu edhe ajeti tjetër: ***“Kur të hyni në shtëpi, të përshëndetni njëri-tjetrin me përshëndetje të mirë.”*** *(En-nurë:61).* Prej të gjitha ajeteve që përmendëm vërejmë se fjala “En-nefs” përfshin edhe trupin, andaj është më gjithëpërfshirëse se fjala “Err-rruh” (shpirt).

Disa dijetarë mendojnë se fjala “En-nefs” nga një herë përdoret edhe për fjalën “Err-rruh”, siç është ajeti kuranor: ***“O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt, i vetëkënaqur e i pranuar!”*** *(el-Fexhr: 27-28).* Mendimi i tretë i dijetarëve thotë se ekzistojnë ndryshime në mes fjalës “Ennefs” dhe “Erruh”, duke u mbështetur në atë se Allahu xh.sh. na urdhëron që të mendojmë , të studiojmë në vetveten tonë: ***“Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni kah e shihni?”*** *(Edh-dharrijat: 21).* Në ndërkohë që çështjen e shpirtit e konsideroi që ka të bëjë vetëm me Te: ***“Thuaj shpirti është çështje e Zotit tim”.*** Përgjigja në këtë është se Allahu pabesimtarët do t’i dënojë me një dënim të përgjithshëm, atëherë si mundet që shpirtat e tyre mund ta bartin të mirën e përgjithshme dhe ta meritojnë dënimin?

Ibnu Abbasi e komenton ajetin: “***Allahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre”.*** *(Ez-zumer: 42).*, se Allahu i madhërishëm krijoi ke bijtë e Ademit “En-nefs” dhe “Erruh” (shpirtin) dhe në mes tyre diçka që është sikur drita e diellit. “En-nefs” është mendja

dhe ajo që bënë dallimin, kurse shpirti është ai që krijon jetën. Kur flenë njeriu del “ vetëm nefsi” kurse “shpirti” mbetet dhe ata nuk dalin së bashku përveç me rastin e vdekjes. Me këtë koment pajtohen shumë dijetarë të Perëndimit, të cilët shohin se shpirti është i krijuar prej tri elementeve, ato janë prej një trupi që shkëlqen, ky trup bart dritën e shenjtë, e cila dhuron jetë. Po ashtu ai bart mendjen, të cilën e quajnë “nefs”, që përfaqëson forcën e ndjenjës dhe të kuptuarit në qenien e gjallë.

Të tjerët e shikojnë “shpirtin” si një trup madhështor, që nuk shihet, i cili ka fuqi shpirtërore dhe mendore dhe se krijimi i “shpirtit” është krijimi i “nefsit”, por dallimi në mes tyre është se shpirtin me të cilin meleku e pajis foshnjën -është en-”nefs”- me kusht që ai t’i bashkëngjitet trupit, me këtë bashkëngjitje përfiton atributet e të lavdëruarit apo të qortuarit. Ai ose do të jetë “nefs i prirur për të keq”, apo “nefs qortues”, apo “nefs i bindur”: ***“Pasha nefsin*** *(shpirtin)* ***dhe për atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqën dhe të mirën! Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten.”.*** *(Esh-shems: 7-10).* Vendi i shpirtit do të jetë vazhdimisht në botën e shkëlqimit. Kurse en-nefs nuk quhet kështu, vetëm kur ai është brenda në trup. Shpirti po ashtu është i lirë vazhdimisht dhe përdor aftësitë e tij në mënyrë të drejtpërdrejt në botën e shkëlqimit. Shpirtat janë si ushtarë, ata që njihen mes veti bashkohen e ata që nuk njihen nuk pajtohen, për dallim të “nefsit”, i cili është i lidhur me botën materiale dhe nuk vepron përveç nëpërmes trupit në të cilin jeton dhe në kuadër të fuqisë së tij. Kurse Pejgamberi a.s. thoshte: *”Pasha Atë në duart e të cilit është shpirti i Muhamedit“*. Në rast vdekje del “nefsi” prej trupit për t’u kthyer te Krijuesi i vet në botën e eterit, atëherë quhet “Erruh” (shpirt) përsëri.

Marrë nga gazeta “El-Ahram” e Kajros, 25. shkurt 2007.

Përktheu nga arabishtja:

Fuad Morina

Dr. Abdul Hadi Misbah

IS THE HEART THE PLACE OF LOVE, HATRED OR DEVOTION?

(Summary)

The heart is mentioned in many ayats of the noble Qur’an as well as the hadiths of the Prophet as the place of iman, such as: “***For such He has written Faith in their hearts”*** *(al-Mujadilah:22).* “***The believers are only those who, when Allah is mentioned, feel a fear in their hearts”*** *(al-Anfal:2).* “***And whosoever honours the Symbols of Allah, then it is truly from the piety of the heart”*** *(al-Hajj:32).*

عبد الهادى مصباح

هل القلب مكان المحبة و الكراهية و التقوى؟

(خلاصة البحث)

القلب ذكر في آيات كثيرة للقرآن الكريم و احاديث نبوية القلب هومكان الإيمان.ومن الآيات التى ذكر فيها " لَئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ" (المجادلة 22). وكذلك في الاية الاخرى: "إِنَّمَا الْمؤمِنون الَّذين إِذا ذُكِر اللَّه وجِلَتْ قُلُوبُهُمْ" (الانفال 2). واذن في الاية الاخرى : "ذَلِكَ وَمَن يُعَظِّمْ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِن تَقْوَى الْقُلُوبِ" (الحج 32).

EDUKATË FETARE

Gentian Jetishi

AFTËSI TË MËSIMDHËNIES TË LËNDËS SË FESË

Hyrje

Në procesin e integrimeve evropiane të shtetit të Kosovës, përveç obligimeve tjera mbetet që shpejt të rregullohet edhe çështja e lëndës së edukimit fetar në shkollat publike, ngjashëm si në shumicën e vendeve evropiane.

E padiskutueshme që kjo lëndë do të ligjërohet nga mësimdhënës që kanë përgatitje akademike teologjike, të cilët padyshim do ta kompletojnë stafin shkollor në procesin e përgjithshëm të mësimit. Veçanërisht tani kur në të gjitha seminaret për procesin edukativo-mësimor theksohet si element me rëndësi relacioni njerëzor mes mësimdhënësit dhe nxënësit. E padyshim që në këtë aspekt profesorët e lëndës së fesë mund të ofronin shumë më shumë se të tjerët, meqë raportet ndërnjerëzore do të jenë pjesë e materialit që do t'u ligjërohet nga ata.

Me anën e këtij shkrimi do të mundohemi që këtij procesi t'i kontribuojmë me ide dhe materiale, duke filluar prej cilësive që duhet t'i ketë ligjëruesi i lëndës së fesë deri te metodat e vlerësimit dhe testimit, çështje kjo që mund t'iu hyjnë në punë edhe mësimdhënësve të lëndëve tjera.

Virtytet e mësimdhënësit të lëndës së fesë

Si të bëhemi mësimdhënës ideal?

Para së gjithash, mësimdhënësi i lëndës së fesë duhet të jetë i përgatitur në shumë aspekte, prej të cilave si thelbësore mund të theksojmë këto elemente: besimin e pastër dhe të qëndrueshëm, etikën dhe diturinë ose edukatën e përgjithshme.

Këto janë vetëm për sa i përket përgatitjes paraprake të përgjithshme të profesorit, por në raport me nxënësit dhe materialin që do ta ligjërojë profesori i lëndës së fesë duhet të ketë në konsideratë edhe këto çështje:

- Duhet patjetër që të përgatitet paraprakisht për atë që do ta ligjërojë dhe të dijë se çka do të presë që nxënësit do të mësojnë ose duhet të mësojnë;
- Duhet ta dojë dhe ta çmojë punën e tij;
- Duhet të bëjë interesant mësimin, që nxënësit të mos bien në gjumë e të flenë në orë të mësimit;
- Duhet të ketë personalitet të vetin dhe të mos e fsheh nga nxënësit, që të tregohet jo vetëm mësues por edhe si njeri i zakonshëm;
- Duhet të ketë njohuri shumëpërfshirëse, jo vetëm të lëndës në fjalë;
- Duhet të tregohet zbavitës, në kuptimin pozitiv të fjalës;
- Duhet të tregojë respekt për njohuritë e nxënësit: El Atau thotë: "*Ndonjëherë më flet i riu ndonjë fjalë edhe e dëgjoj sikur të mos e kem dëgjuar kurrë më parë edhe nëse po atë e kam dëgjuar para se të lindte ai*"
- Duhet që të dijë si të dialogojë me nxënësit dhe të jetë i përgatitur për të mirëkuptuar dhe me hijeshi t'ua përmirësojë konceptet e ndryshme nga realja;
- Duhet të jetë modest që nxënësit t'i drejtohen edhe për probleme *tjera, ata doemos duhet t'u besojnë juve e të çlodhen te ju, qenien e tyre duhet tërësisht t'ua dorërzojnë si dhe të shpalosin mendimet që i bartin në gjokset e tyre'*,
- Duhet që t'ua mësoni dhe t'ua mbani mend emrat;

- Duhet të ngjallni vetëbesim te nxënësit, ‘me të vërtetë mësimdhënësi është njeri i madh, e njeri i madh nuk është ai, që nëse ulesh me të, do ta shohësh vetveten të vogël, por është ai, që nëse ulesh me të do ta shohësh veten se je njeri i madh’ [Dr.Abdul Kerim Bekkar];
- Duhet të jetë i sinqertë, sepse më shumë se kushdo tjetër nxënësit e vërejnë kur mësuesi shtiret.

Këto janë vetëm disa prej pikave që duhet t’i ketë parasysh ligjëruesi i lëndës së fesë, për më tepër, secili nga ata ligjërues është intelektual që ka njohuri esenciale nga jeta e Pejgamberit a.s., i cili është patjetër modeli më i mirë i profesorit e sidomos për lëndën e fesë.

Mjetet e mësimdhënies

Inkorporimi i lëndës së edukimit fetar në shkollat publike pa dyshim do të jetë investimi më gjigant në procesin edukativo-arsimor, sidomos për dimensionin shpirtëror të nxënësve që deri tani është neglizhuar nga shoqëria jonë. Tendencat për ta mbajtur larg shkollës informacionin për fenë dhe impaktin pozitiv që feja ka tek individi, sollën një mori problemesh që vendin tonë ta radhisin ndër më kryesorët në dukuritë negative, si trafikimi i qenieve njerëzore, konsumimi dhe shpërndarja të drogës (mbi 20 000 përdorues të drogës në Kosovë) dhe prostitucion që tani raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit e paraqet si alarmante. Edhe trafikantët edhe dilerët e drogës dhe konsumuesit e saj janë njerëz të vendit tonë dhe nga mesi ynë. Si do të ishte veprimi i tyre po t’i kishim edukuar me kohë për respekt të qenies njerëzore dhe dinjitetit njerëzor.

Sigurisht që një dekadë pas futjes së lëndës për fenë në shkollat publike, shoqëria jonë do të ndjejë normalizimin e saj si shoqëri dhe konkurrencën në arenën ndërkombëtare si çdo komb normal me njerëz vitalë, aktivë dhe produktivë.

Si lëndë e re për procesin edukativo-arsimor, ligjëruesëve të saj do t’u duhet pak kohë deri në përshtatje dhe perfeksionim të mësimdhënies së kësaj lënde komform njohurive thelbësore të fesë dhe di-

namizmit të kohës, ndonëse ky element i përzgjedhjes së mënyrës së shpërndarjes së informacioneve, gjegjësisht metodologjisë së mësimdhënies shihet si dobësi gati e të gjithë mësimdhënësve dhe madje dhe e profesorëve universitarë në të gjitha universitetet tona.

Disa nga elementet që duhet t’i ketë në konsideratë mësimdhënësi i lëndës së fesë

Roli i mësimdhënësit: Mësimdhënësi i lëndës së fesë duhet të kuptojë rolin e rëndësishëm që ka në përcjelljen e informacioneve dhe ndikimit të tij në të kuptuarit të atyre informacioneve nga ana e nxënëseve. Realisht ai është **ekspert i dhënies së njohurive fetare** për nxënësit e tij. Në të njëjtën kohë është edhe **menaxher**, për atë se çka do të ligjërojë dhe mënyrën se si do ta përcjellë atë gjë te nxënësit e tij duke marrë në konsideratë të gjitha veçoritë e nxënësve të klasës së tij si fjala vjen, moshën, gjininë, disponimin e tyre momental e të ngjashme. Duhet gjithashtu paraprakisht të dijë se si do ta organizojë orën, ambientin e klasës, si do të jenë të ulur nxënësit dhe cilat do të jenë mjetet e mësimdhënies. Veç tjerash duhet të ndjejë edhe përgjegjësinë dhe rolin e tij si **këshillues** ose **psikolog**, duke marrë në konsideratë sjelljet dhe ndryshimet e herëpashershme të sjelljeve të nxënësve nga faktorë të ndryshëm, të ketë parasysh ndjenjat njerëzore të nxënësve, të cilat mund të ndikojnë te mësimnxënia dhe sjellja e tyre.

Përzgjedhja e materialit: Shumica e profesorëve i stërngarkojnë nxënësit me materiale dhe teori që nuk u hyjnë kurrë në punë. Edhe përzgjedhja e materialit urgjent dhe të dobishëm për klasën e caktuar duke i njohur rrethanat e nxënësve në fjalë është përgjegjësi e profesorit të lëndës.

Mësimi mekanik dhe efektiv: Në përgjithësi në vendin tonë shquhen profesorët që ligjërojnë mekanikisht dhe u kërkojnë nxënësve që mësimet t’i mësojnë në mënyrë mekanike. Është tipike për shumicën e profesorëve t’i hipin librit përmbi dhe ta lexojnë rresht për rresht, atë çfarë shkruan në libër, pa lëvizur fare nga ‘karrigia tepër’ e tyre dhe pa aspak dinamizëm. Më e tmerrshme është që ajo çfarë kërkojnë

nga nxënësit është pikërisht mësimi mekanik si po të obligoheshin të mësonin ndonjë poezi. Në përgjithësi kjo vërejtje është për të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit dhe krejt në fund vitin e kaluar edhe Ministria e Arsimit pati bërë disa lëvizje për të ndryshuar praktikën nga obligimi i mësimit mekanik në efektiv.

Përcjellja sistematike e aftësisë së mësim nxënies: Mësimdhënësi duhet të dijë se aq sa është pjesëmarrës aktiv në orë, ai në të njëjtën kohë është edhe observues - vështrues i asaj se si po e përçon mesazhin e tij dhe si po e pranojnë nxënësit. Me një fjalë duhet të jetë i vëmendshëm për atë çfarë e thotë dhe se si e thotë.

Bashkëveprimi në klasë: Mësimi nuk është koncepti që është krijuar në vetëdijen tonë, ku mësuesi flet dhe nxënësit dëgjojnë. Ka qindra mijëra metoda për ta bërë orën sa më atraktive.

Një nga analizat të teknikave të bashkëveprimit dhe prej më të sofistikuarave është Sistemi i Analizave të Bashkëveprimit nga Flander.

Më poshtë në tabelë mund të shihni analizën e Flanderit për kohën që mësuesi dhe nxënësit duhet të flasin në orë.

Kategoria		
Mësimdhënësi	Indirekt	1. Pranimi i ndjenjave njerëzore
		2. Lavdërimi ose inkurajimi
		3. Pranimi ose përdorimi i ideve të nxënësve
		4. Të bërit pyetje
	Direkt	5. Ligjërata
		6. Dhënia e urdhrave
		7. Kritika apo justifikimi i autoritetit (pse mësuesi e bëri atë që e bëri)
Nxënësi		8. Përgjigjet e nxënësve
		9. Bashkëveprimi i nxënësve gjatë të folurit
		10. Qetësia dhe konfuzioni

Përdorimi i masmedies dhe teknologjisë: Jo vetëm fotove, pikturave, slide show, film, muzik(ilahi), por edhe televizori, kompjuteri dhe gjitha tjerat janë në dispozicion të mësimdhënësit, dhe është dora e tij të zgjedhë se cila nga këto do t'i hyjnë në punë.

Teknika të parapërgatitjes së mësimit

Qëllimi i këtij shkrimi është t'iu ndihmojë mësimdhënësve të lëndës së fesë se si të bëhen planifikues të mirë. Pa planifikim paraprak të asaj se si do ta drejtojë energjinë e vet dhe të nxënësve të tij, mënyrën se si do ta organizojë mësimin, ambientin e mësimit pavarësisht qëllimeve të mira të mësimdhënësit, mund të ndodhë të mos realizohet ajo çfarë pret.

Në vazhdim do të përmendim disa nga teknikat e parapërgatitjes së mësimit, thjesht për të provokuar mendjen e profesorit për një gjë të tillë dhe jo patjetër të ndiqen pikë për pikë ato. Ka edhe teknika tjera që mësimdhënësi mund t'i ketë mësuar edhe diku tjetër, që mund t'i hyjnë në punë në procesin e parapërgatitjes së mësimit.

Qartësimi i objektivave ose edhe shkrimi i tyre

Të diturit paraprakisht të objektivave, asaj se çfarë pret nga nxënësit, e ndihmon mësimdhënësin që të përzgjedhë metodën më ideale për dhënien e atij informacioni dhe të kuptojë nëse mesazhi i tij ka arritur te nxënësit.

Shkrimi i objektivave përfshin shkrimin e objektivave për secilin mësim veç e veç por edhe për lëndën në tërësi.

Si shembull:

Për temën: "Besimi në Zotin Një" si objektiva të mundshme mësimdhënësi mund të konsiderojë edhe këto:

- Nxënësit të kenë koncept të qartë të ndjenjës së besimit në Zotin Një.
- Që kjo ndjenjë pos aspektit emocional të shoqërohet edhe një koncept teorik dhe argumentet faktike të ndryshme për Besimin në

Zotin Një të arrijnë te nxënësit, që të ndiejnë rehatinë dhe palëvizshmërinë përballë çfarëdo kundërfakti tjetër.

- Që ky besim në Zotin Një te nxënësit të jetë i pastër prej çfarëdo forme që e cenon atë (shirk, kufër), dhe forma të besëtytnisë.

Përzgjedhja dhe hartimi i mësimit

Korrikula është plani sistematik i mësimdhënies që e përcakton temën dhe përmbajtjen e asaj çfarë mësimdhënësi do të ligjërojë. Zakonisht ajo hartohet nga ekspertë përkatës të institucionit gjegjës. Por, ajo nuk është shpallje hyjnore dhe profesori herë pas herë për të njëjtën temë përzgjedh përmbajtje tjetër për trajtimin e temës në fjalë, kuptohet duke e vlerësuar atë si më të përshtatshme për klasën dhe rrethanat e klasës së caktuar.

Planifikimi dhe vlerësimi

Mësimdhënësi i lëndës duhet që në fillim të bëjë vlerësimin për gjendjen dhe njohuritë e nxënësve për lëndën në fjalë, në mënyrë që të ketë pasqyrë të qartë për njohuritë e nxënësve të klasës në fjalë.

Prej teknikave që mund të përzgjedhë për të bërë vlerësimin mund të jenë:

- Kontakti me nxënësit një nga një,
- Analizë të aktiviteteve të nxënësve,
- Debatet në klasë,
- Testi, etj.

Këto janë disa teknika të parapërgatitjes së mësimit. Të tjera teknika nga përvoja e mëhershme apo njohuritë e profesorit të lëndës së fesë janë mëse të mirëseardhura. Qëllimi është që mesazhi të arrijë te nxënësit në formën më të mirë, duke mos i munduar, stërangazhuar nxënësit me obligime të shumta, duke llogaritur në ndryshimet drastike që kanë ndodhur në disponimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Shkathtësi të mësimdhënies

Aftësitë e mësimdhënësit shfaqen në mënyrën se si i shfrytëzon teknikat e mësimdhënies gjatë orës mësimore, njëjtë sa diktohet edhe nga përgatitja dhe karakteri moral i mësimdhënësit. Mënyra se si mësimdhënësi komunikon me nxënësit, si i motivon ata, si përpiqet të përforcojë njohuritë e tyre, dhe si e menaxhon orën mësimore përcaktojnë një përqindje të madhe në të kuptuarit të nxënësve.

Komunikimi

Pa komunikim nuk mund të zhvillohet ora mësimore. Procesi i komunikimit përfshin procesin katërfazash, i cili mund të shihet në figurën më poshtë. **Dërguesi** e ndërton *mesazhin* duke e njohur mirë audiencën e që do ta pranojë dhe si të tillë e nis për te ta, më konkretisht te **pranuesi**. Pranuesi i mesazhit, pasi të bëjë pranimin e mesazhit, *reagon* gjegjësisht i përgjigjet atij.



Në procesin e komunikimit duhet të aktivizohen të gjitha shqisat e publikut gjegjësisht nxënësve përmes dy shkathtësive komunikuese: verbale dhe joverbale. Në aftësitë verbale përfshihen fjalët, kuptimet e tyre apo edhe materialet e shënuara, ndërsa aftësitë joverbale përfshijnë shprehjet e fytyrës, lëvizjet trupore, shfrytëzimi i hapësirës, mjeteve, kohës, volumi dhe toni i zërit e ngjashëm.

Diku 70% të kuptimit të mesazhit thuhet se vjen nga komunikimi joverbal dhe vetëm 30% prej komunikimit verbal.

Motivimi

Njeriu është qenie komplekse. Ora mësimore pavarësisht qasjes akademike dhe shkencore që duhet të ketë, nuk duhet lënë anash raportet humane mes nxënësve dhe mësimdhënësit, duke i marrë në konsideratë nevojat e tyre psikologjike dhe sociologjike.

Motivimi është faktor shumë i rëndësishëm në procesin e mësimit në klasë. Motivimi mund të konsiderohet forcë stimuluese që i nxit nxënësit për të vepruar.

Motivimi është i brendshëm dhe i jashtëm. Motivimi i brendshëm përcaktohet nga sjellja e nxënësve dhe nevojat e tyre. Nga ana tjetër, motivimi i jashtëm përcaktohet nga ambienti i klasës, strategjia e mësimdhënësit e tjera.

Teknika të ndryshme të stimulimit për të përfituar dhe mbajtur vëmendjen e nxënësve mund të jenë: a) përdorimi i gjesteve; b) fokusimi dhe theksimi i tepërt në çështjen në fjalë; c)shfrytëzimi i pauzave; ç)përdorimi i llojeve të ndryshme të interaksionit; d)lëvizjet e mësimdhënësit etj.

Menaxhimi i orës mësimore

Menaxhimi i orës mësimore varet edhe nga lloji i lidershipit që mësimdhënësi zgjedh të jetë ose është i tillë prej natyre apo rrethanash socio-kulturore. Gjithashtu mbarëvajtja e orës mësimore përcaktohet edhe nga atmosfera e klasës, teknikat e kontrollimit, modeli i disiplinës dhe disponimi i nxënësve në ditën dhe orën e caktuar.

Llojet e lidershipit të mësimdhënësit veçohen në tri kategori kryesore: lidershipi **autoritar** (që tregohet dominues, i fuqishëm, u bën trysni dhe kritikon vazhdimisht), lidershipi **demokrat** (që shpërndan përgjegjësitë dhe delegon përgjegjësitë edhe te nxënësi për ta motivuar dhe nxit për dije dhe për pavarësi intelektuale) dhe lidershipi i më-

simdhënësit **liberal** (që nuk ndërhyn shumë, dhe i lë gjerat të rrjedhin vetë).

Nga ana tjetër, atmosfera në klasë është një përgjegjësi dhe aftësi e mësimdhënësit. Si duket klasa, si janë të vendosur bankat (ulëset), dhe objektet tjera në klasën e caktuar patjetër që e ndihmojnë zhvillimin e suksesshëm të orës në fjalë.

Në shumicën e rasteve, aftësitë dhe shkathtësitë e mësimdhënësit janë natyrale ose edhe të përfituara nga mësimi ose përvoja gjatë jetës, por përballja me këtë formë të organizuar të ideve mund ta provokojë për të mirë mendimin e tij për t’u perfeksionuar edhe më shumë në metodologjinë tij për mësimdhënie të suksesshme.

Gentian Jetishi

TEACHING SKILLS IN RELIGIOUS EDUCATION

Introduction

(Summary)

As part of the efforts to integrate in Europe, Kosova must also deal with the issue of the introduction of the subject of religious education in public schools (as has been done in other European countries).

It is certain that this subject will be taught by people who have studied theology. The latter can play a special role especially as far as the interaction between teachers and students is concerned as they will teach inter-human relations as part of their courses.

غنتيان يتيشى

كفاءة التعليم للمادة الدينية

(خلاصة البحث)

في جراءة انضمام دولة كوسوفا للاتحاد الاوروبي يبقى من الواجب عملية معالجة التعليم الديني في المدارس العامة,مثل ما هومعمول بالدول الاروبية.

يطلب من المختصين ان يتم تعليم هذه المادة من قبل الناس يحملون مؤهلات آكادمية و دينية الامر الذى سيرفع من شأن التعليم في المدارس وبصفة خاصة ان في مثل هذه الدراسة يجب أخذ الاعتبار الاجراءات و العلاقة بين المدرس ميذ. و بهذا الخصوص مدرس الدين يمكن ان يساهم كثيرا في عملية رفع مستوى التعليم في المدارس.

EDUKATË FETARE

Akademik Feti Mehdiu

MËSIMET MBI FENË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT (Përvojat nga rajoni dhe modalitetet e përshtatshme për Kosovën, 14-15 mars, 2011)

Kërkesa për rikthimin e lëndës edukatë fetare në shkollat publike, e filluar pas vitit 1991, në shtetet e bllokut komunist, ku bënte pjesë edhe Kosova[1] prej vitit 1945 deri më 1990, arriti kulminacionin e shqyrtimit rrafsh pas 20 vjetësh, me konferencën: **Mësimet mbi fenë në institucionet publike të arsimit,** që e organizoi Bashkësia Islame e Kosovës, më 14 dhe 15 mars 2011.

Gjatë kësaj periudhe njëzetvjeçare (1991-2011) tema e Edukimit fetar në shkollat publike ka qenë objekt diskutimi disa herë në media të ndryshme të Kosovës. Dritarja, të cilën e hapi e përditshmja *Infopres*[2] në shtatot-tetor 2009, sipas mendimit tim, ka qenë potez shumë i qëlluar dhe produktiv për këtë çështje, që fatkeqsisht nuk e ndoqi asnjë organ tejtër në Kosovë. Madje as ata që në vitin 1991 ishin inicia-

[1] Bashkësia Islame e Kosovës e shtroi këtë kërkesë qysh nga viti 1991, dhe revista Dituria Islame ka sjellë tekste informative me interes për çështjen në fjalë.

[2] Infopres, e përditshme që botohet në Prishtinë, nga data 14 shtator 2009 deri më 5 tetor 2009, hapi faqen për Debat: Për apo kundër edukatës fetare në shkolla.

torë të kësaj çështjeje.[3] Edhe tryeza: Mësimt mbi fenë... duket se do të përjetojë fatin e debatit në Infopres.

Në faqet e Infopresit u shpalosën shlirë të gjitha mendimet për dhe kundër kësaj kërkese. Me gjithë faktin se me atë rast dolën në sipërfaqe mendime edhe për çështje, të cilat nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë, ose nuk kanë pasur fare lidhje me temën bosht, aty është prezentuar një platformë mbi të cilën mund të ndërtohet sistemi i edukimit fetar në shkollat publike, sepse u bënë publike përvoja dhe opsione të ndryshme të rajonit dhe të traditës së vendit. Qasja e larmishme gjatë atij diskutimi me formulime jo të sakta si:, *edukatë islamiste, leksione islame, fe e shqiptarit..., feja jasht shkollës ..., mendësi orientale …, fe për të gjithë nxënësit pa dallime, fe e sjellur nga Turqia, feja që i ndan nxënësit…* e të tjera, i obligon institucionet shtetërore me përgjegjësi dhe kompetencë arsimore, edukative dhe fetare të Kosovës që të angazhohen për sqarime plotësuese rreth këtyre çështjeve sepse në debatin e gazetës “Infopres” u pa se ka njerëz të cilët rrahin gjoks për t’i prirë një procesi shumë të rëndësishëm, siç është edukimi fetar, por kanë mugesa të mëdha në formimin e tyre professional për të cilin flasin, si edhe zbraztësi të mëdha kulturore e fetare. Kjo u shpreh gjatë atij diskutimi me ngatërrimin e nocioneve fetare, ideologjike, kulturore, gjeografike etj., nga ana e pjesëmarrësve në diskutim, me qëllim a nga mosdija, krejt njëlloj. Mjafton që fut huti në opinionin e painformuar sa duhet.

Me ato qasje nga ekspertë të kësaj fushe apo vullnetmirë është trasuar një rrugë stabile për arsyeshmërinë e rikthimit të kësaj lënde dhe u dhanë kordinatat kryesore të rrugës së cilës duhet ecur. Sa i përket mundësisë për realizimin e këtij projekti kapital për edukimin e brezave të shëndoshë për shtet të shëndoshë, u mbetet organeve shtetërore me kompetencë që të sigurojë mekanizmat dhe mjetet për realizimin konkret në shkollat publike.

Emrues i përbashkët i tërë asaj që u zhvillua është se shoqëria e Kosovës pa edukatën fetare në sisitemin shkollor publik, ka mangësi

[3] Shih Dituria Islame e vitit 1992.

të cilat vendet e rajonit i kanë tejkaluar pas vitit 1990, madje pjesërisht edhe brenda Kosovës. Kjo mangësi një ditë do të paraqesë pengesë për pranimin e Republikës së Kosovës në Bashkësinë Evropiane. Republikat që përbënin shtetin e Jugosllavisë, të gjitha e kanë në planprogramet e tyre dhe e zbatojnë edukatën fetare në shkollat publike, Kroacija, Bosnja, Serbia, Maqedonija. Vendet tjera evropiane këtë çështje e kanë zgjidhur më përpara.

Përvoja e tyre është ndihmesë shumë e çmueshme për Kosovën. Kjo duhet të vjelë përvojën e atyre vendeve dhe në harmoni me traditën vetjake që është zbatuar deri në vitet e 50-ta të shekullit njëzet, ta realizojë më lehtë dhe me mangësi më të vogla çështjen e edukimit fetar në shkollat publike duke e vënë në binarë sistemorë me përgjegjësi dhe kompetencë profesionale që të jetë në shërbim të populit dhe ardhmërisë së shtetit.

Tryeza e 14 marsit 2011, me gjithë faktin se nuk e ka shfrytëzuar sa duhet përvojën e diskutimeve paraprake lidhur me këtë çshtje, që dëshmohet me formulimin jo saktë të temës bosht: *”Mësimet mbi fenë…* “ në vend se të ishte *Edukata fetare në shkollat publike* - ashtu siç është formuluar në gjuhën angleze, sepse bëhet fjalë për shkollat fillore dhe të mesme dhe jo për nivelin universitar, e ngrit këtë çështje edhe një shkallë më afër për ta vënë në zbatim lëndën edukatë fetare në shkolat publike.

Kontributet e prezentuara në këtë Konferencë shkencore, kryesisht trajtuan edukatën fetare nga aspekte të ndryshme: historike, teorike dhe praktike. Pati trajtesa edhe për nivelin e studimeve të larta, gjë që nuk ishte temë e kësaj tryeze.[4] Megjithatë, të gjitha trajtesat afruan brumë të mjaftueshëm për të gatuar kulaqin që hahet në Kosovë dhe duhet të gatuhet sot. Hiq anët teorike dhe historike të përvojës botërore dhe të rajonit, ku bie Kosova, Kosova ka fatin që ka mundësi t’u

[4] Në Kosovë është e zgjedhur çështja e shkollimit të kuadrave fetare si në nivelin e kualifikimt të mesëm, është Medreseja Alauddin, qysh nga viti 1962, si edhe kualifikimit superior, qysh nga viti 1993, por ka mbetur akoma e hapur çështja e edukimit fetar në shkollat publike duke filluar nga shkolla fillore. Dhe kjo çështje është e hapur vetëm për nxënësit e përkatsisë kombëtare shqiptare.

shmanget mangësive që e kanë përcjellë këtë çështje në vendet e caktuara dhe të ndërtojë sistem jo eksperimental por të zgjedhë një model të zbatueshëm për afat më të gjatë. Kjo mund të arrihet në mbështetje të përvojës së Austrisë dhe të Kroacisë - si model për ta ndjekur, si nga këndvështrimi legjislativ ashtu edhe nga ai ekzekutiv, por edhe të përvojës së Bosnjës dhe Maqedonisë për t’iu shmangur parregullsive të infrastruktures legjislative dhe ekzekutive.

Kosova nuk e ka atë standard që edukatën fetare ta lërë në duar të Organizatave Joqeveritare dhe donacioneve vullnetare. Edukata fetare është pjesë e traditës shkollore në këtë hapsirë, e organizuar bashkërisht me institucionet fetare dhe shtetërore dhe e financuar nga buxheti i shtetit, të cilin buxhet e mbajnë qytetarët e Kosovës. Dhe kështu duhet të jetë. Çdo zgjidhje tjetër e shpie në rrugë pa krye edukatën fetare.

Edukata fetare për shkollat publike në Kosovë, është një gatesë që tëhullet e gatuhet qe dy dekada dhe është gati për t’u bërë realitet. Për t’u përmbyllur me sukses dhe për dobi të qytetarëve të Kosovës, dhe për shtetin e Kosovës duhet vetëm edhe pak më shumë vullnet konstruktiv dhe pak më shumë punë në ballfaqimin e potencialit financiar dhe kadrovik nga subjektet me kompetencë dhe përgjegjësi. Këtu janë institucionet që përfaqsojnë vullnetin e popullates që i përkasin fesë konkrete dhe institucionet e shtetit që bartin barrën e përgjegjësisë për arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj që janë garanci e shoqërisë së ardhshme të Kosovës.

Kjo tashmë është bërë pjesë edhe e programit të Qeverisë së Kosovës, që është dëshmuar edhe me marrëveshje të subjektëve fetare dhe politiko-shoqërore. Prandaj, faza tjetër kërkon formimin e trupave punuese konkrete nga subjektet bartëse të këtij procesi dhe në afate të caktuara të kristalizojnë platformën për realizim të kësaj të drejte dhe obligimi elementar ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Është me rëndësi të dorës parë që gjërat të emërtohen drejt e saktë dhe të kenë mbështetjen e organeve me kompetence profesionale shtetërore të harmonizuar dhe të mbëlshtetur edhe në infrastsukturë legjislative dhe ekzekutive. Kjo hap rrugën që në shkollat publike të Kosovës, të rikthehet lënda Edukata fetare dhe në mbështetje të kësaj

institucionet që përfasojnë fetë - jo shkollat fetare - në bashkëpunim me institucionet kompetente të shtetit të harmonizojnë platformën konkrete.

Vetëm angazhimet konkrete me afate të caktuara japin rezultate konkrete.

Feti Mehdiu

RELIGIOUS EDUCATION IN PUBLIC EDUCATIONAL INSTITUTIONS IN KOSOVA (Experiences from the region and suitable modalities for Kosova, March 14-15, 2011)

(Summary)

The calls for the reintroduction of religious education in public schools, which were first made after 1991 in the countries of the former communist block (part of which Kosova was between 1945 and 1990) continue to be made 20 years later, as is the case with this conference: Religious education in public educational institutions in Kosova (organized by the Islamic Community of Kosova, on March 14-15, 2011). During this period (1991-2011) the issue of religious education in public schools was the topic of discussion a number of times in different media. The issue was first discussed in the *Infopress Daily* in 2009.

فتحى مهدي

تعليم الدين في المؤسسات الحكومية

(تجربة المنطقة و النموذج الامثل لكوسوفا 14–15 مارس 2011)

(خلاصة البحث)

ان طلب اعادة مادة الدين في المدارس الحكومية التى بدأت منذ سنة 1991 في اكثر الدول شيوعية حيث خضعت كوسوفا من سنة 1945 الى 1990 وصلت القمة بالندوة التى عقدت في بريشتينا تحت رعاية المشيخة الاسلامية بتاريخ 14-15 مارس 2011 بعنوان "تعليم الدين في المؤسسات العامة".

خلال هذه الفترة التي تبلغ عشرون سنة (1991-2011) موضوع التربية الدينية كان موضع نقاش في وسائل الاعلام المختلفة عدة مرات و نذكر منها جريدة "انفوبرس" خلال شهر سبتمبر- اكتوبر 2009 في رأيي كان نقاشا موفقا الا انه لم يتخذ اي اجراء بشأن تطبيق هذا الموضوع.

LEXIMI I KUR'ANIT TE VARRI GJATË DHE PAS VARRIMIT TË TË VDEKURIT

Argumentet për leximin e Kur'anit famëlartë janë argumente të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, është e domosdoshme që këto argumente të përfshijnë të gjitha vendet, kohërat, personat dhe gjendjet. Nuk lejohet që këto argumente të bëhen dhe të konsiderohen si specifike, përveç nëse argumentet e vërtetojnë të kundërtën, sepse një gjë e tillë do të ishte risi në fenë islame dhe vështirësim i asaj që All-llahu xh.sh. dhe Pejgamberi a.s. e kanë lehtësuar.

Duke u bazuar në këtë, leximi i Kur'anit famëlartë te varri gjatë varrimit të të vdekurit ose pas varrimit, është legjitim dhe i lejuar sipas sheriatit islam, sepse argumentet e sheriatit për leximin e Kur'anit famëlartë janë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, ka shumë transmetime nga Pejgamberi a.s. për këtë çështje, po ashtu shumë lajme dhe të dhëna nga paraardhësit tanë të ndershëm. Lidhur me këtë çështje flet Imam Ebu Bekr El Halal El Hanbelij në kapitullin *"El Kiraetu ala El Kubur"* në librin *"El Xhamia"*, po ashtu El Hafidh Shemsudin bin Abdulwahid El Makdesi El Hanbeli ka shkruar kapitull të posaçëm për këtë çështje, po ashtu Imam El Kurtubij El Maliki në librin e tij *"Et-Tedhkiretu fi Ahwal El Mewta ve Umur El Ahireti"*, El Hafidh Es-sujuti Esh-shafii në librin *"Sherh Es-sudur bisherh Hal Elmewta ve El Kubur"*, El Hafidh Es-sejid Abdullah bin Es-sidik El Gimari në

librin e tij *"Tewdih El Bejan Liwusul thevab El Kur'an"*, dhe shumë të tjerë që kanë shkruar lidhur me këtë çështje.

1. Nga hadithet e vërteta dhe të qarta në këtë çështje janë: Transmeton Abdurrahman bin El Ala bin El-Lexhlaxhi nga babai i tij i cili thotë: "Më ka thënë babai im - El-Lexhlaxh ebu Halid, o biri im kur të vdes më vendos në varr dhe kur të më vendosësh në varr thuaj 'Me Emrin e All-llahut, dhe nga Umeti i të dërguarit të All-llahut - *Bismilah ve ala mileti resulullah* - pastaj më mbulo me dheun ngadalë dhe lehtë, lexoje te koka ime Fatihan dhe ajetet e fundit të sures Bekare, sepse unë kam dëgjuar Pejgamberin a.s. që ka thënë kështu[1]. Transmetohet nga Ibni Omeri r.a. i cili thotë: "Kam dëgjuar Pejgamberin a.s. që ka thënë: "Kur të vdes dikush nga ju mos e burgosni (mos e mbani gjatë pa e varrosur), shpejtoni që ta dërgoni në varr, dhe lexojeni te koka e tij Fatihan dhe te këmbët e tij (te varri) fundin e Sures Bekare (dy ajetet e fundit të kësaj sureje).[2]

Në këtë çështje ka edhe shumë transmetime tjera, transmetohet nga Aliu r.a. nga pejgamberi a.s. i cili ka thënë: "Kush kalon pranë varreve ta lexojë *"Kul Huwallahu Ehad"* njëmbëdhjetë herë, pastaj sevapet e atij leximi t'i dedikojë për të vdekurit në ato varre, e atij do t'i jepen sevape aq sa ka varreza në atë vend[3], pastaj hadithi i transmetuar nga Ebi Hurejre, i cili ka thënë: "Ka thënë Pejgamberi a.s.: "Kush hyn në varre dhe e lexon Fatihan pastaj *Kul Huwallahu* dhe *El hakumu Et tekathur* pastaj thotë: O zoti im sevapet për leximin e fjalëve tua ua dedikoi besimtarëve dhe besimtareve që janë në këto varre, ata (të vdekurit në varre) do të ndërmjetësojnë tek All-llahu xh.sh. për të[4], Hadithi i transmetuar nga Enesi r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

---

1 El Mu'xhem El Kebir vëll.19 fq.220.
2 Xhamia El Ehadith vëll.4 fq.65; Ed-Der El Menthur vëll.1 fq.28; Fet-h El Kadir Li Shewkani vëll.1 fq.29; Kenz El Umal vëll.15 fq.601; Fet-h El Bari - Ibni Haxher vëll.3 fq.184.
3 El Fikh El Islami ve Ediletuhu vëll.2 fq.680; Fetawa El Ez-her vëll.5, fq.471; Tefsir Hakij Kapitulli 39 vëll.14, fq.364; Tefsir Ruh El Bejan Suretu En-nexhm vëll.9, fq.205; El Kiraetu Ala El Kubur - El Halal; Es-semerkandi Fedail Kul Huvallah.
4 Metalib Uli En-nuha kapitulli Zijaretu El Kubur vëll.5 fq.9; Tuhfetu El Ahvedhij vëll.3, fq.275; Hashijetu El Xhumel vëll.7, fq.252; Fewaid - Ebu El Kasim Ez-zenxhanij.

"Kush hyn në varre, dhe e lexon Suren JaSin All-llahu xh.sh. do t'ua lehtësojë atyre që janë në varre, dhe ai (lexuesi) do të ketë sevape të mira sa është numri i personave në ato varre"[5].

El Hafidh Shemsudin bin Abdulwahid El Makdesi El Hanbeli në librin e tij në kapitullin, i cili ka të bëjë me këtë çështje thotë: " Këto hadithe edhe nëse do të ishin të dobëta numri i madh i transmetimeve argumenton se kjo çështje ka bazë në fenë islame, myslimanët vazhdojnë të jenë të bashkuar lidhur me këtë në çdo kohë e në çdo vend dhe lexojnë Kur'an për të vdekurit e tyre pa asnjë refuzim, dijetarët në këtë çështje janë të pajtuar me konsensus.[6]

2. Është transmetuar në Sunet (Hadith) dhe në lajmërime të shumta për leximin e sures JaSin për të vdekurit, transmetohet nga Makal bin Jesar nga Pejgamberi a.s. që ka thënë: "Lexojeni Suren JaSin për të vdekurit tuaj" (shprehja "*Lexojeni*" - ka ardhur në formën urdhërore).[7]

3. Në sheriatin islam kemi argumente të shumta për leximin e Fatihas te xhenazja sepse kjo sure përmban në vete shumë begati dhe sjell dobi për të vdekurin, përmban në vete kërkim mëshire dhe falje mëkatesh, veçanti të cilat nuk gjenden në suret tjera, transmetohet nga Ubadetu bin Es-Samit se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ummu El Kur'an - surja Fatiha - mund t'i zëvendësojë suret tjera, e tjerat sure nuk mund ta zëvendësojnë atë"[8].

Kjo tregon se kjo sure është më gjithë përfshirëse sesa në namazin e xhenazes ose jashtë saj, ka shumë hadithe që argumentojnë se surja Fatiha këndohet në namazin e xhenazes dhe hadithe të tjera që argum-

[5] Tuhfetu El Ahvedhij vëll.3, fq.275; Tefsir Kurtubij vëll.15, fq.3; Hashijetu El Xhumel vëll.7, fq.252; Fetawa El Ez-her vëll.5, fq.471.
[6] Tuhfetu El Ahvedhij vëll.3, fq.275; Merkat El Mefatiih Sherh Mishkat El Mesabiih vëll.5, fq.465.
[7] Ebu Dawud Kitab El Xhenaiz hadithi nr.2714; Tefsir El Menar vëll.8, fq. 234; Musned Et-Tajalisij vëll.2, fq.224; Fetawa El Ez-her vëll.5, fq.471.
[8] Tefsir Thalebij kapitulli 7 vëll.1, fq.27; Tefsir Nisaburi vëll.1, fq.23; Mefatih El Gajb vëll.1, fq.146; Nihajet El Muhatxh vëll.4 fq.181.

entojnë se ajo sure lexohet gjatë varrimit, ose pas varrimit siç transmeton Ibni Omer në hadithin e lartpërmendur në *Taberani* dhe të tjerët, transmeton Ummu Afif En-Nehdije e cila thotë: "Na ka urdhëruar Pejgamberi a.s. të lexojmë suren Fatiha tek të vdekurit tonë"[9], transmetohet nga Ummu Sherik, e cila ka thënë: "Na ka urdhëruar Pejgamberi a.s. që ta lexojmë suren Fatiha te xhenazja"[10].

4. Për leximin e sures Fatiha dijetarët islam kanë argumentuar me hadithin e transmetuar nga Ibni Abbas, i cili thotë: "Ka kaluar Pejgamberi a.s. pranë dy varreve, dhe ka thënë: Ata dy janë duke u dënuar por nuk po dënohen për ndonjë mëkat të madh", pastaj ka thënë: "Por, njeri nga ata dënohet sepse përgojonte, ndërsa tjetri nuk i ka kushtuar kujdes urinës", pastaj ka thënë (Ibni Abbasi): e ka marrë Pejgamberi a.s. një degë të njomë dhe e ka ndarë në dy pjesë i ka mbjellë ato dy pjesë te secili varr nga një, pastaj ka thënë: "Ndoshta do të ketë lehtësim të dënimit për ata dy derisa të thahen këto dy degë (ngase do të bëjnë tesbih - luten për ta"[11].

El Hitabij ka thënë : "Kjo është argument se është e pëlqyer të lexohet Kur'an te varri, sepse nëse shpresojmë se do t'u lehtësohet dënimi atyre dy personave në varre për shkak të tesbihut që bën ajo degë e njomë, atëherë me leximin e Kur'anit shpresojmë edhe më shumë për bereqet dhe mëshirë"[12].

Kurtubi në librin e tij "*Et Tedhkiretu*" thotë: "Disa dijetarë kanë argumentuar për leximin e Kur'anit famëlartë te varri me hadithin në të cilin tregon për Pejgamberin a.s. që ka këputur degën e njomë, dijetarët kanë thënë: "Nga kjo kuptohet se është i pëlqyer leximi i Kur'anit dhe mbjellja e pemëve te varri, sepse nëse do t'u lehtësohej dënimi atyre në varre për shkak të pemës së njomë, e cila bën tespihë atëherë

[9] El Ahad we El Methanij vëll.5, fq. 464; Esedu El Gabe vëll.1, fq. 1470; Mewsuatu Etraf El Hadith vëll.1, fq. 5104.
[10] Ibni Maxhe vëll.4, fq. 445; Subul Es-selam vëll.2, fq. 104; Mewsuatu Et-Tahrixh vëll.1, fq. 13033.
[11] Sahih Buhari Kitab El Xhenaiz nr. i hadithit 1289; Muslim Kitab El Xhenaiz nr. i hadithit 2041.
[12] Umdetu El Karii Sherh Sahih El Buhari vëll.4, fq. 497.

si është me leximin e Kur’anit nga një njeri besimtar mysliman?”, ka thënë: “Për këtë arsye dijetarët e kanë konsideruar të pëlqyeshme vizitën në varre, sepse leximi i Kur'anit lehtëson dënimin e të vdekurit nga vizita që bën njeriu në varre “[13]

Dijetarët islamë e kanë pëlqyer leximin e Kur'anit te varri duke u bazuar në hadithin më lart, sepse nëse ka shpresë për lehtësimin e dënimit për shkak se pema bën tespihë All-llahun xh.sh., e leximi i Kur'anit është më primar dhe më i arsyeshëm se kjo[14].

5. Transmetohet në dy librat e hadithit Sahih (Buhari dhe Muslim) se Pejgamberi a.s. në shumë raste ka fal namazin e xhenazes në varre, e namazi përmban edhe leximin e sures Fatiha dhe salavat mbi Pejgamberin a.s., dhikr e dua, nëse lejohet një pjesë atëherë lejohet i tëri. Dijetarët islamë konsiderojnë se sevapet i arrijnë të vdekurit duke u bazuar në lejimin e të bërit haxh për tjetrin dhe arritja e sevapeve të haxhit për të vdekurin, haxhi përmban në vete edhe namaze dhe në namaz lexohet surja Fatiha dhe sure të tjera, ky është kuptimi përfundimtar, edhe nëse disa ngrenë dyshime mbi këtë, ai dyshim është i pavlerë sepse asnjëri nga dijetarët islamë nuk është kundër asaj se nëse një njeri bën dua dhe lexon Kur'an për të vdekurin dhe atë lexim dhe dua ia dedikon të vdekurit sevapet do t’i arrijnë të vdekurit me lejen e All-llahut xh.sh.[15].

6. Kështu kanë vepruar myslimanët gjeneratë pas gjenerate pa e kundërshtuar këtë askush, ky mendim është te të gjitha medh-hebet madje El Hafidh Shemsudin bin Abdulwahid El Makdesij El Hanbelij ka thënë se për këtë çështje ka konsensus të dijetarëve islamë (Ixhma), transmeton Esh-shejh El Uthmanij në librin e tij “*Rahmetu El Umeti Fi Ihtilaf El Eimeti*” në të cilin thotë: “Dijetarët janë të pajtimit me konsensus se kërkimfalja, duaja, lëmosha, haxhi, lirimi i robit, iu sjell-

[13] Et-Tedhkiretu LilKurtubij vëll.1, fq. 84; Et-Tedhkireti fi Ahwal El Mewta we Umur El Ahiretu vëll.1, fq. 92.
[14] Sherh En-newewij ala Sahih Muslim vëll.3, fq. 202.
[15] Fetawa El Bejt El Muslim, fq. 182.

in dobi të vdekurve, dhe sevapet arrijnë te i vdekuri, leximi i Kur'anit te varri është i pëlqyer”[16].

Ka argumente të shumta nga tradita dhe lajmet e të dhënat nga Selefu Salihinët (Gjenerata e ndritshme) për pëlqimin e leximit të Kur'anit te varri, transmeton Ibni ebi Shejbe nga Imam Shafiu i cili thotë: “Ensarët (medinasit) lexonin Suren Bekare për të vdekurin”[17], transmeton El Halal në librin e tij *“El Kiraetu Ala El Kubur*” në të cilin thotë: “Kur u ka vdekur Ensarëve (medinasve) dikush janë shpërndarë te varri i tij dhe kanë lexuar Kur’an”[18].

Transmeton El Halal nga Ibrahim En-neh’ij, i cili ka thënë: “Nuk ka asnjë problem nëse lexohet Kur’an te varret”, po ashtu transmetohet nga El Hasen bin Es-sabah Ez-zaferanij, i cili thotë: E kam pyetur Imam Shafiun r.a. për leximin e Kur'anit në varre ai ka thënë: Nuk është problem[19].

Transmetohet nga Alij bin Musa El Hadad, i cili thotë: Kam qenë me imam Ahmed bin Hanbelin r.a. dhe me Kudame El Xhewherij në një varrim të një xhenazeje, kur e kemi varrosur të vdekurin një njeri i verbër është ulur pranë varrit dhe ka lexuar Kur'an, atij i ka thënë Imam Ahmedi r.a.: O ti, leximi i Kur'anit te varri është bidat, kur kemi dalë nga varret Muhamed bin Kudame i ka thënë Imam Ahmed bin Hanbelit: Çka thua për Mubeshir El Halebij (çfarë njeriu ishte) ai tha: Ishte njeri i drejtë dhe i vendosur dhe pa gabime në hadith, Imam Ahmedi tha: A mos ke shkruar diçka për këtë person?, ai tha -po, me ka treguar Mubeshir nga Abdurrahman bin El Alae bin El Lexhaxh nga babai i tij se ai e ka porositur të birin e tij që kur të varroset të lexohet te koka e tij surja Fatiha dhe fundi i sures Bekare (dy ajetet e fundit të sures Bekare), kam dëgjuar nga Ibni Omer r.a. që ka porositur kështu, atëherë Imam Ahmedi i tha: Kthehu dhe thuaj atij njeriu që të lexojë Kur'an te varri.[20]

[16] Po Aty; Rahmetu El Umeti fi Ihtilaf El Eimeti.
[17] Musanif ibni Ebi Shejbe vëll.2, fq. 445.
[18] El Wasitij fi Tarih Wasit vëll.1, fq. 190.
[19] El Emru Bil Maruf ve En Nehju An El Munker Li Ebi Bekr vëll.1, fq. 294.
[20] El Mugni ibni Kudame vëll. 2, fq. 224.

Me këtë hadith ka argumentuar Jahja bin Muiin kur është pyetur nga El Abas bin Muhamed Ed-Durij për leximin e Kur'anit te varri.

Leximi i Kur’anit te varri sipas Imamëve të medh-hebeve të pranuara në librin *“El Fetawa El Hindije”:* sipas medh-hebit Hanefi thuhet: “Është e pëlqyer që kur të varroset i vdekuri të ulen njerëzit te varri për një kohë sa mund të theret një kafshë dhe të shpërndahet mishi i saj, e të lexojnë Kur’an dhe të bëjnë dua për të vdekurin”, transmetohet se këto fjalë janë të Muhamed bin El Hasan r.a., këtë mendim e kanë pranuar të gjithë dijetaret e medh-hebit Hanefi.[21]

Ndërsa sipas dijetarëve të medh-hebit Maliki leximi i Kur'anit te varri është i pëlqyer, në librin Hashije Ed-Desuki në *“Esh Sherh El Kebir”* thuhet: Ibni Habib është i mendimit se leximi i Kur'anit te varri është i pëlqyer, po ashtu El-Lahmij është i të njëjtit mendim, madje në disa vende Ibni Habib thotë se është i pëlqyer leximi i sures JaSin te varri.[22]

I vdekuri përfiton nga leximi i Kur'anit pa marrë parasysh a lexohet Kur'ani te varri apo lexohet në shtëpi, ndërsa Muhamed bin Ahmed El Merurizij thotë: Kam dëgjuar Ahmed bin Hanbelin që ka thënë : Kur të shkoni te varret këndojeni Fatihan, Muawedhetejn (*Kul Eudhu Birabi El Felek* dhe *Kul Eudhu Birabi En Nas*) dhe Kul Huwallahu Ehad dhe këtë lexim dërgojeni për ata që janë në varre sepse atyre u arrijnë sevapet.[23]

Sipas dijetarëve të medh-hebit Shafi, është e pëlqyer përshëndetja me selam për të vdekurit në varre nga ai i cili i viziton ata dhe të bëjë dua për të vdekurit në varre, është e pëlqyer të lexohet nga Kur'ani aq sa di përmendësh personi, me këtë mendim janë pajtuar me konsensus dijetarët e medh-hebit Shafi.[24]

[21] El Fetawa El Hindije vëll.1, fq. 177; El Xhewheretu En Nejiretu vëll.1, fq. 429; El Fetawa El Hindijetu vëll.4, fq. 481.
[22] Hashijetu Ed-Desuki vëll.1, fq. 423; Hashijetu Ed-Desuki ala Esh-Sherh El Kebir vëll.4, fq. 173.
[23] Et-Tedhkireti fi Ahwal El Mewta we Umur El Ahiretu vëll.1, fq. 274.
[24] El Mexhmuatu Sherh El Muhdhib vëll.5, fq. 311.

Është e pëlqyer që të ulet afër varrit një kohë, afërsisht një orë e të lexohet Kur'an, të bëhet dua, të mbahet ligjëratë, dhe të tregohen tregime të njerëzve të devotshëm, Imam Shafiu r.a. thotë: Është e pëlqyer që të këndohet Kur'an te varri, kanë thënë edhe nëse këndohet tërë Kur'ani do të ishte mirë[25], është e pëlqyer që të këndohet Kur'an te varri, nëse këndohet i gjithë Kur'ani do të ishte mirë.[26]

Transmeton El Hafidh Edh-Dhehebij se kur ka vdekur Ebi Xhafer El Hashimi El Hanbeli, i cili ishte Shejh i Henbelive është varrosur afër varrit të Imam Ahmed Hanbelit r.a., njerëzit kanë qëndruar te varri i tij një kohë të gjatë sa që thuhet se te varri i tij është bërë hatme Kur'ani famëlartë 10 mijë herë[27].

Madje edhe Shejh Ibni Tejmije i cili e ka konsideruar leximin e Kur'anit te varret se është bidat mendim me të cilin ka rënë ndesh me konsensusin e dijetarëve që nga selefët e parë e deri më sot, transmetohet se njerëzit dhe nxënësit e tij kanë qëndruar te varri i Ibni Tejmijes dhe kanë lexuar Kur'an, kanë lexuar Kur'an edhe në shtëpitë e tyre për Ibni Tejmijen[28].

Sevapet e leximit të Kur'anit dhe sevapet për dëgjimin e leximit do t’i kushtohen të vdekurit në varr. I vdekuri do të mëshirohet në varr duke u bazuar në ajetin Kur'anor, i cili është gjithëpërfshirës dhe jo specifik, All-llahu xh.sh. thotë: ***“Kur lexohet Kur’ani, ju dëgjonie atë*** *(me vëmendje)* ***dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë“*** *(A'rafë 204),* Andaj nuk është e pa logjikshme dhe nuk është e paarsyeshme që të mos e kaploi mëshira dhe t’i arrijnë sevapet të vdekurit nga leximi i Kur'anit, nga Pejgamberi a.s. ka thënë se i vdekuri (shpirti i tij) i dëgjon edhe zhurmën e këmbëve të pjesëmarrësve në varrim. Sevapet për lëmoshën i arrijnë të vdekurit, edhepse ai nuk e përjeton lëmoshën, pastaj lutja dhe kërkimfalja i sjellin dobi, sepse Kur'ani është lutje dhe kërkimfalje, është një vepër e cila të ofron te All-llahu xh.sh..

[25] El Edhkar vëll.1, fq. 162.
[26] Fetawa El Ez-her vëll.7, fq. 458.
[27] Sejr Alam En-nubelai vëll.18, fq. 547; El Muntedhim vëll.18, fq. 316,317; Dhejl Tabakat El Hanabile vëll.1, fq. 17,22,23; Elbidajetu ve En-Nihajetu vëll.12, fq. 129.
[28] Fetawa El Bejt El Muslim, fq. 184.

Pejgamberi a.s. thotë: “Kur të vdes njeriu është këputur (ndërpre-rë) puna e tij përveç nga tri gjëra: lëmosha, dituria që ka lënë dhe nga e cila kanë dobi të tjerët, ose fëmijët e devotshëm të cilët luten për të”. Kur'ani është edhe lutje dhe lëmosh nga fëmijët e devotshëm, nga shokët e devotshëm dhe nga besimtarët e sinqertë të cilët ua dërgojnë sevapet e leximit të Kur'anit të vdekurit në varr.[29].

Përgatiti:
Zuhdi B. Hajzeri

[29] Et-Tedhkireti fi Ahwal El Mewta we Umur El Ahiretu vëll.1, fq. 288.

READING QUR'AN FOR THE DEAD

(Summary)

The arguments, according to which we have to read the noble Qur'an, are general and comprehensive. It is required that these arguments include all places, periods of time, persons and modes of being. These arguments cannot be considered specific, unless they prove the contrary, as this would be something new in Islam and would make more difficult something that was made easy by Allah and his Prohet (PBUH).

قراءة القرآن الكريم عند القبر اثناء و بعد دفن الميت

(خلاصة البحث)

ان الادلة القرأن الكريم هي براهين عامة و شاملة و هذا يجب ان يشمل كل الاماكن والازمنة والاشخاص والاحوال و لا يسمح بان هذه الادلة تكون خاصة الا اذا كانت الادلة عكس ذلك لان هذا يعتبر بدعة في الدين الاسلامى و يشكل صعوبة للاشياء التى سهل الله سبحانه و تعالى و رسوله.

PORTRETE TË SAHABEVE

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

OTHMAN IBNU AFFAN

> **“Historia e pejgamberisë nuk mban mend ndonjë njeri të jetë miqësuar dy herë me një pejgamber përveç Othman bin Affanit, Allahu qoftë i kënaqur me të”.**

Ai është pronar i dy dritave….
Pronar i dy shpërnguljeve….
Bashkëshort i dy vajzave…
Othman bin Affani, Allahu qoftë i kënaqur me të.

***

Othman bin Affani, Allahu qoftë i kënaqur me të, ishte i respektuar te populli i vet, në kohën e injorancës. Ai kishte një autoritet të madh ….

Kishte pasuri të madhe ……Bënte një jetë të begatshme…..

Ishte tejet modest ….. Shumë i turpërueshëm…

Për këtë, populli i vet e donin shumë dhe e respektonin, kështu një grua prej fisit kurejsh e luhatte fëmijën e saj duke i kënduar:

Të dua o Rrahman
Ashtu si e donë Kurejshitët Othmanin

Kur drita e Islamit nisi të ndriçoj në Mekke, Othmani ishte prej të parëve që u përfshi me dritën e tij….

***

Islami i Othman bin Affanit ka një tregim të gjatë, të cilin historianët edhe sot e tregojnë.

Se në kohën e injorancës kur i kishte arritur lajmi se Muhamedi i biri i Abdullahut e kishte martuar me të bijën e tij, Rukijen me të birin e mixhës së saj Utbe bin Ebi Leheb…

Ishte penduar shumë, që ai nuk kishte pasur fat të martohej me të…

Sepse ai dinte moralin e saj të lartë dhe familjen e saj të ndershme….

Andaj hyri në familjen e vet i shqetësuar.

Aty e gjeti hallën e tij Su'da bintu Kurejz. Ajo ishte një grua e vendosur, e mençur, e shtyrë në moshë, andaj ia shpalosi brengën e vet…

Ajo e përgëzoi me paraqitjen e një pejgamberi që do t’i thyejë idhujt…

Do të thërret në besimin e një Zoti të vetëm…

Ajo ia bëri të dashur këtë pejgamber dhe e përgëzoi se ai do të arrijë tek çdo gjë që dëshiron.

Othmani tregon e thotë: dola dhe unë po mendoja për tërë atë që më tha halla ime….

Takova Ebu Bekrin dhe i tregova atij për atë që më kishte lajmëruar, ai më tha:

Betohem në Allahun se halla jote ka thënë të vërtetën. Ajo të ka paralajmëruar për të mirë o Othman….

Ti je njeri i vendosur dhe i mençur. Nuk mund të fshihet ty e vërteta, e as nuk mund të përzihet me të pavërtetën…Pastaj më tha:

Ç'janë këta idhuj që u besojnë populli ynë?!....

A nuk janë prej gurëve të ngurtë, që nuk dëgjojnë dhe nuk shohin?

Ia ktheva: Po ashtu është.

Pastaj shtoi: Atë që ta ka thënë halla jote o Othman është realizuar. …

Allahu e ka dërguar pejgamberin e tij të pritur. E ka dërguar tek të gjithë njerëzit me fenë e vërtetë.

Ia ktheva: Kush është ai?!

Më tha: Ai është Muhamedi i biri i Abdullahut i biri i Abdul Mutalibit.

Ia ktheva: Es-Sadik-ul- Emin (I sinqerti besniku).?.

Ebu Bekri ma ktheu: Po…ai është vet…

I thash: A mund të më shoqërosh deri tek ai?.

Më tha: Po…Shkuam deri te Pejgamberi a.s..

Kur më pa mua më tha: “Përgjigju o Othman thirrësit të Allahut... unë jam i dërguari i Allahut tek ju veçanërisht, dhe tek krijesat e Allahut në përgjithësi…”

Othmani thotë: Posa iu afrova afër dhe dëgjova fjalët e tij, u qetësova dhe pranova misionin e tij…..

Pastaj shqiptova fjalën e njëshmërisë: “Nuk ka Zot tjetër dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij”.

****

Askush nga familja e tij benu Hashim nuk kishte besuar deri më atë ditë……

Mirëpo, askush nga familja e tij nuk ishte armiqësuar me të, përveç mixhës së tij Ebu Lehebit….

Ai dhe gruaja e tij, Umu Xhemil, ishin armiqtë më të mëdhenj të Muhamedit a.s..... Për këtë, Allahu xh.sh. për të dhe gruan e tij zbriti suren “el-Mesed”, ku thuhet:

“Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka!

Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet tjera.

Ai, me siguri do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,

Poashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit,

Në qafën e së cilës do të ketë një litar prej fijesh palme”.

Urrejtja e Ebu Lehebit dhe gruas së tij, Umu Xhemilit ndaj Pejgamberit a.s. dhe myslimanëve, me kalimin e kohës u shtua edhe më tepër, derisa erdhën në atë gjendje që e urdhëruan të birin e tyre Utben ta lëshojë gruan e tij Rukijen, të bijën e Muhamedit a.s., në shenjë hakmarrje ndaj babait të saj.

****

Othmani, posa dëgjoi për shkurorëzimin e Rukijes, përpak sa nuk fluturoi prej gëzimi…Nxitoi dhe kërkoi dorën e saj prej Pejgamberit a.s., të cilën Pejgamberi a.s. ia dha për grua.

Hatixheja e bija e Huvejlidit dhe nëna e myslimanëve është ajo që ia paraqiti Othmanit r.a…..

Othmani ishte më i pashmi i fisit kurejsh, por edhe Rukija ishte shumë e bukur. Kështu me rastin e martesës së tyre këndonin:

Bashkëshortët më të bukur që ka par njeriu

Rukija dhe burri i saj Othmani.

****

Me gjithë pasurinë dhe autoritetin që kishte, Othmani, nuk mundi t'i shpëtoj torturave të popullit të vet, pas përqafimit të Islamit.

Kështu, mixha i tij El-Hakemi, donte që i riu i fisit Abdu Shems ta braktiste fenë e re dhe të kthehej në fenë e Kurejshit …Për ta realizuar këtë qëllim atij iu kundërvuan, ai dhe burrat e fisit të tij…El-Hakemi e kishte lidhur Othmanin dhe i kishte thënë:

A po braktisë fenë e baballarëve dhe gjyshërve të tu e po hyn në një fe të re?!

Betohem në Allahun se nuk do të lirojë derisa mos ta braktisësh fenë që ke përqafua.

Othmani ia ktheu: Betohem në Allahun se nuk do ta braktis fenë time asnjë herë e as nuk do të largohem nga Pejgamberi im deri sa të jem gjallë.

Mixha i tij El-Hakemi ende vazhdonte ta torturonte ….

Kjo e bënte atë edhe më të vendosur dhe më të fuqishëm në fenë e vet. Mixha i tij më në fund kur pa vendosmërinë e tij e la të lirë.

Mirëpo, kurejshitët vazhduan ta urrejnë dhe ta persekutojnë, gjë që më në fund nuk i mbeti rrugë tjetër vetëm ta lëshojë Meken dhe të largohet edhe prej Pejgamberit a.s..

Othmani ishte prej myslimanëve të parë që u shpërngul për në Abisini, ai dhe bashkëshortja e tij Rukija, Allahu qoftë i kënaqur me të dy… Kur u afrua momenti i udhëtimit të tyre, Pejgamberi a.s. shkoi të përshëndetet me ta dhe u tha:

"Allahu qoftë në shoqërimin e Othmanit dhe gruas së tij Rukijes…

Allahu qoftë në shoqërimin e Othmanit dhe gruas së tij Rukijes…

Othmani është i pari që po shpërngulet me familjen e tij pas të dërguarit të Allahut Lutit a.s."

***

Qëndrimi i Othmanit dhe gruas së tij Rukijes në Abisini nuk zgjati shumë, ashtu siç vepruan muhaxhirët tjerë. Malli për Pejgamberin a.s. dhe Mekken kishte tejkaluar çdo kufi…

Ata u kthyen dhe u vendosën në Meke. Derisa Allahu i madhërishëm i lejoi Pejgamberit a.s. dhe besimtarëve tjerë të shpërngulen për në Medine. Së bashku me besimtarët tjerë edhe këta dy u shpërngulën për në Medine.

***

Othmani r.a. mori pjesë në të gjitha betejat dhe luftërat me Muhamedin a.s….

E vetmja luftë që nuk kishte marrë pjesë ishte beteja e Bedrit….

Në atë kohë ishte angazhuar rreth shëndetit të gruas së tij Rukijes.

Kur Pejgamberi a.s. u kthye prej Bedrit, Rukija kishte kaluar në botën e amshueshme.

Pejgamberi a.s. u pikëllua shumë për vdekjen e saj.

Ai e ngushëlloi Othmanin r.a. në mënyrën më të mirë duke e llogaritur si pjesëmarrës në betejën e Bedrit…

I ndau atij pjesën e caktuar të plaçkës së luftës. Për grua ia dha vajzën tjetër Umi Kulthumin…

Për çka njerëzit e quajtën " pronar i dy dritave".

Martesa e tij e dytë me të bijën e Pejgamberit a.s. ishte një respekt i veçantë, të cilin nuk kishte pasur fat ta gëzonte askush para tij.

Historia e pejgamberisë nuk mban mend që një njeri të jetë bërë dhëndër i një të dërguari të Allahut dy herë përveç Othman bin Affanit. Zoti qoftë i kënaqur me të.

***

Islami i solli Othmanit begatitë dhe privilegjet më të mëdha, të cilat mund t'i dëshiroj ndonjë mysliman në jetën e tij.

Andaj, nuk ka mundur që myslimanët t'i godas ndonjë e keqe e që Othmani të mos jetë i pari që i ngushëllon dhe u del në ndihmë atyre….

***

Kështu shohim se kur Muhamedi a.s. vendosi ta dërgojë ekspeditën e tij ushtarake në Tebuk, nevoja për ndihmë financiare ishte më e madhe se për luftëtarë.

Ushtria romake numerikisht ishte më e madhe, ushtarakisht më e përgatitur si dhe beteja zhvillohej në terrenin e saj..

Myslimanëve duhej të bënin një rrugëtim të gjatë…

Armatimi ishte i paktë…

Mjetet e luftës ishin edhe më të pakta….

Në Gadishullin Arabik po mbretëronte një thatësi e madhe që nuk mbahej në mend.

Për këto shkaqe Pejgamberi a.s. u detyrua ta kthejë një numër të madh të njerëzve nga mobilizimi për në luftë. Ata i brengoste pamundësia e tyre të përfshihen në xhihad … si dhe mos dhënia e shansit të bijnë shehidë…

Sepse ata nuk posedonin mjete transporti.

Shumë prej tyre u detyruan të kthehen me sy të përlotur ….

***

Në këtë gjendje, Pejgamberi a.s. hipi në minber. Pasi që madhëroi dhe falënderoi Alllahun xh.sh. ashtu si Ai meriton…Nisi t'i nxit myslimanët të jenë sa më dorëlirë duke u premtuar atyre shpërblime të mëdha.

Pas tij u ngrit në këmbë Othmani r.a. dhe tha:

Unë marrë mbi vete përgatitjen e njëqind deveve me të gjitha nevojat e tyre o i dërguari i Allahut…

Pejgamberi a.s. zbriti për një shkallë më poshtë nga mimberi.

Othman bin Affani u ngrit për të dytën herë dhe tha:

Unë marrë mbi vete përgatitjen edhe të një qind deveve me të gjitha nevojat o i dërguari i Allahut…

Atëherë fytyrën e Pejgamberit a.s. e përshkoi gëzimi.

Zbriti prej mimberit për një shkallë.

Othman bin Affani u ngrit për të tretën herë dhe tha:

Unë marrë mbi vete përgatitjen e njëqind deveve tjera me të gjitha nevojat, o i dërguari i Allahut.

Pejgamberi a.s. atëherë nisi të japë shenjë në drejtim të Othmanit me dorën e vet fisnike, për gjestin fisnik të tij duke thënë:

“Nuk do t’i ndodh asnjë dëm Othmanit pas gjestit të tij të sotëm…

Nuk do t’i ndodh asnjë dëm Othmanit pas gjestit të tij të sotëm….”

***

Pasi që Pejgamberi a.s. zbriti prej mimberit... Osmani shkoi në shtëpinë e tij…

Së bashku me devetë dërgoi edhe një mijë dinarë të artë…

Kur dinarët u hodhën në prehenin e Pejgamberit a.s.. nisi t’i rrotulloj një nga një, duke thënë:

“Allahu të shpërbleftë ty o Othman me atë që ke mbajtur fshehtë dhe atë që ke shpallur…

Atë që është prej teje dhe atë që do të jetë

Derisa të bëhet kiameti.”

***

Gjatë sundimit të Omer el-Farukut, Allahu qoftë i kënaqur me të, vendin e kishte goditur një thatësi e madhe, që kishte shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë, për derisa ai vit ishte quajtur viti i hirit, prej thatësisë së madhe.

Njerëzit ishin lodhur prej skamjes dhe një mëngjes ishin drejtuar tek Omeri ibnul Hattabi, të cilit i kishin thënë:

O zëvendës i të dërguarit të Allahut! Qielli nuk po lëshon shi. Toka nuk po rritë bimë. Njerëzit janë para një shkatërrimi të plotë…

Çka të bëjmë?!.

Omeri ia hodhi atyre një shikim të dhembshëm dhe u tha:

Keni durim. Pritni shpëtimin nga Allahu i madhërishëm…

Unë shpresoj se para se të arrijë mbrëmja, Allahu do të dërgojë një shpëtim për ju.

Para se të arrijë mbrëmje u përhap lajmi se një karvan i Othman bin Affanit do të arrij në mëngjes prej Shamit në Medine.

Pas përfundimit të namazit, njerëzit shkonin në grupe për ta pritur karvanin.

Tregtarët ishin të parët që interesoheshin për të. Karvani erdhi me një mijë deve të ngarkuara me miell gruri, vaj dhe rrush të thatë…

***

Karvani i deveve arriti para dyerve të shtëpisë së Othman bin Affanit, Allahu qoftë i kënaqur me të. Punëtorët filluan të zbritnin barrën e ngarkuar mbi to….

Tregtarët hynë tek Othmani dhe i thanë:

Shitna mallin që të ka arritur ty o Eba Amr.

Othmani ia ktheu: Pranoj ofertën tuaj me respekt të thellë.

Sa më jepni fitim për mua?

Ata i thanë: për një dërhem të japim dy.

Ai u përgjigj: më kanë dhënë më shumë se që po më jepni ju…

Atëherë i shtuan….

Othmani ia ktheu: Më kanë dhënë më shumë së që më shtuat….

Tregtarët shtuan…

Ai ia ktheu: Më kanë dhënë më shumë….

Atëherë tregtarët i thanë:

O Eba Amr, në Medine nuk ka tregtarë të tjerë përveç neve….

Nuk besojmë të ketë ardhur para nesh dikush tjetër….

Kush është ai që të ka dhënë më shumë se që të ofruam na?!

Atëherë, Othmani iu drejtua e u tha:

Allahu i madhërishëm më ka dhënë për çdo dërhem dhjetë.

A mund të shtoni ju më tepër?

Të gjithë ia kthyen një goje:

Jo o Eba Amr..

Atëherë, Othmani iu drejtua tregtarëve me këto fjalë:

Unë kam dëshmitar Allahun e madhërishëm se tërë këtë barrë që ka bartur ky karvan do t'ua japë sadakë të varfërve myslimanë…Nuk dua prej askujt një dërhem apo një dinar….

Të vetmen gjë që dua është shpërblimin dhe kënaqësinë e Allahut të madhërishëm.

***

Kur hilafeti kaloi te Othman bin Affani r.a., në kohën e tij u nënshtrua Armenia dhe Kaukazi….

Fitoret e ushtrisë myslimane vazhduan në Horasan, Kerman, Sixhistan, Qipro, dhe në një pjesë të mirë të Afrikës.

Kjo bëri që njerëzit të pasurohen shumë, pothuajse më shumë se çdo kund tjetër në botë.

***

Kështu, Hasan el-Basriu r.a. tregon për pasurimin, prosperitetin dhe mirëqenien e njerëzve në kohën e Othman bin Affanit.

Për sigurinë dhe qetësinë që jetonin, thotë:

O njerëz ejani të merrni dhuratat tuaja.

Njerëzit shkonin dhe merrnin dhuratat e tyre të plota…

O njerëz, ejani të merrni rrogat tuaja.

Njerëzit shkonin dhe merrnin rrogat e tyre të plota.

Po ashtu kam dëgjuar me veshët e mi - betohem në Allahun - duke thënë:

Ejani dhe merrni rrobat tuaja.

Njerëzit shkonin dhe merrnin rrobat e gjata e të mira. Po ashtu thuhej:

Ejani të merrni tëlyen dhe mjaltë.

Nuk është për t’u habitur se të ardhurat në kohën e Othman bin Affanit ishin të vazhdueshme…

Të mirat ishin të shumta….

Njerëzit jetonin të lumtur. Nuk ka pasur një besimtar ta ketë pasur frikë besimtarin. Myslimani e donte myslimanin, e respektonte dhe e ndihmonte atë.

***

Po, disa njerëz kur ngopen çarten prej të mirave….

Kur, Allahu u çon të mira, disa nuk janë mirënjohës për këtë…

Kështu ata e fajësuan Othmanin për disa gjëra, sikur të bënte ato dikush tjetër nuk do ta qortonin.

Për fat të keq ata nuk u ndalën vetëm te qortimi. Sikur të ndaleshin aty çështja do të ishte më e lehtë.

Shejtani i mallkuar vazhdoi t'i inspiroj ata me vesin e keq të urrejtjes, duke mbjell në shpirtrat e tyre të keqen.

Derisa kundër tij, u ngrit një grup i madh i njerëzve të fiseve të ndryshme, të cilët e mbajtën të rrethuar në shtëpinë e tij për dyzet ditë rresht. Ata ia kishin ndërpre furnizimin me ujë.

Këta mosmirënjohës kishin harruar se Othmani kishte blerë pusin “Rume” me të hollat e tij që prej tij të pinë banorët e Medinës si dhe vizitorët e saj.

Ata më parë nuk kishin pasur ujë të pijshëm.

Ia kishin ndaluar të shkonte për t’u falur në xhaminë e Pejgamberit a.s…, duke harruar se Othmani r.a. ishte i pari që bëri zgjerimin e

xhamisë së Pejgamberit a.s. me të hollat e tij private, që myslimanët të kenë mundësi të falen lirshëm në të..

Meqenëse, Othmani r.a. ishte lodhur nga rrethimi dhe shihte se e keqja sa vinte e po zgjerohej, thirri një numër prej shtatëqind sahabeve dhe bijve të tyre që t'i vijnë në mbrojtje.

Në mesin e tyre, ishte Abdullah ibnu Omer ibnul Hattab, Abdullah ibnu Zubejr ibnul Avvam. Hasani dhe Husejni, dy bijtë e Ali ibnu Ebu Talibit, Ebu Hurejre e shumë të tjerë…

***

Mirëpo, Othman bin Affani, pronar i dy dritave, i zoti i dy hixhreteve, njeri bamirës, preferoi që më mirë të derdhet gjaku i tij se sa gjaku i myslimanëve në mbrojtje të tij…

Preferoi që më mirë të vdes ai, se sa të vriten myslimanët në vend tij.

Andaj, kërkoi me vendosmëri prej atyre që kishin ardhur për ta mbrojtur, ta lënë atë në caktimin e Allahut…

Betohem në Allahun se cili do prej jush ka respekt ndaj meje ta ndalë dorën e tij , të mos bëjë rezistencë ndaj kundërshtarëve.

Shërbëtorëve u kishte thënë se cilido prej jush që kthen shpatën e tij në këllëf, ai është i lirë….

***

Për një çast, halifi i myslimanëve, Othman bin Affani r.a. ishte kotur. Para se kundërshtarët e tij ta vrisnin, kishte pa në ëndërr Pejgamberin, paqa dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të…..

Me të ishin dy sahabet, Ebu Bekr Es-Sidiku dhe Omer ibnul Hattabi.

Dëgjoi Pejgamberi a.s. duke i thënë atij: “Ngrënë me ne sonte o Othman, atëherë e kuptoi se ai do të shkoj te Krijuesi i vet. …Do të takohet me Pejgamberin a.s.

***

Othmani r.a. u zgjua agjërueshëm….

Kërkoi t’i sjellin për të veshur done të gjata, nga frika që mos t'i zbulohet avreti, kur ta mbysin mëkatarët gjakatarë.

Othman bin Affani, robi i devotshëm u vra ditën e xhuma, më tetëmbëdhjetë të muajit dhil hixh-xhe…

Agjërueshëm e duke u falur….

Tubues i Kur’anit fisnik….

Dhëndëri i të dërguarit të Allahut….

Kaloi në botën e amshueshme i etur dhe agjërueshëm, libri i Allahut ishte hapur në mes duarve të tij.

***

Ngushëllim për myslimanët është se në mesin e vrasësve të Othmanit, Allahu pastë mëshirë mbi të, nuk kishte asnjë prej sahabeve...

Nuk ishte asnjë prej bijve të sahabeve….

Me përjashtim të një njeriut të vetëm, të cilin agresorët e shoqëruan në fillim, por ai më vonë u turpërua dhe u pendua…

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

UTHMAN IBN AFFAN

(Summary)

“The history of the prophets does not record anyone to have married two daughters of a Prophet, except Uthman ibn Affan, May Allah be pleased with him””.

He is the possessor of the two lights...
A participant in the two migrations …
The husband of the two daughters …
Uthman ibn Affan, May Allah be pleased with him

د.عبد الرحمن رأفت الباشا

عثمان ابن عفان

(خلاصة البحث)

ان تاريخ النبوة لا يذكر ان احدا من الناس صار خليلا مرتين لأحد الانبياء ما عدا عثمان ابن عفان رضي الله عنه.

هو صاحب ذو نورين ...

صاحب هجرتين ...

زوج بنتين ...

عثمان ابن عفان رضي الله عنه و أرضاه

Mexhid Yvejsi

POETI I POETËVE
APO NË POEZI MBRETI I MBRETËRVE
HAFIZ SHIRAZI 1320-1389

Kush është Hafiz Shirazi?

Hafiz Shirazi 1320-1389

Hafiz Shirazi është njëri nga poetët më të njohur, është njëri nga poetët më të dashur, është njëri nga poetët e paharruar, është njëri nga poetët më të cituar...!

Hafiz Shirazi është poet persian, ku në Iran apo Persi, nëse ndodhet vetëm një libër në ndonjë shtëpi, ai libër është Divani i Hafizit nga Shirazi...!

Hafiz Shirazi cilësohet poet i poetëve, apo në poezi mbret i mbretërve...!

Është një poet, që me vargjet e tij plot frymëzim, ende citohet, admirohet, çmohet e vlerësohet pa pushim, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim....!

Divani i Hafizit, nënshkruar nga Shah Kasemi, 1617 Muzeu Kombëtar i Persisë, Teheran



Divani (Përmbledhja) e poezive të Hafizit

Një jetëshkrim i shkurtër

Hafiz Shirazi u lind rreth vitit 1320, në qytetin Shiraz, që ndodhet afër pjesës qendrore të Iranit. Është djali i tretë i Bahauddinit, i cili ishte një tregtar, por ishte burrë i devotshëm, besimtar e dijetar. Merrej me tregti të qymyrit, por vdiq i ri, pa lënë aspak pasuri...

Hafiz Shirazi njihet në tërë botën si poet me emrin Hafiz Shirazi, por ky nuk është emri i tij i vërtetë. Hafiz është titull, që i jepet atij që e mëson përmendësh Librin e Shenjtë, Kur'anin e madhnueshëm.

Hafiz Shirazi, qysh si fëmijë, në moshën dhjetëvjeçare, Kur'anin e madhëruar e kishte mësuar përmendësh. E kishte mësuar prej babës së tij, Bahauddinit, i cili e këndonte në vazhdimësi me devotshmëri...! Kështu, në shenjë nderimi e admirimi, të gjithë filluen ta thërrisnin djaloshin e ri me titullin Hafiz, jo vetëm pse e dinte përmendësh Kur'anin e madhnueshëm, kjo është e natyrshme, por sepse e këndonte në katërmbëdhjetë mënyra të ndryshme...!

Hafiz Shirazi qysh si fëmijë ishte një djalë shumë i zgjuar, përveç Kur'anit që e kishte mësuar përmendësh, ai i kishte memorizuar edhe veprat e poetëve mistikë siç janë: Sa'adiu, Attari, Nizamiu dhe Rumiu...

Emri i tij i saktë është: Shemseddin apo Shems el-Din Muhammed, ndërsa emri i tij i plotë është: Hoxha Shemseddin Hafiz el-Shirazi. Emri i parë Hoxha në të vërtetë është titull, që do të thotë: mësues, dijetar, ndërsa mbiemri Shirazi është emri i qytetit të lindjes, që tregon, dëshmon, vendlindjen apo prejardhjen e tij.

Mësimet fillestare dhe Medresenë i kreu në Shiraz, ku ishte një nxënës shumë i zgjuar, ndërsa pas diplomimit ishte një profesor, dijetar, udhërrëfyes shumë i shquar... Për disa vite, përveç Shirazit, Hafizi ka jetuar në Isfahan dhe Jezd, kudo që ka shkuar, kudo që ka jetuar, vazhdimisht poezitë e tij i ka recituar...!

Divani i Hafiz Shiraziut
Miniaturë persiane, 1585.

Disa veçori të poezisë së tij

Poezia e Hafizit shquhet kryesisht për disa veçori:

Kjo botë është e përkohshme, hutuese, mashtruese, prandaj duhet maturia, dituria, njohja e vetvetes si hap i parë drejt njohjës të së vërtetës. Materia të robëron, ndërsa shpirtërorja të liron, të shpëton.

Tematika e shpirtërores, ku besimi, adhurimi, edukata, morali, i japin kuptimin e vërtetë kësaj jete, për të cilën duhet përpjekje, me dashuri, mëshirë, me një zemër të pastër, të dlirë...

Te poezia e Hafizit, Shpirtërorja, Shenjtërorja ka kuptimin jo vetëm mirësi, nderim vetes, por edhe respektin për mendimin e besimin e tjetrit...

Këto veçori nuk njohin kufi, prandej poezia e Hafizit edhe sot duket bashkëkohore dhe është arsyeja që është përhapur në përmasa botërore.

Frymëzimi dhe ndikimi

S’ka dyshim se ky frymëzim Hafizit i erdhi nga besimi, imani, i erdhi nga Islami, Kur’ani, por ky frymëzim pati ndikim edhe te budistët, hindusët, hebrenjtë, zoroastrianët, krishterët...

Poezia e Hafizit, për shkak të frymëzimit, është përkthyer në gjuhët kryesore të Lindjes dhe të Perëndimit....

Vepra e Hafizit në gjuhën angleze është përkthyer për herë të parë nga filologu anglez, William Jones (1746-1794), që në vitin 1771. Shkrimtarët, filozofët, në veçanti poetët e rëndësishëm botërorë, siç janë, poeti, esseisti, filozofi amerikan, Ralph W. Emerson (1803-1882) dhe poeti, filozofi, dramaturgu gjerman, Johan W. von Goethe (1749-1882), janë impresionuar dhe frymëzuar nga poezia e Hafizit. Shkaku i këtij frymëzimi dhe ndikimi, Gëte e shkroi vëllimin me poezi “Lindja dhe Perëndimi”

Në nderim të poetit Hafiz Shirazi, në një mur në qendër të qytetit Minneapolis, në shtetin Minnesota, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, janë shkruar këto vargje të Hafizit:

DIELLI ASNJËHERË NUK THOTË

Edhe pas
gjithë këtyre viteve,
Dielli asnjëherë
Tokës nuk i tha:
"*Më ke borxh*."

Shih se çfarë ndodh
me një Dashuri
si kjo!
Kjo e ndriçon
tërë Qiellin.

-Hafizi

Vizitorët para vargjeve të Hafizit - të shkruara në një mur në qendër të qytetit Minneapolis, në shtetin Minnesota, në Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Fëmijët amerikanë frymëzohen e fotografohen para vargjeve të Hafizit - të shkruara në një mur në qendër të qytetit Minneapolis, në shtetin Minnesota, në Shteteve të Bashkuara të Amerikës

"Divani" i Hafizit në botën shqiptare

Prania e "Divanit" të poetit persian, Hafiz Shirazi, në botën shqiptare është e hershme, madje më e hershme se në familjen evropiane të sotme. Studiuesi i njohur Reza Karami thotë:

"Gjatë studimeve dhe kërkimeve në Arkivin Qendror të Shqipërisë, hasim në dorëshkrime ose shkrime që faktojnë praninë e tij këtu. Prania e Hafizit në Shqipëri, vend me kulturë të lashtë, vihet re në vitin 1456. Kjo flet për një fakt të rëndësishëm kulturor (pra ai ka qenë i pranishëm në Shqipëri disa shekuj më parë se në familjen europiane të sotme)".

Sipas studiuesit turk Riza Ayhan, në koleksionin e dorëshkrimeve orientale të ruajtura në arkivat e Shqipërisë, janë 34 përmbledhje në gjuhën perse. Ndërsa, sipas studiuesit shqiptar Shaban Sinani:

"Në Fondin 725 të Arkivit Qendror Shtetëror të Shqipërisë ruhen katër kopjime të "Divanit" të Hafiz Shirazit".

Sipas një studimi monografik, nga studiuesi Sadik Mehmeti nga Kosova, "Katalogu i dorëshkrimeve arabe, turke dhe persiane në Arkivin e Kosovës, në dorëshkrimin me nr. 57 ndodhet pikërisht "Divani"i Hafiz Shiraziut, kopjuar në format xhepi.

Për këtë dorëshkrim dihet emri i shkruesit, i cili quhet Skender bin Selman, (Skenderi i biri i Selmanit). Ky dorëshkrim ishte pronë e Myftiut të Prishtinës dhe mban vulën e bibliotekës së tij.

Dy - tri fjalë përmbyllëse

Hafiz Shirazi ndërroi jetë në vitin 1389. Jetoi në këtë jetë 69 vjet. Gjatë jetës së tij, ai nuk botoi asnjë poezi, por ato u përhapën në formë gojore, kështu qarkullonin dhe frymëzonin.

Përmbledhja e parë e poezive të Hafizit, "Divani", në trajtë të shkruar, doli në dritë 30 vjet pasi që Hafizi kishte ndërruar jetë... !

Sot, pas 600 vjetësh, në gjithë rruzullin tokësor, në mbi 30 vende të botës, organizohen tubime, simpoziume, konferenca shkencore, përkujtimore, që kanë për qëllim të përçojnë dashuri, paqe, besim, mirëkuptim, përmes vargjeve, poezish të thurrura nga Hafiz Shirazi i Persisë, por që i përket mbarë njerëzimit...!

Disa poezi nga Hafiz Shirazi

BURIMI

Aq shumë lot
Kam derdhur
Duke vajtuar,
Sa cilido
Që do t'më
Kishte takuar
Do të habitej.
Nga habia
Do të pyeste:
Lum miku im,
Cili është
Ky burim?

NE DHE DASHURIA

Ne
Jemi njerëz,
Të cilët
Kanë nevojë
Për dashuri,
Sepse
Dashuria
Ndaj së vërtetës
Është
Shpirti i jetës...

DIELLI, TOKA DHE SHPIRTI

Dielli
Fitoi në një garë bukurie
Në diamant u shdërrua,
Vendosur ashtu qysh i ka hije
Në dorën e djathtë
Të All-llahut të Madhëruar.

Toka
Pajtohet të bëhet unazë
Unazë në gishtin e këmbës
Këmbës të së dashurit tim
Dhe për këtë kurrë nuk ndieu
Keqardhje për këtë vendim.

Shpirti
I dha zemrës sime
Një ide të shkëlqyeshme
Kështuqë Hafiz po ngrihet
Si një diamant po rritet
Në krahë të madhërishëm…

ARTI I VËRTETË

Arti i vërtetë
Na zbulon
Se zbrazëtira
Ose errësira
Nuk ekziston.

Për sufiun e vërtetë
Nuk ka vetmi
Në këtë botë të ndritshme
Përplot tallje
Të mahnitshme…

Përktheu nga anglishtja:
Mexhid Yvejsi, Gjakovë

Burimet kryesore:

1. *The Gift: Poems by Hafez the Great Sufi Master*, a collection of poems by **Daniel Ladinsky** published in 1999 by Penguin Books,
2. Jan Rypka, *History of Iranian Literature*. Reidel Publishing Company. 1968
3. Hafiz, *Divan-i-Hafiz*, translated by Henry Wiberforce-Clarke, Ibex Publishers, Inc., 2007.
4. Peter Avery, *The Collected Lyrics of Hafiz of Shiraz*, 603 p. (Archetype, Cambridge, UK, 2007).
5. *Divān-e Hāfez*, Volume 1, *The Lyrics (Ghazals)*, edited by Parviz Natel-Khanlari (Tehran, Iran, 1362 AH/1983-4).
6. PERLA, Revistë Shkencore –Kulturore, Nr.1 (40), Tiranë, 2006
7. Thackston, Wheeler: "A Millennium of Classical Persian Poetry," *Ibex Publishers Inc.* 1994.
8. J.V. Gëte, Vepra të zdherura1-3, Poezi, Rilindja, Prishtinë, 1989.
9. Historia e Letërsisë Botërore, 1-7, Rilindja, Prishtinë, 1987.
10. Walker, Benjamin. *Persian Pageant: A Cultural History of Iran.* Calcutta: Arya Press, 1950.

Mexhid Yvejsi

THE POET OF POETS THE KING OF KINGS HAFEZ SHIRAZI 1320-1389

(Summary)

Who is Hafez Shirazi?

Hafez Shirazi is one of the greatest, most adored and most outstanding poets...!

Hafez Shirazi is a Persian poet. There is no house in Iran (Persia) that does not have the Divan of Hafez...!

Hafez Shirazi is regarded as the king of kings in poetry...!

He was a poet, who, through his inspiring verses, continues to be quoted, admired and highly evaluated, be it in the East be it in the West...!

مجد عويس

شاعر الشعراء او ملك الملوك حافظ شيرازى 1320–1389

من هو حافظ شيرازى؟

(خلاصة البحث)

حافظ شيرازى يعتبر من الشعراء و احبهم و من الشعراء الذين يذكر أكثر.

حافظ شيرازى هو شاعر فاريسي في اي بيت في ايران او افغانستان اذا وجد كتاب واحد هذا الكتاب هو ديوان حافظ شيرازى.

يعتبر حافظ شيرازى شاعر الشعراء او ملك الملوك.

هو من الشعراء الذين وجد قبول سواء في الشرق او في الغرب و شعره كان و ما زال محل احترام و تقدير في كل انحاء العالم.

RECENSIONE

Shahbaze Vishaj

IMAM VEHBI ISMAILI - ERUDIT I KOHËS SONË Imam Vehbi Ismaili: “VEPRA 1-8”, botoi SHB “Logos-A”, 2009, Shkup (3940 faqe).

Dy fjalë në vend të hyrjes

Seriozitetin dhe përkushtimin që po tregon Shtëpia Botuese *“Logos-A”* me seli në Shkup (filiala në Prishtinë dhe Tiranë), në botimin e veprave të plota të autorëve të traditës (po edhe atyre bashkëkohorë) duke filluar nga Sami Frashëri (20 vëllime), autorët e shekullit të kaluar, si Hafiz Ali Korça (12 vëllime), Hafiz Ibrahim Dalliut, Hafiz Ali Ulçinakut e deri të autorët bashkëkohorë si Nexhat Ibrahimi (10 vëllime) flet për përkushtimin që kjo redaksi i ka vënë vetes që publikut lexues t’ia afrojë vlerat e pakontestueshme kombëtare, kulturore, letrare, shkencore, filologjike dhe fetare që personalitete të shquara të kombit tonë nga të gjitha trojet etnike lanë trashëgim (po edhe sot krijojnë, si Nexhat Ibrahimi) duke sjellë frymën e eruditëve shqiptarë që lanë trashëgim pas vetes.

Në këtë vazhdimësi duhet përmendur botimin e veprës së plotë të Imam Vehbi Ismailit në tetë libra (3940 faqe), e cila vjen si një gur xhevahiri në duart e lexuesve shqiptarë, përkatësisht vjen në shtëpitë tona duke stolisur mendimin shqiptar me vlera të njëmendëta kulturore e letrare, atdhetare dhe fetare. Se, SHB *“Logos-A”* gjendet në krye të kësaj vepre, flet një e dhënë: Imam Vehbi Ismaili vdiq më 17 maj 2008, ndërsa kjo shtëpi botuese me tërë potencialin botues-redaktues, arriti që veprën e plotë të këtij misionari ta përgatisë për shtyp, madje ta botojë dhe të dalë para lexuesve në vitin 2009. Kjo flet për seriozitetin dhe përkushtimin e kuadrit profesional të kësaj redaksie që t’ua afrojë njerëzit e penës me shpejtësi rrufeje, pra për të mos i lënë në harresë e as t’i mbulojë pluhuri i harresës. Natyrisht, këta njerëz si Hafiz Ali Korça, Hafiz Ali Ulçinaku dhe Imam Vehbi Ismaili tërë jetën e tyre ngelën në harresë pikërisht nga sistemet shoqërore që mbretëruan në trevat shqiptare, madje u desh që këto sisteme të bien njëherë e përgjithmonë, për të rilindur këta korifej kombi si fenikset dhe ne ta njohim veprën e tyre të plotë. Se nëpër çfarë rrathësh të ferrit kaluan këta eruditë të kombit, mjafton që ta citojmë një fjali pikërisht të Imam Vehbi Ismailit, dhënë publicistit dhe shkrimtarit Hasan Hasani në një intervistë të botuar në gazetën *“Shkëndija”* (shtator, 1994) ku thotë: “Në Miçigan 43 vjet iu luta Zotit ta zhdukë komunizmin”.

Ky ishte misioni jetësor i Imam Vehbi Ismailit gjatë tërë jetës, pra deri në frymën e fundit, kur edhe kaloi në përjetësi.

Në vend të letërnjohtimit

Imam Vehbi Ismaili u lind më 25 nëntor 1919 në Shkodër, në një familje të njohur fetare dhe atdhetare. Babai, Haxhi Ismail Hakiu, ishte njeri i respektuar në Shkodër dhe një prej dijetarëve të njohur jo vetëm në Shkodër, por edhe më gjerë. Si dijetar i fesë, Haxhi Ismail Hakiu kishte një bibliotekë me mijëra libra në gjuhën arabe, turke dhe persiane. Imami i ardhshëm Vehbi Ismaili katër klasë të shkollës fillore i kreu në Shkodër. Ishte nxënës i shkëlqyeshëm. Leximin e kishte pasion. Qysh në këtë kohë ai nisi të lexonte veprat e Aleksandër Dymas: *“Konti i Monte Kristos”* dhe *“Tre musketarët”*, vepra këto që në atë kohë i përkthente në gjuhën shqipe Kostë Çekrezi dhe i botonte në periodikun e kohës, por edhe si broshura (fletore) të vogla prej tetë faqesh. Në vitin 1928, babai i Vehbi Ismailit emrohet Myfti në Krujë. Kështu Vehbiu klasën e pestë e vazhdoi në Krujë. Mirëpo, në Krujë nuk kishte shkollë të mesme, kështu që Vehbi Ismaili detyrohet që të punojë në Krujë në zyrën e tatimeve. Në vitin 1933 regjistrohet në Medresenë e Naltë në Tiranë. Kjo ishte një shkollë me autoritet, përkrah Normales së Elbasanit dhe Gjimnazit të Tiranës. Madje, ai që kryente këtë shkollë mund të regjistrohej në të gjitha universitetet e Evropës, meqë atëbotë në Shqipëri nuk kishte Universitet. Në këtë shkollë ai mësoi gjuhën arabe, angleze dhe persiane. Madje, nisi të merrej edhe me shkrime dhe i botonte në revistën *“Zani i Naltë”*, që ishte organ i Komunitetit Mysliman-Shqiptar. Po ashtu bashkëpunoi edhe

me të përjavshmen *“Vatra e rinisë”*, ku botonte tregime të shkurtëra. Mirëpo, me të mbaruar këtë shkollë, edhe pse mund të punonte si imam xhamie, Imam Vehbi Ismaili vendosi t’i vazhdojë studimet fetare në Egjipt. Kështu, në vitin 1937 shkon në Egjipt dhe regjistrohet në Universitetin *“Al’azhar”* të Kajros, në Fakultetin e Teologjisë, ku në vitin 1945 edhe diplomoi. Pas diplomimit nisi të punojë në Egjipt. Këtu, përveç punës së përditshme, për komunitetin shqiptar që jetonte atje, nisi t’i përkthejë në gjuhën arabe novelat e Ernest Koliqit dhe tregimet e Qamil Guranjakut dhe i botonte në revistat: *“El Risaleh”* (Mesazhi), *“Eththekafe”* (Kultura) dhe *“El Kitab”* (Libri). Ndërsa në revistën *“El Hilal”* Imam Vehbi Ismaili botonte tregimet e veta me motive nga historia islame. Kah fundi i vitit 1948 Imam Vehbi Ismaili ftohet nga Shoqëria Shqiptare-Amerikane Myslimane në Detroit (Miçigan) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të udhëheqte komunitetin fetar mysliman. Kështu, në prill të vitit 1949 vendoset në Detroit, ku u gjend në mesin e shumë shqiptarëve, të cilët pas Luftës Dytë Botërore kishin ikur nga atdheu si emigrantë politikë. Këtu edhe filloi një jetë e dytë për Imam Vehbi Ismailin, ku punoi, shkroi, botoi, përktheu, njëherësh u mor intensivisht me aktivitetet kulturore e kombëtare, fetare e atdhetare për 59 vjet pandërprerë, deri në frymën e fundit, ku më 17 maj 2008, edhe vdiq.

Për 59 vjet në Detroit (Miçigan) SHBA, Imam Vehbi Ismaili zhvilloi një aktivitet të gjërë kulturor e kombëtar. Këtë e dëshmojnë këto fakte. Aktiviteti i tij zhvillohet në dy drejtime. Drejtimi i parë: më 30 korrik 1949 organizon Kongresin e Parë të Shqiptarëve në Detroit; gjatë viteve 1950-1958 boton revistën *“Jeta myslimane shqiptare”* në gjuhën shqipe dhe atë angleze; më 6 qershor 1951 inauguron xhaminë e parë në Detroit; më 23 shkurt 1963 ndërtohet qëndra e madhe islame me xhaminë dhe anekset e saj; më 23 gusht 1988 viziton Shqipërinë pas 49 vjetësh; më 10 korrik 1993 themelon Komunitetin Mysliman Shqiptar për SHBA dhe Kanada, ku kryetar zgjidhet pikërisht Imam Vehbi Ismaili; më 1993 boton revistën fetare *“Thirrja islame”;* më 1996, kryetari i Shqipërisë, Sali Berisha, e dekoron me urdhërin *“Flamuri i demokracisë”*. Drejtimi i dytë: përfshin aktivitetin e bujshëm të Imam Vehbi Ismailit si shkencëtar dhe shkrimtar, me ç’rast botoi vepra të ndryshme letrare dhe shkencore me karakter fetar, po edhe përktheu literaturë të denjë me karakter universal. Veprat origjinale: *“Islamizmi dhe lutjet”* 1976, *“Muhamedi dhe mësimet e tij”* 1995, *“Muhamedi, profeti i fundit”* 1985, *“Muhamedi*

profeti islam” 1987, *“Historia e pejgamerëve I”* 1997, *“Historia e pejgamerëve II”* 1998, *”Jusufi i drejtë”* 1994, *“Ymeri pranon fenë islame”* 1987, *“Kërkuesi i së vërtetës”* 1989, *“Bilali, Mezini i profetit”* 1988, *“Një tufë lule”* 1985; *“Studime islame”* 1988, *“Dritë nga Kurani”* 1992; *“Ç’është islamizmi”* 1992, *“Kujtime të rinisë”* 1993; *“Predikimet e xhumasë dhe Bajrameve”* 1988; *“150 hadithe”* 1990; si dhe veprat e përkthyera: *“Muhamedi profeti njeri”* 1987, *“Muhamedi”* (njëzet tregime) 1990; *“Mrekullia e madhe”* 1990; *“Feja islame”* 1987; *“Zoti është me ne”* 1995; *“Në skajet e historisë”* 1986; *“Banorët e shpellës”* 1988; *“Ebu Dherr El Gaf-Fari”* 1986 etj. duke u përmbyllur kështu e tërë vepra letrare, origjinale dhe e përkthyer, e eruditit islam Imam Vehbi Ismaili.

Këtu më poshtë, në këtë paraqitje të veprës së plotë prej tetë veprave të Imam Vehbi Ismailit, me rastin e botimit të tyre nga *“Logos-A”* e Shkupit, do të ndalemi veç e veç për secilin libër, në mënyrë që të formohet një gjykim i plotë për veprën madhore të këtij eruditi, siç është Imam Vehbi Ismaili.

Studime për jetën dhe veprën

Libri i parë që i prin këtij kompleti titullohet *“Studime për jetën dhe veprën e Imam Vehbi Ismailit”* (Vepra 1) hapet me shkrimin *“Dy fjalë rreth botimit”* shkruar nga redaktori i përgjithshëm Zekerija Ibrahimi, i cili i bën një vështrim të përgjithshëm veprimtarisë botuese të *“Logos-A”*, sidomos botimeve të veçanta, pastaj vështirësive dhe dilemave që kishin në përgatitjen dhe rënditjen e veprës së gjërë të Imam Vehbi Ismailit, duke filluar nga përmbajtja, gjuha, shprehjet shkodrane etj. Pas këtij shkrimi vjen ai i Nexhat Ibrahimit, i cili edhe e përgatiti për botim serinë e veprave të Imam Vehbi Ismailit, që në shkrimin “Imam Vehbi Ismaili xhevahir mbi xhevahirë” jep portretin e plotë të këtij eruditi, siç pohon që në titullin e punimit “xhevahir mbi xhevahirë”, andaj edhe pohon: “Imam Vehbi Ismaili i përket llojit të personaliteteve që janë të rrallë porsi uji në shkretëtirë. Ky pohim konsiston me angazhimin optimal të tij për ndriçimin e çështjeve dhe temave që e preokuponin kohën kur ai veproi. Pohimi i tillë konsiston dhe me spektrin e fushave që ai trajton. Për këtë arsye, përpunimi dhe arsyetimi më i themeltë i vlerësimit të opusit intelektual, shkencor dhe organizativ të Imam Vehbiut kërkon njohje të kontekstit të gjerë kohor dhe hapësinor të lindjes, zhvillimit dhe kontributit të tij të gjithanshëm”.

Libri vazhdon me studimin e tre autorëve: Faik Luli, Islam Dizdari dhe Nexhmi Bushati me titull “Imam Vehbi Ismaili” (botuar në Shkodër me

1997 në librin *“Në kujtim të brezave”*) ku i bëhet një analizë e thellë jetës dhe veprës së këtij korifeu të kohës, punim ky shkencor të cilin e përforcojnë 113 referenca (fusnota) që flasin qartë se me çfarë gjeniu kemi të bëjmë. Ndërsa intervista e publicistit dhe shkrimtarit nga Prishtina, Hasan Hasani, botuar në revistën *“Shkëndija”* në shtator të vitit 1994 me titull “Në Miçigen 43 vjet iu luta Zotit ta zhdukë komunizmin” paraqet në detaje jetën dhe veprën e Imam Vehbi Ismailit të dhënë nëpërmjet të pyetjeve dhe përgjigjeve, të cilën Imam Vehbi Ismaili e dha vetë, e që sipas autorit H. Hasani, nuk u ndryshua qoftë edhe një fjalë e vetme, por u botua ashtu siç e kishte shkruar. Në këtë vazhdë vijnë edhe punimet e prof. Muhamed Mufakut “Vehbi Ismaili - personalitet i veçantë fetar e kulturor”; Dr. Feti Mehdiut “Imam Vehbi Ismaili dhe përkthimi i Kur’ani Kerimit në gjuhën shqipe”, me theks të veçantë në përkthimin e parë të plotë; Idriz Kali “Imam Vehbi Ismaili - një figurë shquar e kombit”; Prof. dr. Beqir Ismaili “Imam Vehbi Ismaili dhe përpjekjet e tij në drejtim të çështjes kombëtare shqiptare” (botuar në gazetën egjiptiane *“Al Hajat”* (Jeta) me 2003); Muhamet Mjeku “Feja e atdheu - të pandashme”; Vehbi Bajrami “Imam Vehbi Ismaili, figurë e ndritur fetare e botës shqiptare”, për të përfunduar ky lbër me shkrimet e Fejzi Zaganjorit, Haxhi Faik Hoxhës; H. Sulejman ef. Rexhepit; Elez I. Lagreta shkruar përkitazi me dekorimin e Imam Vehbi Ismailit “Pishtar i demokracisë”, mbajtur në sallën e Teatrit “Migjeni” në Shkodër, më 25 nëntor 1996, organizuar nën patronazhin e Myftinisë së Shkodrës dhe Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, me ç’rast presidenti i Shqipërisë, z. Sali Berisha, e dekoroi Imam Vehbi Ismailin me Urdhrin “Flamuri i demokracisë”.

Historia e pejgamberëve në dy libra

Libri i dytë përbëhet nga dy vepra të Imam Vehbi Ismailit, si: *“Historia e pejgamerëve I”* (1997) dhe *“Historia e pejgamerëve II”* (1998). Imam Vehbi Ismaili në parathënien e librit të parë pohon se për historinë e pejgamberëve në gjuhën shqipe para tij kishin shkruar Hafiz Ali Korça, Prof. Haki Sharofi dhe Bajrush Ahmeti, ku burim kryesor i këtyre librave, qoftë i autorëve të lartpërmendur, qoftë edhe i vetë Imam Vehbi Ismailit, ishte libri *Kur’ani i Shenjtë*. Sipas Imam Vehbi Ismailit “Synimi kryesor i këtyre tregimeve të pejgamberëve që na tregohen në Kur’an është për të ngulur në shpirtërat e besimtarëve që Zoti është Një, i Plotëdishëm e Plotëmëshirshëm e tjera; dhe se ky besim është gurra e të gjitha të mirave. Prandaj, veçoritë e këtyre tregimeve janë këto: 1. Nuk

përcaktojnë dhe flasin me hollësi për personalitetet mbi të cilët flitet, por bëjnë fjalë, më tepër, për ftesat e tyre. 2. Nuk përmend kohën dhe vendet e ngjarjeve, vetëm rrallë ndonjëherë. 3. Përdor një stil të përpikët d.m.th. shkon drejt në temë, pa përmendur hollësira të panevojshme në çka synon”. Kjo flet qartë se misioni që ia kishte shtruar vetes përpara Imam Vehbi Ismaili ishte që me tema dhe motive nga Kur’ani të shkruajë tregime me përmbajtje kuranore, në mënyrë që lexuesit t’i njohë edhe më shumë me këto tema dhe motive, duke ua afruar atyre në trajtë rrëfimi artistik siç është tregimi. Në librin e parë gjejmë tregime të shkruara për këta pejgamberë: Ademin, Idrizin, Nuhin, Hudin, Salihin, Ibrahimin, Ismailin, Lutin, Is’hakun dhe Jakubin. Ndërsa në librin e dytë gjenden tregimet për pejgamberët: Jusufin, Shuajbin, Ejubin, Musain, Harunin, Junusin, Uzejrin, Eljesain, Dhulkiflin, Llukmanin, Dautin, Sulejmanin, Zekeriain dhe Jahjanë.

Tregimet për këta 24 pejgamberë janë shkruar me një përkushtim të madh, me një frymëzim të thellë, me një gjuhë të rrjedhshme, që lexuesin e mbajnë pezull gjatë gjithë kohës së leximit. Imam Vehbi Ismaili duke mos u larguar nga motivet dhe përmbajtja e Kur’anit, krijoi tregime të bukura, si një artist i mrekullueshëm, duke njoftuar lexuesin nëpërmjet të rrëfimit të natyrshëm për tërë madhështinë e këtyre figurave të shenjta të Islamit, duke i shëtitur lexuesit nëpër jetën e tyre të ëmbël dhe të bujshme, nëpër ëndrrat dhe raportet ndërnjerëzore, jetën familjare, luftërat e shenjta, mbrojtjen e popullit, vrasjet dhe gjykimet, marrëdhëniet familjare e shumë të tjera që në kujtesën e lexuesit nguliten thellë. E tërë kjo është arritur nëpërmjet të rrëfimi dhe gjuhës së rrjedhshme të dijetarit dhe shkrimtarit Imam Vehbi Ismaili.

Tre libra për Profetin Muhamed

Libri i tretë përbëhet nga tre libra të veçantë: *“Muhamedi dhe mësimet e tij”* (1995), *“Muhamedi profeti i fundit”* (1995) dhe *“Muhamedi profeti islam”* (1987). Puna krijuese e Imam Vehbi Ismailit nuk di të këputet për asnjë moment gjatë tërë jetës së tij në shërbim të Islamit. Këtë vazhdimësi ky predikues i vyer e ndoq i frymëzuar, në radhë të parë nga studiuesit boterorë të islamit, të cilët shkruan qindra e mijëra vepra për jetën e Muhamedit, po edhe paraardhësit e tij, studiuesit shqiptarë islamë. Kështu, ky studiues vetëm sa e plotëson misionin e tij shpirtëror ndaj figurave qëndrore të Islamit. Këtë e dëshmojnë edhe tri veprat e lartpërmendura për pejgamberin Muhamed që gjeten vend në

këtë vëllim. Misioni që Imam Vehbi Ismaili ia ka ngarkuar vetes, ilustrohet me këtë citat nga *Paraqitja* e librit të parë *“Muhamedi dhe mësimet e tij”*, ku thotë: “Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të dërguarin e fundit, Muhamedin, i cili na e kumtoi mesazhin e fundit hyjnor, Kur’anin, që po të veprojmë në bazë të tij, sigurojmë lumturinë në të dy jetët. Paqa e Zotit dhe bekimet e Tij u derdheshin dhe mbi familjen, shokët dhe besimtarët e Muhamedit a.s.”. Në këtë vepër jipet jeta dhe vepra e Muhamedit nga lindja, fëmijëria, martesa, vuajtjet dhe mundimet, mënyra e predikimit, besimet e popullit, refugjatët myslimanë, udhëtimet e profetit, përhapja e islamizmit, Muhamedi qeveritar, trimëritë e tij, shpirtmadhësia e tij, sinqeriteti, përulësia, durimi, ndjesa, ndërshmëria, mirësia, respekti, guximi etj. Dhënë nëpër kapitujt e kësaj vepre madhështore.

E kësaj natyre është edhe vepra e dytë *“Muhamedi profeti i fundit”* që është një doracak kushtuar brezave të rinj. Këtë e dëshmon edhe vetë autori Imam Vehbi Ismaili, i cili në parathënien e këtij libri thotë: “Ky libër, natyrisht, nuk është një jetëshkrim i plotë i Profetit, por janë paraqitur disa anë të jetës së tij, meqë qëllimi i këtij libri është përdorimi i tyre në shkollat fetare në Faltoret tona, mësuesi duhet të ketë njohuni ma të gjana mbi të, që të jetë në gjendje me u shpjegue dhe thekësue qëndrime në jetën e Profetit, në mënyrë që fëmija të mundohet ta marrë shembull për jetën e vet”. Tërë ky mision është paraqitur në 16 kapitujt e këtij romani biografik për Profetin Muhamed. Ndërsa libri i tretë “Muhamedi profeti islam” që është vepra më e kompletuar për Profetin Muhamed nga Imam Vehbi Ismaili, autori njofton lexuesit me misionin dhe rolin e Muhamedit, Arabinë, arabët dhe Abisininë, lindjen e Pejgamberit dhe fëmijërinë e tij, Muhamedin jetim dhe rritjen e tij tek i ungji, martesën, Muhamedin profet, besimtarët e parë, vuajtjet dhe mundimet, emigrimin në Abisini, vitet e dëshprimit, predikimin e islamizmit, Muhamedin në Medine, Muhamedin burrështeti, ku vihet në mbrojtje të lirisë, me ç’rast e gjejmë në ballë të luftërave të Bedrit, Uhudit, Hendekut, Hudejbijes, pushtimi i Mekës, lufta e Hunejnit, reformat e të tjera, që autori Imam Vehbi Ismaili i ka dhënë në tridhjetë e një netë përkatësisht në tridhjetë e një kapituj jetësorë. E tërë kjo vjen si rezultat i njohjes së thellë që Imam Vehbi Ismaili kishte mbi jetën dhe veprën e Profetit Muhamed, duke na dhuruar këto tri vepra që gjetën vend në vëllimin e tretë të këtij kompleti, ku dominojnë faktet historike, të cilat janë të marrura nga literatura e gjerë mbi Muhamedin shkruar në gjuhët botërore, si: arabe, frënge, angleze etj.

Kështu, me të drejtë, autori në parathënien e këtij libri pohon: “Nuk besojmë të ketë njeri në botë që të jetë diskutuar më shumë sesa Profeti i jonë Muhamed, qoftë në vepra, qoftë në besim. Nuk është për t’u çuditur që të jenë shkruar më shumë libra për të dhe fenë islame, ngase mund të jenë shkruar për ndonjë njeri ose për ndonjë fe tjetër, meqë efekti i tij dhe i fesë myslimane ka qenë madhështor në zhvillimin e qytetërimit botëror. Në këto vepra, kritikat, të sharat, akuzat dhe abuzimet që i janë bërë Muhamedit nuk mungojnë, bile mund të thomi se janë të shumta. Por s’ka dyshim se sa më tepër zhvillohet njerëzimi, aq më shpejt dhe më plotësisht lirohet mendja njerëzore nga fanatizmi. Sa më tepër përparojnë studimet e historisë me anën e metodës kritike dhe shkencore, aq më tepër çmohet dhe i shtohet vlera Profetit tonë. Kjo gjë provohet nga studimet e lira që janë bërë mbi jetën e tij në këto vjetët e fundit, nga shkrimtarë që s’janë myslimanë. Këta shkrimtarë i kanë hedhur poshtë të gjitha kritikat që, në kohën e kaluar, i janë bërë Profetit nga bashkëfetarët e tyre, kritika që janë fryte të fanatizmit. Mjafton të përmendim Enciklopedinë Britanike, e cila e quan Muhamedin Profetin më suksesplotë në historinë e njerëzimit”.

Drama dhe tregime me motive fetare

Libri i katërt përfshin me vete pesë librat: *“Jusufi i drejt”* (1994), *“Ymeri pranon fenë islame”* (1987), *“Kërkuesi i së vërtetës”* (1989), *“Bilali mezini i profetit”* (1988) dhe *“Një tufë lule”* (1985) me gjithsej 784 faqe libri. Nisur nga libri i parë i këtij vëllimi *“Jusufi i drejtë”*, temë kjo e huazuar nga Kur’ani dhe tashmë e njohur nga lexuesit shqiptarë, sepse në këtë bazë u shkruan vepra të njohura nga autorë të njohur shqiptarë, si *“Jusufi e Zelihaja”* nga Muhamet Çami dhe Hafiz Ali Korça. Kështu, këtë temë e shfrytëzoi edhe Imam Vehbi Ismaili, përkundër autorëve Muhamet Çami dhe Hafiz Ali Korça, që veprat e tyre i shkruan në vargje, Imam Vehbi Ismaili këtë temë e shtjelloi në gjininë e dramës, ku dialogët zhvillohen kryesisht mes Jusufit dhe babait të tij, Jakubit. Por, nuk mungojnë edhe personazhet tjera si: Ashari, Dani, Zebuluni, Gadi, Simeoni, Reubeni, Zera, Isakiri, Judahi, Lejena, Kryetari Prijsi, Djaloshi, Shërbëtori, Tellalli, Gruaja, Azizi, Vajza, Esnata, Zonja, Kushëriri, Furrëtari, Shërbyesi, Mbreti, Ministri, Oficeri etj. Arsyetimin për këtë dramë Imam Vehbi Ismaili e jep me këto fjalë: “Mendimi im është se më tepër se kurrë sot, populli shqiptar ka nevojë për një literaturë fetare morale, që të ndikojë për nxjerrjen e

popullit tonë nga pellgu në të cilin e kishte zhytur komunizmi enverian, se tregon si smira të shtyn në urrejtje dhe ajo të bën të bësh krime, në të shihet dinjiteti njerëzor, morali i lartë, besimi dhe mbështetja në Zotin, pasi të pajisesh me dituri dhe puna e pareshtur, dhe fundi dhe zemërgjerësia për të falur ata që pendohen se kanë bërë ligështi, parime këto që i mësojnë të gjitha fetë, dhe që janë të domosdoshme për zhvillimin e përparimin e popullit shqiptar kudoqoftë”.

Edhe vepra *“Ymeri pranon fenë islame dhe dy tregime tjera nga historia”*, në të vërtetë janë tri rrëfime të shkruara në dramë, ku rrëfehet se si Ymeri pranon islamin, fuqinë e besimit që e pati e motra e tij Fatimja, rreshtimi në shkollën e profetit Muhamed e deri te arritja e lartësive kur Ymeri bëhet njëri prej sunduesve më me famë të myslimanëve që ka lënë gjurmë në historinë islame. Ndërsa në dy tregimet tjera Imam Vehbi Ismaili rrah temën e lakmisë. Kështu tregimi *“Lakmia e madhe”* tregon përfundimin e atij që Zoti i jep të mira, por që ai nuk i përdor për të mirën e shoqërisë në të cilën jeton. Ndërsa tregimi i tretë *“Heroina muslimane”* paraqet gratë myslimane në shërbim të fesë, e cila historikisht ishte pjesë aktive në shërbimin e fesë islame. Shihet qartë synimi i autorit Imam Vehbi Ismaili që rrëfimet e tij të brumosën me temën moralizuese, e cila shërben në ngritjen e moralit të njeriut, në edukimin e drejtë gjithnjë me synim të mirën, njerëzoren, të bukurën, të dobishmen.

Edhe libri i tretë i këtij vëllimi, titulluar *“Kërkuesi i së vërtetës”* paraqet në mënyrë romanore portretin e një persiani të quajtur Selman, njërit prej njerëzve më të dashur të Profetit Muhamed. Këtë temë e kanë trajtuar edhe shumë historianë dhe studiues të vjetër myslimanë, kështu që edhe Imam Vehbi Ismaili ia hyri kësaj pune duke krijuar një vepër prej 173 faqesh, një romani me përmbajtje nga Kur’-ani, prej nga ky shkrimtar i mori të gjitha motivet, duke u frymëzuar me tërë qenien e tij, për të trajtuar këto tema, që padyshim kanë lënë gjurmë edhe në këtë krah të letërsisë sonë me përmbajtje fetare.

Në këtë gjerdan veprash të vendosur në këtë vëllim vjen edhe *“Bilali mezini i profetit”*, ku paraqitet portreti i jetës së mezinit të Profetit Muhamed. Bilali ishte joarab, një skllav nga Abisinia (Etiopia), por që ishte një njeri i dashur dhe besnik ndaj profetit Muhamed. Autori Imam Vehbi Ismaili përveç literaturës, për këtë vepër u mbështet edhe në burime të sakta të literaturës së lashtë islame. Kështu “Jeta e Bilalit është provë e gjallë që shekuj para se të dëgjohej për revolucionin francez, feja islame u siguroi

ithtarëve të saj të njëjtat të drejta njerëzore, por pa dallime race, ngjyre apo klase shoqërore. Bilali, skllavi abisinas arriti të bëhej Mezini dhe arkëtari i profetit Muhamed”, përfundon Imam Vehbi Ismaili.

Ky vëllim përmbyllet me veprën *“Një tufë lule”* që ka një histori të vogël. Imam Vehbi Ismaili këtë vepër e shkroi gjatë kohës kur studionte në Kajro, ndërsa i ngeli në dorëshkrim deri në vitin 1985 kur e botoi në Detroit të SHBA-ve. Kjo paraqet fazën e parë të shkrimeve të këtij shkrimtari, fazën e rinisë së hershme. Këto 15 tregime, si gjithë vepra e tij, me motive fetare, paraqesin interesimet e hershme të krijuesit të ri me të gjitha mungesat që mund t’i kishte. Mirëpo, përvoja e gjatë gjashtëdhjetëvjeçare në krijimtari bëri që ky emër të respektohet nga brezat në vijim kudo ndër shqiptarë që patën rastin ta lexojnë veprën madhore të tij. Pikërisht për këtë vepra e tij e gjerë la gjurmë të pashlyeshme ndër lexues e studiues, madje u bë objekt shqyrtimi nga brezat në vijim që me këmbënguljen e tij stoike la gjurmët e veta në historinë e literaturës islame ndër shqiptarë. Këtë e ilustrojnë disa nga titujt e këtyre tregimeve të përmbledhura në librin *“Një tufë lule”*, si: *“Drita e gjithësisë”*, *“Gruaja më e lumtur”*, *“Shpella Hara”*, *“Ngadhënjim i papritun”*, *“Vullneti i hekurt”*, *“Stolitë e imperatorit”* etj.

Studiues i devotshëm i Islamit

Libri i pestë përbëhet nga pesë libra, kryesisht nga fusha e studimeve të çështjeve të ndryshme nga fusha e islamit. Librat *“Studime islame”* (1994), *“Islamizmi dhe lutjet”* (1993), *“Dritë nga Kur’ani”* (1992, *“Ç’është islamizmi”* (1992) dhe *“Kujtime të rinisë”* (1993) e dëshmojnë këtë më së miri. Libri *“Studime islame”* daton nga viti 1988 (botimi i parë), me ç’rast Imam Vehbi Ismaili u bën një studim të thukshëm çështjeve islame në përgjithësi, duke u nisur nga baza, Kur’ani i Shenjtë, çka përmban ai, Muhamedi dhe mësimet e tij, lutjet, mënyra e predikimit, besimet e popullit pagan, përhapja e islamizmit në Medine, mësimet islame, dashuria e myslimanëve ndaj profetit, Muhamed dhe ligjet e natyrës, të falurit (namazi) dhe rëndësia e tij, mirëbërja e detyruar (zeqati), liria në fenë islame (ajo politike, mendore dhe fetare), pozita e gruas në fenë islame, besimi në fenë islame, baza e çdo feje - përsosmëria morale etj. Këto janë vetëm disa nga temat me të cilat u mor Imam Vehbi Ismaili në librin e tij “Studime islame”, ku në mënyrë të thelluar shkoqiti dhe analizoi këto fenomene që padyshim paraqesin bazën e islamizmit si teori dhe filozofi në përgjithësi. Dhe, Imam Vehbi Ismalili shkon edhe më larg. Libri i dytë *“Islamizmi dhe lutjet”* që paraqet një vazhdimësi në

kontinuitet, që në kapitullin e parë *"Ç'është islamizmi"* shkruan: "Sipas Kur'anit, feja islame, është aq e vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Kjo fe nuk e ka burimin te Muhamedi, se të vërtetat dhe themelet e kësaj feje i predikuan dhe profetët e mëparshëm si Ademi, Nuhi, Ibrahimi, Musaj e Isaj, paqja e Zotit qoftë mbi ta. Në të vërtetë është feja e çdo profeti që u duk në çdo kohë dhe në çdo vend të botës. Por Muhamedi, a.s. është ai që i bëri interpretimet e fundit këtij sistemi hyjnor dhe me ardhjen e tij u plotësua dhe u përfeksionua; dhe prandej me të drejtë sikur thotë Kur'ani, duhet të konsiderohet feja natyrale e njeriut: "Natyra e bërë nga Zoti në të cilën ka krijuar njerëzinë, nuk ka ndryshim në krijesat e Zotit; ajo është feja e vërtetë, por shumica e popullit nuk e di". Pastaj vijnë *parimet teorike* të Islamit, si: besimi në një Zot, besimi në engjëjt, besimi në librat e shenjtë, besimi në profetët, besimi në jetën e amshueshme, përkatësisht *parimet praktike*, si: fjala e dëshmisë, falja, zeqati, agjërimi, pelegrinazhi etj. Këtu në mënyrë studioze flitet edhe për kremtet, martesat, shërbimet për të vdekurit e deri të lutjet profetike, si lutja e ditës së flamurit, himni mysliman shqiptar. Ndërsa libri *"Dritë nga Kur'ani"* ngërthen në vete dhjetë porosi hyjnore. Meqë këtë autori përherë e bën për lexuesit shqiptarë dhe shqiptarët në përgjithësi, mjafton ta citojmë një mendim të dhënë në Parathënie, ku jipet qartë mesazhi për rolin dhe rëndësinë e këtij libri, me ç'rast thuhet: "Ne, në këtë vepër të përvuajtur, menduam, që me rastin e një vizite që po bëjmë këto ditë në Shqipëri, t'u paraqesim vëllezërve tanë myslimanë shqiptarë dhe motrave tona myslimane shqiptare përkthimin dhe shpjegimin e tre versioneve, që përmbajnë dhjetë këshilla Hyjnore, me anë të të cilave do të kenë mundësi, po t'i vënë në zbatim, t'i pastrojnë shpirtrat, t'i ndriçojnë mendjet e të sigurojnë lumturinë në të dyja botët". Prandaj, këto dhjetë porosi identifikohen me lumturinë dhe mbarësinë e domosdoshme dhe të gjithanshme të njerëzimit, që studiuesi Imam Vehbi Ismaili nëpërmjet të këtij libri ua bëri më të afërta lexuesve shqiptarë. Po ashtu edhe libri i katërt i këtij vëllimi *"Ç'është islami"*, të cilin Imam Vehbi Ismaili e botoi në gjuhën angleze, njofton lexuesit, ata shqiptarë dhe ata të gjuhës angleze me shtyllat e besimit islam, veprimet e besimit, barazinë dhe vëllazërimin në islamizëm, diturinë në islamizëm, lutjet në islamizëm etj., me ç'rast paraqesin bazën e islamizmit në përgjithësi. Dhe ky vëllim (i pesti) mbyllet me librin *"Kujtime të rinisë"*, ku autori-studiuesi flet mbi myslimanët në Jugosllavi, Greqi, Rumani, Bullgari, Turqi, Hungari, Francë, Angli, Poloni, Holandë,

Japoni etj. Lidhur me këto shkrime, autori Imam Vehbi Ismaili jep këtë sqarim: "Kur u shkruan këta artikuj, në vendet ku kishte pakica myslimane kishte numër të vogël myslimanësh, me përjashtim të ish-Jugosllavisë që me boshnjakët dhe shqiptarët arrinin atëherë afro katër milionë, por ç'prej atëherë e deri më sot kanë kaluar afro 60 vjet, dhe numri i myslimanëve qoftë nga emigrantët, qoftë nga ata që kanë përfaqësuar fenë islame në Europë, është shtuar shumë, qoftë në Gjermani, Francë, Angli dhe Zvicër dhe shumë vende tjera". Duke shkruar për myslimanët në çdo shtet të lartpërmendur, autori jep pasqyrën e vërtetë të shtrirjes së këtij komuniteti në Evropë dhe më gjerë. Këto të dhëna janë bindëse dhe fakte të pamohueshme, që flet për shtrirjen e këtij komuniteti.

Këta ishin pesë librat e studimeve, të cilët Imam Vehbi Ismaili i botoi në gjuhën shqipe dhe atë angleze, e që gjetën vend në vëllimin e pestë të veprës së plotë të tij, duke shpalosur në këtë mënyrë horizontet e gjera të diturisë së tij rreth interpretimit në mënyrë studioze të çështjes së islamit në përgjithësi, kësaj doktrine që sot preokupon njerëzit në mbarë rruzullin tokësor, pa dallim feje e race, e që padyshim, autorit i siguron një vend të merituar në këtë fushë të krijimtarisë shkencore.

Studime mbi sjelljet dhe kremtet

Libri i gjashtë me 610 faqe përmban në gjiun e vet dy libra të Imam Vehbi Ismailit: *"150 Hadithe"* - fjalë të Profetit Muhamed (1993) dhe *"Predikimet e Xhumasë dhe Bajramëve"* (1999). Kur jemi te libri i parë *"150 Hadithe"*, atëherë për lexuesit duhet sqaruar se *Hadith* në gjuhën arabe do të thotë: fjalë, kumtim, lajmërim. Andaj, këto 150 hadithe janë përzgjedhur si mendimet më të arta të profetit Muhamed. Këto janë fjalët, mendimet, veprimet, shpjegimet, porositë e profetit, të cilat për myslimanët paraqesin udhërrëfimet si duhet jetuar, vepruar e krijuar në jetën e përditshme, në shoqëri, në bashkësinë islame, në luftë, në paqe, në shkencë, në teologji, në drejtësi etj. Nisur nga këto, Imam Vehbi Ismaili që në fillim shkruan: "Njeriut i është dhuruar fuqia e mendimit, fuqia për të mësuar, ditur e për të dalluar të mirën nga e keqja dhe të drejtën nga e shtrembëta; përgjithësisht njeriut i është dhuruar prirja të anojë nga e mira dhe të largohet nga e liga. Me gjithë këte, Zoti nuk e la njeriun të endet duke u mbështetur vetëm në intelegjencën e tij, e cila nga një herë mund të zgjedhë të keqen në vend të së mirës pse mund të duket sikur është për të mirën e interesin e tij personal. Dy persona mund të bien shumë lehtë në kundërshtim në përcaktimin e të

drejtës dhe të shtrembërës po të kenë interesa të përkundërta personale. Prandaj, Zoti me mëshirën e Tij dërgoi mesazhe hyjnore me anë të disa njerëzve të tij të zgjedhur, profetë, për t'i treguar njerëzisë udhën e drejtë dhe të mirë. Këto kumtime ose zbulime u janë dërguar popujve dhe kombeve të ndryshme kohë pas kohe për t'u treguar atyre çka ishte e mirë për të gjithë". Kështu, rregullat, mënyra e kumtimit dhe veprimit të këtyre që u thanë më lart u bënë objekt shqyrtimi, studimi dhe interpretimi i Imam Vehbi Ismailit në zbërthimin e këtyre 150 haditheve në 220 faqe libri. Edhe ky libër hyn në gjerdanin e shkrimeve përkatësisht studimeve që i bëri gjatë tërë jetës së tij.

Ndërsa libri i dytë *"Predikimet e xhumasë dhe Bajrameve"* paraqet një studim të mirëfilltë të shtrirë në 52 kapituj që Imam Vehbi Ismaili ua bën këtyre ditëve të shenjta, siç është e Xhumaja dhe kremtat e dy bajrameve (Bajrami i Madh dhe Kurban Bajrami), ditë këto të shënuara ndër myslimanë si të shenjta. Se cili është qëllimi i këtij studimi dhe rëndësia e ditëve të shenjta, siç është e Xhumaja dhe kremtet e bajrameve, po japim një mendim të shkëputur nga Imam Vehbi Ismaili, ku thotë: "Duke qenë se predikimi i xhumasë është mësim dhe edukatë për shumicën e gjendjes duhet që predikuesi të ketë dituri të mjaft mbi Kur'anin dhe Hadithin (fjalët e profetit) si dhe historinë Islame, për më tepër ai duhet të lexojë, përveç libra besimi dhe ato të atheistave që kështu t'i njohë mendimet e tyre dhe të përgatitet për t'u dhënë përgjegje; sikur duhet të lexojë filozofi, sociologji e psikologji dhe mbi rrymat mendore të kohës së tij, që të jetë i edukuar dhe të jetë në gjendje të diskutojë mbi këto subjekte. Varfëria kulturore e predikuesit është më e dëmshme se varfëria e gjakut në një të sëmurë ose të dobët fizik. Është vënë re se shumë predikues kanë dështuar nga kjo varfëri". Megjithatë, objekt studimi në këtë vepër janë edhe besimi, pendimi, mbrojtja e lirisë, e atdheut, besnikëria, sinqeriteti, fjala e mirë, bujaria, durimi, krenaria, mëshira, puna, liria fetare, paqja etj., që rrumbullakojnë detyrimin e çdo krijese njerëzore ndaj besimit të tij, në këtë rast, të Islamit.

Këtu mbyllet kapitulli i krijimtarisë letrare dhe shkencore e këtij eruditi të islamit, me theks të veçantë të Islamit ndër shqiptarë, duke përmbyllur veprën e tij të plotë origjinale në gjashtë vëllime-libra.

Përkthyes i pasionuar vlerash të dëshmuara

Imam Vehbi Ismaili një pjesë të mirë të jetës së tij të gjatë krijuese, përveç krijimtarisë origjinale si tregimtar, novelist, dramaturg e mbi të

gjitha si studiues i problemeve dhe çështjeve të Islamit, që në këtë komplet librash u vendosën në gjashtë vëllime, ua kushtoi edhe vlerave të dëshmuara të letërsisë arabe, të cilat i zgjodhi me shije dhe i përktheu në gjuhën shqipe me përkushtim e dashuri. Kështu, para lexuesve shqiptarë solli vlera të dëshmuara si një përkthyes i pasionuar. Në këtë komplet veprash, dy librat e fundit me 1304 faqe gjetën vend përkthimet brilante, e këto janë tetë vepra të botuara më parë si libra të veçantë: tregime, novela, drama, studime etj., nga autorë të njohur dhe dëshmuar arabë, krijimtaria e të cilëve është e mbështetur kryesisht në çështjet islame me taban Kur'anin e Shenjtë. Ky segment krijimtarie paraqet vazhdimësinë e veprës origjinale të Imam Vehbi Ismailit, ku problemet të cilat i merr në shqyrtim apo më mirë të themi që e frymëzojnë, janë të njëjta, nga një burim me ato që i përktheu në gjuhën shqipe. Pra, veprat e përkthyera në gjuhën shqipe të cilat u vendosën në dy vëllimet e fundit (shtatë dhe tetë) janë nga autorë të njohur arabë, si *Libri i shtatë*: Teufik El-Hakim: *"Muhamedi - profeti njeri"* 1987 (dramë në pesë akte); Abdet-Tev-Vab Jusuf: *"Muhamedi"* 1987 (njëzet tregime); Prof. Muhammed Muteveli Sha'ravi: *"Mrekullia e madhe"* 1990 (studim); *Libri i tetë:* Seyyid Abul Al'a Maududi: *"Feja islame"* 1993 (studim); Muharrem Murad: *"Zoti është me ne"* 1995 (tregime nga historia islame); Habib Xhamati: *"Nga skajet e historisë"* 1986 (tregime); Taufik Al Hakim: *"Banorët e shpellës"* 1967 (dramë); Abdel Hamid Xhudeh Es-Sah-Har: *"Ebu Dherr el Gaf-Fari"* 1986 (studim biografik).

Meqë në këtë paraqitje me rastin e botimit të veprës së plotë në tetë vëllime-libra të Imam Vehbi Ismailit, këtu më poshtë do të përpiqemi që lexuesit t'i njoftojmë së paku me nga tri-katër fjali për secilën vepër të lartpërmendur.

Dramaturgu i njohur egjiptian i shekullit njëzet Teufik Al Hakim, autor i mbi 100 veprave letrare: tregime, novela, romane, drama, ditarë, shqyrtime letrare e filozofike, vjen në gjuhën shqipe me dy vepra dramaturgjike: *"Muhamedi - profeti njeri"* dhe *"Banorët e shpellës"*. Nëse në dramën *"Muhamedi - profeti njeri"* shkrimtari Teufik Al Hakim u mor me jetën e profetit Muhamed, pra me autorin e historisë së Haditheve duke ua paraqitur lexuesve këtë figurë sikur të kishte ndodhur në kohën e tyre, me dramën e dytë *"Banorët e shpellës"* (1933) u bë shkrimtar i njohur jo vetëm në Egjipt, por edhe jashtë tij. Drama "Banorët e shpellës" është një vepër që motivet e saj burojnë pikërisht nga Kur'ani, nëpërmjet të cilës mësohet se jeta nuk është diçka abstrakte, por diçka e za-

konshme që e lidh njeriun me rrethin shoqëror, ku jeton.

Imam Vehbi Ismaili në gjuhën shqipe përktheu nga gjuha arabe edhe tri përmbledhje me tregime, natyrisht nga autorë të ndyshëm arabë, si: Abdet-Tev-Vab Jusuf: *“Muhamedi”* 1987, Muharrem Murad: *“Zoti është me ne”* 1995, dhe Habib Xhamati: *“Nga skajet e historisë”* 1986. Në librin *“Muhamedi”* të autorit Abdet-Tev-Vab Jusuf paraqitet jeta e profetit Muhamed në njëzet tregime duke rrëfyer për kafshët, bimët, sendet siç janë: libri, elefanti, guri, deveja, rrushi, gjarpri, pëllumbi, kali, mali, shkëmbi, delja, pema, monedha, flamuri etj., gjithnjë i frymëzuar nga libri i shenjtë Kur’ani. Ndërsa libri i dytë me autor Muharrem Murad *“Zoti është me ne”* përbëhet kryesisht me tregime nga historia islame. Ky cikël librash me tregime mbyllet me autorin Habib Xhamati dhe librin *“Nga skajet e historisë”*. Autori i këtyre tregimeve frymëzimet e tija i mbështet gjithmonë në dorëshkrimet e lashta të zbuluara në Lindje dhe në Perëndim. Pikërisht kjo bëri që të bëhej ndër shkrimtarët e njohur në Egjipt. Tregimet: *“Marija katolike”*, *“Pallati i dëshmorëve”*, *”Mbreti dhe foshnja”*, *“Qyteti i gjakut”*, *“Flija e nderit”*, *“E vrau me dorë të vet”*, *“Dashnorja e armikut”*, *“Shpërblimi i së mirës”*, *“Vajza luftarake”*, *“Fatimeja”*, *“Gjella e helmueme”*, *“Sinqeriteti i Nilit”*, *“Miqësie e vjetër”*, *“Bukuria vrasëse”*, *“Flij e dashurisë”*, *“E çmendura”*, *“Dashuria e piktorit”* etj. e bëjnë këtë autor ndër më të shquarit jo vetëm në Egjipt, por në mbarë letërsinë arabe. Natyrisht, një meritë të madhe e gëzon edhe Imam Vehbi Ismaili që këto tregime, këta autorë, i zgjodhi, i përktheu në gjuhën shqipe, duke njoftuar kështu botën shqiptare me krijimet e më të shquarëve nga letërsia arabe. Këtë mision Imam Vehbi Ismaili e kreu me përkushtim të madh, që do të thotë se mbetet në historinë e përkthyesve të shquar nga gjuha arabe në gjuhën shqipe.

Kapitullin e fundit të përkthimeve Imam Vehbi Ismaili e mbyll me tre libra të tjerë, këtë radhe me tre libra studimesh nga autorët arabë, si: Muhammed Muteveli Sha’ravi: *“Mrekullia e madhe”*, Seyyid Abul Al’a Maududi: *“Feja islame”* dhe Abdel Hamid Xhudeh Es-Sah-Har: *“Ebu Dherr el Gaf-Fari”*. Libri i parë i Muhamed Muteveli Sha’ravit *“Mrekullia e madhe”* është një studim i shkëlqyeshëm që lexuesve u afron mundësi ta besojnë këtë mrekulli. Këtu në mënyrë të qartë jepet fryti i punës së shkencëtarëve, të cilët me shpikjet e tyre arritën edhe të zbresin në hënë. Por, Zoti i këtyre shkencëtarëve, gjithnjë duke u mbështetur në përmbajtjen e librit të shenjtë, Kur’anit, vallë, athua nuk ka fuqi që ta bënte Burakun një mjet fluturues. Pikërisht këtu qëndron edhe madhështia e Zotit, i cili nëpërmjet profetit të vet Muhamedit, bëri edhe mrekulli të papara. Kurse libri i dytë, studimi *“Feja islame”* e Seyyid Abul Al’a Maududit, autor i famshëm i shekullit njëzet me më shumë se 65 vepra të ndryshme mbi fenë islame, nëpërmjet të këtij libër-studimi ka përmbledhur në mënyrë të shkëlqyeshme gjithë çka duhet të dijë myslimani mbi fenë e tij. Për këtë arsye ky libër, përveç gjuhës shqipe, është përkthyer edhe në gjuhët angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle, japoneze etj. Ky cikël prej tre librave-studimeve përmbyllet me librin e Abdel Hamid Xhudeh Es-Sah-Har me titull *“Ebu Dherr el Gaf-Fari”*. Ky studim filozofik i shkruar në 21 kapituj në formë romani flet mbi Ebu Dherr El-Gaf-Farin dhe jetën e tij. Këtu, sipas fjalëve të profetit Muhamed, duke portretizuar këtë person, thotë: “Nuk ka bajtun toka dhe nuk i kanë ba hije pemët ndonjë njeriu ma të drejtë në fjalë se Ebu Dherri”, që flet për miqësinë e shokut të tij, të cilin e çmonte shumë. Madje, sipas Imam Vehbi Ismailit, “ky libër mund të quhet më tepër një portret i Ebu Dherrit sesa historia e tij, autori është munduar të paraqesë karakteristikat e këtij shoku të profetit që të mund të merret shembëll nga ata që duan të kenë përpara një figurë të qartë të një personi të edukuar në shkollën e profetit”.

Dy fjalë në vend të përfundimit

Imam Vehbi Ismaili (1919-2008) plot 59 vjet punoi në SHBA, në shërbim të fesë islame. Gjatë kësaj periudhe shkroi tregime me përmbajtje fetare, biografi profetësh e sidomos të Muhamedit, shkrime nga filozofia islame, stdudime nga historia e islamit, gjithnjë duke shfrytëzuar amën e tij të pashterrshme, Islamin si filozofi dhe doktrinë, përkatësisht Kur’anin, i cili i priu në jetë si diell rrezeart, në punë, në krijimtari deri në frymën e fundit. Veprat e shumta që la trashëgim Imam Vehbi Ismaili u shkruan dhe u botuan në gazeta dhe revista në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Madje, shumë libra të këtij eruditi u botuan në gjuhën angleze në SHBA dhe në Angli. Natyrisht, vepra e tij paraqet një shembëll të shkëlqyer të veprimtarisë së tij në dobi të formimit shpirtëror e kombëtar në çdo vend ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët. Pikërisht kjo ishte vepra e tij letrare e shkencore e përshkuar nga fryma dhe teoritë filozofike islame që i dhanë epitetin erudit i kombit, vlerësim ky që rrallëkush e meriton. Këtë epitet Imam Vehbi Ismaili e meritoi në saje të veprës së tij të shkëlqyeshme vlerësuar nga opinioni krijues intelektual e shkencor shqiptar e ndërkombëtar që udhëhiqen nga doktrina islame.

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
Fenomeni i quajtur Tarik Ramadan 5

Dr. sc. Nehat Krasniqi
**Bibliotekat e Periudhës Osmane në trojet shqiptare
në dritën e dorëshkrimeve arabike 13**

Enes Kariq
Komentimi i Kur’anit dhe ideologjitë e shekullit njëzet.............. 35

Mr. Ejup haziri
Veçoritë kryesore të legjislacionit islam.. 67

Akademik Enes Kariq
Al-Muqaddima vepra kryesore e Ibn Haldūnit............................ 95

Ramadan Shkodra
Myderriz Hasan efendi Nahi - Arsimdashës e patriot i shquar . 111

Akademik Feti mehdiu
Reflekse kur’anore në poezinë e Mehmet Akifit 121

Ibrahim Bajjumi Madhkour
Studimi i filozofisë islame 131

Dr. Naceur jabnoun
Islami dhe menaxhmenti - (7)... 153

Mr.Qemajl Morina
**Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas revistës “Al-Xhinan”
të Bejrutit 1878-1881.. 175**

Dr. Abdul Hadi Misbah
A është zemra vend i dashurisë, urrejtjes dhe devotshmërisë? . 183

Gentian Jetishi
Aftësi të mësimdhënies të lëndës së fesë 189

Akademik Feti Mehdiu
Mësimet mbi fenë në institucionet publike të arsimit 201

**Leximi i Kur'anit te varri gjatë
dhe pas varrimit të të vdekurit.. 209**

Dr. Abdurrahman rafet el-basha
Othman Ibnu Affan... 219

Mexhid Yvejsi
**Poeti i poetëve apo në poezi mbreti i mbretërve
Hafiz Shirazi 1320-1389 .... 233**

Shahbaze Vishaj
Imam Vehbi Ismaili - erudit i kohës sonë 245

Përmbajtja 261